

NGA EKSPERIENCA E PËRBASHKËT FITOJNË TË GJITHË

60 + INTOSAI  
50 +

SEKRETARIATI I PËRGJITHSHËM

Transparencë Përgjegjësi Qeverisje e Mirë

Në shërbim të qytetarëve

**60**<sub>VJET</sub>  
**INTOSAI,**

**50**<sub>VJET</sub>  
**SEKRETARIATI I PËRGJITHSHËM**

Seria: Botime KLSH - 09/2014/30

Tiranë 2014

Titulli në origjinal:

## **60 vjet INTOSAI, 50 vjet Sekretariati i Përgjithshëm**

**Përkthimi u realizua nga audituesit e KLSH-së:**

Adela Sollaku, Albana Gjinopulli, Alkida Llakaj, Amantia Patozi, Dalina Demi,  
Erjola Meçaj, Ermira Vojka, Ina Sokoli, Marvin Karalli, Redina Karapici, Xhuljeta Çelaj.

**Redaktore:** Albana Gjinopulli; Xhuljeta Çelaj

**Përgatitja dhe botimi u realizuan nën drejtimin e:**

Bujar Leskaj, Irena Islami

**Art Design:** Kozma Kondakçiu

**Seria:** Botime KLSH - 09/2014/30

**ISBN :** 978-9928-159-26-7

Tiranë 2014



## Parathënie

I nderuar lexues,

Organizata e institucioneve supreme të auditimit, INTOSAI është struktura e dytë ndërkombëtare më e madhe, pas Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), me 192 SAI (Institucione Supreme të Auditimit) anëtare dhe 5 SAI të asociuara. Që nga themelimi në vitin 1953, në zbatim të motos së saj “Experientia Mutua Omnibus Prodest” (Nga Eksperienca e përbashkët, përfitojnë të gjithë), INTOSAI ka shkëmbyer dije dhe ka nxitur bashkëpunimin me SAI-ve anëtare, duke iu përmbajtur vlerave themelore të institucioneve të auditimit më të lartë publik, si, pavarësia, integriteti, profesionalizmi, besueshmëria, përfshirja, bashkëpunimi dhe inovacioni.

INTOSAI është ndërtuar dhe funksionon si një organizatë e përhershme profesionale, autonome, e pavarur dhe jopolitike e institucioneve supreme të auditimit dhe i përfaqëson ato në raportet me OKB, me organizatat e tjera ndërkombëtare dhe me donatorët ndërkombëtarë. Ajo ka marrëveshje me 22 institucione donatore dhe përgatit e lançon programe e thirrje për projekte zhvillimi dhe ndërtimi kapacitetesh për të gjitha SAI-t kudo në botë.

E organizuar për të funksionuar si në nivel botëror ashtu dhe rajonal, INTOSAI ka gjashtë struktura rajonale, ndër të cilat nga më kryesoret është EUROSAL, organizata evropiane e institucioneve supreme të auditimit. INTOSAI e bazon aktivitetin e saj të përditshëm tek Sekretariati i Përgjithshëm, me seli në Vjenë, nga viti 1963 dhe i merr vendimet kryesore, nëpërmjet Kongresit të saj, të quajtur INCOSAI, i cili mbledhet çdo tre vjet.

Në këto 61 vite ekzistence, INTOSAI ka organizuar 21 kongrese dhe me qindra forume, simpoziume të përbashkëta me OKB-në, workshope, seminare dhe aktivitete të tjera rajonale e planetare, që lidhen me ndërtimin dhe zhvillimin e kapaciteteve audituese, si dhe ka pasur arritje të shumta përsa i përket pavarësisë, rritjes së kompetencave, efijencës dhe qëndrueshmërisë së SALve.

Që nga viti 1992, organizata ka përgatitur dhe publikuar një gamë të gjerë standardesh, udhëzuesish dhe praktikash më të mira, të quajtura ISSAI, të cilat i kanë ndihmuar dhe i ndihmojnë në praktike SAI-t në të gjithë botën, për të rritur pavarësinë, forcuar identitetin dhe shtuar kapacitetet e tyre profesionale.

Ndër dokumentet themelore të INTOSAI-t janë Deklarata e Limës e vitit 1977, e quajtur ndryshe Magna Carta ose Kushtetuta e institucioneve supreme të auditimit dhe Deklarata e Meksikos e vitit 2007 për forcimin e pavarësisë së SAI-ve.

Që nga viti 2004, INTOSAI ka përgatitur dhe implementuar dy plane strategjike zhvillimi 2005-2010 dhe 2011-2016, duke përcaktuar qëllime strategjike, vlera dhe prioritete, si dhe duke fituar besimin dhe vlerësimin e SALve, për sa i përket çështjeve të planifikimit strategjik, diversifikimit të strukturës organizative dhe rritjes së kapaciteteve audituese nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave më të mira.

INTOSAI ka rritur njohjen ndërkombëtare nëpërmjet Rezolutës A/ 66/209 të datës 22 dhjetor 2011 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Në këtë rezolutë, Asambleja vlerësoi punën e bërë nga INTOSAI në promovimin më të madh të efikasitetit, përgjegjshmërisë, efektivitetit, transparencës dhe përdorimin e burimeve publike me efikasitet dhe efektivitet për të mirën e qytetarëve, njohu parimet e pavarësisë të përcaktuara në deklaratat e



Limës dhe Meksikos, si dhe inkurajoi shtetet anëtare dhe parlamentet e tyre që të zbatojnë parimet e përmbajtura në këto Deklarata, në përputhje me strukturën kombëtare institucionale.

Në fushën e menaxhimit publik, kjo organizatë po tërheq gjithnjë e më tepër vëmendjen e grupeve të shumta të interesit, në radhë të parë të institucioneve ndërkombëtare si OKB, FMN, Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim e Zhvillim, etj, duke u kthyer në një organizëm “standard-bërës” shumë i nevojshëm dhe një lojtar shumë i rëndësishëm në përmirësimin e qeverisjes kombëtare dhe rregullave të auditimit ndërkombëtar.

Në zbatim të Planit Strategjik të Zhvillimit 2011-2016, INTOSAI po promovon përmirësime të vazhdueshme mes anëtarëve të saj, duke inkurajuar bashkëpunimin intensiv mes tyre (Objektivi 3), si dhe duke studiuar fusha dhe metodologji të reja auditimi, përmes strukturës së saj shumë të rëndësishme, Institutit të Zhvillimit (IDI).

Me krizën mbarë botërore financiare dhe ekonomike, SAI-t dhe vetë INTOSAI po përballen me kërkesa në rritje të grupeve të interesit dhe me çështje të reja auditimi, që kërkojnë që metodologjitë audituese të ndryshojnë me shpejtësi. Çështje të tilla si zhvillimi i qëndrueshëm i financave publike, qeverisja kombëtare, siguria kombëtare, pjesëmarrja qytetare, evoluimi i politikave, rregulloret e sistemit financiar, si dhe auditimi investigativ janë kthyer në sfidat dhe objektivat më të reja për SAI-t dhe organizatën e tyre.

Përmes përgatitjes së standardeve profesionale, ngritjes së kapaciteteve institucionale dhe shkëmbimit intensiv të njohurive, INTOSAI, krahas garancisë së rritjes së pavarësisë së SAI-ve anëtare, ka ofruar dhe po ofron një kontribut jetik për promovimin e qeverisjes së mirë, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies dhe luftimin e korrupsionit, duke kontribuar në shërbime më të mira ndaj qytetarëve dhe forcimin e besimit të publikut në qeverisjen publike.

KLSH është anëtare e INTOSAI-t nga viti 1984 dhe mbas vitit 1992, ka marrë pjesë në të gjitha aktivitetet kryesore të organizatës, duke u kthyer në anëtar aktiv i strukturës së saj rajonale, EUROSAI-t. Ky aktivitet ka ardhur në rritje gjatë tri viteve të fundit, ku KLSH është përfaqësuar në grupet e punës të EUROSAI-t, duke dhënë kontributin e tij modest.

Gjatë periudhës 2012-2014, në përputhje me objektivat themelore të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH 2013-2017, aktiviteti auditues i institucionit ka synuar zbatimin e plotë të standardeve profesionale të INTOSAI-t, si nëpërmjet trajnimeve intensive brenda dhe jashtë vendit, me ekspertë të njohur të huaj e vendas, ashtu dhe me botimin e 30 librave për auditimin suprem, duke përshtatur në shqip përmbledhje të ISSAI-ve kryesore, duke përkthyer dhe përshtatur udhëzues për auditimin e performancës, shënimet praktike të auditimit financiar, standardet ISSAI për auditimin e borxhit publik, standardet ISSAI për auditimin mjedisor, etj.

Krahas këtyre botimeve profesionale, KLSH ka botuar në kolanën e tij librin “EUROSAI”, që prezanton Organizatën Evropiane të Institucioneve më të Larta të Auditimit, duke dhënë profile për secilin nga 50 SAI-t evropiane, si dhe librin “Historiku i Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ku evidentohen fillesat e Institucionit Suprem të Auditimit në Shqipëri nga viti 1925, si dhe format që ai ka marrë në rrjedha të ndryshme të historisë së shtetit shqiptar, duke vlerësuar të gjithë ata që ndihmuan në formësimin e institucionit si një institucion bazë i shtetit shqiptar.



Rëndësia e librit “50 Vjet Sekretariat i Përgjithshëm dhe 60 Vjet INTOSAI” është e jashtëzakonshme për të gjitha SAI-t në botë, për të dokumentuar kujtesën historike të organizatës së tyre, përpjekjet për formimin, zhvillimin dhe rritjen e imazhit të saj, për prodhimin e standardeve të pranuar ndërkombëtarisht dhe përpjekjet për forcimin e pavarësisë dhe identitetit të SAI-ve në shoqëritë dhe qeverisjet publike ku kontribuojnë.

Në mënyrë të veçantë, përkthimi në shqip i këtij libri ka rëndësi për audituesit e KLSH, por edhe për të gjithë audituesit publikë të vendit, për të kuptuar domethënien dhe peshën e organizatës mbarëbotërore INTOSAI, për të cilën Asamblea e Kombeve të Bashkuara ka miratuar Rezolutën A/ 66/209 më datë 22 dhjetor 2011, ku theksohet se “ Shtetet anëtare të OKB me kënaqësi i kushtojnë vëmendje të veçantë: a) Punës së INTOSAI-it në promovimin sa më të madh të efikasitetit, llogaridhënies, efektivitetit, dhe transparencës dhe në pranimin dhe përdorimin efikas dhe efektiv të burimeve publike në të mirë të qytetarëve; dhe b) Deklaratave të Lima-s dhe Meksikos”.

KLSH falënderon Sekretariatit e Përgjithshëm të INTOSAI-t, në veçanti Sekretarin e Përgjithshëm dhe Presidentin e Gjykatës Austriake të Auditimit, Dr. Josef Moser, për dhënien e lejes për botimin e këtij libri në shqip.

**Dr. Bujar Leskaj**





<b>Përmbajtja e Lëndës</b>	<b>Faqe</b>
<b>Hyrje</b>	<b>3</b>
Heinz Fischer, Presidenti Federal i Republikës së Austrisë	3
<b>Parathënie</b>	<b>6</b>
Josef Moser, SAI i Austrisë (Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t)	6
Liu Jiayi, SAI i Kinës (Kryetar i INTOSAI-t 2013 - 2016)	13
Terence Nombembe, SAI i Afrikës së Jugut (Kryetar i INTOSAI-t 2010-2013)	17
<b>INTOSAI E SHKUARA- E TASHMJA-E ARDHMJA</b>	<b>21</b>
Një vështrim i shkurtër historik i INTOSAI-t	23
INTOSAI sot – Nga eksperiencia e përbashkët, përfitojnë të gjithë	33
Tetë shtyllat e pavarësisë	40
Rezoluta e OKB-së	43
Një vështrim i INTOSAI-t	45
Rruga e zhvillimit dhe vizioni për INTOSAI-n – Drejt së ardhmes së INTOSAI-t	47
<b>Kontribute nga Anëtarët e INTOSAI-t</b>	<b>55</b>
SAI i Algjerisë	57
SAI i Australisë	61
SAI i Azerbajxhanit	65
SAI i Bahrainit	69
SAI i Bangladeshit	75
SAI i Bullgarisë	81
SAI i Kanadasë	85





SAI i Kilit	89
SAI i Kinës	95
SAI i Kolumbisë	105
SAI i Kubës	109
SAI i Qipros	115
SAI i Danimarkës	121
SAI i Ekuadorit	129
SAI i Estonisë	133
Gjykata Evropiane e Audituesve	139
SAI i Gjermanisë	145
SAI i Hondurasit	151
SAI i Hungarisë	155
SAI i Indisë	161
Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t (IDI)	169
SAI i Irakut	177
SAI i Japonisë	183
SAI i Koresë	191
SAI i Kuvajtit	197
SAI i Latvisë	203
SAI i Lihteinshteinit	209
SAI i Lituaniës	213
SAI i Maltës	221
SAI i Meksikës	229
SAI i Moldovës	237



SAI i Monakos	243
SAI i Marokut	247
SAI i Holandës	253
SAI i Zelandës së Re	259
SAI i Paragwait	265
SAI i Polonisë	271
SAI i Portugalisë	277
SAI i Arabisë Saudite	283
SAI i Sllovakisë	291
SAI i Afrikës së Jugut	297
SAI i Spanjës	303
SAI i Suedisë	311
SAI i Zvicrës	319
SAI i Ukrainës	325
SAI i Emirateve të Bashkuara Arabe	333
SAI i Mbretërisë së Bashkuar	339
SAI i Shteteve të Bashkuara të Amerikës	345
SAI i Jemenit	353
<b>INTOSAI NË TË DHËNA DHE FAKTE</b>	359
Një vështrim i INTOSAI-t	359
Kryetari i INTOSAI-t	361
Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t	367
Anëtarët e INTOSAI-t	369
INCOSAI 1953 – 2013	391



Takimet e Bordit Drejtues të INTOSAI-t 1966-2013	411
Grupet Rajonale të Punës INTOSAI	421
Çarti organizativ i INTOSAI-t 2013	443
Komitetet, Nën komitetet, Grupet e Punës, Task Forcat, Grupet e Projekteve dhe Institucione të tjera të INTOSAI-t nga 1971 - 2013	447
Seminare dhe Simpoziume OKB/INTOSAI 1971-2013	467
KLSH në Kongreset e INTOSAI-t (INCOSAI) 1992-2013	487
<b>TIMELINE</b>	501
INTOSAI timeline	501



## Parathënie

- nga Presidenti Federal i Republikës së Austrisë, Heinz Fischer

## 60 vjetori i INTOSAI-t

### 50-vjetori i Sekretariatit të Përgjithshëm në Vjenë

- Parathënie nga Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI-t, Josef Moser

## 2013 - Një Fillim i ri për Anëtarët INTOSAI-t

- Parathënie nga Kryetari i INTOSAI-t 2013-2016, Liu Jiayi

## INTOSAI - Të bëjmë ndryshim në jetën e qytetarëve

- Parathënie nga Kryetari i INTOSAI 2010-2013, Terence Nombembe





## Parathënie nga Presidenti Federal i Republikës së Austrisë, Heinz Fischer



Ishte viti 1953, kur Institucionet Supreme të Auditimit dhe organizatat partnere të 33 shteteve, u takuan në Kubë për kongresin e tyre të parë të organizuar nga INTOSAI - Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit – i cili deri në vitin 2013, përfshin 191 anëtarë të plotë dhe të 4 anëtarë të asociuar.

10 vjet më vonë, në vitin 1963, Gjykata austriake e Auditimit mori rolin e Sekretariatit të Përgjithshëm për herë të parë. Që prej asaj kohe, selia e sekretariatit i ka pasur zyrat në Vjenë.


Në vitin 2013 festuam 60 vjetorin e INTOSAI-t dhe 50 vjetët e Sekretariatit të Përgjithshëm në Vjenë.

Në përputhje me moton “Experientia Mutua Omnibus Prodest” (Nga Eksperiencia e përbashkët, përfitojnë të gjithë), INTOSAI dhe Sekretariati i Përgjithshëm - është një organizatë e përhershme profesionale, autonome, e pavarur dhe jopolitike e institucioneve të auditimit për shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara ose të agjencive të saj të specializuara, si dhe i përfaqëson ato si një organizatë ndërkombëtare e njohur mbështetëse.

Përmes përgatitjes së standardeve profesionale, ngritjes së kapaciteteve institucionale, si dhe ndarjes së njohurive, INTOSAI ofron një kontribut jetik për promovimin e qeverisjes së mirë, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies dhe luftimin e korrupsionit, në këtë mënyrë kontribuon në ruajtjen e besueshmërisë dhe forcimin e besimit të publikut në qeverisjen publike.

Njohja e INTOSAI-t është rritur në mënyrë të qëndrueshme në 60 vitet e fundit për shkak të aktiviteteve të ndryshme dhe Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së A/66/209 e datës 22 dhjetor 2011, sigurisht ka shënuar një hap tjetër të rëndësishëm. Në këtë rezolutë, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së vlerësoi punën e bërë nga INTOSAI në promovimin më të madh të efikasitetit, përgjegjshmërisë, efektivitetit, transparencës dhe përdorimin e burimeve publike me efikasitet dhe efektivitet për të mirën e qytetarëve. Në të njëjtën kohë, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, gjithashtu i njohu parimet e pavarësisë të përcaktuara në Deklaratat e Limës dhe Meksikos, si dhe inkurajoi shtetet anëtare të zbatojnë parimet e specifikuar në ato deklarata në përputhje me strukturën kombëtare institucionale.


Ky vlerësim i punës së INTOSAI-së, gjithashtu i atribuohet në një shkallë të konsiderueshme aktiviteteve të kryera në Sekretariatit të Përgjithshëm, me seli në Gjykatën Austriake të Auditimit. Si Presidenti Federal i Republikës së Austrisë, kjo gjë më bën veçanërisht krenar.





Do të doja të shpreh urimet e mia më të sinqerta për INTOSAI-n dhe Sekretariatën e tij të Përgjithshëm në këtë vit përvjetori, si dhe jam i bindur se ata do të ndjekin këtë rrugë të suksesshme, në interes të auditimit të jashtëm të qeverisë







## **60 vjetori i INTOSAI-t – 50-vjetori i Sekretariatit të Përgjithshëm në Vjenë**

### **Parathënie nga Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI-t, Josef Moser**




Në vitin 2013 Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) festoi 60 vjetorin, dhe Sekretariati i Përgjithshëm festoj 50 vjetorin e tij. Me rastin e kësaj ngjarjeje, është një nder i madh dhe kënaqësi për mua të paraqes panoramën e përpjekjeve aktuale të INTOSAI-t dhe të hedh dritë mbi sfidat dhe qëllimet e ardhshme.

Ky vit përvjetori, na jep mundësinë të shikojmë pas, të shikojmë historinë mbresëlënëse dhe të suksesshme të një organizate, e cila e ushtron veprimtarinë e saj në mbarë botën. Nga njëra anë, ajo vë në praktikë moton e saj Experientia Mutua Omnibus Prodest (Nga përvoja e përbashkët, përfitojnë të gjithë) dhe, nga ana tjetër, vepron në të njëjtin nivel të Kombeve të Bashkuara dhe partnerëve të tjerë ndërkombëtarë. Ky zhvillim ka ardhur si rezultat i përkushtimit dhe angazhimit aktiv të anëtarëve të INTOSAI-t, të cilët kanë luajtur një rol vendimtar në nxitjen dhe forcimin e organizatës në vendet e tyre.

Ka disa piketa që ilustrjnë historinë e suksesit të INTOSAI-t, si një platformë e pavarur ndërkombëtare, e cila shërben në shkëmbimin e njohurive dhe përvojave, si dhe vepron si një zë i Institucioneve Supreme të Auditimit në bashkësinë ndërkombëtare. Këto piketa përfshijnë zhvillimin e Planit Strategjik me katër qëllime strategjike, në bazë të të cilave bazohen të gjitha aktivitetet e komiteteve, grupeve të punës dhe Task Forcat, si dhe përgatitjen e Strategjisë së Komunikimit që shërben për të mbajtur një nivel të qëndrueshëm të informacionit dhe zhvillimit në komunitetin e INTOSAI-t, në frymën e barazisë gjithëpërfshirëse. INTOSAI është angazhuar për zbatimin aktiv dhe efektiv të prioritetëve strategjike dhe qëllimeve të komunikimit, të cilat janë themeluar për të rritur përgjegjshmërinë, transparencën dhe qeverisjen e mirë dhe për të ruajtur besueshmërinë e Institucioneve Supreme të Auditimit. Angazhim i qëndrueshëm, është pasqyruar në transferimin e njohurive dhe rritjen në këtë mënyrë të njohurive, shpërndarjen e informacioneve të orientuar drejt grupeve të përcaktuar, përgatitjen e udhëzuesve, krijimi i bazave të të dhënave dhe, përfundimisht, përcaktimi i standardeve të pranuar ndërkombëtarisht dhe direktivave që kontribuojnë në thelb të një krijimi të qëndrueshëm dhe të fortë, të pavarur, profesional dhe të besueshëm të një organizate model.

Në 60 vitet e fundit, INTOSAI ka arritur të veprojë si organizatë e pranuar globalisht për shkëmbimin e eksperiencës, ideve dhe praktikave më të mira për 191 anëtarët me gjuhë të ndryshme, kultura të ndryshme dhe pasurimin e përvojave. Kjo shumicë, si dhe këmbëngulja në trajtimin e barabartë, barazia dhe një niveli i qëndrueshëm i informacionit në të gjitha vendet, e shndërruan INTOSAI-n në një pionier në auditimin ndërkombëtar të qeverisë. Nëpërmjet identifikimit dhe shpërndarjes së temave qendrore të auditimit të qeverisë, të cilat marrin parasysh globalisht zhvillimet e rëndësishme dhe aktuale, INTOSAI ka shërbyer si





shtegshënuesi dhe forca shtytëse për risi që prej themelimit të tij. Ndërveprimi gjithëpërfshirës me organizatat e tjera partnere ndërkombëtare, si pjesë e këtyre aktiviteteve, bën që gjatë këtyre dekadave INTOSAI të krijojë një kuadër të institucionalizuar për bashkëpunim ndërmjet organeve të INTOSAI-t dhe organizatave partnere, duke krijuar qasje të reja që forcojnë vlerat themelore të sanksionuara në statutet e INTOSAI-t dhe që janë praktikuar në mënyrë aktive në organizatë. Kjo, në veçanti, ilustron në mënyrë të qartë nga nisma e suksesshme për të forcuar pavarësinë e SAI-ve, e cila u kurorëzua me miratimin e Rezolutës A/66/209 për Promovimin e Efikasitetit, Përgjegjshmërisë, Efektivitetit dhe Transparencës së Administratës Publike, duke fuqizuar Institucionet Supreme të Auditimit, nga Asambleja e 66-të e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, e cila shërben si një shembull i rëndësishëm për faktin se sa rezultate mund të arrihen nëse ata bashkëpunojnë me njëri-tjetrin. Me rëndësi po aq të madhe, në këtë kontekst janë edhe aktivitetet e shumta që vënë në dukje vlerën dhe përfitimet e SAI-ve, për të forcuar besimin e qytetarëve.


Sekretariati i Përgjithshëm si një ndërlidhës i INTOSAI-t, falenderohet sepse ka qenë në gjendje që t'i shërbejë qëllimeve dhe zhvillimit të mëtejshëm të organizatës dhe për t'i dhënë përmbajtje motos “Experientia Mutua Omnibus Prodest” në formën e një bashkëpunimi të frytshëm dhe një shkëmbimi të gjallë të përvojës mes Kongresit, Bordit Drejtues, Grupeve Rajonale të Punës, Komiteteve, Nën komiteteve, Grupeve të Punës dhe Task Forcave. Në këtë kontekst, është me rëndësi që Sekretariati i Përgjithshëm duhet t'iu përgjigjet nevojave dhe shqetësimeve të secilit anëtar, për të ruajtur dhe për të promovuar një rrjedhje të lirë dhe të plotë të informacionit dhe përvojës, si dhe për të shpërndarë njohuritë globale dhe know-how të fituar në përvojën praktike të auditimit. Fokusi mbi mënyrën praktike të punës të orientuar drejt anëtarëve, është diskutuar në temat e Kongresit të 21-të.

Gjithashtu për të ardhmen, Sekretariati i Përgjithshëm konsideron si detyrë kryesore të tij kontributin në progresin e vazhdueshëm të SAI-ve anëtare, për shembull duke organizuar dhe mbajtur simpoziume, si dhe duke mbështetur zbatimin e Planit Strategjik, e standardeve dhe udhëzimeve profesionale ndërkombëtare të auditimit. Ashtu si në 50 vitet e fundit, bashkëpunimi në bazë të besimit dhe partneritetit, tolerancës, paragjykimeve dhe konsensusit, duhet të jetë themeli.

Pjesëmarrja e madhe në këtë përvjetor dhe diversiteti i kontributeve nga shtetet e ndryshme anëtare, tregon se zhvillimi i INTOSAI-t nuk është i kufizuar në 60 vjetorin e tij. Në dritën e sfidave të sotme globale ekonomike, organizata ka vendosur qëllime ambicioze me Planin Strategjik dhe masat e ardhshme të zhvillimit, e cila na lejon të shohim drejt të ardhmes me besim.

Në këtë drejtim, do të doja të falënderoja të gjithë anëtarët dhe anëtarët e asociuar të INTOSAI-t, organizatat tona partnere të jashtme, IPU, OECD, IFAC, IBP dhe Kombet e Bashkuara, si dhe të gjithë anëtarët e organeve të INTOSAI-t dhe subjekteve për angazhimin e tyre të palodhur, angazhimin e tyre të përkushtuar dhe besimin e tyre në organizatë. Është kënaqësi për mua, që t'ju paraqesë një panoramë të përgjithshme të 60 viteve të fundit të INTOSAI-t dhe të aktiviteteve të 50 viteve të Sekretariatit të Përgjithshëm.


Do të doja të falënderoj të gjithë ata që kanë kontribuar në këtë publikim përvjetori. Do të doja të falënderoj Kryetarin e INTOSAI-t që po largohet dhe Audituesin e Përgjithshëm të Afrikës së Jugut, Terence Nombembe, për kryesimin e tij të suksesshëm të INTOSAI-t në tre vitet e fundit dhe për kontributin e tij të çmuar në këtë publikim.





Për më tepër, do të doja të shpreh falënderimet e mia të veçanta për Kryetarin e ardhshëm të INTOSAI-t dhe Audituesin e Përgjithshëm të Kinës, Liu Jiayi, i cili gjithashtu do ta drejtojë INTOSAI-n në një të ardhme të suksesshme në tre vitet e ardhshme. Shpreh mirënjohjen time për Institucionin Suprem të Auditimit të Kinës, për kontributin e madh për procesin e botimit. Pa angazhimin e tij, ky botim nuk do të kishte qenë i mundur me këtë cilësi.

Ju uroj lexim të këndshëm të këtij publikimi.





## 2013 - Një Fillim i ri për Anëtarët INTOSAI-t

### Parathënie nga Kryetari i INTOSAI-t 2013-2016, Liu Jiayi

Në datat 21-26 tetor, 2013, do të mbahet në Pekin, Kinë INCOSAI XXI. Kjo ngjarje e rëndësishme përkon me përvjetorin e 60 vjetorin e INTOSAI-t dhe 50 vjetorin e Sekretariatit të Përgjithshëm me seli në Vjenë, Austri.

Për të festuar këtë rast historikisht të veçantë, INTOSAI jo vetëm që do të mbajë një ceremoni festive për 60 vjetorin në INCOSAI XXI, për të rishikuar dhe përmbledhur procesin e saj të zhvillimit dhe të përshkruajë qëllimet e ardhshme të zhvillimit, por gjithashtu do të hartojë dhe do të nxjerrë një botim të veçantë, bazuar në kontributet e Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI), për të përkujtuar 60 vjetorin e INTOSAI-t dhe 50-vjetorin e Sekretariatit të Përgjithshëm të Austrisë, të organizuar nga Gjykata Austriake e Auditimit. Publikimi i veçantë do të paraqitet në ceremoninë festive për të gjithë pjesëmarrësit në asamblenë e përgjithshme.




Publikimi i veçantë do të jetë një retrospektivë e historisë së INTOSAI-t. Në një moment të tillë të veçantë, ne shikojmë prapa në evolucionin e INTOSAI-t nga 29 anëtarët themelues në 1953 në 191 anëtarë sot, duke qëndruar si organizata e dytë më e madhe ndërkombëtare në botë. Nga Havana deri në Johannesburg, në të gjitha kongreset, motoja e INTOSAI-t, “Nga eksperiencia e përbashkët, përfitojnë të gjithë”, është konsideruar si pikë nisje për idetë dhe udhëzuesit për auditimin kombëtar. Për më tepër, INTOSAI është i përkushtuar për të promovuar shkëmbimin dhe bashkëpunimin midis SAI-ve, duke treguar energji dhe pasion për risi. Me përpjekjet e përbashkëta të Sekretariatit të Përgjithshëm dhe anëtarëve të SAI-ve, parimet kryesore të përcaktuara në Deklaratat e Limës dhe Meksikës janë përfshirë në një rezolutë të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, duke treguar se roli i rëndësishëm i SAI-ve në promovimin e efikasitetit, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, ka qenë i njohur nga palët e interesuara në një shkallë më të gjerë.

Publikimi i veçantë do të jetë gjithashtu një parashikim i mënyrës se si INTOSAI do të merret me sfidat dhe do të kërkojë zhvillimin e përbashkët. Me vështrimin nga e ardhmja, në këtë moment historik, ne presim që në shekullin e 21-të, shoqëria njerëzore do të përjetojë rritje të globalizimit dhe integritet ekonomik, si dhe kontrolli kombëtar do të duhet të merret me sfidat e ndryshme të zhvillimeve të reja për të adresuar çështje si qeverisja kombëtare, qëndrueshmëria afatgjatë e politikave të financave dhe kështu me radhë. INTOSAI, gjithashtu nxit mundësi të reja historike në forcimin e kapaciteteve të SAI-ve, promovimin e bashkëpunimit dhe zhvillimit mes SAI-ve, si dhe pjesëmarrjen në qeverisjen globale. Në këtë pikë, SAI-t duhet që jo vetëm të përfitojnë nga njohuritë dhe arritjet e INTOSAI-t, por edhe të eksplorojnë potencialin e inovacionit dhe progresit të INTOSAI-t dhe SAI-ve anëtare, si dhe të përmbledhë përvojat dhe të planifikojë objektivat e ardhshme të INTOSAI-t që së bashku të krijojnë një të ardhme më të mirë.

10 vjet më parë, kur festohej 50 vjetori në Hungari, INTOSAI përgatiti një botim të veçantë, në të cilin proceset e








zhvillimit janë shqyrtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse nga pikëpamja e komiteteve të tij, grupeve të punës dhe nën komiteteve. Në 60-vjetorin e INTOSAI-t, shpresojmë që të fillojë me kontributet e SAI-ve, në mënyrë që të shihen veprimet që janë marrë për të nxitur zhvillimin e auditimit kombëtar dhe të kryejnë funksionet e tyre specifike në INTOSAI. Më e rëndësishmja, ne dëshirojmë të dëgjojmë çdo SAI në lidhje me shpresat dhe perspektivat për zhvillimin e ardhshëm të SAI-t të tyre dhe INTOSAI-t si organizatë.

INCOSAI i vitit 2013 do të nxjerrë në pah parimet e shkencave humane, të mjedisit, zhvillimit, komunikimit dhe bashkëpunimit, si dhe do të karakterizojë frymën e përfshirjes, harmoninë, risitë, efikasitetin, dhe ndryshimin. Me këtë rast, kur ne të shqyrtojmë dhe të përmbledhim historinë e INTOSAI-t, anëtarët do të nisin një udhëtim të ri të zhvillimit, i cili fillon në vitin 2013.





## INTOSAI - Të bëjmë ndryshim në jetën e qytetarëve

### Parathënie nga Kryetari i INTOSAI 2010-2013, Terence Nombembe

Në vitin 2003, INTOSAI publikoi një libër të veçantë për të kujtuar 50 vjetorin e INTOSAI-t, ku janë mbuluar piketat kryesore të organizatës. Është nder për mua të sjell reflektimet e mia mbi 60 vjetët e ekzistencës së kësaj organizate - veçanërisht 10 vitet e fundit - dhe se si Institucionet Supreme të Auditimit kanë bashkëpunuar për të bërë ndryshime në jetën e qytetarëve.




Që prej emërimit tim si Kryetar i Bordit Drejtues të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) në nëntor të vitit 2010, kam patur privilegjin të përjetoj në plan të parë vitalitetin dhe vendosmërinë e një organizate të drejtuar nga liderë që kanë fokus të qartë strategjik. Në nivel të bordit drejtues dhe atë rajonal është e qartë se INTOSAI ka bërë përparim të madh në realizimin e vizionit të tij, duke ndjekur qëllimet dhe prioritetet e tij strategjike. Gjatë 60 viteve të fundit, kjo dëshirë për përmirësim të vazhdueshëm përmes bashkëpunimit dhe shkëmbimit të njohurive, ka bërë të mundur që INTOSAI të rritet si organizatën plot jetë dhe me ndikimin që ka sot.

Më vijim, duke konsideruar si kulmore momente si Deklaratat e pavarësisë e Limës dhe Meksikës, të cilat na kanë ndryshuar rrënjësisht si Institucione Supreme të Auditimit (SAI), zhvillimet e rëndësishme në vazhdimësi pasurojnë punën e SAI-ve në nivel global, përfshijnë fillimin e Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI), duke ofruar në këtë mënyrë dëshmi për profesionalizimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e organizatës dhe anëtarëve të saj.

Miratimi i fundit nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e Rezolutës A/66/209 mbi pavarësinë SAI-ve, përfaqëson një gur themeli jetik në përpjekjet e përbashkëta të të gjithë SAI-ve për të forcuar pavarësinë e tyre. Kjo rezolutë, pranon faktin se SAI-t mund të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë objektive dhe efektive vetëm në qoftë se ata janë të pavarur nga subjekti i kontrolluar dhe janë të mbrojtur ndaj ndikimit e jashtme, kjo jo vetëm që i ka dhënë SAI-ve njohjen globale që meritojnë, por shërben edhe si një mjet i fuqishëm gjatë përpjekjeve të tyre për pavarësi.

INTOSAI ka arritur t'i drejtoj operacionet e saj në mënyrë më efikase dhe avantazhet e një qasjeje të fokusuar kanë qenë të dukshme. Gjashtë prioritetet strategjike që po mbështesin strategjinë e INTOSAI-t, fokusohen edhe më nga afër në ngritjen e kapaciteteve të SAI-ve, për t'u bërë institucione të forta dhe të pavarura profesionale, të aftë për të promovuar efikasitetin, përgjegjshmërinë, efektivitetin dhe transparencën e administratës publike.

Roli im si Kryetar, më ka ofruar mundësinë të promovoj dhe të përforcoj në mënyrë aktive rëndësinë e prioritetëve strategjike të INTOSAI-t. Mes prioritetëve strategjike, kuadri ISSAI përqendrohet në forcimin e kapaciteteve të SAI-ve në mënyrë intensive. Këto norma dhe standarde të klasit botëror mundësojnë një bazë të





besueshme profesionale, si dhe rezultatet e cilësisë së SAI-ve kontribuojnë në forcimin e qeverisjes dhe mbikëqyrjes. Kjo ka rëndësi të veçantë për zhvillimin e SAI-ve. Unë jam i bindur se puna e vazhdueshme në projekte harmonizimi, për të krijuar një grup të plotë dhe koherent të standardeve që do të kenë vlera universale për SAI-t, do të promovojë zbatimin e suksesshëm në pjesën më të madhe të tyre.

Angazhimi i INTOSAI-t për të arritur profesionalizimin, ka qenë një faktor i madh kontribuues në krijimin e Sekretariatit të Bashkëpunimi të Donatorëve të INTOSAI-t dhe Komitetin Drejtues të Donatorëve, si një zgjidhje e qëndrueshme për nevojën e ngritjes së kapaciteteve mes SAI-ve të zhvilluara. Kontributet bujare nga komuniteti i donatorëve, pavarësisht vështirësive financiare globale, janë dëshmi e rolit të vlefshëm që pritet të përmbushin SAI-t. Lidhja mes INTOSAI-t dhe komunitetit të donatorëve, është forcuar në mënyrë të konsiderueshme që në takimin e parë të Komitetit Drejtues të Donatorëve të INTOSAI-t, mbajtur në Marrakesh, Marok në vitin 2010. Takimi i katërt i Komitetit Drejtues të Donatorëve të INTOSAI-t, mbajtur në Jaipur në Indi në fund të shkurtit 2012, shërbeu për shpалosjen e bashkëpunimit të ngushtë mes SAI-ve dhe donatorëve. Shoqëruar me pjesëmarrjen në Forumin e 4-t të Nivelit të Lartë (FNL) mbi Efikasitetin e Ndihmës në Busan, në nëntor të vitit 2011, këto aktivitetet e fundit kanë bërë shumë për të forcuar njohjen e INTOSAI-t si një organizatë model. Kjo ishte hera e parë që INTOSAI pati mundësi të marrë pjesë në FNL, e cila u ndoq nga krerët e shtetit, ministra dhe mbi 2.000 përfaqësues nga publiku, shoqëria civile publike, sektori privat dhe organizatat ndërkombëtare në të gjithë globin. Ky takim, që synoi të bjerë dakord për një partneritet të ri global, për bashkëpunim efektiv të zhvillimit, ofroi një mundësi të paçmuar për të adresuar pjesëmarrësit mbi rëndësinë e SAI-ve të forta dhe të pavarura, për zhvillim të qëndrueshëm kombëtar dhe përdorim efektiv të burimeve publike.

Rezultatet nga ky takim treguan një interes të qartë në rritjen e përdorimit të partneritetit global, të ngjashëm me modelin e INTOSAI-t, si një mekanizëm për të promovuar një bashkëpunimi trekëndor. Kjo ishte një kohë e përshtatshme për të ndarë me komunitetin global shembullin e INTOSAI-t, si një organizatë model në kushtet e një partneritet gjithëpërfshirës të organizatave globale nga 190 vende me mbi 50 vjet përvojë. Sukseset tona në promovimin e shkëmbimit të njohurive, për mësimin e ndërsjelltë, bashkëpunimin, morën suport në vendosjen e standardeve globale dhe krijimin e ndikimit shoqëror dhe mbështetjen e ndërsjelltë për reforma.

Vlerë të madhe në krijimin e partneriteteve të forta globale brenda organizatës sonë, kanë Grupet Rajonale të Punës, të cilat kanë luajtur një rol të rëndësishëm në forcimin e INTOSAI-t, duke ofruar një platformë të arritshme për SAI-et e zhvilluara dhe ato në zhvillim, për të paraqitur pikëpamjet e tyre në përmirësimin e auditimit në sektorin publik. Nga shkëmbimi i vazhdueshëm i eksperiencave të historive të suksesit nga perspektivat e ndryshme rajonale, SAI-t kanë vënë në jetë moton e INTOSAI-t: Nga eksperiencia e përbashkët, përfitojnë të gjithë.

Duke parë nga afër nivelin e përkushtimit dhe pasionit që mbizotëron në të gjithë rajonet, ka qenë një përvojë modeste dhe vazhdon të jetë një dëshmi tjetër për rezultatet e shumta që INTOSAI mund të arrijë me anë të përpjekjeve të kombinuara të të gjithë anëtarëve të saj. Ndryshimi në jetën e qytetarëve, ka qenë forca lëvizëse e INTOSAI-t për 60 vitet e fundit. Jam i bindur që do të mbetet e palëkundur edhe në dekadat që do të vijnë, ndërkohë që INTOSAI punon për të siguruar një botë, e cila ka nevojë urgjente për një qeverisje efektive, me auditime të një cilësie të lartë në sektorin publik.






INTOSAI

E Shkuar – e Tashme – e Ardhme

**NJË VËSHTRIM  
I SHKURTËR HISTORIK  
I INTOSAI-t**







## Një Vështrim i shkurtër historik i INTOSAI-t

### Fillimet e ndërkombëtarizimit

Që nga themelimi i Institucioneve Supreme të Auditimit në Evropë, gjatë shekullit të 17, 18 dhe 19, zhvillimi i tyre është formësuar nga shkëmbimi i vazhdueshëm i përvojave dhe modeleve të praktikave më të mira. Në vitin 1761, kur Maria Teresa, Perandoresha Habsburge, për shembull, kërkoi të reformojë menaxhimin financiar të Austrisë dhe rrjedhimisht themeloi Dhomën e Kontabilitetit Mbretëror- paraardhësi i Gjykatës së sotme Austriake të Auditimit - në 23 dhjetor të të njëjtit vit, ajo mori shembullin e Prusisë, ku Dhoma e Përgjithshme e Llogarive (më vonë: Dhoma e Lartë e Llogarive e Prusisë) ishte themeluar që në vitin 1714. Në kohën kur mbizotëronin strukturat monarkike dhe absolute të pushtetit, ky shkëmbim padyshim ishte i kontrolluar dhe i detyruar nga sundimtarët. Kjo gjë ndodhte për arsye se duhej fituar një avantazhi i drejtpërdrejtë mbi fuqitë e tjera të mëdha evropiane. Sundimtarët, të cilët kishin njohuri për pasqyrat financiare, ishin në pozicionin që mund të planifikonin paraprakisht më lehtë dhe kishin në dispozicion fonde të lira. Kjo ishte me rëndësi qendrore nga pikëpamja e ushtrisë, duke qenë se ushtria në atë kohë shpesh konsumonte më shumë se 50 për qind të buxhetit vjetor. Për shkak të mundësisë për të parashikuar më mirë financat publike, shtetet mund të mbanin forca të armatosura, të cilat, nëse ishte e nevojshme, mund të përdorshin si një instrument i politikës së pushtetit. Kur, për shembull, në fillim të viteve 1860, u hartuan plane në Vjenë për të reformuar Institucionin Suprem të Auditimit, kreu i institucionit dërgoi shërbëtorët e vet në qytetet e Evropës Qendrore, të mbanin nën vëzhgim institucionet e tjera të kontrollit.

Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore në vitin 1918, Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) rritën dukshëm marrëdhëniet e tyre bilaterale. Nga një anë, rënia e Perandorive të mëdha të Gjermanisë, Austro - Hungarisë dhe Rusisë ndryshoi hartën e Evropës: lindën shtetet e reja kombëtare dhe bashkë me to edhe burokracitë e reja, si dhe u krijuan institucionet shtetërore, mes tyre edhe Institucionet Supreme të Auditimit. Nga ana tjetër, rënia e këtyre monarkive, i dha jetë rritjes së demokracisë në Evropën Qendrore. Monarkët u zëvendësuan nga asamblatë parlamentare, të cilat sollën ndryshim në mjedisin kushtetues të Institucioneve Supreme të Auditimit, sepse shumica e tyre ishin krijuar sipas strukturave të pushtetit monarkik. Institucionet Supreme të Auditimit intensifikuan bashkëpunimin me njëri - tjetrin në dy nivele. Herë pas here, Institucionet e "reja" Supreme të Auditimit kërkonin mbështetje nga institucionet më të vjetra, gjë që fillonte nga sigurimi i informacionit mbi statusin ligjor të institucionit në fjalë, si dhe shkëmbimit të njohurive në fushën e auditimit dhe ndërtimin e kapaciteteve. Megjithatë, aktorët e ndryshëm, u angazhuan edhe në shkëmbimin intensiv mbi bazën ligjore të Institucioneve Supreme të Auditimit që në vitet 1920. Edhe në atë kohë, pavarësia e institucioneve të kontrollit përbënte një problem qendror. Ndryshimet kushtetuese lidhur me institucionet e auditimit, u vërejtën me vigjilencë nga shtetet e tjera, u shkëmbyen konceptet moderne ligjore dhe u identifikuan shembuj të praktikave më të mira. Shpesh baza ligjore e Institucioneve të tjera Supreme të Auditimit, shërbeu si nxitje për ndryshime në shtete të ndryshme. Niveli i lartë i rrjeteve bilaterale reflektonte pozitën e veçantë të Institucioneve Supreme të Auditimit, në kuadër të institucioneve shtetërore: Institucionet Supreme të Auditimit nuk i përkasin as ekzekutivit dhe as administratës.



## Ndërkombëtarizimi i Shkencave Administrative dhe Institucioneve Supreme të Auditimit

Gjatë shekullit të 19, shteteve të ndryshme iu dhanë shumë detyra, me një spektër shumë të zgjeruar të përgjegjësi duke filluar nga siguria e brendshme dhe e jashtme, deri tek arsimi, transporti dhe infrastruktura. Në përputhje me rrethanat, administrata filloi të rritet dhe sfidat e reja u shfaqën në fushën e të drejtës administrative dhe metodave administrative. Si rezultat, u organizua Kongresi i Shkencave Administrative në Bruksel në vitin 1910, në të cilin morën pjesë shtetet e përzgjedhura për të ngritur një komision ndërkombëtar. Pas Luftës së Parë Botërore, kongreset janë mbajtur çdo katër vjet, deri në vitin 1930, ku Komisioni Ndërkombëtar u shndërrua në Institutin Ndërkombëtar për Shkencat Administrative, me seli në Bruksel.

Kongresi i parë u mbajt në Bernë (Zvicër), pas Luftës së Dytë Botërore në vitin 1947. Institucionet Supreme të Auditimit morën pjesë dhe kjo rezultoi në një bashkëpunim të përforcuar mes institucioneve të auditimit. Kjo nuk ndodhi vetëm për shkak të valëve të përgjithshme të bashkëpunimit ndërkombëtar që është stimuluar me vetëdije menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore në të gjitha nivelet e bashkëpunimit të shtetit, por edhe për statusin e auditimit suprem financiar në atë kohë. Nga njëra anë, Institucionet Supreme të Auditimit ekzistonin në shumë vende, por rëndësia e tyre si pjesë e administratës shtetërore nuk ishte e theksuar. Pavarësisht nga kornizat e ndryshme ligjore dhe strukturat e ndryshme organizative të institucioneve të auditimit - si gjykatat e drejtësisë apo gjykatat e auditimit - të gjithë institucionet u përballën me të njëjtat sfida: forcimi i pavarësisë së auditimit, duke lëvizur nga auditimet e thjeshtë financiare në auditime të plota. Nga ana tjetër, SAI-t që morën pjesë në kongresin e Bernës e kuptuan se mungonte një platformë e pavarur ndërkombëtare, për çështje të veçanta në lidhje me auditimin financiar.

### Themelimi i INTOSAI-t

Në vitin 1953, 34 SAI dhe organizata partnere u takuan me iniciativën e kryetarit të Institucioni Suprem i Auditimit të Kubës për të marrë pjesë në Kongresin e I në Havanë. Në këtë rast, INTOSAI (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit) u themelua si një shoqatë ndërkombëtare dhe pjesëmarrësit e kongresit vendosën të zhvillojnë një kongres të INTOSAI-t në vende të ndryshme çdo tre vjet. Për të lehtësuar komunikimin midis Institucioneve Supreme të Auditimit dhe për të mbështetur ato SAI që do të organizonin Kongreset (INCOSAI), SAI i Kubës mori përsipër Sekretariatit e Përgjithshëm të INTOSAI-t. Temat e diskutimit përfshinin sistemet e kontabilitetit publik, pavarësinë e SAI-ve dhe marrëdhëniet e SAI-ve me legjislativin, si dhe auditimin e bërë nga SAI-t e lidhur me tenderat e ndërtimit publik.

INCOSAI II u mbajt me rastin e përvjetorit të 125-të të Gjykatës së Llogarive të Belgjikës, në Bruksel në vitin 1956, në të cilin u përgatit një draft i parë i Urdhrave të Përhershëm të INTOSAI-t. Tre vjet më vonë, familja INTOSAI u mbledh në Rio de Janeiro, ku anëtarët vendosën t'i besojnë Kubës drejtimin e Sekretariatit të Përgjithshëm dhe krijuan grupe rajonale pune në pesë kontinentet.



## Austria si Drejtuesja e Re e Sekretariatit të Përgjithshëm

Me rastin e INCOSAI-t të II-të dhe të frymëzuar nga Belgjika, Hans Frenzel, Presidenti i Gjykatës Austriake të Auditimit, shfrytëzoi rastin e dhënë, nga përvjetori i 200 i Gjykatës Austriake të Auditimit, të ftojë SAI-t në Vjenë, si vendi i Kongresit të vitit 1962. Në fund të fundit, Gjykata Austriake e Auditimit festoi dyqind vjetorin e saj në vitin 1961. Përpjekjet u kurorëzuan me sukses, si në vitin 1959, në Kongresin e III në Rio de Janeiro, ku Gjykata Austriake e Auditimit u ngarkua me organizimin e Kongresit të ardhshëm në Vjenë. Vetëm një vit më vonë, Gjykata kubane e Auditimit u shpërbë në prag të Revolucionit Kuban. Si pasojë, Sekretariati i Përgjithshëm, si shtylla kurrizore organizative dhe "kujtesa institucionale", ndaloi së ekzistuari dhe u ri ngrit çështja se si të menaxhojnë bashkëpunimit ndërmjet kongreseve.

Duke organizuar Kongresin e IV Ndërkombëtar të Institucioneve Supreme të Auditimit (INCOSAI) në Vjenë më 18 - 26 maj 1962, Gjykata Austriake e Auditimit fitoi një know-how të plotë ndërkombëtar. Për arsye praktike, Raportuesi i Përgjithshëm francez, Roger Leonard, hodhi ide të shumta në funksion të Sekretariatit të Përhershëm gjatë takimit të dytë plenar më 25 maj 1962. Në fjalën e tij, Gösta Renlund nga Suedia theksoi organizimin e përkryer të Kongresit IV nga Gjykata Austriake e Auditimit dhe kërkoi që t'i besojë Gjykatës Austriake të Auditimit menaxhimin e Sekretariatit të Përhershëm.

Si pasojë, Hans Frenzel, Presidenti i Gjykatës Austriake të Auditimit, i kërkoi pjesëmarrësve që këtë sugjerim ta hidhnin në votim: "Të ngrenë duart të gjithë ata që janë dakord që Austria të drejtojë Sekretariatit të Përhershëm për tre vitet e ardhshme - domethënë deri në Kongresin e ardhshëm". Mocioni u miratua me unanimitet. Që nga viti 1963, Gjykata Austriake e Auditimit ka nënshkruar qarkoren e saj si pjesë e aktiviteteve të saj ndërkombëtare me Sekretariatit Ndërkombëtar të Përhershëm të Institucioneve Supreme të Auditimit në Gjykatën Austriake të Auditimit, si dhe ka kryer ndryshimet e nevojshme në organizimin e saj të brendshëm, në mënyrë që të përmbushë detyrat e saj të reja.

Në Kongresin Ndërkombëtar të V, i cili u mbajt më 15 - 24 qershor 1965 në Jeruzalem, Gjykata Austriake e Auditimit mori shumë vlerësim për aktivitetet e realizuara. Në takimin e dytë plenar më 24 qershor 1965, Gjykata Austriake e Auditimit u ngarkua me menaxhimin e mëtejshëm të Sekretariatit Ndërkombëtar. Pas miratimit në mbledhjen plenare, si dhe së bashku me një bord të ri këshillues u ngarkua edhe me përgatitjen e rregullores që përcaktonte bazat për bashkëpunimin e ardhshëm të SAI-ve.

Periudha mes Kongresit të V dhe VI Ndërkombëtar, që u mbajt në Tokio më 22 - 30 maj 1968, u mbizotërua nga një proces intensiv negociatash, si dhe vota të shumta në krijimin e rregullores. Pjesëmarrësit në Kongresin e VI, njohën unanimisht punën e suksesshme të Gjykatës Austriake të Auditimit gjatë periudhës gjashtë - vjeçare si drejtuese e Sekretariatit Ndërkombëtar. Mundësia që selia e përhershme e Sekretariatit Ndërkombëtar të qëndronte në Gjykatën Austriake të Auditimit u hodh në votë. Gjatë ditës së dytë, Asambleja e Përgjithshme e Kongresit më 30 maj 1968, miratoi Urdhrat e para të Përhershme të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Që nga data 30 maj 1968, Gjykatës Austriake të Auditimit iu besua përgjithmonë menaxhimi i Sekretariatit Ndërkombëtar, ose Sekretariati i Përgjithshëm, siç u quajt më vonë. Që atëherë, Presidenti i Gjykatës Austriake të Auditimit ka qenë edhe Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t.



## INTOSAI dhe Kombet e Bashkuara

Marrëdhëniet me Kombet e Bashkuara filluan të intensifikoheshin shumë herët. Jo vetëm që një përfaqësues i Kombeve të Bashkuara mori pjesë si vëzhgues që në INCOSAI I në Havana, por edhe përfaqësuesit e Kombeve të Bashkuara ose agjencitë e saj të specializuara vazhduan të merrnin pjesë në diskutimet e kongreseve, gjithashtu ata qëndruan në kontakt edhe pas takimeve të kongresit. Në vitin 1962, Gjykata Austriake e Auditimit vendosi kontaktet e saj të para me Këshillin Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara me rastin e INCOSAI IV. Në vitin 1965, Itzhak Nebenzahl, Kryetari i Bordit Drejtues dhe Kryetar i SAI-t të Izraelit, dhe Jörg Kandutsch, Kryetari i Gjykatës Austriake të Auditimit, filluan një nismë të plotë me qëllim intensifikimin e marrëdhënieve me Kombet e Bashkuara.

Në mars të vitit 1966, Itzhak Nebenzahl shkoi në Kombet e Bashkuara për të zhvilluar bisedime me ta. Atje, ai u mbështet nga Kurt Waldheim, ambasadori austriak në Kombet e Bashkuara. Disa javë më vonë në mbledhjen e tij të parë, Bordi Drejtues vendosi të bëjë thirrje për anëtarësim në Këshillin Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara (ECOSOC), si organizatë joqeveritare, të cilës i është dhënë Kategoria B si status konsultativ. ECOSOC kaloi mocionin unanimisht më 5 qershor 1967. Gjatë një takimi me Jorg Kandutsch në Kombet e Bashkuara në Nju Jork në tetor 1968, u përmend për herë të parë organizimi i seminareve të përbashkëta për shkëmbimin e njohurive dhe ngritjen e kapaciteteve. Pjesëmarrësit, gjithashtu propozuan krijimin e një shkolle administrative për ngritjen e kapaciteteve të audituesve në vendet në zhvillim, me qëllim krijim e shkencës së auditimit dhe krijimin e një organizate neutrale për auditimin e projekteve të ndryshme të ndihmës së zhvillimit. Më pas, përfaqësuesit e Sekretariatit të Përgjithshëm të INTOSAI-t, morën pjesë në takimin e punës së ekspertëve të OKB-së në Jugosllavi dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Bisedat e mbajtura dhe kontaktet e krijuara në atë kohë, mes të tjerash me emërimin e një Liaison Officer, që përfaqësonte interesat e INTOSAI-t në OKB në Nju Jork, filluan të jepnin shpejt frytet e veta. Në fillim të vitit 1970, ECOSOC i dha INTOSAI-t Kategorinë II në status konsultativ, dhe në fund të njëjtin vit Kombet e Bashkuara ranë dakord për organizimin e një seminari të përbashkët. Në maj 1971, Seminari i parë i OKB/INTOSAI u mbajt në Baden, Austri - kjo shënoi fillimin e një bashkëpunimi intensiv dhe të frytshëm, i cili do të zgjaste dekada, midis INTOSAI-t dhe Kombeve të Bashkuara. Pjesëmarrësit nga 55 vende diskutuan pyetje në lidhje me pavarësinë e auditimit, teknikat dhe praktikat e auditimit, problemet e auditimit dhe sfidat e paraqitura nga auditimet e ndërmarrjeve publike. Ndërkohë, Simpoziumi i 22-të u mbajt me sukses në Vjenë në marsin e 2013.

## Anëtarët e INTOSAI-t

Kur Institucionet Supreme të Auditimit u takuan në Havanë (Kubë) më 2 - 9 nëntor 1953, askush nuk mund të kishte imagjinuar se sa shumë do të rritej organizata në dekadat në vijim. Shumë shpejt, pas Kongresit të parë, u bë e qartë nevoja për takime të mëtejshme, në një distancë kohore prej tre vjetësh. Në rrjedhën e viteve, numri i Institucioneve Supreme të Auditimit që merrnin pjesë në Kongrese u rrit vazhdimisht: ndërsa numri e SAI-ve, i cili ishte 29 në Kubë, u dyfishua në dymbëdhjetë vjet, ku rreth më shumë se 64 Institucionet Supreme të Auditimit e pranuan ftesën për të marrë pjesë në INCOSAI VI në Jeruzalem.



Trazirat gjeopolitike pas Luftës së Dytë Botërore, natyrisht kontribuan në rritjen e pjesëmarrësve. Procesi i dekolonizimit arriti kulmin pas Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1960 duke shkaktuar rritjen e numrit të shteteve të pavarura: në vitin 1965 rreth 50 shtete ishin ish koloni dhe territore që kishin qenë në vartësi të shteteve kolonialiste. Ky fenomen shkaktoi në shtetet e reja krijimin e institucioneve të reja - mes tyre edhe Institucionet Supreme të Auditimit. Listat e pjesëmarrësve në Kongreset e gjatë gjashtë dekadave të fundit, përshkruajnë në mënyrë të qartë faktin se Institucionet Supreme të Auditimit në shtetet e reja kanë marrë pjesë në INCOSAI-t dhe janë anëtarësuar në INTOSAI, në mënyrë që të përfitojnë nga ky shkëmbim i përvojës. Për këtë arsye, nuk përbën çudi që INTOSAI ka kontribuar në këtë zhvillim gjeopolitik përmes përpjekjeve të tij për të forcuar auditimin publik në një mënyrë të qëndrueshme, nëpërmjet organizimit të seminareve OKB/INTOSAI. Këto përpjekje me qëllim pranimin e shpejtë të komunitetit INTOSAI, nuk kanë pushuar së ekzistuari. Menjëherë pas rënies së Bashkimit Sovjetik në vitin 1991, shumë anëtarë të rinj u pranuan në INTOSAI. Sidomos ndryshimet pas vitit 1989, çuan në një rritje të shpejtë në anëtarësimet në INTOSAI: nga rreth 120 në fund të viteve 1980 në 191 në 2013.

INTOSAI e ka konsideruar gjithmonë veten një organizatë jo-politike. Ajo është e hapur për të gjitha Institucionet Supreme të Auditimit të shteteve sovraane që janë anëtare të Kombeve të Bashkuara. Në kohën e Luftës së Ftohtë, gjatë konfrontimit të dy blloqeve ideologjike "Lindjes" dhe "Perëndimit", pas Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1989, organizata provoi se bashkëpunimi ndërkombëtar mund të kapërcej kufijtë, madje edhe ato ideologjike: SAI-t nga "Lindja" dhe "Perëndimi", u takuan në Kongrese dhe u munduan të gjenin zgjidhje për sfidat e përbashkëta për auditimin publik ndërkombëtar në grupet e punës.

## INTOSAI shkon drejt prirjeve rajonale

Që në INCOSAI III në Rio de Janeiro në 1959 u krijuan Grupet Rajonale të Punës në pesë kontinentet. Detyrat e tyre duhet të përfshinin koordinimin e aktiviteteve dhe propozimeve nëpër rajone, për të siguruar një përgatitje të suksesshme të INCOSAI-t që do të pasonte. Këto nën organizata duhet të shërbenin si një qendër shtesë për informacion dhe shkëmbimin e dokumentacionit. Një vend në rajon duhet të bënte koordinimin e Grupit Rajonal të Punës në mënyrë që të vepronte si një ndërlidhës për grupin dhe Sekretariatit e Përgjithshëm.

Ky zhvillim ka filluar me krijimin e ILACIF si organizatë paraardhëse e OLACEFS në vitin 1965. Grupet Rajonale të Punës u krijuan më vonë: AFROSAI (1976), ARABOSAI (1976), ASOSAI (1978), PASAI (1987), CAROSAI (1988), EUROSAI (1990). Është detyrë e Grupeve Rajonale të Punës të promovojnë qëllimet e INTOSAI-t në nivel rajonal. Ato shërbejnë si platforma bashkëpunimi profesional dhe teknik të anëtarëve në rajon. Nga themelimi i tyre dhe në vazhdimësi, ato kanë qenë gjithmonë partnere të domosdoshëm të INTOSAI-t.

Një forum për shkëmbimin e përvojës është krijuar me vendim të Bordit Drejtues në vitin 1971: në të njëjtin vit nisi botimi pilot i Revistës Ndërkombëtare të Auditimit të Qeverisë. Pasi kjo çështje u paraqit në INCOSAI VII në Montreal (Kanada), Bordi Drejtues vendosi në vitin 1972 që ta publikojë Revistën tremujore në të tri gjuhë anglisht, frëngjisht dhe spanjisht nga viti 1974. Që nga viti 1983, Revista është botuar edhe në gjermanisht dhe arabisht. Ajo konsiderohet si publikim zyrtar i INTOSAI-t dhe një mjet i rëndësishëm i komunikimit mes anëtarëve.



## INTOSAI - Në pulsën e kohës

Ashtu si edhe vetë bota, INTOSAI ka ndryshuar në 60 vitet e fundit, por nuk e ka humbur përqendrimin në interesat thelbësore dhe çështjet shqetësuese të auditimit ndërkombëtar. Temat e Kongreseve dhe Seminareve të ndryshme zbulojnë dy modele bazë. Së pari, INTOSAI është përpjekur që temat të kenë gjithmonë lidhje me aktualitetin dhe të trajtojë pyetje mbi çështjet aktuale. Për këtë arsye, që në Kongresin e parë, SAI-t trajtuan ndërmarrjet publike të auditimit. Çështja në lidhje me aplikimin e sistemeve elektronike të përpunimit të të dhënave për auditimet, u trajtua në vitin 1971. INTOSAI, gjithashtu ngriti task force për të përmbushur sfidat e paraqitura nga krizat aktuale, në mënyrë që të gjejë zgjidhje të shpejta dhe efektive për auditim e qeverisë, si për shembull INTOSAI Tsunami Task Force.

Së dyti, INTOSAI nuk e ka humbur kurrë vëmendjen ndaj çështjeve kryesore të auditimit të qeverisë që kanë si temë qendrore pavarësinë e SAI-ve. Parakushtet themelore për auditimin e pavarur publik, gjenden tashmë në axhendat e Kongreseve dhe Seminareve. Miratimi i Deklaratës së Limës në INCOSAI IX në Peru në vitin 1977 paraqiti një moment historik për të kodifikuar të gjitha shtyllat mbi të cilat qëndron pavarësia e auditimit të qeverisë. Kjo risi është ende në zhvillim sot: në vitin 2007 u nënshkrua Deklarata e Meksikës, si dhe në vitin 2011 INTOSAI me sukses arriti të përcaktojë shtyllat kryesore të pavarësisë së auditimit të qeverisë në Rezolutën e Kombeve të Bashkuara A/66/209 "Nxitja e Efikasitetit, Përgjegjshmërisë, Efektshmërisë dhe Transparencës së Administratës Publike, duke forcuar Institucionet Supreme të Auditimit.

Në këtë rezolutë, Kombet e Bashkuara shprehimisht pranojnë se "Institucionet Supreme të Auditimit" mund të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë objektive dhe efektive vetëm nëse ato janë të pavarura nga subjekti i audituar dhe janë të mbrojtura nga ndikimet e jashtme". Kombet e Bashkuara i inkurajonë anëtarët e tyre, aty thuhet "të aplikojnë, në përputhje me strukturat e tyre kombëtare institucionale, parimet e përcaktuara në deklaratat e Limës dhe Meksikës ". Megjithatë, INTOSAI nuk është një institucion që qëndron mbi dafina dhe aktivitetet e shumëfishta janë shembulli më i mirë për këtë. Detyra që duhet të realizohet është që të njoftohet parlamenti kombëtar në lidhje me këtë dokument, sepse kjo rezolutë i mundëson familjes së INTOSAI-t të kërkojë me shumë këmbëngulje zbatimin e parimeve themelore të pavarësisë. Rezoluta miraton sidomos ato SAI që ende po luftojnë për të fituar plotësisht pavarësinë së tyre.


Arritjet e INTOSAI-t, të cilat në thelb pasqyrojnë moton e organizatës, nuk janë më pak të rëndësishme. Krijimi i grupeve të punës dhe hartimi i udhëzuesve, duke filluar nga mesi i viteve 1980, ka ndihmuar në mënyrë të ndjeshme zhvillimin e INTOSAI-t në një organ përcaktues të standardeve. Së pari, udhëzuesit kanë dalë si dokumente zyrtare të INTOSAI-it. Me përgatitjen e Manualit për Komisionet, që është miratuar në INCOSAI XV në Kajro në vitin 1995, organizata përcaktoi për herë të parë kriteret për hartimin e udhëzuesve. Në INCOSAI XIX në Meksikë, u prezantuan standardet ISSAI (Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit). Përgatitjet për këtë kuadër kanë filluar tashmë në vitin 2002 dhe kanë qenë gjithashtu pjesë e Planit Strategjik të parë të INTOSAI-t 2005-2010. Qëllimi ka qenë zhvillimi i një kuadri profesional të standardeve dhe udhëzuesve për audituesit, të cilët përballen me të gjitha sfidat e ngjashme. ISSAI-t e para u miratuan në INCOSAI XIX në



Meksikë dhe udhëzuesit, atëherë ekzistues, janë përfshirë në standardet ISSAI. Në INCOSAI XX në Afrikën e Jugut, u miratuan ISSAI-t e mëtejshëm. Zbatimi i ISSAI-ve sjell shumë avantazhe. Midis tyre janë sigurisht rritja e cilësisë së punës, besueshmërisë dhe kompetencës. Në vitet në vijim INTOSAI do të shtojë përpjekjet e tij për t'i futur standardet ISSAI në komunitetin e INTOSAI-t dhe për të mbështetur SAI-t në zbatimin e tyre.

Historia e INTOSAI tregon se organizata ka jetësuar moton e saj. Eksperienca e përbashkët ende po praktikohet në mënyrë aktive dhe mbetet me rëndësi të madhe për zhvillimin e ardhshëm të INTOSAI-t.








INTOSAI

E shkuar – e tashme – e ardhme

**INTOSAI SOT –  
NGA EKSPERIENCA E PËRBASHKËT  
PËRFITOJNË TË GJITHË**





## INTOSAI Sot –

### Nga eksperiencia e përbashkët, përfitojnë të gjithë

**60 vjetori i INTOSAI-t** *(Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI-t, Josef Moser)*

Këtë vit, në 2013-n, me rastin e INCOSAI XXI në Pekin, Kinë, INTOSAI feston 60 vjetorin. Ishte një moment i rëndësishëm dhe vendimtar në nëntor të vitit 1953, kur 34 Institucione Supreme të Auditimit (SAI) dhe institucione partnere u mbledhën në Havanë në një kongres me iniciativë të Institucionit Suprem të Auditimit të Kubës dhe hodhën themelet për organizatën tonë.



Thelbi për këtë kongres ka të bëjë me faktin se, në një mjedis gjithnjë e më të institucionalizuar, auditimi i jashtëm i qeverisë mund të mbizotërojë vetëm nëpërmjet bashkëpunimit me të tjerët. Vetëm në këtë mënyrë ishte - dhe ende është - e mundur që të fitohen njohuri për sistemet e ndryshme, perspektivat dhe metodat, si dhe për të shkëmbyer njohuri dhe përvojë në mënyrë që të forcohet auditimi i qeverisë. Pra pa auditim, të gjitha përpjekjet janë të kota.

Me të njëjtin frymëzim si shtetet e bashkësisë ndërkombëtare kur bashkuan forcat në vitin 1945 dhe themeluan Kombet e Bashkuara me 51 shtetet themeluese, për të mbështetur lirinë e sapo fituar dhe për të promovuar sigurinë ndërkombëtare, SAI-t dhe organizatat nga 33 shtete nga Azia, Evropa dhe Amerika e Jugut, u takuan për Kongresin e parë ndërkombëtar të Institucioneve Supreme të Auditimit vetëm 8 vite më vonë: Argjentina, Belgjika, Bolivia, Brazili, Kanadaja, Kili, Kolumbia, Kosta Rika, Kuba, Republika Dominikane, Gjermania, Ekuador, El Salvadori, Franca, Guatemala, Haiti, Selia e Shenjtë, Italia, Libani, Meksika, Holanda, Nikaragua, Norvegjia, Panamaja, Paraguai, Portugalia, Puerto Riko, Spanja, Suedia, Zvicra, Mbretëria e Bashkuar, Kombet e Bashkuara, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Venezuela. Gjatë kësaj ngjarjeje të paharrueshme u themelua familja e INTOSAI-t.

Ideja themelore e kësaj ngjarjeje në vitin 1953, dëshira për të mësuar nga të tjerët dhe për të shkëmbyer eksperiencën, me qëllim zgjerimin e fokusit të auditimit në të gjithë botën, nuk ka ndryshuar që prej Kongresit të parë në Kubë. Ashtu si 60 vjet më parë, SAI-t nga të gjitha rajonet e botës takohen sot nën frymëzimin e motos së INTOSAI-t *Experientia Mutua Omnibus Prodest* (Nga eksperiencia e përbashkët, përfitojnë të gjithë) për të shkëmbyer përvojën dhe për të mësuar nga njëri - tjetri, duke kontribuar në mënyrë thelbësore për rritjen e efektivitetit të aktivitetit të tyre.

Qasja ishte - dhe ende është pas 20 kongresesh – gjetja e partnerëve, nevoja për përpjekje dhe për të shfrytëzuar mundësinë e të mësuarit nga njëri-tjetri, shkëmbimin e njohurive dhe përvojës, për të përcaktuar rastet e praktikave më të mira dhe për të vepruar në përputhje me rrethanat, në mënyrë që të ngrihen sfida të ndryshme në auditimet e qeverisë.

Në dokumentet e INCOSAI I në vitin 1953, parimet bazë përshkruhen si më poshtë: "Përveç forcimit të marrëdhënieve ndërkombëtare, qëllimi kryesor i këtij kongresi është që të shkëmbejë përvojën dhe të diskutojë



të gjitha çështjet që kanë lidhje në mënyrë specifike me punën e përditshme të Institucioneve Supreme të Auditimit, si për shembull çështjet në lidhje me kushtetueshmërinë institucionale, organizimin, funksionet, pavarësinë, buxhetin, etj., duke marrë parasysh shembujt e praktikave më të mira të institucioneve pjesëmarrëse. "Organizata jonë është themeluar në bazë të kësaj ideje themelore, duke nxitur shkëmbimin e ideve, njohurive dhe përvojës, dhe 60 vjet më vonë INTOSAI vazhdon ende ta praktikojë këtë ide, si një organizatë autonome, e pavarur dhe jo-politike profesionale.

Në të njëjtën kohë, krijimi i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), ishte goditja e parë për të nisur një auditim qeverie në nivel global, të strukturuar dhe të orientuar. Auditimi i qeverisë është një parakusht për menaxhimin e shëndoshë financiar. Që në fillim në INCOSAI I, auditimi u vendos dhe u trajtua tërësisht në një kontekst ndërkombëtar, si dhe u trajtua edhe gjatë seancave të punës. Disa nga 16 temat e kongresit e parë, janë ende të vlefshme edhe sot, si për shembull auditimi i brendshëm i administratës publike me qëllim kontrollin e saj, aktivitetet e Institucioneve Supreme të Auditimit në auditimin e autoriteteve lokale ose teoria e pushtetit të kontrollit brenda kufijve të ligjit modern kushtetues. Që atëherë, pavarësia ka qenë në qendër të diskutimeve të Kongresit. Një nga temat e Kongresit I, për shembull, sillej rreth: Pavarësia jetike e Institucioneve Supreme të Auditimit; Shtrirja dhe Garantimi i kësaj Pavarësie.

Me kalimin e kohës, nevoja në këtë lloj bashkëpunimi ndërkombëtar, për të forcuar auditimin e jashtëm të qeverisë, jo vetëm që nuk e ka zvogëluar, por - tamam si në procesin e vazhdueshëm të ndërkombëtarizimit të bashkësisë së shteteve, si dhe të financave dhe ekonomisë - është rritur në mënyrë të qëndrueshme. Në vazhden e bashkëpunimit intensiv ndërmjet shteteve, në të cilat SAI-t kombëtare kryejnë aktivitetet e tyre, SAI-t duhet të rrisnin aktivitetet e tyre në rrjete, si dhe në mënyrë e duhur për të përmbushur pritshmërinë e përcaktuara për to.

INTOSAI, si një organizatë plot jetë dhe e suksesshme, ofron kornizën më të mirë për këtë. Zhvillimet e shumëfishta pozitive që INTOSAI ka pësuar në rrjedhën e historisë e ilustrojnë këtë mënyrë qartësisht.

Në këto 60 vitet e fundit, anëtarësimi i INTOSAI-t është rritur nga 29 në 191 SAI anëtare dhe 4 anëtarë të asociuar. Organizata i ka siguruar të gjithë anëtarëve të saj një rrjet global ekspertësh për shkëmbimin e përvojës.

Për më tepër, anëtarët e INTOSAI-t kanë gjithashtu entitete të kontaktit në nivel rajonal në formën e shtatë Grupeve Rajonale të Punës- AFROSAI, ARABOSAI, ASOSAI, CAROSAI, EUROSAI, OLACEFS dhe PASAI. Këto grupe rajonale pune marrin në konsideratë qëllimet dhe misionin e INTOSAI-t – duke promovuar administrim të mirë, përmirësim të rezultateve, transparencë, përgjegjshmëri, besueshmëri, luftën kundër korrupsionit, besimin e publikut, dhe përdorimin efikas të fondeve publike për të mirën e qytetarëve – si dhe në të njëjtën kohë ato marrin parasysh dallimet rajonale dhe nevojat heterogjene.

Në mënyrë që të vazhdojë me përpjekjet për të strukturuar aktivitetet e një organizate të modelit ndërkombëtar, INTOSAI i është përgjigjur kërkesave të një udhëzuesi strategjik, i cili është përmendur që para ndërimit të mijëvjeçarit. Gjithashtu u themeluar për këtë qëllim një Task Force e kryesuar nga shefi i atëhershëm i SAI-t të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, David M. Walker.



Plani i parë strategjik i INTOSAI-t për periudhën 2005-2010, i cili u paraqit në INCOSAI XVIII, në vitin 2004 në Budapest, specifikonte katër qëllime strategjike që përcaktojnë strukturën dhe punën e INTOSAI-t në mënyrë të qëndrueshme:

Objektivi 1: Përgjegjshmëria dhe Standardet Profesionale

Objektivi 2: Ngritja e Kapaciteteve Institucionale

Objektivi 3: Shkëmbimi i Njohurive dhe Trajnimet

Objektivi 4: Organizata Ndërkombëtare Model

Zhvillimet e fundit tregojnë se ky strukturim i punës së INTOSAI-t është shpërblyer:

Me ISSAI-t, Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, të gjitha SAI-t kanë në dispozicion një grup global të standardeve të auditimit për aktivitetet e tyre, të cilat mund të përdoren si pikë referimi në punën e tyre kombëtare të auditimit.

Këto standarde mund të shfrytëzohen në fushën e ngritjes së kapaciteteve për zhvillimin e strukturave të reja dhe për marrjen e njohurive. Aktualisht, ato janë gjithashtu të integruar në aktivitetet e ndihmës së zhvillimit të INTOSAI, qoftë si pjesë e IDI-t, Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t, ose si pjesë e Bashkëpunimit të Donatorëve të INTOSAI-t.

Kjo strukturë gjithashtu i mundëson INTOSAI-t që gjithmonë të përgjigjet në mënyrë fleksibël ndaj sfidave të jashtme. Si reagim i drejtpërdrejtë ndaj katastrofës cunami, INTOSAI ngriti Task Forcën mbi Përgjegjshmërinë për Kontrollin dhe Ndihmën ndaj Katastrofave të ndodhura në dhjetor të vitit 2004, e cila ka punuar për këtë çështje që nga viti 2007 si një grup pune dhe do të paraqesë pesë ISSAI për miratim në INCOSAI-n e vitit 2013. Gjithashtu, INTOSAI iu përgjigj menjëherë krizës financiare në fund të vitit 2008. Në të njëjtin vit, u krijua Task Forca e INTOSAI-t mbi Krizën Financiare Globale: Sfidat për SAI-t (tani është krijuar Grupi i Punës për Modernizimin Financiar dhe Reformat Rregullatore).

Megjithatë, INTOSAI nuk po bashkëpunon me sukses vetëm brenda, pra me anëtarët e tij, por edhe jashtë, vis-à-vis me partnerët e saj të jashtëm. Që nga vitet 1970, INTOSAI ka bashkëpunuar intensivisht me Kombet e Bashkuara në veçanti. Gëzon status të veçantë konsultues në ECOSOC dhe është i përfaqësuar në Komitetin e Kombeve të Bashkuara për Ekspertët e Administratës Publike (CEPA). Mbi të gjitha, INTOSAI dhe Kombet e Bashkuara kanë organizuar 22 seminare të përbashkëta dhe simpoziume. Këto seminare OKB/INTOSAI shërbejnë përforcim për kapacitetet institucionale të SAI-ve. Nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencës dhe informacionit në lidhje me zonat aktuale të auditimit të qeverisë, simpoziumet e OKB/INTOSAI japin një kontribut thelbësor në zhvillimin e SAI-ve kombëtare.

Simpoziumet e organizuara bashkërisht OKB / INTOSAI dhe temat e tyre gëzojnë interes të madh në komunitetin e INTOSAI-t dhe të Kombeve të Bashkuara. Këto simpoziume në dekadën e fundit – të organizuara nga Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t në bashkëpunim me Kombet e Bashkuara - kanë pasur një ndikim



veçanërisht të qëndrueshëm:

- Vlera dhe Përfitimet e Auditimit të Qeverisë në një mjedis të globalizuar (2007)
- INTOSAI: Partner aktive në Rrjetin Ndërkombëtar Kundër Korrupsionit; Sigurimi i Transparencës për Promovimin e Sigurimit Social dhe Zvogëlimin e Varfërisë (2009)
- Praktikrat efektive të bashkëpunimit mes SAI-ve dhe qytetarëve për të rritur përgjegjshmërinë publike (2011)
- Auditimi dhe Aktivitetet këshilluese nga SAI-t: risqet, mundësitë, si dhe mënyrat për angazhimin e qytetarëve (2013)

Shumë zhvillime vendimtare, për shembull, origjinën e kanë në simpoziume: Përgatitja e një standardi për matjen e vlerës dhe përfitimet e auditimit të qeverisë (simpozium i vitit 2007), i cili do të miratohet nga INCOSAI XXI në Pekin, apo Rezoluta e OKB-së për forcimin e pavarësisë së SAI-ve (Simpoziumi i vitit 2009), janë vetëm disa shembuj të iniciativave të ndërmarra gjatë Simpoziumeve OKB/INTOSAI.

Rezoluta A/66/209 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara për Promovimin e efikasitetit, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, duke fuqizuar institucionet supreme të auditimit, shënon ndoshta një nga ngjarjet më të rëndësishme të historisë së bashkëpunimit mes INTOSAI-t dhe Kombeve të Bashkuara. Me këtë rezolutë, shtetet anëtare të INTOSAI-t kanë në dispozicion të tyre një vendim nga bashkësia ndërkombëtare që shkon përtej sferës së efektivitetit të SAI-ve dhe që u mundëson atyre të kërkojnë me shumë këmbëngulje zbatimin e parimeve të pavarësisë, të cilat tashmë janë të përcaktuara nga Deklarata e Limës, 1977 dhe nga Deklarata e Meksikos, 2007.

Megjithatë, bashkëpunimi ndërkombëtar i INTOSAI-t, nuk ndalet me Kombet e Bashkuara, por shkon edhe më tej në mënyrë që t'i japë trajtën e duhur zhvillimeve aktuale. Partnerë të rëndësishëm të tjerë të INTOSAI-t janë, ndër të tjera, Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve Publik (IFAC), Instituti i Audituesve të Brendshëm (IIA), Unioni Ndër-Parlamentar (IPU), Banka Botërore, dhe - siç është përmendur më sipër, për ngritjen e kapaciteteve - Komuniteti Ndërkombëtar i Donatorëve.

Historia e INTOSAI-t dhe në veçanti aktivitetet aktuale, evidentojnë luftën e etërve themelues të INTOSAI-t "për shkëmbimin e njohurive, përvojës, si dhe për të mësuar nga njëri-tjetri".

Në përputhje me moton, INTOSAI ende po praktikon shkëmbimin e njohurive dhe përvojës - jo vetëm në kuadër të familjes së madhe të INTOSAI-t, por edhe me partnerët e tjerë. Kudo në botë, INTOSAI perceptohet si një zë i besueshëm i auditimit të jashtëm të qeverisë dhe aktivitetet e tij ushtrojnë ndikim të madh në përputhje me interesat e SAI-ve kombëtare.

INTOSAI funksionon në mënyrë të shkëlqyer. Secili prej anëtarëve të tij dhe në veçanti ata më aktivë që kanë kontribuar në mënyrë vendimtare në suksesin e kësaj organizate, kanë marrë përgjegjësi dhe funksione vullnetarisht si pjesë e aktiviteteve të INTOSAI-t. Do të doja t'i shpreh atyre vlerësimin tim më të sigurtë.



## Përvjetori i 50 i Sekretariatit të Përgjithshëm të INTOSAI-t në Vjenë

Do të doja të shpreh përzemësisht falënderimin tim për familjen INTOSAI, për besimin që i ka dhënë për dekada të tëra Gjykatës Austriake të Auditimit, si mikpritëse e Sekretariatit të Përgjithshëm të INTOSAI-t.

Në vitin 2013, Gjykata Austriake e Auditimit ka festuar 50 vjetorin e Sekretariatit të Përgjithshëm, me qenë se selia e tij ka qenë në Vjenë nga viti 1963. Është një nder i madh dhe kënaqësi për Gjykatën Austriake të Auditimit, të ketë privilegjin të drejtojë Sekretariatit të Përgjithshëm të INTOSAI-t prej një kohë kaq të gjatë dhe, në të njëjtën kohë, kryetari i Gjykatës Austriake të Auditimit të jetë Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t.

Që në fillim, Sekretariati i Përgjithshëm ishte me rëndësi jetike për organizatën, duke vepruar si drejtues për risitë dhe një qendër informacioni, si dhe si subjekti i kontaktit për anëtarët e INTOSAI-t në të gjithë botën dhe për partnerët e tjerë globalisht aktiv. Në cilësinë e subjektit qendror administrativ të INTOSAI-t, Sekretariati i Përgjithshëm është në qendër të rrjetit të auditimit të jashtëm qeveritar. Sekretariati i Përgjithshëm vepron si ndërlidhës brenda familjes INTOSAI dhe për partnerët tanë të jashtëm. Zhvillimet ekonomike, politike dhe shoqërore në mbarë botën kanë përcaktuar sfida të vazhdueshme dhe të reja për INTOSAI-n. Ka qenë gjithmonë detyrë e Sekretariatit të Përgjithshëm që të identifikojë sfidat e tilla. SAI i Kubës, i cila mikpriti Sekretariatit e parë të Përgjithshëm, kishte njohur tashmë nevojën e shkëmbimit të përvojave dhe njohurive.

Që kur Sekretariati i Përgjithshëm e ka selinë në Gjykatën Austriake e Auditimit, është përpjekur të rrisë më tej shkëmbimin e njohurive mes anëtarëve dhe ka organizuar aktivitete bashkëpunimi mes SAI-ve dhe organizatave të jashtme partnere më publike.

Në aktivitetet e tij, Sekretariati i Përgjithshëm nuk duhet vetëm të përpiqet për të vepruar si një ndërlidhës mes Grupeve Rajonale të Punës, Komiteteve të INTOSAI dhe palëve të interesuara, por edhe synon të kryej proceset administrative. Sekretariati i Përgjithshëm gjithashtu vepron, në mënyrë të veçantë, si një organizatë e prirur nga risitë. Ajo identifikon dhe komunikon çështjet aktuale dhe temat prioritare për anëtarët e saj, duke rritur ndërgjegjësimin dhe rritjen e ekspertizës si brenda dhe jashtë INTOSAI-t. Për Gjykatën Austriake të Auditimit, është një nder i veçantë që INTOSAI - në reminishencë të kontributit të çmuar të bërë nga ish - Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI-t, Jörg Kandutsch - jep Çmimin Kandutsch Jörg për të njohur arritjet e rëndësishme dhe kontributet në auditimin e qeverisë çdo tre vjet me rastin e INCOSAI-t.

Në përputhje me moton e INTOSAI-t, Sekretariati i Përgjithshëm bën përpjekje për t'u siguruar të gjithë anëtarëve një platformë të përshtatshme për shkëmbimin e hapur të dijes dhe përvojës. Në bashkëpunim me katër Komitetet kryesore - Komiteti i Standardeve Profesionale (KDP), Komiteti i Ngritjes së Kapaciteteve (CBC), Komiteti për Shkëmbimin e Njohurive dhe Dijes (KSK), Komiteti i Financës dhe Administratës (FAC) - 4 Qëllimet Ndërlidhëse, 8 Nën komisionet, 9 Grupet e Punës, 3 Task Forcat, Revista Ndërkombëtare e Auditimit të Qeverisë, Iniciativa për Zhvillimin e INTOSAI-t (IDI), si dhe Sekretariati i Përgjithshëm angazhohet në çuarjen përpara të ideve të etërve themelues dhe forcimin e shkëmbimit të njohurive dhe përvojës brenda familjes INTOSAI, si dhe me partnerët e jashtëm.





Për këtë arsye, Sekretariati i Përgjithshëm ia kushton aktivitetet e veta krejtësisht anëtarëve të INTOSAI-t dhe përpiqet të përmbush detyrat e tij, të përcaktuara në statutet e Planit Strategjik dhe Udhëzuesin e Komunikimit:

- mbajtja e kontakteve me anëtarët e INTOSAI-t,
- ndihmon Komitetet, Këshillin Drejtues, Nën komitetet, Grupet e Punës, Task Forcat dhe Grupet e Projektit në kryerjen e detyrave të caktuara,
- ofrimin e mbështetjes për Goal Chairs dhe Goal Liaisons,
- promovimin e Grupeve Rajonale të Punës në aktivitetet e tyre,
- ruajtjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve me organizatat dhe institucionet ndërkombëtare, •përgatitjen dhe zbatimin e buxhetit të INTOSAI-t.

Që nga viti 1971, Sekretariati i Përgjithshëm ka organizuar Simpoziumet e përmendura më sipër me OKB-në, të cilat në mënyrë të veçantë u shërbejnë qëllimeve të trajnimit për SAI-t e vendeve në zhvillim. Këto simpoziume i janë dedikuar gjithmonë shkëmbimit të njohurive të anëtarëve, si dhe ngritjes së kapaciteteve. Për më tepër, ato kanë shërbyer edhe si udhërrëfyes për zhvillime të shumta brenda INTOSAI-t, si për shembull përgatitjen e lartpërmendur të standardeve ISSAI, me qëllim që Sekretariati i Përgjithshëm në të ardhmen të veprojë si një zë aktiv i organizatës, si dhe për të mbështetur anëtarët e INTOSAI-t në ngritjen e kapaciteteve në mënyrë të qëndrueshme dhe efektive, duke u siguruar që çdo SAI mund të veprojë si një organizatë e pavarur model në vetvete dhe të njihet si institucion i tillë.

Në këtë frymë, Sekretariati i Përgjithshëm do të vazhdojë të:

- japë një kontribut aktiv të orientuar drejt së ardhmes për zbatimin e Planit Strategjik të INTOSAI-t dhe të mbështesë anëtarët e tij, si dhe grupet e tyre në zbatimin e Planit Strategjik të INTOSAI në mënyrën më të mirë të mundshme,
- marrë pjesë në mënyrë aktive në mbledhjet e Këshillit Drejtues, të Komitetit të Financave dhe Administrimit, Këshillit Drejtues të Objektivave 1 në 3, dhe në Kongrese, duke kontribuar për një qeverisje efektive dhe një zbatim të qëndrueshëm të Planit Strategjik të INTOSAI, të përdorë rezultatet e takimeve të Bordit Drejtues, Kongreseve, ngjarjet ndërkombëtare, si dhe aktivitete të tjera në lidhje me zbatimin e Planit strategjik të INTOSAI-t, sidomos edhe nëpërmjet faqes së internetit të INTOSAI-t dhe nëpërmjet mjeteve efektive dhe efikase në lidhje me komunikimin e politikave të INTOSAI-t,
- veprojë si një forcë shtytëse dhe novatore për temat aktuale dhe globale që i përkasin auditimit të qeverisë, si dhe të planifikojë dhe organizojë ngjarje ndërkombëtare për çështjet aktuale që kanë të bëjnë me auditimin e qeverisë, veçanërisht në bashkëpunim me OKB-në (Simpoziumet OKB/INTOSAI),
- bashkëpunojë me Grupet Rajonale të Punës së INTOSAI-t, në bazë të besimit dhe partneritetit duke respektuar autonominë e tyre,



-bashkëpunojë me IDI-n në bazë të partneritetit,

-t'i përmbahet parimit të barazisë së të gjithë anëtarëve të INTOSAI-t,

-promovojë qëllimet dhe parimet e përcaktuara në politikën e komunikimit të brendshëm brenda vendit (vis-à-vis me anëtarët, organet e tjera të INTOSAI-t dhe grupet), dhe (vis-à-vis me organizatat partnere dhe aktorët) të jashtëm,

-të sigurojë burimet teknike, organizative dhe gjuhësore për të çuar përpara aktivitetet e INTOSAI-t në mënyrë efikase dhe efektive, si dhe në përputhje me Statutin,

- bashkëpunojë me partnerë globalë (p.sh. OKB, OECD, IPU, IIA, IFAC, Komunitetin e Donatorëve) për të shërbyer në auditimin e qeverisë, në mënyrën më të mirë të mundshme, në nivel global dhe për garancitë e ruajtjes së pavarësisë së INTOSAI-t si një institucion autonom, i pavarur, jo politik.

- zbatojë vlerat qendrore të INTOSAI-t, si pavarësia, integriteti, profesionalizmi, besueshmëria, gjithë përfshirja, bashkëpunimi dhe risitë.

Në përfundim, do të doja të falënderoja të gjithë anëtarët e INTOSAI-t për besimin dhe bashkëpunimin e tyre të shkëlqyer.

Për shkak të angazhimit të të gjithë anëtarëve, dhe sidomos ata që kanë marrë përsipër funksionet dhe përgjegjësitë në kuadër të INTOSAI-t, ky institucion është më i fortë se kurrë.

Për këtë arsye, mund t'ju sigurojmë se INTOSAI është i përgatitur për sfidat e ardhshme.



## Tetë shtyllat e pavarësisë

### Pavarësia e Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI-t)

Çfarë nënkuptojmë me pavarësi të SAI-t?

I. 1. Statusi Ligjor	II. Drejtuesit e SAI-ve	III. Veprimtaria	IV. Aksesi në informacion
<p>Në mënyrë që të garantohet pozicioni ligjor i përshtatshëm dhe efektiv i SAI-ve në shtetet respektive, duhet të përcaktohet qartë kuptimi i pavarësisë së SAI-ve në kushtetutë, legjislacion, përfshirë edhe dispozitat ligjore për aplikimin de facto të saj.</p>	<p>Kushtet për përcaktimin e drejtuesve të SAI-ve dhe anëtarëve të institucioneve kolegjinale, duhet të specifikohen në legjislacion. Pavarësia e drejtuesit të SAI-t dhe anëtarëve të institucioneve kolegjinale, mund të sigurohet vetëm nëse mandatet e tyre kanë një kohë të mjaftueshme dhe mund të largohen nga detyra nëpërmjet proceseve të pavarura nga ekzekutivi.</p>	<p>Në mënyrë që të përmbushin me efektivitet mandatin e tyre, SAI-t duhet të jenë të pavarur në zgjedhjen e çështjeve që do të auditohen, në planifikimin e auditimit, si dhe në metodat e auditimit që do të zbatohen, sikundër edhe gjatë kryerjes së auditimit, si dhe në organizimin dhe menaxhimin e SAI-t. SAI-t duhet të jenë të lira dhe nuk duhet të kenë ndërhyrje nga legjislativi dhe ekzekutivi, ndërkohë që kryejnë detyrat e auditimit.</p>	<p>Audituesit duhet të kenë informacion të pakufizuar dhe në kohë për të gjitha dokumentet që i nevojiten gjatë kryerjes së auditimit.</p>



## V.

### Raportimi i rezultateve të auditimit

SAI-t duhet të raportojnë në lidhje me rezultatet e auditimit, të paktën një herë në vit; megjithatë ata janë të lirë të raportojnë edhe më shumë here, nëse e konsiderojnë të nevojshme.

## VI.

### Përmbajtja dhe koha e raportit të auditimit

SAI-t duhet të jenë të lirë të caktojnë përmbajtjen e raportit të auditimit, si dhe të publikojnë dhe të evadojnë raportet, sapo ta kenë dërguar atë në subjekt.

## VII.


### Mekanizmet efektiv të ndjekjes së rekomandimeve

SAI-t duhet të kenë procedura të pavarura për ndjekjen e rekomandimeve të auditimeve, për t'u siguruar se subjektet e audituara kanë trajtuar në mënyrën e duhur observacionet dhe rekomandimet, si dhe janë marrë masat e duhura për zbatimin e tyre.

## VIII.

### Burimet


SAI-t duhet të kenë në dispozicion burime njerëzore, materiale dhe monetare të mjaftueshme dhe duhet të menaxhojnë buxhetet e tyre pa ndërhyrje ose kontroll nga qeveria dhe autoritetet e saj.



EXPERIENTIA MUTUA OMNIBUS PRODEST



# INTOSAI at a Glance



## PARTNERË TË JASHTËM

United Nations

- ECOSOC (Economic and Social Council)
- UNDESA (UN Department of Economic and Social Affairs)
- UNDPADM (UN Division for Public Administration and Development Management)
- CEPA (Committee of Experts on Public Administration)
- UNODC (UN Office on Drugs and Crime)

IPU (Inter-Parliamentary Union)

OECD (Organisation for Economic Co-operation and Development)

IFAC (International Federation of Accountants)

IBP (International Budget Partnership)



## Rezoluta e OKB-së: A/66/442

## Asambleja e Përgjithshme

15.03.2012

**Rezoluta e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme****66/209. Promovimi i efijencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës në administrimin publik, duke forcuar rolin e institucioneve supreme të auditimit.***Asambleja e Përgjithshme,*

Më mbështetje të rezolutës së Këshillit Social dhe ekonomik 2011/2, datë 26 prill 2011, Gjithashtu, në mbështetje të rezolutave 59/5, datë 2 dhjetor 2004 dhe 60/34, datë 30 nëntor 2005, si dhe rezoluta e mëparshme mbi administrimin dhe zhvillimin publik,

Në mbështetje të Deklaratës së Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara<sup>1</sup>

Duke theksuar nevojën për përmirësimin e efijencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës në administrimin publik

Duke theksuar gjithashtu faktin se një administrim publik efijent, i përgjegjshëm, efektiv dhe transparent, ka një rol kryesor në zbatimin e qëllimeve të zhvillimit të pranuar ndërkombëtarisht, duke përfshirë edhe objektivat e zhvillimit të Mijëvjeçarit.

Duke theksuar nevojën për krijimin e kapaciteteve, si një mjet për të promovuar zhvillimin mirëpritjen e bashkëpunimeve ndërmjet INTOSAI-t dhe Kombeve të Bashkuara, në lidhje me këtë,

1. Njeh faktin se Institucionet Supreme të Auditimit, mund të ushtrojnë detyrat e tyre në mënyrë efijente dhe efektive, vetëm nëse ata janë të pavarur nga njësitë e audituar dhe janë të mbrojtur nga ndikimet e jashtme.
2. Gjithashtu, njeh rolin e rëndësishëm të këtyre institucioneve, në promovimin e efijencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës në administrimin publik, i cili i vjen në ndihmë edhe arritjes së objektivave dhe prioriteteve për zhvillim kombëtar, si dhe arritjes së qëllimeve të pranuar ndërkombëtarisht, duke përfshirë edhe qëllimet e zhvillimit të Mijëvjeçarit.
3. Vlerëson punën e INTOSAI-t në promovimin e efijencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës, si dhe përdorimin me efijencë dhe efektivitet të burimeve publike, në të mirë të qytetarëve.
4. Gjithashtu, vlerëson Deklaratën e Limës, Udhëzuesit mbi rregullat e auditimit të vitit 1977<sup>2</sup> dhe Deklaratën e Meksikos mbi pavarësinë e SAI-ve, në vitin 2007<sup>3</sup> dhe inkurajon shtetet anëtare të aplikojnë këto deklarata, në përputhje me strukturat e tyre kombëtare.

<sup>1</sup> Shiko rezolutën 52/2

<sup>2</sup> Deklarata e Limës, Udhëzime mbi Rregullat e Auditimit, miratuar në Kongresin e 9-të të INTOSAI-t, 17-26 tetor 1977.

<sup>3</sup> Deklarata e Meksikos mbi INTOSAI-n, miratuar në Kongresin e 19-të të INTOSAI-t, 5-10 nëntor 2007.



5. Inkurajon shtete anëtare dhe institucionet e ngjashme në OKB, të vazhdojnë dhe të intensifikojnë marrëdhëniet e tyre, duke përfshirë edhe ngritjen e kapaciteteve, me INTOSAI-n, për të promovuar mirë qeverisjen, efikasitetin, përgjegjshmërinë, efektivitetin dhe transparencën, duke forcuar rolin e Institucioneve Supreme të Auditimit.

*Takimi plenar i 91-të  
22 dhjetor 2011*






INTOSAI

E shkuara – E tashmja – **E ardhmja**

**RRUGA E ZHVILLIMIT  
DHE E VIZIONIT PËR INTOSAI-n –  
Drejt së ardhmes së INTOSAI-t**





## Rruga e Zhvillimit dhe e Vizionit për Intosai-N – Drejt së Ardhmes së Intosai-t

### 1. Sfidat me të cilat përballlet INTOSAI

INTOSAI është organizata e dytë ndërkombëtare më e madhe, pas OKB. Që nga viti 2004, INTOSAI ka dekretuar dhe implementuar dy plane strategjike, ka përcaktuar qëllime strategjike, vlera dhe prioritete, ka publikuar një gamë të gjerë standardesh, udhëzuesish dhe praktikash më të mira, si dhe ka ndarë gjerësisht eksperiencën dhe koncepte të shumta auditimi. Ai ka organizuar shumë workshop, seminare dhe aktivitete të tjera që lidhen me krijimin e kapaciteteve, si dhe ka pasur arritje të shumta për sa i përket pavarësisë, rritjes së kompetencave dhe efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së SAI-ve. INTOSAI ka fituar së tepërmi besimin dhe vlerësimin e SAI-ve, për sa i përket çështjeve të planifikimit strategjik, diversifikimit të strukturës organizative, si dhe për sa i përket mekanizmit të hapur të punës që ai praktikon. Në fushën e menaxhimit publik, kjo organizatë po tërheq gjithnjë e më tepër vëmendjen e grupeve të shumta të interesit, duke u kthyer në një organizëm “standard bërës” shumë i nevojshëm dhe një lojtar shumë i rëndësishëm në arenën e auditimit ndërkombëtar.



Së bashku me zhvillimin e vazhdueshëm të INTOSAI dhe evoluimin e shpejtë të globalizimit dhe teknologjisë së informacionit, situata globale po pëson ndryshime të thella. Mjedisi i jashtëm i auditimit po sjell mundësi të reja, ndërsa domethënia dhe shtrirja e tij vazhdon të pasurohet dhe të zhvillohet. Zhvillimet e reja në SAI të ndryshme, sjellin sfida të shumta për INTOSAI-n, duke përfshirë edhe çështje që lidhen me trajtimin e nevojave për zhvillim në auditim, përmirësimet e mundshme në mënyrën e organizimit dhe operacioneve, si dhe metodat për të siguruar arritjen e objektivave. INTOSAI duhet të trajtojë në mënyrën e duhur këto sfida, në mënyrë që të arrijë zhvillime maksimale.

#### **Sfidat që paraqiten me zhvillimin e SAI-ve.**

Sfidat fillestare me të cilat u përball INTOSAI, erdhën nga nevoja për të përballuar dhe integruar zhvillime të reja brenda SAI-ve. Sipas Planit Strategjik të INTOSAI-t 2011 - 2016, INTOSAI ka për qëllim të “promovojë përmirësimet e vazhdueshme mes anëtarëve të saj”. Për këtë arsye, është e nevojshme që INTOSAI të kryej kërkime mbi çështje me interes të përbashkët për SAI-t, si dhe të inkurajojë bashkëpunimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tyre (INTOSAI Qëllimi 3). Një nga detyrat kryesore të INTOSAI-t është të studiojë fusha dhe metodologji të reja auditimi, si dhe të publikojë dhe promovojë rezultatet e tyre.

Me ndryshimet e fundit në mjedisin e auditimit të jashtëm, po shfaqen gjithnjë e më tepër çështje të reja auditimi dhe metodologjitë audituese po ndryshojnë me shpejtësi. Gjithashtu edhe kërkesat e grupeve të interesit ndaj SAI-ve, janë gjithmonë në rritje e në zhvillim. Çështje - si zhvillimi i qëndrueshëm, qeverisja kombëtare, siguria kombëtare, pjesëmarrja qytetare, evoluimi i politikave, rregulloret e sistemit financiar, si dhe auditimi investigativ (forensic), janë kthyer në objektivat më të reja për SAI-t.



### **Sfidat që solli globalizimi**

Një tjetër sfidë që po përballon INTOSAI, është të kuptojë dhe të trajtojë me qartësi, procesin e globalizimit. Që në vitet 1990, si pasojë e integritit ekonomik, globalizimi ka pushtuar botën në mënyrë agresive. Kriza hipotekare amerikane dhe kriza e borxhit evropian, i ka tejkaluar impaktet në qeverisjen kombëtare duke shkaktuar një ndikim të madh edhe në vendet e tjera. Që nga viti 2011, mungesa e ekuilibrit të jashtëm është kthyer në një çështje kyçe në koordinimin e politikave ndërkombëtare. Çekuilibri ekonomik global, ristrukturimi i sistemit financiar ndërkombëtar, si dhe reforma rregullatore financiare, janë kthyer në çështje globale me interes të përbashkët, duke bërë thirrje për një zgjidhje urgjente nga ana e bashkësisë ndërkombëtare.

Ndërkohë, rëndësia e një qeverisjeje globale, po spikat gjithnjë e më tepër. Gjithnjë e më tepër, vendet po kuptojnë se vetëm duke përdorur mekanizmat ndërkombëtare, ata mund të zgjidhin në mënyrë eficiente, shumë probleme globale me të cilat po përballen. Aktualisht, rregullat dhe mekanizmat e qeverisjes globale, po kalojnë një fazë të re tranzicioni. Kuadri ekzistues ekonomik ndërkombëtar, ka nevojë për përmirësime të vazhdueshme, në mënyrë që të krijohet një sistem ekonomik ndërkombëtar dhe një sistem qeverisës global, në favor të efijencës. Kjo gjë gjithashtu, kërkon edhe reagimin e duhur ndaj çështjeve si mekanizmat e tregtisë botërore, ndryshimet klimatike, lufta kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave, si dhe promovimi i një ekonomie të balancuar me përfitim universal. Si një organizatë profesionale e krijuar nga SAI-t e Kombeve të Bashkuara, INTOSAI luan një rol kryesor në inkurajimin e tyre për të audituar llogaritë dhe veprimtaritë qeveritare dhe në përmirësimin e menaxhimit dhe përgjegjshmërisë qeveritare.

Me autoritetin që gëzon, INTOSAI ka potencialin për tu bërë një pjesëmarrës efektiv në qeverisjen globale, si dhe në koordinimin, vlerësimin dhe promovimin e kësaj qeverisjeje. Një nga pikat e axhendës në seksionin e 66-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB, ishte dhe miratimi i një rezolute e cila njihje rolin thelbësor të SAI-ve, në promovimin e efijencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës në administratën publike. INTOSAI ka nevojë të përmirësojë parashikimet e tij kundrejt çështjeve globale, duke përfshirë edhe punën e tij, si dhe të përgatitet për një pjesëmarrje më të gjerë në vazhdim, në qeverisjen globale.

### **Sfidat e përballuara në forcimin e vetë përmirësimit, përmirësimit të efijencës dhe arritjen e mirë-qeverisjes**

INTOSAI po angazhohet për tu kthyer në një organizatë ndërkombëtare model, duke përcaktuar një strukturë organizative të larmishme dhe një mekanizëm pune të hapur dhe përfshirës, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë efijencës dhe qeverisjes së brendshme. INTOSAI integron në mënyrë pozitive punën e Komiteteve të saj, Grupeve të Punës, Nën-Komiteteve dhe Skuadrave të Projekteve. Nëpërmjet përcaktimit të Qëllimeve të Bashkëpunimit, formulimit të Udhëzuesve të Komunikimit, zbatimit të Mjeteve Online të Ndërveprimit, si dhe nëpërmjet platformave të tjera të punës, INTOSAI siguron një komunikim dhe koordinim efektiv, transparent dhe në kohë, ndërmjet anëtarëve të saj dhe grupeve të interesit.

Megjithatë, në praktikë, ekzistojnë pengesa dhe vështirësi që ndikojnë më rolin e INTOSAI-t, të cilat përfshijnë: Së pari, me rritjen e numrit të organizmave të brendshëm, si dhe të çështjeve më shqetësuese, puna e Komiteteve dhe Grupeve të Punës së INTOSAI-t, ka nevojë të forcohet dhe koordinohet më tej. Së dyti, disa nga platformat e



komunikimit dhe bashkëpunimit, nuk janë përdorur ende në mënyrë efektive. Së treti, pjesëmarrja e anëtarëve të INTOSAI-t në aktivitete është e kufizuar nga hendeqet në sistem dhe burimet e papërshtatshme, të cilat sjellin një pjesëmarrje jo të balancuar ndërmjet anëtarëve. Së katërti, rezultatet e aktiviteteve të INTOSAI-t duhet të promovohen dhe zgjerohen më tej. Së pesti, INTOSAI duhet vazhdimisht të demonstrojë rolin dhe opinionin e tij në fusha të ndryshme.

## 2. Një Projekt për zhvillimin e INTOSAI-t në të ardhmen

Duke u përballur me sfidat që paraqiten nga zhvillimet në fushën e auditimit, globalizimi dhe vetë përmirësimi, INTOSAI duhet të marrë në konsideratë përditësimin e misionit, detyrave dhe përgjegjësi të tij, si dhe të eksplorojë për reformimin dhe inovacione në mekanizmat e tij operacionale dhe koordinuese. Si Kryetari i radhës i INTOSAI-t, duke marrë parasysh rolin pozitiv të tij dhe duke planifikuar zhvillimet e ardhshme, CNAO parashikon se do të aplikojë Planin Strategjik 2011 - 2016 si një projekt zhvillues, si dhe do të arrijë të përmbushë kërkesat e SAI-ve, nën një këndvështrim të ri. Krahas përmirësimeve të vazhdueshme të kuadrit të Standardeve Ndërkombëtare dhe përditësimit të teknikave audituese, INTOSAI gjithashtu do të udhëheqë dhe asistojë anëtarët e tij, në trajtimin dhe priorizimin e detyrave dhe çështjeve të mëposhtme:

Së pari, në përmbushjen e sfidave që i paraqiten zhvillimit të auditimit kombëtar, INTOSAI duhet të mbajë parasysh rëndësinë e çështjes në fjalë, si dhe të përditësojë dhe përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme planifikimin e tij strategjik. Bazuar në një kuptim të plotë të çështjeve të reja dhe zhvillimit të auditimit në shoqërinë e sotme, INTOSAI mund të zhvillojë kërkime, shkëmbime, si dhe të publikojë rezultate për t'u bërë pararendës i auditimit të sektorit publik.

Ndërsa INTOSAI në mënyrë aktive promovon kërkime praktike mbi auditimet e performancës, financiare dhe të pajtueshmërisë dhe vendos standarde profesionale për audituesit, ai në mënyrë aktive duhet edhe të merret me zhvillimin e ri të SAI-ve, si dhe të sjellë çështje të reja të auditimit dhe metodologjisë në këtë fushë, për të siguruar largpamësi, forcimin dhe integrimin e fushave të reja, si dhe të metodave që lidhen me shkëmbimin e njohurive. INTOSAI duhet të inkurajojë SAI-t të përqendrohen (por jo të kufizohen) në temat e mëposhtme në të ardhmen:

- **Roli i SAI-ve në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm në shoqërinë njerëzore.** Zhvillimi i qëndrueshëm i shoqërisë njerëzore, është aspirata dhe qëllimi i përbashkët i të gjithë vendeve dhe një nga çështjet më të rëndësishme me të cilën përballen qeveritë dhe SAI-t, në mileniumin e ri. Në mënyrë që të komunikohen plotësisht vlerat dhe përfitimet e punës audituese, INTOSAI duhet të inkurajojë në mënyrë aktive zhvillimin e auditimeve, nëpërmjet implementimit të bashkëpunimeve multilaterale dhe iniciativave të rëndësishme që ndërmarrin Komitetet dhe Grupet e Punës së INTOSAI-t. INTOSAI gjithashtu, duhet të nxis krijimin dhe përmirësimin e një sistemi të qëndrueshëm raportimi, të kryej auditime bashkëpunuese në fushat e mjedisit global dhe rajonal, si dhe të vlerësojë zbatimin dhe efektet e objektivave kombëtare të planifikimit strategjik dhe nivelin e progresit ekonomik dhe shoqëror. Për më tepër, ai duhet të lëshojë në kohë raporte të rëndësishme kërkimore në shërbim të shoqërisë dhe publikut, si dhe të kontribuojë në sigurimin e qëndrueshmërisë së mbijetesës njerëzore, rritjen ekonomike, zhvillimin social dhe mbrojtjen e mjedisit.



- **Të promovojë përmirësime konstante të qeverisjes kombëtare.** Edhe pse sistemet kombëtare politike dhe sistemet e kontrollit ndryshojnë nga vendi në vend, SAI-t duhet të jenë të gjithë të angazhuar për forcimin e përgjegjshmërisë dhe transparencës së financave publike dhe të administratës publike dhe të favorizojnë vendosjen dhe përmirësimin e mekanizmave rregullatorë. Si rezultat, nxitja e qeverisjes së mirë është kthyer në një objektiv të rëndësishëm të auditimit kombëtar. Përmes funksionit të tij të kontrollit dhe balancimit të pushtetit, auditimi mund të luajë një rol të rëndësishëm dhe pozitiv në promovimin e demokracisë, përmirësimin e sundimit të ligjit, luftën kundër korrupsionit, ruajtjen e sigurisë kombëtare, nxitjen e reformës, duke ruajtur jetesën e njerëzve dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm. INTOSAI mund të inkurajojë SAI-t për t'iu përshtatur situatave të reja dhe kërkesave dhe për të vazhduar procesin e forcimit dhe përmirësimit të auditimit kombëtar.

INTOSAI duhet të vazhdojë ti përshtatet tendencave të kohës dhe praktikave zhvillimore të SAI-ve, për të përmirësuar mekanizmat e saj të planifikimit strategjik, të kryej hulumtime në auditimet e ardhshme, si dhe të promovojë këmbimin e eksperiencave, bashkëpunimin dhe shkëmbimin e njohurive mes SAI-ve, të ndajë praktikat më të mira dhe eksperiencat e auditimit kombëtar dhe vazhdimisht të përmirësojë cilësinë dhe efektet e auditimit, duke u kthyer në pionier dhe lider në auditimin e sektorit publik.

Së dyti, për të përmbushur sfidat që sjell globalizimi, INTOSAI duhet të inkurajojë SAI-t për të marrë pjesë në auditimet ndërkombëtare bashkëpunuese dhe auditime të organizatave ndërkombëtare. Ndërkohë, ai mund të organizojë dhe të marrë pjesë në qeverisjen globale të nivelit të lartë dhe të bëhet një partner dhe një lojtar kyç në qeverisjen globale.

Në epokën e globalizimit, qeverisja globale me vlerat e saj unike, rregullat dhe mekanizmat operacionale, përbën një shqetësim të madh. INTOSAI duhet të pranojë ndikimin që sjell globalizimi ndaj SAI-ve, të reagojë ndaj pritshmërive të palëve të interesit, si dhe të vlerësojë përmbushjen e sfidave të shumta që vijnë me globalizimin. INTOSAI duhet të përfaqësojë një zë të koordinuar dhe të unifikuar, si dhe të veprojë në emër të të gjithë SAI-ve në arenën ndërkombëtare, për sa i përket çështjeve ndër-kufitare ndërkombëtare. Së bashku me organizata të tjera ndërkombëtare, të shoqërisë civile dhe tregut ekonomik global, INTOSAI duhet të jetë një hallkë e rëndësishme në përgjegjshmërinë e sektorit publik dhe duhet të marrë pjesë në mënyrë aktive (por jo të kufizuar) në aktivitetet e mëposhtme në të ardhmen:

- **Pjesëmarrja në formulimin e kuadrit rregullator për qeverisjen globale.** Si një pjesëmarrës në qeverisjen globale, INTOSAI mund të luajë një rol më aktiv në nxitjen e qeverisjes së mirë globale. Ai duhet të ndjekë trendin e kohës dhe të marrë masa pozitive dhe efektive për tu konsultuar dhe planifikuar së bashku me OKB, Bankën Botërore, G20, OECD dhe institucionet e tjera shumëpalëshe të qeverisjes, si dhe të luajë rolin e këshilltarit në ECOSOC, të marrë pjesë në Konferencat e OKB dhe aktivitete të tjera shumëpalëshe. Përveç kësaj, ai duhet të ndihmojë në përmirësimin e rregullave ekonomike ndërkombëtare si standardet financiare ndërkombëtare, përmirësimin e standardeve të kontabilitetit dhe auditimit të sektorit publik global dhe të krijojë një sistem vlerësimi tregues për zhvillimin social dhe progresin në mënyrë që të marrë pjesë në ndërtimin e qeverisjes shumëpalëshe.

- **Të marrë pjesë në aktivitetet e qeverisjes globale.** INTOSAI ka burimet dhe aftësinë për të marrë pjesë në qeverisjen globale. INTOSAI duhet të inkurajojë SAI-t të marrin pjesë në aktivitetet e qeverisjes për zhvillimin



social dhe vlerësimin e progresit, të ofrojë shërbime të pavarura të auditimit për organizatat ndërkombëtare dhe multinacionale, si dhe të trajtojë dhe të zgjidhë çështje rajonale dhe globale dhe për të nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar ekonomik dhe shoqëror. INTOSAI mund të konsiderojë krijimin e një grupi pune për qeverisjen globale në mënyrë që të studiojë problemet relevante praktike, si forcimi i disiplinës financiare, zbulimi i rreziqeve ekonomike, lufta kundër korrupsionit dhe ruajtja e operacioneve të ekonomisë botërore të qëndrueshme.

INTOSAI duhet të bëhet një organizatë ndërkombëtare e angazhuar për qeverisjen globale dhe një krijues, organizator, aktor dhe mbikëqyrësi i parimeve globale ligjore, rregullave dhe institucioneve. Kryetari i INTOSAI, Sekretari i Përgjithshëm, si dhe aktorë të tjerë të kësaj organizate, duhet të marrin pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet shumëpalëshe të komuniteteve ndërkombëtare për të realizuar qëllimet përkatëse.

Së treti, për të përmbushur sfidat e forcimit të vetë-përmirësimit, përmirësimin e efikasitetit dhe arritjen e një qeverisje të mirë, INTOSAI duhet të miratojë masa të ndryshme për të përsosur mekanizmat e tij të punës, për të përmirësuar komunikimin dhe për të siguruar pjesëmarrjen e barabartë të SAI-ve në kuadër të kornizës ekzistuese organizative. Ai duhet të fokusohet në ngritjen e kapaciteteve të vendeve në zhvillim dhe të bëhet një organizatë model ndërkombëtare me qeverisje të fuqishme të brendshme.

Duke u përballur me sfidat e forcimit të vetë-përmirësimit, përmirësimin e efikasitetit dhe arritjen e një qeverisje të mirë, INTOSAI duhet të forcojë edhe më tej menaxhimin e tij të brendshëm dhe të zbatojë parimet e mëposhtme:

- **Praktikimi i parimeve të zhvillimit, bashkëpunimit, komunikimit, koordinimit dhe efijencës** gjatë operacioneve. Si një organizatë ndërkombëtare e SAI-ve, INTOSAI është nyja kryesore dhe një platformë tepër e rëndësishme vendimmarrëse për shkëmbimin e informacionit, bashkëpunimit teknik dhe organizimin e seminareve në fushën e auditimit të qeverisë nëpër botë. Për të siguruar efikasitetin dhe efektivitetin si një organizatë ndërkombëtare, ai duhet të zbatojë parimet e zhvillimit, bashkëpunimit, komunikimit, koordinimit dhe efikasitetit, si dhe të sigurojë pjesëmarrje të barabartë të SAI-ve në çështjet ndërkombëtare të auditimit. Ai duhet të kërkojë konsensusin nëpërmjet negociimeve, të ndjekë zhvillimin nga bashkëpunimet dhe të bëjë përpjekje për të zgjeruar konvergencën e interesave të të gjitha vendeve. Duke ndjekur parimin "diskutojmë dhe konsultohemi, kërkojmë gjuhën e përbashkët duke rezervuar dallimet, jemi përfshirës dhe të hapur", INTOSAI do të arrijë ndarjen e përvojës, bashkëpunimit dhe një situatë të favorshme. Për këtë qëllim, INTOSAI duhet të përmirësojë më tej koordinimin e tij dhe komunikimin me masat, duke përfshirë miratimin e Udhëzuesit të Komunikimit, duke marrë pjesë në mënyrë aktive në konferenca ndërkombëtare dhe nëpërmjet broshurave botuese, për të zgjeruar ndërveprimin me grupet e interesit. Ai gjithashtu duhet të integrojë dhe të konsolidojë forma të ndryshme të ndihmës financiare të marra nga komisionet e INTOSAI dhe ti planifikojë ato si një e tërë nga Komiteti i Administrimit të Financave. Ai duhet të studiojë mundësinë e publikimit të Raportit të Performancës së INTOSAI-t dhe rezultatet e tjera të punës dhe të inkurajojë SAI-t për të përdorur në mënyrë aktive rezultatet përkatëse kërkimore.



• **Ti kushtohet rëndësi e veçantë pjesëmarrjes së barabartë dhe nevojës për krijimin e kapaciteteve për vendet e zhvilluara dhe më pak të zhvilluara.** Për të siguruar zbatimin e suksesshëm të prioriteteve strategjike të listuara në Planin Strategjik të INTOSAI-t, INTOSAI duhet t'i kushtojë vëmendje ndërtimit të kapaciteteve të SAI-ve. INTOSAI duhet ti kushtojë rëndësi aspiratave të tyre legjitime dhe të promovojnë zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar me komunitetin e donatorëve. Ai duhet të rrisë mbështetjen e mjaftueshme dhe të qëndrueshme financiare dhe të përqendrohet në sigurimin e ndihmës dhe mbështetjes në drejtim të kapitalit, teknologjisë dhe të trajnimit të personelit. Në Komitetet e INTOSAI-t dhe aktivitetet e lidhura me të, ai duhet të mbrojë përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e drejtë të SAI-ve, si dhe të ofrojë ndihmë financiare, të inkurajojë ata që të marrin pjesë në mënyrë aktive në punën e INTOSAI-t dhe të kontribuojë në zhvillimin e përbashkët dhe bashkëpunimin ndërkombëtar .

INTOSAI duhet të bëhet një organizatë ndërkombëtare model, me shfaqje të lartë efikasiteti dhe pjesëmarrje të barabartë. Kryetari i INTOSAI, Sekretari i Përgjithshëm, si dhe aktorë të tjerë të kësaj organizate, duhet bashkërisht të promovojnë mirë qeverisjen e brendshme për INTOSAI.

## Epilog

Me përshpejtimin e progresit shkencor dhe teknologjik dhe globalizimin, modeli politik dhe ekonomik botëror ka pësuar ndryshime të mëdha dhe zhvillimi ekonomik dhe social po hyn në një fazë të re. Me qëllim përmirësimit e rolit të auditimit kombëtar, SAI-t duhet të bazohen në kushtet e tyre aktuale dhe të adaptojnë mënyra dhe metodologji auditimi më kreative. Ata duhet të marrin masa efektive për të rritur kapacitetet e auditimit dhe për të përmbushur sfidat për të kënaqur nevojat e qeverisjes kombëtare. SAI-t duhet të forcojnë shkëmbimin e ndërsjellë dhe të bashkëpunimit dhe të ndajnë praktikat më të mira kombëtare dhe përvojën mes njëri-tjetrit, për të arritur një zhvillim të përbashkët të auditimit kombëtar në mbarë botën.

Për tu përballur me situata dhe sfida të reja të zhvillimit, INTOSAI ka nevojë të forcojë qeverisjen e brendshme dhe të përmirësojë mekanizmat e tij të planifikimit strategjik. Ne fuqimisht besojmë se INTOSAI do të luajë një rol më pozitiv dhe më aktiv në qeverisjen globale në të ardhmen dhe do të kthehet në një pionier në sektorin e auditimit publik, një pjesëmarrës i rëndësishëm i qeverisjes globale dhe një organizatë ndërkombëtare model. CNAO pret me pozitivitet bashkëpunime të reja me SAI-t anëtare të INTOSAI-t, për të forcuar më tej shkëmbimin e ndërsjellët, në mënyrë që të japë kontribute të reja dhe pozitive në zhvillimin e ardhshëm të INTOSAI-t.






**bosh**






# KONTRIBUTE NGA ANËTARËT E INTOSAI-t





## Kontribut nga SAI i Algjerisë

### PËRVJETORI I INTOSAI-t





Në prag të 60-vjetorit të INTOSAI-t, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi rezolutën (A/66/209) më 22 dhjetor 2012, e cila konfirmon Deklaratën e Limës dhe Meksikës si dokumente integrale dhe që forcojnë pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit.

Kjo Rezolutë e OKB-së paraqet me të vërtetë një moment të ri në historinë 60-vjeçare të auditimit të qeverisë nga SAI-t duke pranuar shprehimisht se:

- Institucionet Supreme të Auditimit mund të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë objektive dhe efektive vetëm nëse ato janë të pavarura nga subjekti i kontrolluar dhe janë të mbrojtur nga ndikimet e jashtme;
- Institucionet Supreme të Auditimit luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e efikasitetit, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, e cila është e favorshme për arritjen e objektivave të zhvillimit, duke përfshirë edhe Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit.

Me këtë rezolutë, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara inkurajon shtetet anëtare të zbatojnë parimet e përcaktuara në Deklaratën e Limës dhe në Deklaratën e Meksikës, të cilat përcaktojnë tetë shtyllat e pavarësisë së SAI-ve si kërkesat themelore për auditimin e qeverisë dhe inkurajon ata që të intensifikojnë bashkëpunimin e tyre me INTOSAI-n.

Duke forcuar SAI-t, kjo rezolutë kurorëzon suksesin e INTOSAI-t në aktivitete të shumëfishta në historinë e tij 60-vjeçare.

Për SAI-n tonë, kjo ngjarje festive gjithashtu paraqet një mundësi për të vlerësuar rezultatet e arritura, në mënyrë që të zhvillojmë një kuptim më të mirë të sfidave të ardhshme.



### Zhvillimi i bashkëpunimeve – një burim kënaqësie për SAI-n tonë

Që nga anëtarësimi në INTOSAI, Gjykata e Auditimit të Republikës Demokratike të Algjerisë, ka njohur një zhvillim vendimtar në bashkëpunimin e saj ndërkombëtar, gjë që theksohet edhe nga arritjet tona cilësore.

Pjesëmarrja në Kongrese të ndryshme të INTOSAI-t, në simpoziume të organizuar bashkërisht me OKB dhe në takime e seminare të tjera, i kanë dhënë një mundësi Gjykatës së Auditimit, që të angazhohet në mënyrë aktive, si dhe të përfitojë nga përvoja të ndryshme të SAI-ve pjesëmarrëse. Normat ISSAI të përgatitura nga INTOSAI,



janë një burim frymëzimi për aktivitetet e SAI-t tonë.

## Zhvillimet më të fundit në INTOSAI

Që nga themelimi i tij në vitin 1953, INTOSAI ka përjetuar një zhvillim të rëndësishëm, me një anëtarësim në rritje nga 29 në 191 SAI. Edhe sot, INTOSAI është ende duke luajtur një rol thelbësor në promovimin e qeverisjes së mirë dhe transparencës e llogaridhënies publike në përgjithësi.

Sot, INTOSAI ofron një kuadër institucional që është pjesë e Kombeve të Bashkuara dhe është njohur ndërkombëtarisht si përfaqësimi profesional i SAI-ve në mbarë botën. Organizata arriti sukses duke u bërë një platformë globale për ekspertët e auditimit financiar, ku ata mund të adresojnë çështjet e interesit aktual dhe mund të mbledhin informacion mbi normat më të reja të auditimit të qeverisë dhe procedurat e praktikave më të mira.

Struktura më fleksibël dhe një organizim efektiv, janë domosdoshmëri për të siguruar zhvillime të mëtejshme në të ardhmen.

## Sfidat në të ardhmen

INTOSAI ka përgatitur Planin Strategjik 2011 - 2016: Ky plan ka qëllime ambicioze, zbatimin konkret i të cilave përbën avantazh për realizimin e Qëllimit Strategjik 4 - Organizata Ndërkombëtare Model. Ky qëllim bazohet në parimet themelore të cilat duhet të nxisin miratimin e procedurave organizative dhe administrative, në mënyrë që të inkurajohet një pjesëmarrje e plotë e SAI-ve në aktivitetet e tij. Për të arritur këtë, INTOSAI mbështet krijimin e strukturave të reja vendimmarrëse që sigurojnë kujdesin e nevojshëm: Kjo përfshin një ndërlidhje të drejtpërdrejtë mes Sekretariatit të Përgjithshëm, Këshillit drejtues, Komiteteve, Nën Komiteteve, Grupeve të Punës dhe Task Forcat, si dhe një bashkëpunim intensiv mes Komiteteve për të ruajtur rrjedhën e informacionit dhe për të lehtësuar përpunimin e tij të drejtë.

Në përputhje me këtë, Sekretariati i Përgjithshëm, ofron mbështetje administrative, menaxhon buxhetin, mbështet Bordin Drejtues në aktivitetet e tij dhe në Kongres, lehtëson komunikimin dhe organizon seminare. Kjo është arsyeja pse ai gjithashtu duhet të sigurojë në të ardhmen fonde të mjaftueshme për të siguruar zbatimin efikas dhe dinamik të masave të përcaktuara në Planin Strategjik. E gjithë kjo nuk mund të parashihet pa një fleksibilitet thelbësor, gjë që garanton kapacitetet e nevojshme për INTOSAI-n në mënyrë që të jetë në gjendje të përmbushë sfidat aktuale dhe të ardhshme.


Ky fleksibilitet përfshin struktura organizative që i mundësojnë INTOSAI-t të përmbushë detyrat e tij, duke marrë në konsideratë parimet e efektivitetit, ekonomisë dhe efikasitetit. Me këtë kontribut, Gjykata Algjeriane e Auditimit do të donte të siguronte angazhimin e saj të plotë për këtë botim të përbashkët dhe mbështetjen e saj të plotë në përpjekjet e bëra nga INTOSAI.





## Kontribut nga SAI i Australisë

Bashkëpunimi i Zyrës Kombëtare  
të Auditimit të Australisë  
me INTOSAI





## Seksioni A

1. Institucioni Suprem i Auditimit të Australisë, Zyra Kombëtare Australiane e Auditimit (ANAO), ka qenë një anëtare aktive e INTOSAI-t pasi u bashkua me organizatën në takimin e 3 të Bordit Drejtues të INTOSAI-t, mbajtur në Japoni më 22 Maj 1968. ANAO ka qenë anëtar i Bordit Drejtues të INTOSAI në vitet 1977-1998 dhe e ka vazhduar zhvillimin e saj nëpërmjet përfshirjes dhe pjesëmarrjes në Kongrese dhe grupe të ndryshme të punës.

2. ANAO organizoi INCOSAI XXI në Sidnej në prill 1986. Dy rezultatet më të rëndësishme nga ky takim përfshinin shfaqjen e auditimit të performancës si një zgjatje të ligjshme të mandatit të auditimit të sektorit publik dhe krijimin e Inicativës për Zhvillim të INTOSAI-t.

3. ANAO merr pjesë në dy grupe rajonale ASOSAI dhe PASAI dhe si anëtare e nën-grupit ASOSAI, ANAO priti takimin e10 dhe të 19 të Bordit Drejtues, në vitin 1980 dhe vitin 1989. ANAO ka pritur dy seminare të organizuara nga ASOSAI, në të cilët morën pjesë mbi 50 pjesëmarrës secili. Në vitin 2006 ANAO priti një takim të Task Forcës së INTOSAI mbi përgjegjësitë dhe auditimin e çështjeve që lidhen me fatkeqësitë natyrore. ANAO është gjithashtu një anëtare e Nënkomitetit të Auditimit të Performancës, Grupit të Punës për Auditimin IT dhe Grupit të Punës për Auditimin Mjedisor.

4. Vitet e fundit, ANAO-s i është kërkuar të marrë pjesë apo të japë opinione vlerësimi për anëtarët e tjerë të INTOSAI-t:

- 2007 - Peer review për Zyrën Kontabël Qeveritare të ShBA
- 2010 - Peer review për ZAP Kanadez
- 2012 - Peer review për SAI-n Indian



5. ANAO ka kënaqësinë të kontribuojë në auditimin në nivel ndërkombëtar përmes aktiviteteve të shqyrtimit të barabartë dhe përfitimet nga të qenit të përfshirë. Opinionet për kolegët përforcojnë rëndësinë e shkëmbimit të ideve dhe përvojës në nivelin e institucionit të auditimit dhe mes anëtarëve të ekipit.

6. ANAO mbështet zhvillimin e auditimit të sektorit publik në vendet fqinje dhe ndan përvojën me Bordin Indonezian të Auditimit (Badan Pemeriksa Keuangan ose BPK) dhe Zyrës së Revizorit të Përgjithshëm Papua Guinea e Re (PNG) përmes programeve kryesore të financuara nga Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar e Australisë (AusAID). Të dy programet përfshijnë prezencën e stafit të ANAO në Xhakartë dhe Port Moresby, për të asistuar në një gamë të gjerë të aktiviteteve që kanë për qëllim forcimin e performancës dhe kapaciteteve të auditimit të pasqyrave financiare në këto njësi, si dhe zhvillimin e marrëdhënieve bashkëpunuese.



7. ANAO gjithashtu mbështet një program të gjerë vizitorësh ndërkombëtarë me rreth 40 pjesëmarrës ndërkombëtare në vit.

## Seksioni B

### Zhvillimet më të fundit në INTOSAI

Rezoluta e Kombeve të Bashkuara A/66/209, e cila promovon eficiencën, përgjegjshmërinë, efektivitetin dhe transparencën në administratën publike, nëpërmjet forcimit të institucioneve supreme të auditimit

8. ANAO mirëpret iniciativën e INTOSAI që pati si produkt Rezolutën e OKB - A/66/209. Rezoluta e OKB-së jep një shtysë të mëtejshme për angazhimin e ANAO për të ndihmuar organizatat homologe të Indonezisë dhe Papua Guinea e Re, në zhvillimin e lidhjeve të ngushta dhe ndërtimin e kapaciteteve përmes programeve ndërkombëtare. Pjesëmarrja e ANAO në forumet ndërkombëtare dhe në programet ndërkombëtare nëpërmjet opinionit mbi kolegët, jep mbështetje të mëtejshme për objektivin e rezolutës së.

9. Koordinimi i Auditimit Ndërkombëtar mbi Ndryshimet Klimatike, Nëntor 2010

10. Në qershor 2007, nën kujdesin e Grupit të Punës së INTOSAI-t mbi Auditimin Mjedisor, përfaqësues nga 14 SAI filluan punën në një projekt bashkëpunues që synon hartimin dhe ndërmarrjen e auditimeve kombëtare mbi programet klimatike respektive qeverive. Si pjesë e këtij bashkëpunimi, ANAO paraqiti dy auditime në prill 2010. Këto auditime japin opinione mbi një numër aspektesh që përfshijnë koordinimin e programeve për ndryshimet klimatike në të gjithë qeveritë, si dhe çështje të ndryshme që lidhen me hartimin dhe zbatimin e programeve për zbutjen e ndryshimeve specifike klimatike.

11. Bashkëpunimi në një shkallë kaq të madhe ishte sfidues, nisur nga mandatet e ndryshme dhe qasjet e auditimit të SAI-ve. Megjithatë, kjo ishte një përvojë me cilësi të lartë për sa i përket të mësuarit dhe ofrimit të mundësive të tjera për pjesëmarrësit.

## Seksioni C


### Mundësitë e INTOSAI-t për të ardhmen

1. INTOSAI ka bërë progres të rëndësishëm vitet e fundit, në shumë fusha, nëpërmjet kontributeve të vendeve anëtare. Por gjithmonë ekziston mundësia për të bërë më shumë, për ta çuar përpara auditimin globalisht. Mundësi të tilla përfshijnë:

- Përbushje më e suksesshme e pritshmërive nga parlamentarët tanë, në fusha të tilla si vlerësimi i vlerës për paratë në auditimet tona të performancës;
- Zbatimi i iniciativave për ngritjen e kapaciteteve, të cilat përfshijnë bashkëpunimin me organizatat donatore; dhe
- Kontribute të mëtejshme në zhvillimin dhe përputhshmërinë me standardet e auditimit që aplikohen gjerësisht.



## Kontribut nga SAI i Azerbaixhanit





**Heydar Asadov**

**Kryetar i Dhomës së Llogarive të Republikës së Azerbajxhanit**

**SFIDAT E ARDHME PËR INTOSAI-n**

Dhoma e Llogarive – Institucioni Suprem i Auditimit të Republikës së Azerbajxhanit, me një eksperiencë më tepër se 10 vjeçare si anëtare e INTOSAI-t, vlerëson jubileun e 60-të të INTOSAI-t dhe atë të 50-të të Sekretariatit të Përgjithshëm në Vjenë, si një event tepër i rëndësishëm për çdo SAI dhe për të gjithë komunitetin e auditimit të jashtëm suprem.

Duke përfituar nga ky rast, është kënaqësi të nxjerr në pah rolin e jashtëzakonshëm të bashkëpunimit mes SAI-t tonë dhe INTOSAI-t në vitet e fundit, si dhe me grupet e saj të punës në rritjen e kapaciteteve të institucionit tonë. Kjo është arsyeja pse do të dëshironim të shprehim mirënjohjen tonë për zyrtarët më të lartë të INTOSAI-t, si dhe për kolegët tanë nga vendet me të cilat bashkëpunojmë. Si një SAI i sapo krijuar, ne e parashikojnë zhvillimin tonë në të ardhmen, në bashkëpunim të ngushtë me INTOSAI-n. Duke identifikuar sfidat e ardhshme për INTOSAI-n dhe si një SAI anëtar në fazën e përmirësimit institucional, do të donim edhe ne të ndanim pikëpamjet tona me kolegët tanë dhe të shprehim sigurinë se pritshmëritë tona do të merren parasysh.



Kryetari i Dhomës së Llogarive të Republikës së Azerbajxhanit,  
Z. Heydar Asadov, në Konferencën e 3të EUROSAT-ARABOSAT  
Abu Dhabi, Emiratet e Bashkuara Arabe, 2011

Së pari, ne vlerësojmë miratimin e Rezolutës A/66/209 për Promovimin e efikasitetit, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, nëpërmjet fuqizimit të institucioneve të larta të auditimit. Ne besojmë se ky dokument mund të perceptohet si njohja ligjore e statusit të SAI-ve, në përputhje me parimet bazë të deklaratave të Limës dhe Meksikës. Ne e vlerësojmë shumë menaxhimin e INTOSAI-t, si dhe të Sekretariatit të Përgjithshëm, për arritjen e një suksesi të tillë. Për më tepër, do të donim të shprehim kënaqësinë tonë për arritjen e këtij suksesi të përbashkët të miratimit të Rezolutës, pasi vendi ynë bëri të gjitha përpjekjet e nevojshme diplomatike për këtë.

Ne konsiderojmë se në vazhden e implementimit të Rezolutës, sfidat kryesore për të tashmen dhe të ardhmen e INTOSAI-t, janë përpjekjet efektive për shqyrtimin e duhur të këtij dokumenti të rëndësishëm të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Prandaj, pavarësia e SAI-ve, duhet të forcohet në përputhje me Deklaratën e Meksikës, rolet e SAI-ve në lidhje me qeverisjen kombëtare publike, si dhe rritjen e zhvillimit social ekonomik. Si prioritet në të ardhmen, ne besojmë se do të ishte shumë e rëndësishme vendosja e marrëdhënieve mes INTOSAI-t dhe krerëve të qeverive, veçanërisht në vendet në zhvillim, si dhe përgatitja e mekanizmave përkatës të bashkëpunimit me krerët e shteteve, në mënyrë që të rritet ndërgjegjësimi ndaj kërkesave të Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.

Ne kemi arritur progres të madh në zhvillimin institucional të SAI-t tonë gjatë viteve të fundit edhe si rezultat i



mbështetjes së përhershme dhe të gjithanshme të Presidentit të Republikës së Azerbajxhanit dhe tashmë jemi në pozita për t'ju përgjigjur të gjitha kërkesave aktuale. Si shembull mund të paraqesim ndërtesën e re dhe moderne të Dhomës, e cila është ndërtuar në një kohë shumë të shkurtër. Ndryshime të rëndësishme janë bërë edhe në bazë të akteve përkatëse ligjore për të zgjeruar kompetencat e Dhomës.

Shtrirja e krizës së fudit financiare dhe pasojat e saj të rënda, tregojnë se do të ishte e arsyeshme të forcohej pavarësia institucionale dhe funksionale e SAI-ve, si institucionet më të rëndësishme të sistemit të menaxhimit financiar të shtetit. Në të njëjtën kohë, do të ishte e dobishme rritja e përgjegjësisë dhe rolit të tyre në sigurimin e një politike financiare më të qëndrueshme dhe efikase. Në këtë drejtim, trajnimet dhe rekomandimet përkatëse të nxjerra nga organizata, do të jenë me rëndësi të madhe për mbështetjen e SAI-ve në këtë fushë.

Ne e konsiderojmë organizimin e trajnimeve dhe sigurimin e asistencës teknike për SAI-t, si një nga sfidat më të rëndësishme për INTOSAI-n, të cilat do të mbështesin zbatimin e ISSAI-ve. Siç dihet, INTOSAI ka zhvilluar veprimtari të konsiderueshme në këtë fushë dhe përmes zgjerimit të mbulimit dhe fushës së zbatimit të ISSAI-ve, INTOSAI do të përmbushë detyrimet e saj me sukses dhe në kohë.

Zbatimi i Udhëzimit të INTOSAI-t për Qeverisjen e Mirë (INTOSAI GOV), do të rrisin fuqishëm rolin e SAI-ve për sa i përket efijencës së auditimit të brendshëm dhe analizimit të informacionit financiar dhe atij mbi performancën. Ajo gjithashtu, do të kontribuojë në zhvillimin e mekanizmave efikase rregullatorë, për përcaktimin dhe zbulimin e borxhit publik. Në këtë drejtim, udhëzimet për standardet e brendshme të auditimit për sektorin publik, udhëzimet për raportimin mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme dhe standarde të tjera të rëndësishme për administrimin e riskut në sektorin publik, mund të çojnë në krijimin e një sistemi të përbashkët të auditimit publik dhe vendosjen e masave efikase përkatëse.

Zbatimi me sukses i sfidave të lartpërmendura në të ardhmen, do të forcojë stabilitetin financiar afatgjatë, i cili do të krijojë një bazë të rëndësishme për rritjen ekonomike. Ai gjithashtu do të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme për rritjen e rolit të SAI-ve në sistemin e menaxhimit të financave publike dhe në rritjen e menaxhimit efikas të fondeve publike. Për të forcuar pavarësinë e SAI-ve në kuptimin metodologjik dhe teknik, duhet të shfrytëzohen mekanizmat e tjera ndihmës të INTOSAI-t, në mënyrë që të përmirësohet kuadri ligjor.



Ndërtesa e re e Dhomës së Llogarive të Republikës së Azerbajxhanit


Krahas këtyre çështjeve, ne besojmë se INTOSAI do të fokusohet në problemet të tilla si auditimi mjedisor dhe lufta kundër korrupsionit, të cilat janë sfidat globale dhe aktuale të shekullit të ri. Ne gjithashtu besojmë se bashkëpunimi mes SAI-ve, do të jetë më i frytshëm dhe efikas në të gjitha sferat e INTOSAI-t.





## Kontribut nga SAI i Bahreinit

**60 VJETORI I INTOSAI DHE 50 VJETORI I SEKRETARIATIT TË  
PËRGJITHSHËM NË VJENË**





Me rastin e 60-vjetorit të INTOSAI-t dhe 50-vjetorit të Sekretariatit të Përgjithshëm në Vjenë, Zyra Kombëtare e Kontrollit të Mbretërisë së Bahreinit (NAO) dëshiron të shprehë përgëzimet e sinqerta për të dy organizmat. NAO gjithashtu, dëshiron të përfitojë nga ky rast për të shprehur mirënjohjen e tij për të gjitha palët që luajtën një rol të rëndësishëm në formimin dhe materializimin e vizionit dhe synimeve të INTOSAI-t, veçanërisht Bordit Drejtues, Komiteteve, Grupeve të Punës dhe Task Forcave. NAO ka kënaqësinë që të paraqesë këtë kontribut në publikimin me rastin e përvjetorit, duke u përqendruar vetëm në çështjet më kryesore.

### Zhvillimi i bashkëpunimit ndërkombëtar mes SAI-ve



INTOSAI ka promovuar në mënyrë aktive iniciativat që synojnë mbështetjen e përdorimit të duhur të fondeve publike, duke siguruar udhëzime për SAI-t anëtare. Përpjekje të tilla kanë përfshirë edhe promovimin e shkëmbimit të ideve, njohurive dhe përvojës mes SAI-ve, për të mundësuar përmbushjen e nevojave të tyre profesionale.

Kontributi i INTOSAI-t lidhur me këtë evolucion, doli në pah me miratimin e Deklaratës së Limës (1977) dhe Meksikës (2007), të cilët trajtojnë mbrojtjen e pavarësisë së SAI-ve nga ndikimet e jashtme të njësive të audituara.

Kryetari i KLSH e Bahrein, Z. Hassan Khalifa Al-Jalahma, në simpoziumin e 21 UN / INTOSAI Vjenë, Austri, 2011

INTOSAI ka ofruar mundësi përmirësimi për SAI-t anëtare, duke siguruar mjetet dhe njohuritë e nevojshme për të përballuar rritjen e kërkesave profesionale dhe institucionale të tyre. Ky fuqizim u bë i mundur falë organizimit të aktiviteteve për ndërtimin e kapaciteteve, të tilla si trajnime, asistencë teknike, shkëmbimi i informacionit dhe njohurive, et. NAO ka përfituar edhe nga bashkëpunimi me SAI të tjera anëtare, në aspektet e hulumtimit, ngritjes së kapaciteteve dhe trajnimit. Pjesëmarrja e NAO-s në një shumëllojshmëri të mënyrave të bashkëpunimit, të tilla si takime, vizita dhe konferenca, i ka dhënë atij mundësinë për të njohur nevojat dhe parashikuar qëllimet për të ardhmen.



Takimi i Komitetit Drejtues të Komitetit Profesional Standardeve (PSC) të INTOSAI Manama, Mbretëria e Bahreinit, 2007



Roli jetik që INTOSAI ka luajtur dhe vazhdon të luajë, është manifestuar në një histori sukcesi. Një sukses i tillë u njoh edhe në Asamblenë e 66të të Kombeve të Bashkuara, i cili miratoi Rezolutën e A /66/209 “Nxitja e efikasitetit, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, duke forcuar institucionet e larta të auditimit”.

## Zhvillimet më të fundit në INTOSAI

Arritja kryesore e INTOSAI, ndër të tjera, ishte dhe krijimi dhe adoptimi i Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI).

Në shtator 2005, NAO pati privilegjin të emërohej përfaqësuese e Organizatës Arabe të Institucioneve Supreme të Auditimit (ARABOSAI) në Komitetin e Standardeve Profesionale INTOSAI (PSC). NAO organizoi takimin e 4t të këtij Komiteti, në Prill 2007. Ajo gjithashtu ka organizuar një kurs trajnimi me titull “Rritja e ndërgjegjësimit ndaj ISSAI-ve” për anëtarët ARABOSAI, në shtator 2010.

Si referencë për punën audituese, NAO ka miratuar zyrtarisht ISSAI të cilat janë miratuar në Kongresin e XX të INTOSAI-t, mbajtur në Afrikën e Jugut në nëntor 2010. Të shtatë Grupeve të Punës së INTOSAI, ju kërkua të kontribuojnë në mbështetje të anëtarëve të tyre për sa i përket zbatimit të ISSAI-ve. Në lidhje me këtë miratim formal, praktikat e NAO-s kanë ndryshuar nga ajo e të qenit të vetëdijshëm për këto standarde, në vënien e tyre në praktikë. NAO është e vetëdijshme se sfida e saj në të ardhmen është që të shtrijë proceset dhe praktikat e saj në masën që e lejon ligji, në mënyrë që të plotësojë kërkesat e ISSAI-ve dhe t'i bëjë ato pjesë integrale të sistemeve dhe procedurave operative. Në këtë drejtim, NAO ka besim se INTOSAI do të vazhdojë të ofrojë mbështetje dhe vlerësim, ashtu siç është deklaruar në objektivin e parë (Përgjegjësitë dhe Standardet Profesionale) të Planit Strategjik të INTOSAI 2011-2016.

Një tjetër shembull i mirë i kontributit të çmuar të INTOSAI-t, janë edhe përfitimet e NAO-s nga pjesëmarrja e në Kongresin e XX-të INCOSAI, ku tema kryesore ishte vlerat dhe përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit. Bazuar në çështjet e trajtuara në këtë takim, NAO ka zhvilluar një manual udhëzimi me temë “Matja e Impakteve Financiare të Rekomandimeve”, si dhe ka organizuar një kurs trajnimi mbi këtë temë, në prill 2010. Aktualisht, NAO është në fazat fillestare të praktikimit të veprimtarive që lidhen me manualin e përmendur më sipër. Gjithashtu, NAO pasur privilegjin e të qenit anëtare në Grupin e Punës për vlerat dhe përfitimet e SAI-ve, që u krijua gjatë Kongresit të XX-të.

## Sfidat e të ardhmes për INTOSAI-n

NAO beson se INTOSAI po shkon drejt një faze të madhe që përfshin miratimin e Planit Strategjik 2011-2016 të miratuar rishtazi, i cili synon të sigurojë që po i kushtohet vëmendja e duhur ngritjes së kapaciteteve, siç përcaktohet në Qëllimin 1 dhe 2 të Planit Strategjik. NAO pret vazhdimin e përpjekjeve të INTOSAI-t në zbatimin e programeve aktuale për zhvillimin e kapaciteteve, në mënyrë që të ndihmojë SAI-t anëtare në përballjet e tyre me presionin e kërkesave dhe pritshmërive në rritje. Përveç kësaj, INTOSAI pritet të vijojë rolin e saj për fuqizimin e SAI-ve anëtare dhe sigurimin e tyre me mjetet dhe njohuritë e nevojshme.

Për të trajtuar në mënyrë të përshtatshme pritjet e sipërpërmendura dhe për të përmirësuar performancën e



qeverive, NAO beson se INTOSAI dhe SAI-t anëtare do duhet të rrisin dhe intensifikojnë bashkëpunimin dhe koordinimin ndërkombëtar. Në këtë drejtim, INTOSAI mund të jetë forumi i përshtatshëm për të ndihmuar më tej promovimin e kulturës së qeverisjes së mirë dhe për të kontribuar në përmirësimin e autonomisë dhe ndërtimin e kapaciteteve të SAI-ve anëtare.


Një tjetër prioritet kyç strategjik për të ardhmen, do të jetë edhe asistimi i SAI-ve anëtare në zbatimin me sukses të Kuadrit ISSAI, si dhe promovimi në rritje i shkëmbimit të njohurive.

## Konkluzion

Në këto 10 vite, që nga themelimi i tij, NAO ka kaluar nëpër një proces evoluimi dhe përmirësimi të vazhdueshëm dhe do ta vijojë këtë eksperiencë edhe në të ardhmen. Në këtë kontekst, INTOSAI ka luajtur dhe do të vazhdojë të luajë një rol pozitiv në drejtimin e këtij evoluimi në rrugën e duhur, duke e kthyer NAO-n në një njësi audituese profesionale dhe bashkëkohore.

Pjesëmarrësit në workshop  
në Bahrein, 2012








## Kontribut nga SAI i Bangladeshit

Ahmed Ataul Hakeem, FCMA ish Kontrollor dhe Auditor i  
Përgjithshëm i Bangladeshit

Përvjetori i 60-të i INTOSAI-t







## 1 Hyrje

Ndërsa INTOSAI po hyn në përvjetorin e tij të 60-të (1953-2013), anëtarët e tij mbështesin plotësisht lidhshimin e tij në rritjen e përmirësimeve cilësore të strukturës së auditimit dhe metodologjive në perspektivë globale. Qëllimi përfundimtar është sigurimi i transparencës dhe llogaridhënies në menaxhimin e financave publike. Si pjesë e tranzicionit, Zyra e Kontrollorit dhe Auditorit të Përgjithshëm të Bangladeshit (OCAG) - u bashkua me komunitetin



Ahmed Ataul Hakeem, FCMA ish Kontrollor dhe Auditor i Përgjithshëm i Bangladeshit në Asamblenë e 12-të Jaipur, India

INTOSAI menjëherë pas pavarësisë së saj në vitin 1971. Kjo gjë, tregon angazhimin dhe synimin e OCAG për të zbatuar praktikën më të mirë të cilat mundësojnë arritjen e një cilësie të lartë në të gjitha shërbimet, si dhe përmbushjen e pritshmërive të palëve të interesit. Që nga anëtarësimi i saj, për OCAG, INTOSAI ka qenë udhëzues në të gjitha përpjekjet për të përmbushur mandatin kushtetues në mënyrën më efektive, përmes rritjes së kapaciteteve profesionale dhe institucionale.

## 2 Zhvillimi i bashkëpunimeve Ndërkombëtare mes SAI-ve

**2.1 OCAG dhe Bordi Drejtues i ASOSAI** - Rrugëtimi me INTOSAI-n dhe Grupin e tij Rajonal të Punës ASOSAI, i ka dhënë mundësinë OCAG të krijojë një komunikim më të gjerë, si dhe bashkëpunim dhe vazhdimësi më të madhe për lidhje më të forta mes SAI-ve anëtare. Në përgjigje të përpjekjeve të saj, OCAG është zgjedhur anëtare e Bordit Drejtues të ASOSAI për katër mandate. Si anëtare e Bordit Drejtues, OCAG ka theksuar forcimin e marrëdhënieve të saj dypalëshe dhe shumëpalëshe brenda rajonit, për të nxitur ndërtimin e kapaciteteve dhe zhvillimin profesional mes SAI-ve anëtare.

**2.2 Pjesëmarrjet në Grupet e Punës** - SAI i Bangladeshit ka kontribuar në INTOSAI me përfshirjen e saj në një numër Komitetesh dhe Grupesh Pune - Komiteti i Standardeve Profesionale INTOSAI, Grupi i Punës INTOSAI për Auditimin e Privatizimit, Komiteti INTOSAI për Standardet e Kontrollit të Brendshëm, Grupi i Punës INTOSAI për Auditimin Mjedisor, Grupi i Punës ASOSAI për Udhëzimet mbi Mashtimin dhe Korrupsionin, Grupi i Punës INTOSAI për krijimin e kapaciteteve, si dhe promovimi i praktikave më të mira dhe shqyrtime për kolegët.

**2.3 Pritja e Konferencave ndërkombëtare** - Si pjesë e rritjes së marrëdhënieve të saj dypalëshe dhe shumëpalëshe, OCAG ishte organizatore e konferencës ndërkombëtare mbi përmirësimin e funksioneve të mbikëqyrjes: Sfidat e Reja të Mijëvjeçarit (shtator, 2000), si dhe e Konferencës Rajonale të Audituesve të Përgjithshëm, mbi Harmonizimin e Përpjekjeve Institucionale për Nxitjen e Llogaridhënies në sektorin publik (Gusht, 2004). OCAG gjithashtu ka organizuar një seminar mbi Auditimin Financiar (shtator 2001). Për më tepër, OCAG ka organizuar programe trajnimi për SAI-t e Sri Lanka dhe audituesit e Timorit Lindor, si dhe ka marrë pjesë në Projektin e shtatë kërkimor të ASOSAI-t mbi Auditimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë.



2.4 **Trajnuesit e certifikuar** IDI - Iniciativat për ngritjen e kapaciteteve të ndërmarra nga OCAG, janë bërë edhe më efektive me përfshirjen e trajnuesve tanë të certifikuar nga IDI. Rreth 8 zyrtarë nga OCAG, kanë marrë pjesë në Programin Afat-gjatë Rajonal të Trajnimit (LTRTP), sponsorizuar nga IDI.

2.5 nënshkrimi i Memorandumeve të Mirëkuptimit – Mbështetur në moton e INTOSAI-t, Nga përvoja e përbashkët



Ish Kontrollori dhe Auditori i Përgjithshëm i Bangladeshit, Z. Ahmed Ataul Hakeem, në Konferencën e INTOSAI Forcimi Auditimi Jashtëm Publik të Rajoneve të INTOSAI Vjenë, Austri, 2010

përfitojnë të gjithë, OCAG ka mbajtur marrëdhënie të ngushta bilaterale me shumë SAI. Memorandume Mirëkuptimi (MM) janë nënshkruar me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kinës, Zyrën Shtetërore të Auditimit të Kuvajtit, si dhe me Federatën Ruse dhe atë të Danimarkës. Këto Memorandume kërkojnë nxitjen e shkëmbimit dhe ndarjen e informacionit, njohurive dhe ekspertizës, përmes konsultimeve, seminareve, trajnimeve dhe vizitave.

#### 2.6 **Adoptimi i Standardeve Ndërkombëtare dhe Praktikave të Mira**

- Në bazë të udhëzimeve dhe standardeve INTOSAI, OCAG ka pranuar edhe standardet ndërkombëtare dhe praktikave të mira. Zhvillimi dhe miratimi i

Standardeve të Auditimit të Qeverisë, Kodit të Etikës për Auditimin e Sektorit Publik dhe Manualet e auditimit, paraqesin një moment historik në procesin e modernizimit të auditimit të qeverisë në Bangladesh.

### 3 Zhvillimet më të fundit në INTOSAI

3.1 **Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara dhe Akti i Auditimit të SAI-t të Bangladeshit** - Miratimi i Rezolutës historike A/66/209, e cila pohon rëndësinë e SAI-ve dhe forcimin e kapaciteteve të tyre, paraqet një arritje të rëndësishme në komunitetin global të auditimit. Rezoluta thekson rëndësinë e pavarësisë së SAI-ve nga subjektet e audituar dhe gjithashtu njihë rolin e rëndësishëm të tyre në promovimin e efikasitetit, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike. Në përputhje me Rezolutën e OKB-A / 66/209 të miratuar më 22 dhjetor 2011 dhe parimet e përcaktuara në Deklaratën e Limës, OCAG po zhvillon përpjeke për të forcuar pavarësinë e saj. Në përputhje me rrethanat, OCAG po harton një ligj për të operacionalizuar dhe rinovuar mandatin e saj më tej. Akti i propozuar përfshin një mandat më të zgjeruar në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit. Dispozitat e tjera përfshijnë çështjet që lidhen me autonominë administrative dhe financiare, bashkëpunimin me organet profesionale, etj



**3.2 Përpyjekjet për të zbatuar ISSAI-t** - Standardet Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI) dhe Udhëzimet e INTOSAI-t për Qeverisjen e Mirë, i kanë mundësuar SAI-ve anëtare të krijojnë praktikat dhe metodologjitë më të mira, në përputhje me standardet profesionale. Për këtë arsye, OCAG ka organizuar programe ndërgjegjësimi, trajnime, auditime pilote dhe seminare.

**3.3 Iniciativat për reformim** - Të gjitha nismat reformuese të OCAG janë rindërtuar në përputhje me parimet dhe praktikat më të mira të promovuar nga INTOSAI. Në përputhje me këto përpjekje, OCAG ka ndërmarrë një numër iniciativash për reformim në auditimin e sektorit publik. DFID ka financuar Programin e Reformës së Menaxhimit Financiar (FMRP), Reformat në Auditimin e Qeverisë (Riga) dhe ka asistuar së bashku me UNDP në procesin e forcimit të Zyrës së Kontrollorit dhe Auditorit të Përgjithshëm, si dhe kanë kontribuar në modernizimin e praktikave të auditimit dhe përmirësimin e cilësisë së auditimit. CIDA vazhdimisht ka financuar projekte për forcimin e kontrollit dhe mbikëqyrjen e shpenzimeve publike, ndërsa Banka Botërore ka ndihmuar në financimin e projekteve për menaxhimin e shpenzimeve publike (SPEMP-B).

**3.4 Grupet e Punës së INTOSAI-t** - OCAG është anëtare e nën Komitetit të Standardeve të Kontrollit të Brendshëm, e Grupit të Punës së INTOSAI-t mbi Auditimin IT, etj. Gjithashtu, SAI i Bangladeshit ka marrë pjesë në programe të ndryshme për krijimin e kapaciteteve, si dhe në projekte të përbashkëta të IDI-t dhe ASOSAI. Programet për krijimet e kapaciteteve në të cilat kemi marrë pjesë kohët e fundit, kanë qenë Auditimi i Menaxhimit të Borxhit Publik, Auditimi i Pyjeve, Auditimi IT, si dhe Sigurimi i Cilësisë në Auditimin e Performancës. Tre nga zyrtarët e OCAG janë pajisur nga IDI me diplomën përkatëse në Auditimin e Menaxhimit të Borxhit Publik.

**3.5 Procesi i Planifikimit Strategjik** - Procesi i planifikimit strategjik i miratuar nga OCAG është në përputhje me Planin Strategjik të INTOSAI-t. Përgatitja e Planit Strategjik OCAG (2012 - 2017) është përpjekja e tretë e organizuar, si në nivel organizativ ashtu edhe në atë individual. Vlen të theksohet se një delegacion nga SAI i Bangladeshit, mori pjesë aktive në takimin e IDI-t mbi Procesin e Përgatitjes së Planifikimi Strategjik, të mbajtur në Turqi në shtator 2011 dhe në Vietnam në prill 2012. Në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar mes IDI-t dhe Grupit të Punës së ASOSAI-t për Planifikimin Strategjik, iniciativa të mëtejshme do të ndërmerren për të finalizuar draftin.

## 4 Sfidat e ardhme për INTOSAI-n

INTOSAI ekziston dhe e paraqet veten si një mundësi e rëndësishme për shkëmbimin e përvojës dhe njohurive. Anëtarësia e tij përbëhet nga 191 SAI, shumica e të cilëve përfaqësojnë "zhvillimin" ose "vendet në zhvillim", duke përfshirë edhe OCAG e Bangladeshit. Për sa i përket SAI-t të Bangladeshit, përpjekjet janë orientuar drejt vlerësimit të performancës së ekzekutivit në çështjet e mirë qeverisjes dhe ofrimit të shërbimeve më të mira për publikun.

Në të ardhmen, përpjekjet e INTOSAI-t duhet të drejtohen drejt riorientimit të strategjive të saj në sigurimin e kontrollit të cilësisë dhe të ofrimit të shërbimeve për taksatuesit, nga SAI-t anëtare.

Përpjekja e parë duhet të jetë intensifikimi dhe mbikëqyrja e përpjekjeve për transferimin e njohurive dhe aftësive që lidhen me auditimin modern, nëpërmjet programeve të ndryshme, si dhe sigurimi i kapaciteteve institucionale për SAI-t.




Përpyekja e dytë duhet të jetë publikimi i punës së SAI-ve për grupet e interesit dhe taksa paguesit. Transparenca në aktivitetet e SAI-ve, qasja në informacione dhe shtrirja e ndikimit të mediave, po marrin gjithnjë e më tepër një rëndësi të madhe. INTOSAI mund të luajë një rol të rëndësishëm në mënyrën e përmbushjes së pritshmërive të palëve të interesit nga SAI-t.

Së fundmi, INTOSAI gjithashtu duhet të trajtojë sfidat e nevojave për evoluim dhe perspektivës gjithnjë në ndryshim. Një takim për çështje që kanë të bëjnë me nevojat për trajnim rajonal dhe ndërkombëtar, shkëmbimin e eksperiencave, vlerësimin nga kolegët, etj, do të çonte në promovimin e bashkëpunimit mes SAI-ve.



## Kontribut nga SAI i Bullgarisë

1953/1963 - 60 VJET INTOSAI / 50 VJET SEKRETARIAT I  
PËRGJITHSHËM NË VJENË





## Kontribut nga SAI i Bullgarisë

Zyra Kombëtare e Auditimit të Bullgarisë (BNAO), ka qenë anëtare e INTOSAI-t që në vitin 2001, si dhe anëtare e EUROSAI-t, që në vitin 2002.

Ndër vite, BNAO ka zhvilluar dhe forcuar bashkëpunimin me INTOSAI-n dhe SAI-t anëtare, duke kontribuar në nivel ekspert dhe institucional. Delegacionet tona kanë ndjekur Kongreset INCOSAI të mbajtura që nga viti 2001 dhe kanë mbështetur plotësisht vendimet e tyre. Seminarët e organizuara nga OKB / INTOSAI dhe Sekretariati i Përgjithshëm në Vjenë, kanë qenë gjithmonë me interes për ne, për përmbajtjen e axhendave të tyre dhe diskutimeve interesante.



Kryetari i Zyrës së Auditimit Kombëtar Bullgar, z Valeriy Dimitrov, në simpoziumin 20 UN / INTOSAI  
Vjenë, Austri, 2009

BNAO ka ndjekur dhe mbështetur të gjitha iniciativat e INTOSAI-t dhe ka marrë pjesë në grupe të ndryshme pune për çështjet e auditimit, duke qenë veçanërisht aktive në grupet e punës mbi Privatizimin, Auditimin Mjedisor dhe Borxhin Publik. Fokusi kryesor i përfshirjes së BNAO-s, ka qenë ndarja e përvojës së auditimit dhe të mësuarit nga praktikatat më të mira të SAI-ve në fusha specifike.



Takimi Vjetor i Grupit Punues INTOSAI mbi Privatizimin organizuar nga SAI e Bullgarisë, 2004

SAI ynë ka qenë më tepër i përfshirë në aktivitetet brenda EUROSAI-t, veçanërisht në auditimet e koordinuara të kryera në kuadër të këtij Grupi Pune Rajonal. Kjo gjë ka qenë tepër e dobishme për zhvillimin e aftësive profesionale. Në vitin 2004, BNAO priti takimin vjetor të Grupit të Punës së INTOSAI-t mbi privatizimin, në Sofje. Në të njëjtin vit, BNAO u bë anëtare e Komitetit INTOSAI për Borxhin Publik dhe në vitin 2005, priti takimin vjetor të këtij Komiteti në Sofje. SAI ynë gjithashtu, ka pritur dy mbledhje vjetore të Grupit të Punës së EUROSAI mbi Auditimin e Mjedisit (2004, 2009).



Duke pasur parasysh nevojën për të zhvilluar dhe përmirësuar kapacitetet institucionale në fushën e auditimit publik, BNAO ka marrë pjesë në seminare profesionale dhe workshop-e të organizuar nga Nisma për Zhvillim e INTOSAI (IDI). Sipas Programit Rajonal të Trajnimit Afat-gjatë (LTRTP), audituesit e BNAO janë trajnuar në kurse mbi auditimin financiar, ndërgjegjësimin ndaj mashtrimit dhe auditimin e performancës. BNAO gjithashtu, pati privilegjin të organizonte workshop-in për Projektim dhe Zhvillim të IDI / EUROSAI (CDDË), në Sofje në vitin 2004. Ky ishte event i parë i IDI-t, i cili zgjati për disa javë dhe u mbajt në gjuhët ruse dhe angleze njëkohësisht, duke sjellë kështu së bashku pjesëmarrës nga Evropa Lindore, Ballkani dhe Azia Qendrore. Të tre audituesit përfaqësues të BNAO, përfunduan me sukses programet e CDDË dhe janë certifikuar si specialistë trajnues të IDI.

## Zhvillimet e fundit në INTOSAI

Në përputhje me rekomandimet e dhëna nga INCOSAI XX, BNAO fokusohet në forcimin e rolit të saj në sigurimin e llogaridhënies më të mirë për përdorimin dhe menaxhimin e fondeve publike.

Ligji i ri i BNAO, që hyri në fuqi më 4 janar 2011, ka zgjeruar mandatin tonë dhe ka siguruar një bazë solide për zhvillimin e mëtejshëm, në mënyrë që të përmbushë pritshmëritë gjithnjë e në rritje me të cilat përballet SAI.

BNAO fokusohet në ristrukturimin dhe zhvillimin e metodologjive, në përputhje me kuadrin e ISSAI-ve. Procesi i prezantimit dhe zbatimit të ISSAI-ve, rrit nevojën e ndërtimit të kapaciteteve të qëndrueshme. Përpjekjet e BNAO-s në këtë drejtim, marrin mbështetje të vlefshme nga SAI-t anëtare të INTOSAI. Me mbështetjen e SAI-ve të Belgjikës, Suedisë dhe Norvegjisë, ne patëm mundësi tu ofronim audituesve tanë, trajnime të suksesshme mbi ISSAI-t.

Mbledhja e 62të e Bordit Drejtues INTOSAI në Vjenë, miratoi zbatimin dhe shpërndarjen e ISSAI-ve si një detyrë prioritare për vitin 2012. Për këtë arsye, përpjekjet e BNAO gjatë dy viteve të ardhshme, do të fokusohen në prezantimin e kuadrit ISSAI në procesin e auditimit. Duke njohur rëndësinë e krijimit të kapaciteteve të qëndrueshme për adoptimin e suksesshëm dhe zbatimin progresiv të ISSAI-ve, ne do të vazhdojmë të bashkëpunojmë dhe shkëmbejmë njohuritë dhe praktikën më të mira, me SAI-t më me përvojë në këtë fushë. Gjithashtu, ne do të ndajmë me kënaqësi përvojën tonë me SAI-t simotra, të cilat do të kenë nevojë të trajtojnë çështje për të cilat ne tashmë kemi fituar një eksperiencë, nën moton: *Experientia mutua omnibus prodest*.

Duhet theksuar se, miratimi së fundmi i Rezolutës së OKB-së për pavarësinë e SAI-ve, një ngjarje me rëndësi të madhe për këtë komunitet, u bë i mundur mbi të gjitha, në sajë të përpjekjeve të Sekretariatit të Përgjithshëm të INTOSAI.

## Sfidat e ardhshme për INTOSAI-n

Sfidat e ardhshme për INTOSAI-n, janë të përshkruara në Planin Strategjik 2011-2016. Aktivitetet e organizatës dhe SAI-ve anëtare, do të përqendrohen në gjashtë prioritetet strategjike të përcaktuara në Planin Strategjik.


BNAO mbështet forcimin e komunikimit me INTOSAI-n, dhe bashkohet në përpjekjet për të rritur vlerën dhe përfitimet e SAI-ve, me anë të kontributit të saj në aktivitete dhe iniciativa që kanë për qëllim forcimin e rolit të auditimit të jashtëm publik në parandalimin e mashtrimit dhe korrupsionit, rritjen e transparencës, si dhe përmirësimin e llogaridhënies në sektorin publik.





## Kontribut nga SAI i Kanadasë

# ZHVILLIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR MES SAI-ve QË NGA VITI 1953





## Kontribut nga SAI i Kanadasë

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kanadasë (ZAP Kanada), ka qenë e përfshirë në mënyrë aktive në aktivitete ndërkombëtare për më shumë se 60 vjet, kryesisht nëpërmjet Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), por edhe përmes Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe organizatave të tjera. ZAP Kanada iu bashkua INTOSAI-t në vitin 1953, me Auditor të Përgjithshëm të Kanadasë në atë kohë, Z. Robert Watson Sellar. Që atëherë, ZAP Kanada ka qenë i përfshirë në shumë aktivitete të INTOSAI t, siç përshkruhet më poshtë.

Në vitin 1971, Auditori i Përgjithshëm Maxwell Henderson, priti Kongresin e VII INTOSAI në Montreal, në të njëjtën kohë kur ishte linçuar edhe Gazeta Ndërkombëtare e Auditimit të Qeverisë. Shërbimet e editorialit dhe prodhimit të gazetës, u vendosën në ZAP e Kanadasë nga viti 1971 deri në vitin 1979. Në vitin 1979, këto shërbime u zhvendosën në Institucionin Suprem të Auditimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por ZAP Kanada mbetet anëtare e Bordit Redaktues të revistës.



Auditori i Përgjithshëm i Kanadasë, z Michael Ferguson,  
në Programin e Ndhmës për Auditim Legjislativ dhe Përgjegjësitë për Qeverisje të Mirë  
Nga e majta në të djathtë: Z. Charles Flow-ers (SAI e Belize), Ms Joyce Ndung'u (SAI e Kenia), Mr Mike Ferguson (Auditor i Përgjithshëm i Kanadasë), Ms Elizabeth Augustino (KLSH e Tan-zania), Z. Carlisle Marshall (SAI i Shën Lucia)

Në vitin 1986, në Kongresin e XII INTOSAI në Australi, u themelua Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI (IDI). Auditori i Përgjithshëm Ken Dye, ra dakord që Sekretariati i IDI-t të vendosej në ZAP Kanada, nga viti 1986 deri në vitin 2000. Në vitin 2000, Sekretariati u zhvendos në Institucionin Suprem të Auditimit të Norvegjisë. Megjithatë, ZAP Kanada mbetet anëtare e Bordit Drejtues dhe Komitetit Këshillimor të IDI-t.

Në vitin 1987, Z. Dye mirëpriti Konferencën e Auditorëve të Përgjithshëm të Komonuelthit, në Ottawa.

Në vitin 1998, Auditori i Përgjithshëm Denis Desautels, kryesonte Grupin Task Force të INTOSAI-t për Pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit, i cili u finalizua me hartimin e Deklaratës së Meksikë mbi pavarësinë e SAI-



ve. Raporti i hartuar nga anëtarët e Task Force, u miratua në Kongresin e INTOSAI-t në vitin 2007, nga ku u hartuan edhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, ISSAI 10 dhe 11. Nën udhëheqjen e Sekretarit të Përgjithshëm të INTOSAI, INTOSAI propozoi hartimin e një rezolutive, nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të bashkuara, e cila inkurajon të gjitha shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara, të zbatojnë parimet e parashtruara në deklaratat e Limës dhe Meksikës.

Nga viti 2001 deri në vitin 2006, Grupi i Punës së INTOSAI-t mbi Auditimin e Mjedisit (WGEA), u kryesua nga znj. Fraser. Në vitin 2006, Sekretariati WGEA u zhvendos në Institucionin Suprem të Auditimit të Estonisë. Në nëntor të vitit 2010, u publikua dhe raporti i Grupit të Punës WGEA – “Kordinimi i Auditimit Ndërkombëtar për Ndryshimet Klimatike - Implikimet Kryesore për Qeveritë dhe Audituesit e tyre”. Ky raport, i koordinuar nga ZAP Kanada, prezantoi gjetjet kolektive të auditimeve individuale të kryera nga 14 Institucione Supreme të Auditimit. ZAP Kanada, ka anëtar aktiv në disa nën komitete dhe Grupe Pune të INTOSAI-t. Auditori i Përgjithshëm aktual i Kanadasë, Michael Ferguson, kryeson Nënkomitetin për Kontabilitetin dhe Raportimin.


Në partneritet me agjenci të ndryshme të ndihmave të Kanadasë dhe partnerë të tjerë, ZAP Kanada është e përfshirë në aktivitete në ndihmë të ndërtimit të kapaciteteve në Institucionet Supreme të Auditimit në mbarë botën. Programi Fellowship International, i administruar nga Fondacioni Kanadez Gjithëpërfshirës (CCAF), sjell auditues nga Institucione të ndryshme Supreme të Auditimit në Kanada, për trajnime 10 mujore dhe përvojë pune në fushën e auditimit të performancës, llogaridhënies dhe qeverisjes. Auditori i Përgjithshëm James J. McDonnell, pati një rol tepër të rëndësishëm në krijimin e CCAF, në vitin 1980. ZAP Kanada gjithashtu merr pjesë edhe në projektet e ndërtimit të kapaciteteve në kontinentin Afrikan.



## Kontribut nga SAI i Kilit

Institucioni Suprem i Auditimit të Kilit

Mbi 60 Vitet e INTOSAI-t





*OLACEFS*

*Sekretariati i Përgjithshëm*

*Komiteti i Standardeve Profesionale (PSC)*

*Anëtar*

*Komiteti i Ndarjes së Njohurive (KSC)*

*Nënkomiteti i Standardeve të Kontrollit të Brendshëm*

*Grupi i Punës për Borxhin Publik*

*Grupi i Punës për Auditimin Mjedisor*

*Grupi i Punës për Vlerësimin e Programeve*

*Grupi i Punës për Luftën kundër Korrupsionit dhe Pastrimit të Parave*

*Grupi i Punës për Modernizimin Financiar dhe Reformën Rregullatore*

**Institucioni Suprem i Auditimit të Kilit mbi 60 vitet e INTOSAI-t**

Kontrollori i Përgjithshëm i Republikës së Kilit ka qenë anëtar i INTOSAI-t që prej fillimeve të tij, më saktë që prej Kongresit të II-të të INTOSAI-t në Belgjikë në vitin 1956.

Si i tillë, SAI ynë ka qenë dëshmitar dhe shpesh ka marrë pjesë në mënyrë aktive në zhvillimin e shumë koncepteve rregullore, duke përfshirë këtu edhe Deklaratën e Limës dhe Meksikës, si dhe në zhvillimin e standardeve dhe mjeteve që kanë krijuar mundësi për rritjen e mëtejshme të organizatës sonë ndërkombëtare. Kjo gjë ka forcuar standardet e brendshme, proceset e mirëmbajtjes dhe instrumentet për të mbështetur veprimtarinë e auditimit të SAI-t të Kilit, të cilat vazhdojnë të promovohen nga kuadri i referencës i përcaktuar nga INTOSAI.



*Zyra e Kontrollorit të Përgjithshëm të Republikës së Kilit*



Forca që shtyn aktivitetin e SAI-t tonë është pa dyshim ambienti social, politik dhe ekonomik i Kilit. Kundrejt kritereve ndërkombëtare, ky ambient është i një cilësie të lartë dhe në të njëjtën kohë ai përbën një bazë për monitorimin e ligjshmërisë, e cila përputhet me përkufizimin e INTOSAI-t sa i takon kërkesave esenciale për funksionimin e institucioneve supreme të auditimit. Këto kërkesa esenciale kanë të bëjnë në veçanti me pavarësinë dhe transparencën e aktiviteteve publike, në një kuptim të gjerë, dhe me përgjegjshmërinë e njësisve publike.

Për shkak të këtyre kushteve, Kontrollori i Përgjithshëm ka qenë në gjendje të zhvillojë dhe të vendos në zbatim praktikat më të mira, për të cilat ISSAI-t kanë shërbyer si themele, me qetësinë e nevojshme.

Rezultatet e vlerësimeve të ndryshme të kryera në Kili në temat e llogaridhënies, luftës kundër korrupsionit dhe transparencës, e rendisin Zyrën e Kontrollorit të Përgjithshëm në pararojë. Në të vërtetë, në shumicën e studimeve kjo zyrë zë vendin e parë ndër institucionet publike. Kjo ndodh jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe në nivel nën kombëtar.

Ky fakt, së bashku me kënaqësinë e gjeneruar, tregon se sipas qytetarëve dhe palëve të interesuara Zyra e Kontrollorit të Përgjithshëm të Kilit është një institucion që punon mirë. Ne mendojmë se mjetet e ofruara nga INTOSAI kanë luajtur një rol vendimtar në këtë.

*Foto grupi me rastin e transferimit zyrtar të Zyrës së Sekretarit Ekzekutiv të Institucioneve Supreme të Auditimit të Amerikës Latine dhe Karaibeve (OLACEFS) nga SAI i Panamasë në SAI e Kilit, në Brazilia, Brazil. Janar 2013.*



*Z. Ramiro Mendoza Zuniga,  
Kontrollori i Përgjithshëm i Republikës së Kilit,  
duke përruar Workshop-in  
mbi Ndryshimet organizative të OLACEFS në Kili, 2012*

Me kënaqësi të madhe, SAI ynë tani merr pjesë në grupe të rëndësishme pune, si anëtar i plotë dhe në disa raste si pjesëmarrës i asociuar. Këto grupe pune trajtojnë çështje veçanërisht komplekse për Institucionet Supreme të Auditimit, si për shembull vlerësimi i performancës së SAI-ve.



Kontrollori i Përgjithshëm i Republikës së Kilit është gjithashtu pjesë e OLACEFS, grupi i Institucioneve Supreme të Auditimit që zhvillojnë peer review në përputhje me udhëzimet e INTOSAI-it. Rezultatet e dhëna në këtë mënyrë janë shumë interesante dhe na japin mundësinë të përsosim strategjitë rajonale për këto peer review. Ne jemi të bindur për domosdoshmërinë e krijimit të themeleve të reja për të legjitimuar Institucionet Supreme të Auditimit, si dhe për rëndësinë e mekanizmave të kontrollit të jashtëm në këtë proces.





Sfida të reja lindin që shkojnë përtej mësimeve të së kaluarës dhe të bashkëpunimit të tanishëm dhe që duhet të trajtohen. Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t mund të veprojë si një zë në trajtimin e tyre. Kjo mund të përfshijë përgatitjen e një udhëzuesi parimesh ose - në qoftë se është e domosdoshme – formulimin e detyrave konkrete për grupet e punës tashmë ekzistuese apo të reja.

Këto tema të reja apo sfida lindin nga ndryshimet që shqetësojnë njësoj si shoqëritë dhe shtetet. Prandaj, këto ndryshime përbëjnë një kompleksitet të madh aspektesh që ne duhet të mbajmë nën vëzhgim.

Sidoqoftë, sipas mendimit tonë, zona ku auditimi financiar dhe shoqëria civile takohen, duhet të bëhet prioritet dhe të jetë subjekt i konsideratave të mëtejshme. Kjo ka të bëjë me çështjen se si SAI-t merren me domosdoshmërinë e rrjeteve shtetërore që i kanë bërë qytetarët dhe organizatat e tyre si rrjedhojë me të varur nga autoritetet publike dhe i nënshtrohen formave të ndryshme të kontrollit shoqëror.


Tashmë praktika interesante janë zhvilluar në këtë fushë dhe në disa raste këto kanë qenë të sistematizuar nga SAI-t anëtare të OLACEFS-it. Këto praktika mund të jetë një bazë e vlefshme për një platformë njohurish në kuadrin e INTOSAI-it.

Rëndësia e përgjegjshmërisë, transparencës dhe përfshirjes së shoqërisë civile nuk është vetëm një çështje parimesh, por edhe paraqet një mënyrë praktike për të forcuar kërkesat për qeverisjen.

Kjo pikëpamje rrjedh nga ideja se, sipas ekonomisë industriale, SAI-t mund të kontribuojnë për të ngushtuar hendekun mes qytetarëve dhe autoriteteve publike, përderisa qytetarët përfaqësojnë kontraktorët dhe autoritetet publike përfaqësuesit e tyre. Duke qenë se ka rrezik moral dhe mundësi për sjellje oportuniste nga nëpunësit civilë, dhe se mungesa e informacionit është problem kyç, është e domosdoshme që SAI-t të sigurojnë informacion të besueshëm, i cili është objektiv, i rëndësishëm dhe i kuptueshëm, në mënyrë që qytetarët të mund të kuptojnë, të paktën në disa nga temat politike më të gjera, çfarë bëjnë përfaqësuesit e tyre dhe cilat janë akuzat kundër tyre nga institucionet e auditimit.

Nëse Institucionet Supreme të Auditimit do të kenë sukses në rritjen e kapaciteteve të tyre menaxhuese dhe në këtë mënyrë do të arrijnë rezultate që çojnë në përmirësimin e punës së organeve të auditimit publik - një aspekt që ka qenë gjithmonë në qendër të INTOSAI-it – atëherë, SAI-t do të kontribuojnë për një shoqëri më efektive dhe të vlefshme. Për më tepër, masa të tilla çojnë në qeverisje më të mirë, në përdorim më të mirë të fondeve të pakta dhe në rënien e korrupsionit. Promovimi efektiv i parimeve të përgjegjshmërisë dhe transparencës padyshim do të kontribuojë në arritjen e qëllimeve të zhvillimit të vendeve tona. Ne nuk duhet të strukemi larg nga përpjekjet për të përballuar këtë sfidë.


Së fundi, ky është një kontribut i mëtejshëm që Institucionet Supreme të Auditimit mund të bëjnë për të krijuar mirëqenie dhe për të siguruar qeverisje më të mirë. Në këtë kontekst, INTOSAI duhet të luajë një rol themelor përmes bashkëpunimit aktiv me të gjitha SAI-t anëtare.





## Kontribut nga SAI i Kinës

Përvjetori i 60-të i INTOSAI-t  
dhe Përvjetori i 50-të i Sekretariatit të Përgjithshëm tek  
Gjykata Austriake e Llogarive





*Komiteti i Standardeve Profesionale (PSC)*

*Anëtar*

*Komiteti Drejtues i Komitetit të Standardeve Profesionale*

*Komiteti i Ndarjes së Njohurive (KSC)*

*Komiteti i Financave dhe Administratës (FAC)*

*Nënkomiteti i Auditimit të Pajtueshmërisë*

*Grupi i Punës për Borxhin Publik*

*Grupi i Punës për Auditimin IT*

*Grupi i Punës për Auditim Mjedisor*

*Grupi i Punës për Luftën kundër Korrupsionit dhe Pastrimit të Parave*

*Grupi i Punës për Përgjegjshmërinë e dhe Auditimin e Ndhimave në Situata të Jashtëzakonshme*

*Grupi i Punës për Indikatorët Kombëtarë Kryesor*

*Grupi i Punës për Vlerën dhe Përfitimet të SAI-ve*

*Grupi i Punës për Modernizimin Financiar dhe Reformën Rregullatore*

*Task Force e Komitetit të Financave dhe Administratës të INTOSAI-t për Parashikimin Financiar*

## **Përvjetori i 60-të i INTOSAI-t dhe Përvjetori i 50-të i Sekretariatit të Përgjithshëm tek Gjykata Austriake e Llogarive**

Sistemi i auditimit në Kinë ka një histori të gjatë. Një formë rudimentare e auditimit kombëtar u shfaq në Kinë në fillim të dinastisë perëndimore Zhou, 3,000 vjet më parë, kur “Zaifu” u krijua si një pozicion zyrtar me funksion kryerjen e detyrave të auditimit. Në Kushtetutën e ndryshuar të shpallur në dhjetor të vitit 1982, u përcaktua që Kina do të kishte një sistem të pavarur auditimi. Në shtator 1983, u krijua Zyra Kombëtare e Kontrollit të Republikës Popullore të Kinës (në tekstin e mëtejshëm CNAO), duke hapur një kapitull të ri në zhvillimin e auditimit modern në Kinë.

Gjatë 30 viteve të fundit, CNAO ka kryer në mënyrë aktive eksplorime dhe punë pilot në fushën e auditimit, ka zhvilluar dhe përmirësuar një sistem kombëtar të auditimit me karakteristika kineze, duke i dhënë atij mundësinë të kryej në mënyrë të plotë dhe efektive funksionet e tij të auditimit dhe të mbikëqyrjes. Ndërkohë, CNAO në kontekstin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit ndërkombëtar, kontribuoi në ngritjen e kapaciteteve të SAI-t dhe ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme të INTOSAI-t me rezultate të frytshme.

Me rastin e 60-vjetorit të INTOSAI-t, duke u përballuar me nevojat për avancimin e auditimit kombëtar dhe duke iu përgjigjur sfidave të globalizimit dhe qeverisjes së korporatave, CNAO, pas një zhvillimi 30 vjeçar, ka reflektuar



mbi misionin dhe rolin e auditimit kombëtar, si dhe mbi mënyrën e hartimit të trajektores për zhvillimin e ardhshëm të INTOSAI-t, si kryetar të tij hyrës.

## 1. Rritja e CNAO-s

Në përputhje me dispozitat e përcaktuara në Kushtetutë, CNAO, me një staf prej mbi 3.000 personash dhe nën udhëheqjen e drejtpërdrejtë të Kryeministrit të Këshillit të Shtetit, organizon dhe administron punën e auditimit në të gjithë vendit. Vlerat thelbësore të CNAO-s janë përgjegjshmëria, besnikëria, integriteti, ligjshmëria, pavarësia dhe përkushtimi. Misioni i CNAO-s është të mbrojë interesat e popullit dhe të mbrojë sigurinë ekonomike kombëtare, të promovojë demokracinë, shtetin e së drejtës dhe luftën kundër korrupsionit, të përkrah integritetin dhe të nxisë ndërtimin e një shoqërie harmonike. Ai në mënyrë aktive kryen auditime të financave publike, institucioneve financiare, ndërmarrjeve shtetërore, të përgjegjshmërisë menaxheriale, të burimeve, mjedisit dhe sektorëve të huaja të lidhur me to, si dhe ka bërë eksperimente të dobishme dhe risi si në fushën teorike po ashtu edhe në fushën praktike të auditimit kombëtar.

Në kuptim të vlerave dhe përfitimeve të auditimit, ne mendojmë se auditimi është një pjesë e rëndësishme e sistemit politik kombëtar dhe një kanal jetik për përmirësimin e qeverisjes kombëtare. Auditimi shërben si kontroll dhe ekuilibër i pushteteve, në përputhje me ligjin dhe funksionet, dhe si një sistem imunitar për të ruajtur rritjen e shëndetshme të ekonomisë dhe shoqërisë. Bazuar në mendimet e mësipërme, mund të themi se auditimi në Kinë vepron si një ndërtues i imunitetit në procesin e auditimit të përdorimit të fondeve dhe burimeve publike për të siguruar zhvillimin e shëndetshëm ekonomik dhe social. Së pari, duke kryer rolin e tij parandalues, auditimi kontrollon zbatimin e ligjeve, rregulloreve dhe masave të politikës, dhe siguron një përdorim të ligjshëm, autentik dhe të plotë të fondeve publike. Së dyti, duke kryer rolin e ekspozimit, auditimi zbulon dhe merret me shkelje të ligjeve dhe rregulloreve duke mbrojtur menaxhimin dhe përdorimin e hapur, transparent dhe të ndershëm të fondeve publike. Së treti, duke kryer rolin e tij korrigjues, auditimi identifikon shkaqet e problemeve të menaxhimit të fondeve në nivele sistematike dhe mekanike, ofron propozime për përmirësimin dhe thellimin reformave, si dhe siguron menaxhimin dhe përdorimin efikas dhe shkencor të fondeve publike. Që nga viti 2008, institucionet e kontrollit në Kinë kanë lehtësuar rritjen e të ardhurave dhe uljen e shpenzimeve, si dhe kanë ndihmuar në rregullimin ose shmangien e humbjeve të cilat kanë shkuar deri në rreth 72 bilion juan, dhe transferuar më shumë se 8,500 raste shkeljesh të rëndësishme të ligjeve dhe rregulloreve në departamentet përkatëse gjyqësore për veprime të mëtejshme.

Përsa i përket fushëveprimit dhe prioriteteve të auditimit, CNAO ka mandat të kontrollojë zona duke përfshirë financat publike, departamentet dhe agjencitë qeveritare, institucionet financiare dhe ndërmarrjet shtetërore, fondet dhe investimet e huaja. Numri i subjekteve të çdo viti është rritur nga 1,200 në vitin 1983 në më shumë se 140,000 tani. Ndërkohë, prioritetet tona të auditimit janë zhvendosur nga auditimi financiar dhe auditimii pajtueshmërisë duke u fokusuar në vërtetësinë dhe ligjshmërinë e llogarive, në auditimin e performancës duke theksuar përdorimin efikas të fondeve. Tridhjetë vitet e fundit kanë qenë të rëndësishëm për sa i përket rregullimit të shpenzimeve, përmirësimit dhe përdorimit efikas të fondeve publike. CNAO ka transformuar mënyrën e auditimit nga zbulimi i thjeshtë dhe korrigjimi i gabimeve, në buxhetimin e standardizuar dhe menaxhimin e modernizuar të financave publike në mënyrë që auditimi ti shërbejë menaxhimit makroekonomik



dhe ristrukturimit të financave publike. Ne i kemi dhënë më shumë rëndësi forcimit të mbikëqyrjes dhe kontrollit të pushteteve duke eksploruar mënyra për të kryer auditime përgjegjshmërie. Në pesë vitet e fundit, zyra auditimi në nivele të ndryshme kanë përfunduar auditime përgjegjshmërie për rreth 160,000 zyrtarëve të lartë në administratën publike. Prioriteti ynë janë tashmë auditimet në kohë reale të zbatimit të politikave të mëdha dhe masave të miratuara nga qeveria qendrore, duke përfshirë auditimet e më shumë se 20.000 projekte të rëndësishme investimesh si linja hekurudhore e shpejtësisë së lartë Pekin-Shangai, Tre Gorges dhe Lojrat Olimpikë të Pekinit, si dhe mbi 10.000 projekte të rëndësishme restaurimi dhe rindërtimi pas katastrofave natyrore për të siguruar që rezolutat dhe vendimet e qeverisë janë zbatuar në mënyrë efektive dhe se ekonomia është zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme dhe të shpejtë. I kemi kushtuar po kështu vëmendje të lartë, në mbështetje të sigurisë ekonomike kombëtare, auditimeve dhe studimeve që përfshijnë financat publike, institucionet financiare, investimet dhe asetet shtetërore, për të cilat në vitin 2011 CNAO ka aktivizuar mbi 40.000 auditues për të audituar më shumë se 1.870.000 huamarrje të qeverive lokale në nivel provincial, komunal dhe të qarkut, duke kontribuar në mënyrë aktive për të ruajtur rankimin e kreditit sovran të Kinës, duke përmirësuar sistemin e menaxhimit të financave publike dhe duke lehtësuar ndryshimet e ligjeve dhe rregulloreve përkatëse. Ndërkohë, i kemi kushtuar vëmendje edhe auditimit të përmirësimit të mirëqenies së njerëzve dhe kemi përfunduar auditimin e 18 fondeve të sigurimeve shoqërore në tre kategori, duke synuar që në harkun kohor 2005-2011 të ndikojmë në stabilizimin e pritshmërie të konsumatorëve dhe të mbrojmë një shoqëri harmonike dhe të qëndrueshme. Zhvillimi i qëndrueshëm social dhe ekonomik, është gjithmonë një nga shqetësimet tona kryesore, prandaj për këtë arsye kemi kryer auditime me qëllim kursimin e energjisë dhe reduktimin e emisioneve, si dhe ruajtjen e mjedisit dhe të burimeve. Përveç kësaj, analizat dhe rekomandimet janë hartuar nga perspektiva sistematike, mekanike dhe institucionale për të nxitur risitë dhe thellimin e reformave. Në pesë vitet e fundit, institucionet e auditimit në nivele të ndryshme kanë dorëzuar më shumë se 710,000 raporte auditimi, paraqitur mbi një milion rekomandime dhe kanë krijuar kushtet për më shumë se 28.000 ndryshime apo përmirësime në rregullore dhe në institucione. Për më tepër, janë intensifikuar zbulimet e shkeljeve të rëndësishme ligjore dhe të rregulloreve për të luftuar korrupsionin dhe për të ndërtuar një qeverisje të pastër.

**Për të zhvilluar auditimin e standardizuar dhe profesional të teknologjisë së informacionit**, në Kinë është aprovuar Ligji i Auditimit, Rregullorja për Zbatimin e Ligjit të Auditimit, dispozitat për Auditimin e Përgjegjshmërisë së Udhëheqësit Kryesorë të Partisë, Qeverisë dhe Ndërmarrjeve Shtetërore dhe Standardet Kombëtare të Auditimit, si dhe është ndërtuar një sistem ligjor me Kushtetutën si bazë, Ligjin e Auditimit dhe Rregulloret për Zbatimin e tij si dhe Standardet Kombëtare të Auditimit si kritere të punës në terren. CNAO vazhdimisht synon të nxisë forcimin e praktikës dhe aplikimit të teknologjisë kompjuterike në auditim, duke patur rezultate në automatizimin e zyrave dhe auditimin IT, si dhe në auditimin me bazë rrjeti dhe të sistemeve të informacionit. Ka patur progres të rëndësishëm dhe risi në përmirësimin e teknikave të auditimit duke rritur në mënyrë drastike efikasitetin dhe efektivitetin e tij. CNAO është e angazhuar për të vazhduar forcimin e kapaciteteve të audituesve dhe institucioneve të auditimit, si dhe në zbatimin e programit të kultivimit për profesionistët e auditimit. Si rezultat, aftësia e audituesit për të zbuluar probleme të rrënjosura thellë dhe për të promovuar reformat institucionale dhe mekanike është zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme.



**Për sa i përket transparencës së auditimit,** CNAO vazhdon të përmirësojë publikimin e rezultateve të auditimit dhe informacionit, si dhe promovon sistemin e transparencës në çështjet qeveritare. Në pesë vitet e fundit, institucionet e auditimit në të gjitha nivelet kanë publikuar më shumë se 24.000 njoftime të rezultateve të auditimit në mënyrë të hapur. CNAO gjithashtu mbështet median në kryerjen e raporteve përcjellëse për detyra të mëdha auditimi dhe hap proceset e auditimit në kohën e duhur, duke siguruar një kanal të rëndësishëm për publikun për të kuptuar performancën e departamenteve të qeverisë në përmbushjen e detyrave të tyre dhe për të monitoruar të ardhurat financiare dhe shpenzimet e departamenteve qeveritare. Njoftimet e rezultateve të auditimit dhe bashkëpunimi midis institucioneve të auditimit dhe shtypit nuk kanë lehtësuar vetëm aktivitetet korrigjuese për përgjegjshmërinë në lidhje me problemet e identifikuara gjatë auditimit, por dhe kanë rritur vetëdijen e përgjegjshmërisë dhe performancës në subjektet e audituara, duke përshpejtuar sinqeritetin dhe transparencën e qeverisë kineze në përgjithësi.

CNAO gëzon një shkallë të lartë pavarësie. Nga njëra anë, pavarësia e auditimit i është dhënë me Kushtetutë dhe me ligjet përkatëse. Për shembull, është e përcaktuar shprehimisht në Kushtetutë dhe në Ligjin e Auditimit që institucionet e auditimit, në përputhje me ligjin, në mënyrë të pavarur të ushtrojnë pushtetin e tyre të mbikëqyrjes përmes auditimit, nuk i nënshtrohet asnjë ndërhyrjeje nga ndonjë departament tjetër administrativ ose ndonjë organizatë publike apo individ; dispozita të veçanta janë miratuar edhe në Ligjin e Auditimit dhe në Standardet Kombëtare të Auditimit për pavarësinë e auditimit kombëtar. Në anën tjetër, institucionet e auditimit veprojnë në përputhje me masa të ndryshme të kontrollit të përcaktuara për të siguruar pavarësinë e tyre dhe përpiqen të ushqejnë karakterin e pavarur të audituesve nëpërmjet shprehjes së mendimit të pavarur, përgjegjshmërisë për sjelljet e tyre, gjithmonë duke thënë të vërtetën, dhe integritetin pa kompromis. Për më tepër, institucionet e auditimit kanë raporte auditimi dhe informacione të lidhura me to dhe në mënyrë rigoroze kanë vënë në praktikë një seri procedurash auditimi dhe rregullash, përfshirë këtu dhe garantimin e fondeve për operacionet në terren.

Duke marrë parasysh progresin e bërë në tridhjetë vitet e fundit, auditimi është bërë një pjesë e domosdoshme, endogjene e qeverisjes kombëtare. Me zgjerimin e fushëveprimit të auditimit, cilësia dhe thellësia e auditimeve janë vazhdimisht në përmirësimin, duke çuar në një rritje graduale të ndikimit social të punës së auditimit. Vlera e tij dhe përfitimet janë gjithnjë e më në dukje nga aktorët publikë dhe palët e interesuara, duke tërhequr vëmendjen e SAI-ve të ndryshme.

## **2. Çfarë e pret CNAO-n**

CNAO ka miratuar një Plan Strategjik për Zhvillimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kinës për periudhën e Planit të Dymbëdhjetë Kombëtar për Pesë-Vjeçarin, i cili përcakton objektivat e përgjithshme, detyrat kryesore dhe masat përkatëse për sigurimin e punës së auditimit për të ardhmen.

Katër objektivat kryesore të auditimit për të ardhmen janë si më poshtë. Së pari, promovimi i shtetit të së drejtës, mbrojtja e jetesës së njerëzve, dhe përshpejtimi i reformave dhe zhvillimit, duke i dhënë të fuqi të plotë funksionit të ndërtimit të imunitetit që ka auditimi në mbrojtjen dhe funksionimin e shëndoshë të shoqërisë dhe ekonomisë, në mënyrë që ai të shërbejë më mirë zhvillimin social-ekonomik, thellimin e reformave, duke





përmirësuar demokracinë dhe sistemin ligjor, duke mbështetur sigurinë kombëtare, duke luftuar korrupsionin, duke ndërtuar një qeveri të pastër, dhe duke përmirësuar qeverisjen kombëtare. Së dyti, forcimi i një auditimit IT të standardizuar dhe racional. Së treti, forcimi i përpjekjeve të vazhdueshme për ngritjen e kapaciteteve. Së fundi, shpërndarja e një arkitekture teorike auditimi dhe sistemesh me karakteristika kineze sipas kushteve kombëtare.

Në të ardhmen CNAO do të:

- Intensifikojë më tej zbulimin e shkeljeve të mëdha të ligjeve dhe rregulloreve dhe të krimeve ekonomike, luftojë korrupsionin dhe forcojë mbikëqyrjen dhe kufizimin e pushtetit në bazë të vërtetësisë dhe auditimit të pajtueshmërisë.
- Forcojë praktikën e auditimit në kohë reale mbi zbatimin e udhëzimeve kryesore, politikave dhe masave të makro-kontrollit të qeverisë qendrore, sigurojë që rezolutat dhe vendimet e qeverisë, si dhe politikën dhe masat e ndryshme zbatohen në mënyrë efektive.
- Rrisë përpjekjet e auditimit të projekteve kryesore IT, krijojë dhe përmirësojë një sistem të kompjuterizuar auditimi.
- Sigurojë zbatimin dhe përmirësimin e politikave, ligjeve dhe institucioneve duke forcuar zbulimin e problemeve dhe duke ofruar rekomandime korrigjuese dhe parandaluese mbi bazën e analizave të shëndosha nga këndvështrimi sistemik.
- Kushtojë vëmendje çështjes së sigurisë lidhur me financat publike, institucionet financiare, asetet shtetërore, mjetet e jetesës së njerëzve, burimeve dhe mjedisit, si dhe sistemeve të informacionit; do të zbulojë rreziqet ekzistuese duke marrë kundërmasa për të parandaluar dhe për të zvogëluar rreziqet dhe duke mbrojtur interesat dhe sigurinë kombëtare.

Për të arritur këto objektiva dhe detyra, duhet të forcohen masat mbrojtëse. Së pari, duhet pasuruar më tej kuadri i ligjeve të auditimit, standardet, rregulloret dhe udhëzimet, si dhe duhet forcuar zbatimi i ligjeve që kanë të bëjnë me auditimin. Në të njëjtën kohë duhet të verë në punë një sistem përgjegjësie për kontrollin e cilësisë të auditimit me aktivitete të intensifikuara për inspektimin e cilësisë, në mënyrë që të promovojë tërësisht shtetin e së drejtës mes institucioneve të auditimit. Së dyti, duhet të krijojë dhe të përmirësojë mekanizmin e trajnimit të audituesve dhe duhet të përmirësojë cilësinë e ekipeve të auditimit gjatë praktikës së auditimit, duhet të rrisë arsimin, trajnimin dhe ushtrimet praktike dhe nuk duhet të kursejë përpjekjet për të përmirësuar aftësinë dhe cilësinë e audituesve. Së treti, në mënyrë aktive duhet të eksplorojë auditimet dixhitale, duke mundësuar Qendrën Kombëtare të të Dhënave të Auditimit të sigurojë mbështetje teknike për vlerësimin e auditimit të menaxhimit të financave publike dhe funksionimin e sigurt ekonomik që përfshin financat publike, institucionet financiare, asetet në pronësi të shtetit, fondet për zhvillim të jetesës, etj. Së katërti, duhet të forcojë vlerat e auditimit dhe të rrisë besueshmërinë dhe pavarësinë e institucioneve të auditimit. Së fundi, duhet të forcojë hulumtimet e auditimit për të arritur nivel të lartë kërkimor në mënyrë që të sigurojë mbështetje dhe udhëzime për zhvillimin e punës së auditimit.



### 3. Pjesëmarrja e CNAO-s në INTOSAI

Zhvillimi 30 vjeçar i CNAO-s është reflektuar në arenën ndërkombëtare dhe pjesëmarrjen në aktivitete të INTOSAI-it. CNAO ka aderuar gjithmonë në moton e INTOSAI-t 'Experientia Mutua Omnibus Prodest' dhe ka kaluar nga një SAI përfitues i asistencës teknike për auditimin në një lojtar kyç në INTOSAI.



*Z. Liu Jiayi, Audituesi i Përgjithshëm i Zyrës së Auditimit Kombëtare të Kinës (CNAO), me Audituesin e Përgjithshëm të Afrikës së Jugut, z. Terence Nombembe, dhe Presidentin e Gjykatës së Llogarive Franceze, Z. Didier Migaud, në INCOSAI-n e XX-të në Johannesburg, Afrika e Jugut 2010*

CNAO u anëtarësua në INTOSAI në fazën përgatitore, në maj të vitit 1982. Në shtator të vitit 1983, CNAO aplikoi për anëtarësim në Organizatën Aziatike të Institucioneve Supreme të Auditimit (ASOSAI). Anëtarësimi në këto organizata ndërkombëtare në komunitetin e auditimit shënoi debutimin e CNAO-së në botë, duke vendosur kontakte me bashkësinë ndërkombëtare të auditimit dhe hedhjen e një themeli për shkëmbimin ndërkombëtar të eksperiencave.

Në dhjetë vitet e para pas krijimit, CNAO aktivisht ka shkëmbyer eksperiencë në nivel ndërkombëtar dhe ka bashkëpunuar duke ftuar ekspertë të huaj për të mësuar teknika të auditimit, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe ka nisur projekte afatgjata bashkëpunimi, zhvillimi të shumëkëndshëm me anëtarët më të përparuar të INTOSAI-t. CNAO u përqendrua kryesisht në hulumtimin dhe studimin e punës së auditimit të vendeve me përvojë të pasur në auditim dhe përfitoi njohuri mbi institucionet e huaja të auditimit dhe sistemet e tyre ligjor, për të marrë mbështetje empirike për krijimin e një sistemi të auditimit të përshtatshëm për Kinën.

Në dekadën pasuese, CNAO kaloi nga të mësuarit dhe pranimi i shërbimeve të trajnimit dhe asistencës së pajisjeve nga vendet e tjera, në një qasje më të balancuar me fokus të mësuarit dhe shkëmbimin e eksperiencës së përfituar. Mbi bazën e barazisë dhe përfitimit të ndërsjelltë dhe në kuadër të INTOSAI-t, ai ka marrë pjesë në mënyrë aktive në projektet e bashkëpunimit dhe këmbimit të eksperiencave, duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me SAI dhe zgjeruar gamën e bashkëpunimit.

Ndërkohë, CNAO filloi të luajë një rol aktiv brenda ASOSAI-t. Në vitin 1991, me sukses organizoi një asamble të përgjithshme të ASOSAI-t dhe u zgjodh si Kryetar i ASOSAI-t. Në vitin 2000, CNAO u zgjodh Kryetar i Grupit të Punës ASOSAI të Auditimit Mjedisor (WGEA). Në vitet 2006 - 2009, CNAO përsëri shërbeu si Kryetar i ASOSAI-t. Gjatë viteve, si anëtar i Bordit Drejtues të ASOSAI-t, CNAO mbështeti në mënyrë aktive përpjekjet për ngritjen e kapaciteteve të ASOSAI-t. CNAO deri më tani ka marrë pjesë në pesë projekte kërkimore ASOSAI, është përfshirë



hartimin e Udhëzimeve Kompjuterike të Auditimit, Udhëzimeve mbi Auditimin e Cilësisë së Sistemit të Menaxhimit dhe Udhëzimeve të Auditimit Mjedisor e kështu me radhë, dhe ka mbajtur nëntë evente për ndërtimin e kapaciteteve për ASOSAI-n (duke përfshirë trajnime dhe seminare).

*Asambleja e 10-të ASOSAI  
dhe Simpoziumi i 3-të mbi Rolin e Auditimit në Promovimin e Përgjegjshmërinë  
së Qeverisë mbajtur në Shanghai, Kinë, 2006.*



Në vitin 2002, INTOSAI WGEA ka ngritur një Komitet Drejtues, anëtar i të cilit është dhe CNAO në cilësinë e kryesuesit të ASOSAI WGEA, Ky ishte fillimi i pjesëmarrjes së CNAO-s në punën e Komiteteve dhe Grupeve të Punës që prej anëtarësimit në INTOSAI. Në 10 vitet e mëvonshme, CNAO u bë anëtar i komiteteve të ndryshme të INTOSAI-t, Grupet e Punës dhe Task Forcave, duke përfshirë: Komiteti i Standardeve Profesionale të INTOSAI-t (si dhe Këshilli Drejtues, Nënkomiteti i Auditimit Financiar, Nënkomiteti i Auditimit Pajtuëshmërisë dhe Projekt – Grupi i Harmonizimit), Grupi i Punës për Auditimin IT, Grupi i Punës për Indikatorët Kombëtar, Grupi i Punës për Luftën kundër Korrupsionit dhe Pastrimit të Parave, Grupit i Punës për Vlerën dhe Përfitimet e SAI-ve, Grupi i Punës për Borxhin Publik, Grupi i Punës për Përgjegjshmërisë dhe Auditimin e Ndihmave në Situata të Katastrofave Natyrore, Grupi i Punës për Modernizimin Financiar dhe Reformat Rregullatore dhe FAC Task Force e



*Takimi i 13-të i Grupit të Punës për Auditimin Mjedisor në Guilin, Kinë, 2010.*

INTOSAI-t për Parashikimin Financiar. CNAO gjithashtu organizoi Takimin e 13-të Grupit të Punës të INTOSAI-t për Auditimin e Mjedisit, Takimin e 19-të i Grupit të Punës INTOSAI për Auditimin IT, Takimin e 2-të të Grupit të Punës për Indikatorët Kombëtarë si dhe Takimin e 5-të të Komitetit Drejtues të Standardeve Profesionale. Në vitin 2007, CNAO u bë anëtar i Këshillit Drejtues, si dhe i Komitetit të Financave dhe Administratës të INTOSAI-t. Në vitin 2010, në INCOSAI-n e XX-të, CNAO u emërua si i pari nën kryetar i INTOSAI-t dhe organizues i INCOSAI-t të ardhshëm.



CNAO gjithashtu ka ndërmarrë në mënyrë aktive tema në kongrese INCOSAI. Krahas marrjes së përgjegjësisë për raportimin e temave të kongreseve për disa herë, CNAO ka shërbyer si Kryetar i Temës II, Auditimi Mjedisor dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm, në INCOSAI-n e XX-të, në vitin 2010 dhe tani kryeson Temën I, Auditimi Kombëtar dhe Qeverisja Kombëtare, në INCOSAI-n e XXI-të në 2013.

Që nga viti 2002, CNAO ka mbajtur nëntë seminare ndërkombëtare auditimi me burimet e veta, duke ofruar shërbime trajnimi për rreth 300 auditues nga Azia, Evropa, Afrika, dhe Oqeania. Për më tepër, në bazë të marrëveshjeve dypalëshe, CNAO ka organizuar disa programe trajnimi për audituesit nga SAI i Laosit, Kamboxhias, Mongolisë, Tajlandës, Indonezisë etj.

CNAO deri më tani ka ngritur marrëdhënie shkëmbimi dhe bashkëpunimi me SAI nga më shumë se 140 vende në të gjithë botën në të gjitha kontinentet dhe ka nënshkruar marrëveshje bilaterale bashkëpunimi me më shumë se 30 SAI si Gjykata Federale Gjermane e Auditimit (Bundesrechnungshof), Zyrën e Kontrollorin dhe Audituesit të Përgjithshëm të Indisë, Zyra e Audituesit të Përgjithshëm të Pakistanit, Dhoma e Llogarive të Federatës Ruse, dhe Bordi i Kontrollit të Republikës së Indonezisë etj, duke patur kështu marrëdhënie bashkëpunimi të auditimit bilateral të ndryshme, të bollshme, të frytshëm.

Kohët e fundit, CNAO është përballuar me sfidat globale në mënyrë proaktive dhe ka luajtur një rol të rëndësishëm në pjesëmarrjen dhe lehtësimin e qeverisjes globale. Duke u përballur me krizën globale financiare të vitit 2008, CNAO veprimi menjëherë për të audituar paketën stimuluese ekonomike të Kinës në përgjigje të krizës financiare, e cila ka vendosur kontroll efektiv mbi rreziqet financiare rajonale kundër përhapjes së mëtejshme të krizës. Në vitin 2011, CNAO u bë Kryetar i Bordit të Audituesve të Kombeve të Bashkuara dhe në këtë funksion ka dhënë kontribute të vlefshme ndaj promovimit të auditimeve të performancës në të gjithë organet e OKB-së, duke ngritur një mekanizëm për rotacionin e detyrave të auditimit dhe përmirësimin e qeverisjes së brendshme të Bordit të Audituesve të OKB-së.

Zhvillimi tridhjetë-vjeçar i CNAO ka përfituar nga motoja e INTOSAI-t. Gjatë viteve, një sistem kombëtar auditimi me karakteristika kineze ka marrë formë në kuadër të sistemit unik politik të Kinës socialiste. Auditimi shërben si sistem imunitar në qeverisjen kombëtare dhe kujdesin ndaj financave publike, duke stimuluar pjesëmarrjen në qeverisje globale. Besimi ynë për të ardhmen është se shumë SAI, si CNAO, do të arrijnë zhvillim më të madh me ndihmën e INTOSAI-t.



## Kontribut nga SAI i Kolombisë


*Sandro Morelli Rico*

*Kontrollor i Përgjithshëm*

*i Republikës së Kolombisë*

**INTOSAI:**

**60 Vjet duke Forcuar Auditimin Publik Ndërkombëtar**





*Rico*

*Kontrollor i Përgjithshëm i Republikës së Kolombisë*

*Komiteti për Ndarjen e Njohurive (KSC)*

**Anëtar**

*Grupi i Punës për Auditimin IT*

*Grupi i Punës për Auditimin Mjedisor*

*Grupi i Punës mbi Luftën kundër Korrupsionit dhe Pastrimit të Parave*

## **INTOSAI:**

### **60 Vjet duke Forcuar Auditimin Publik Ndërkombëtar**

Pranimi i domosdoshmërisë për të siguruar një auditim të jashtëm efektiv që vepron në mënyrë të pavarur nga qeveria është pa dyshim një progres vendimtar në zhvillimin e shteteve moderne. Kjo ka të bëjë me mekanizmat e kontrollit, auditimit të përgjegjshmërisë dhe financiar, të cilët mundësojnë që qytetarët, parlamentet dhe qeveritarët vetë të mund të njohin dhe të vlerësojnë se si janë përdorur paratë e taksapaguesve.

Kjo është arsyeja pse funksioni i rëndësishëm i auditimit të qeverisë dhe roli i Institucioneve Supreme të Auditimit pranohen përgjithësisht. Opinioni publik global është i vetëdijshëm për dëmet e shkaktuara nga fenomene si korrupsioni dhe përdorimi i pakujdesshëm i fondeve publike. Kjo situatë parashtron kërkesa të reja mbi institucionet tona çdo ditë.

Që nga themelimi i saj 60 vjet më parë, Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) në funksionin e saj si një platformë ka siguruar kushtet bazë për shkëmbim të ndërsjelltë profesional dhe ka dhënë mbështetje institucionale për pavarësinë e SAI-ve. Kjo reflektohet nga Deklaratat e Limës dhe Meksikës, si dhe me Rezolutën për Promovimin e Efikasitetit, Përgjegjshmërisë, Efektivitetit dhe Transparencës së Administratës Publike duke fuqizuar Institucionet Supreme të auditimit, miratuar fundmi nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.

Këto Deklarata theksojnë dhe pranojnë rëndësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit si shtyllat e një shoqërie më të drejtë dhe një shteti më efektiv që i shërben qytetarëve.

Që prej fillimeve të para të organizatës tonë ndërkombëtare, Kontrollori i Përgjithshëm i Republikës së Kolombisë ka marrë pjesë në mënyrë aktive në aktivitete dhe projekte të INTOSAI-t.



së

*Sandra Morelli Rico*

*Kontrollor i Përgjithshëm i Republikës së Kolombisë*



Për shembull, SAI ynë ka qenë anëtar themelues i ILACIF, sot e njohur si OLACEFS, Grupi i parë Rajonal i Punës i INTOSAI-t. Për më tepër, kemi patur një përfaqësues nga SAI ynë në aktivitetet koordinuese të programeve IDI për disa vjet. Aktualisht, jemi anëtar të Grupit të Punës për Auditimin Mjedisor (WGEA), Grupit të Punës për Auditimin IT (WGITA) dhe Grupit të Punës për Luftën kundër Korrupsionit dhe Pastrimit të Parave (WGFACML).

Shkëmbimi i përvojës dhe i praktikave më të mira të nxitura nga INTOSAI ka sjellë një shumëllojshmëri avantazhesh për Institucionit tonë Suprem të Auditimit. Prandaj do të dëshironim të shprehim falënderimet dhe mirënjohjen tonë të veçantë Organizatës dhe të gjitha SAI-ve që kanë kontribuar në forcimin e saj. Veçanërisht, do të doja të theksoj rolin e Gjykatës Austriake të Auditimit, e cila ka mbajtur Sekretariatit e Përgjithshëm të INTOSAI për 50 vjet. Sekretariati i Përgjithshëm ka kontribuar në mënyrë thelbësore në arritjen e rolit udhëheqës që INTOSAI gëzon në skenën globale.

Përvoja nga e kaluara na ka dhënë gjithashtu mjete të reja dhe më të mira për të trajtuar sfidat e ardhshme të auditimit financiar. Disa nga këto sfida do të jenë ndjekja e kriminalitetit transnacional, dhe identifikimi dhe kufizimi i sjelljeve mashtruese si për shembull konvertimi mashtrues i fondeve publike. Për të siguruar zbulimin dhe dënimin e rasteve të korrupsionit dhe për të garantuar që këto raste mund të shërbejnë si parandaluese, ligjet dhe organet gjyqësore, si dhe Institucionet Supreme të Auditimit duhet të veprojnë së bashku. Vetëm atëherë administrata publike do të jetë transparente. Unë jam e sigurt se INTOSAI do të vazhdojë të luajë një rol thelbësor në përmbushjen e këtyre detyrave në të ardhmen.


Nuk mund të përfundojë këto rreshta të shkurtër, pa përgëzuar komunitetin e auditimit në të gjithë botën për realizimin e kësaj etape, që paraqet një arritje të përbashkët për të gjithë. Pavarësisht vështirësive të ndryshme, vendosmëria, këmbëngulja dhe vullneti i të gjithë SAI-ve na mundësoi arritjen e shumë objektivave. Kjo është arsyeja pse ne padyshim do të kemi më shumë sukses në të ardhmen.





## Kontribut nga SAI-t të Kubës

60 Vjet INTOSAI





*Komiteti i Standardeve Profesionale (PSC)*

*Anëtar*

*Komiteti i Ndarjes së Njohurive (KSC)*

*Nënkomiteti i Standardeve të Kontrollit të Brendshëm*

*Nënkomiteti i Kontabilitetit dhe Raportimit*

*Grupi i Punës për Auditimit IT*

## **60 Vjet INTOSAI**

Institucioni Suprem i Auditimit të Kubës, si anëtarë të tjerë të INTOSAI-t e vlerëson dhe e pranon ndihmesën e dhënë nga INTOSAI gjatë 60 viteve të ekzistencës së tij. SAI i Kubës ndihet krenar që ka mbajtur Sekretariatën e parë të Përgjithshëm të INTOSAI-t gjatë Kongresit të parë të INTOSAI-t (INCOSAI), i cili u zhvillua në Havanë në vitin 1953 me iniciativë të Gjykatës së Llogarive të Kubës.

Kuba drejtoi Sekretariatën e Përgjithshëm deri në vitin 1960. Gjatë kësaj periudhe, shtetet anëtare përgatitën draftin e parë të Urdhëresave të Përhershme të INTOSAI-t dhe ngritën pesë grupet e parë të punës në vitin 1956.

Viti 1959 u shënuar me fitoren e Revolucionit Kuban dhe me një ndryshim rrënjësor në mjedisin ekonomik dhe të auditimit të vendit. Anëtarët e SAI-t, të cilët ishin të korruptuar në një shkallë të lartë, nuk arritën të reagojnë sipas procesin të ristrukturimit. Si rrjedhojë, u miratua ligji për për Ministrinë e Rikuperimit të Mallrave të Përvetësuar si pjesë e procesit të ristrukturimit, e cila rezultoi në qeverinë revolucionare (Akti 78 1959). Ministria u themelua me qëllim për të rimarrë mallrat e tjetërsuara nga prona shtetërore dhe për të zbatuar rimbursimin e këtyre mallrave të përdorura për pasurim të paautorizuar.

Vetëm disa muaj më vonë ky institucion u shpërbë dhe u zëvendësua nga Ministria e re e Financave. Prej atëherë e tutje, institucioni i auditimit, i cili kishte mbajtur emra të ndryshëm, mori funksione të ndryshme dhe në këtë mënyrë u zhvillua vazhdimisht, duke filluar të punojë në mënyrë të strukturuar. Midis 1960 dhe 1975, gjatë fazës së ndërtimit të kësaj strukture të re, Kuba ka marrë pjesë në Kongreset e INTOSAI-t, në seminare dhe workshop-e për shkëmbimin e eksperiencës.

Në vitin 1977 u krijua Komiteti Shtetëror i Financave, i cili përbëhet nga departamente auditimi. Në vitin 1989 Kuba u anëtarësua në Organizatën e Institucioneve Supreme të Auditimit të Amerikës Latine dhe Karaibvee (OLACEFS) dhe rriti pjesëmarrjen e saj në aktivitete të organizuara nga INTOSAI.

Në vitin 1995 u krijua Zyra Kombëtare e Auditimit (ONA), një institucion në vartësi të Ministrisë së Financave dhe Çmimeve (MFP). Ky institucion mban marrëdhëniet e punës dhe promovon shkëmbimin e përvojës dhe të formave të tjera të bashkëpunimit me Amerikën Latine dhe rajonet tjera përmes OLACEFS si një Grup i Punës Rajonal i INTOSAI-t dhe nëpërmjet organizatave të tjera profesionale që lidhen me auditimin e jashtëm dhe të brendshëm.



ONA pastaj filloi punën përgatitore si organizator i Seminarit për Auditimin e Performancës, mori pjesë në seminarin e 11-të të OKB/INTOSAI-t dhe u përfaqësua në negociatat mbi Konventën e OKB-së kundër Korrupsionit, që u mbajt në Vjenë në vitin 2000 që ishte padyshim një përvojë paçmuar.

Për shkak të zhvillimeve të mëtejshme në lidhje me strukturën e re në vend dhe përvojën e fituar në auditim, lindi nevoja për një institucion qendror për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit i cili u ngrit në vitin 2001 si Ministri e Auditimit dhe Kontrollit (MAC). Në këtë periudhë, Kuba mori pjesë në aktivitetet e OLACEFS dhe INTOSAI, për shembull në 2002 dhe 2007 në Seminare të OKB/INTOSAI-t. Gjithashtu Kuba organizoi një seminar mbi përdorimin e teknologjive të informacionit në fushën e auditimit dhe mori pjesë në konferencat EUROSAI-OLACEFS në vitin 2002 dhe 2009.

Zbatimi i qëllimeve të Iniciativës për Zhvillim të INTOSAI (IDI) është me rëndësi të drejtpërdrejtë edhe për Kubën, për shembull, në formën e kurseve në baza vjetore të organizuar mbi Mjetet për Parandalimin dhe Kontrollin e Korrupsionit Administrativ. Qendrat e trajnimit rajonale në Kubë gjithashtu sigurojnë kurse për audituesit, specialistët, drejtuesit dhe nëpunësit civilë. Një nga projektet më të rëndësishme si pjesë e trajnimit kombëtar dhe trajnim të mëtejshëm janë programet e uniformuara të trajnimit për të gjithë audituesit. Deri tani, 1935 auditues të Sistemit Kombëtar të Auditimit (SNA) kanë përfunduar këtë trajnim. Për shkak të marrëveshjes së bashkëpunimit me Kanadanë dhe mbështetjen e trajnuesve të OLACEFS-it, SNA numëron deri tani 73 auditues të cilët po punojnë si trajnues sipas metodave të reja të mësimdhënies.



*Pjesëmarrësit në Kursin e Trajnimi mbi Auditimin e Performancës, 2003.*



*Pjesëmarrësit në Kursin e 6-të të Trajnimit mbi Mjetet për Parandalimin dhe Kontrollin e Korrupsionit Administrativ të mbajtur në Havanë, Kubë, 2011.*

Progresi i arritur në fushën e financave publike dhe në lidhje me auditimin e zgjeruara të administrimit ekonomik, përvoja e fituar në këtë çështje, krijimi i hierarkisë dhe autoritetit të nevojshëm për këtë aktivitet, zbatimi i Rregulloreve të përcaktuara në nenin 9, paragrafi a), i Kushtetutës së Republikës së Kubës në lidhje me mbrojtjen e punës së krijuar nga populli dhe të pronës dhe pasurisë së shtetit socialist, si dhe zbatimi i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit çoi në krijimin e Kontrollorin të Përgjithshëm të Republikës së Kubës në vitin 2009.

Ky institucion suprem publik auditimi, i pajisur me pavarësinë e nevojshme dhe duke vepruar në përputhje me parimet bazë të ligjshmërisë dhe rregullsisë, është rezultat i procesit të institucionalizimit të auditimit në Kubë.



Duke ndjekur qëllimin e INTOSAI-t për të përmirësuar vazhdimisht metodat dhe teknikat, për të nxitur shkëmbimin e përvojës dhe programet e trajnimit dhe për të rritur përdorimin e teknologjive moderne të informacionit, Kuba ka zhvilluar një proces për të siguruar konsistencë dhe koherencë të standardeve efektive të auditimit për të harmonizuar këtë të fundit me standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI) dhe standardet ndërkombëtare për auditimin financiar. Për më tepër, Kuba është e përfaqësuar në një projekt për zbatimin e një shërbimi virtual të bibliotekës për anëtarët e OLACEFS-it dhe vazhdimisht kërkon përditësimin e faqeve të internetit të SAI-ve dhe hyrje në faqet e internetit të organizatave ndërkombëtare në të cilat është anëtare. Progres i madh është arritur edhe në lidhje me përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit në fushën e auditimit, në bashkëpunim të ngushtë me ministrinë përgjegjëse për çështjet.



*Sesion pune në Seminarin e 11 të Ndërkombëtar mbi Auditimin e Performancës, në Havanë, Kubë 2004.*



*Pjesëmarrësit në Seminarin e 11-të Ndërkombëtar mbi Auditimin e Performancës, në Havanë, Kubë, 2004.*

SAI i Kubës tani merret me zbatimin e katër qëllimeve të INTOSAI-t dhe zonat kryesore të aktivitetit të tyre. Kuba është anëtar i Komitetit të Standardeve Profesionale, i Nënkomitetit të Kontabilitetit dhe të Raportimi dhe i Nënkomitetit të Standardeve të Kontrollit të Brendshëm. SAI është edhe anëtar i Komisionit për Ndarjen e



Njohurive dhe Shërbimet e Njohurive dhe gjithashtu merr pjesë në Grupin e punës për Auditimit IT (Objektivi 3). Gjithashtu Kuba u ftua nga INTOSAI për të dhënë një prezantim me temën si raportues mbi Auditimin Kombëtar dhe Qeverisjen Kombëtare për Kongresin e XX-të të INCOSAI-it në Pekin, Kinë.

Gjithashtu, Kuba ka nënshkruar zhvillimin e mëtejshëm të standardeve për kontrollin e brendshëm për të cilat u ekzaminuan baza e aplikueshme ligjore e shtatë shteteve anëtare të Kontrollit OLACEFS dhe modele të tjera të mjedisit ndërkombëtar.

Si rezultat i mbështetjes së Grupit Rajonal të Punës së INTOSAI-it (OLACEFS), si dhe përvojës, përgjegjësisë dhe angazhimit të Kontrollorit të Përgjithshëm të Republikës së Kubës dhe mbështetjes së qeverisë kubane, ky SAI vlerësohet për punën parandaluese në nivel ndërkombëtar.

Një nga rekomandimet e Kongresit të kaluar për anëtarët e INTOSAI-t ishte ingranimi i përpjekjeve të tyre në drejtim të auditimit mjedisor. Në përgjigje të këtij stimulimi ndërkombëtar, SAI i Kubës ka institucionalizuar në Aktin Nr 107/09 të Kontrollorit të Përgjithshëm të Republikës së Kubës ekzistencë e këtij auditimi, ka bashkëpunuar në një kurs mbi auditimin e mjedisit, i cili është financuar nga një projekt kanadez, dhe bashkëpunon me institucionet e tjera kombëtare.

Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) po përballlet me sfidën e frenimit të korrupsionit në të gjitha nivelet. Në përpjekjet për zhvillimin e ardhshëm të INTOSAI-t, duhet të nxisim bashkëpunimin midis të gjitha shtetet anëtare dhe të përpiqemi për të arritur një bazë të përbashkët për metodat e punës. Si pasojë, qëllimet e SAI-t tonë janë fokusuar në zbulimin dhe ndalimin e korrupsionit, i cili është në përputhje me pritjet e qeverisë dhe popullit kuban. Kjo detyrë është ilustruar edhe me fjalët e thëna nga presidenti Raul Kastro Ruz gjatë Konferencës së parë Kombëtare të organizuar nga Partia Komuniste e Kubës: "Vendi ynë mund të fitojë luftën kundër korrupsionit. Ne së pari do të ndalojmë korrupsionin dhe pastaj do ta eliminojmë atë plotësisht pa zhurmë të tepërt."


Përsëri Kuba konfirmon gatishmërinë e saj për të vazhduar bashkëpunimin me INTOSAI-n dhe Institucionet Supreme të Auditimit për sa i përket eliminimit të mungesës së disiplinës, korrupsionit dhe shkeljes së ligjit në vendet tona, duke ofruar kontribute ose duke ndarë përvojat në të gjitha platformat.

Kuba do të donte të falënderonte Organizatën Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit për arritjet dhe shikon mbrapa në historinë e saj 60-vjeçare me krenari dhe vlerësim. Ne jemi të bindur se vetëm duke bashkuar forcat Institucionet Supreme të Auditimit mund të luftojnë të keqen e korrupsionit. Qëllimi kryesor për ne si anëtar i një organizate ndërkombëtare është parandalimi. Prandaj misioni ynë mbështetet në parimet e José Marti: *Parashikimi është arti i shpëtimit.*



## Kontribut nga SAI i Qipros

Sfidat e së Ardhmes  
për INTOSAI-in







*Komiteti i Ndarjes së Njohurive (KSC).....Anëtar*

*Grupi i Punës për Auditimin e Mjedisit*

*Grupi i Punës për Modernizimin Financiare dhe Reformën Regullatore*

### **Sfidat e së Ardhmes për INTOSAI-n**

Nocioni i auditimit të qeverisë ka rrënjët e tij në demokracinë e lashtë të Athinës në shekullin e pestë para lidhjes së krishtit. Sot ai përbën një pjesë të pandashme të çdo sistemi që promovon përgjegjshmërinë dhe mirë qeverisjen. Ky rol shumë i rëndësishëm i është dhënë Institucioneve Supreme Kombëtar të Auditimit të çdo vendi, gjë kjo që lehtëson përgjegjshmërinë, duke siguruar informacion të besueshëm në bazë të cilit publiku i gjerë mund të vlerësojë performancën e atyre në duart e të cilëve është vendosur pushteti ekzekutiv. Prandaj, SAI-t kanë një rol të rëndësishëm në promovimin e besimit të publikut dhe rritjes së transparencës, dhe në të njëjtën kohë ata japin këshilla të shëndosha se si performanca mund të përmirësohet përmes shpenzimeve efektive, efikase dhe ekonomike të fondeve publike.

Nevoja për zhvillimin dhe shkëmbimin e përvojës, njohurive dhe informacionit midis institucioneve të ndryshme supreme të auditimit (SAI) është identifikuar herët në epokën pas- luftës botërore dhe çoi në krijimin e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit me 29 anëtarët themelues në vitin 1953. Motoja INTOSAI-së, *Experientia mutua omnibus prodest*, përcakton shumë qartë çelësin për qëllimet dhe prioritetet e saj. Kanë kaluar gjashtëdhjetë vjet që atëherë dhe INTOSAI ka rritur të jetë një nga organizatat më të mëdha ndërkombëtare, që numëron 191 anëtarë dhe 4 bashkëpunëtorët. Zyra e Auditimit të Republikës së Qipros, në formën e saj aktuale, e cila është themeluar kur Qiproja u bë një shtet i pavarur në vitin 1960, ka qenë një anëtar aktiv i INTOSAI-t që atëherë.



*Anëtar i SAI-t të Qipros, z. Andreas Kourtellis, në Takimin e Komisionit të Kontaktit Drejtuesve të SAI-ve të Bashkimit në Portugali, 2012.*

Gjatë 60 viteve të fundit INTOSAI ka qenë i suksesshëm duke mbledhur së bashku audituesit e qeverive nga pothuajse të gjitha vendet e botës në konferenca dhe aktivitete trajnuese. Kjo kontribuar në përditësimin anëtarëve të saj me zhvillimet e reja në profesionin e auditimit të qeverisë përmes publikimeve dhe ka qenë një forum i rëndësishëm për shkëmbimin e njohurive dhe përvojës. Nëpërmjet ngritjes së grupeve të punës, kjo organizatë ka qenë në gjendje të veprojë si një pioniere në fusha të specializuara të auditimit, si auditimi mjedisor, dhe grupet të saj rajonale kanë qenë në gjendje të trajtojnë në mënyrë më efikase problemet dhe shqetësimet e përbashkëta rajonale.



*Takimi i partnerëve të Auditimit Bashkëpunues për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike nën ombrellën e Grupit të Punës EUROSAI për Auditimin e Mjedisit, Qipro 2011.*

Një nga piketat më të rëndësishme dhe arritjet në historinë e INTOSAI-t, e cila është bërë e mundur nga përpjekjet e palodhshme të Sekretariatit ndër të cilat vlen të përmendim Rezolutën miratuar më 22 dhjetor 2011 nga Asambleja e 66-të e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara e titulluar Promovimi i Efikasitetit, Përgjegjshmëria, Efektivitetit dhe Transparencës në Administratën Publike, duke forcuar Institucionet Supreme të Auditimit. Për herë të parë, Asambleja e Përgjithshme shprehimisht njeh rolin e rëndësishëm të SAI-ve në promovimin e efikasitetit, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike dhe faktin që SAI-t kryejnë detyrat e tyre në mënyrë objektive dhe efektive vetëm nëse ata janë të pavarur. Ky rol është theksuar në krizën e tanishme financiare, ku kufizimet buxhetore e bëjnë shumë të rëndësishme mirë qeverisjen, transparencën dhe përdorimin e frytshëm, ekonomik dhe efektiv të fondeve publike. Arritjet e kaluara kanë vendosur një barrë shtesë për INTOSAI-n në të ardhmen, pasi pritshmëritë janë më të larta dhe qëllimet janë më ambicioze. Në ekonominë e sotme të globalizuara, ku teknologjia pothuajse ka hequr të gjithë kufijtë natyrorë, nevoja e bashkëpunimit dhe e shkëmbimit të informacionit nuk mund të theksohet mjaftueshëm. Kjo tregohet qartë nga numri gjithnjë e në rritje i auditimeve të përbashkëta të ndërmarra, në nivel rajonal ose ndërkombëtar, i cili nuk do të ishte i mundur pa lehtësimin e Sekretariatit të Përgjithshëm të INTOSAI-t.

Përveç kësaj, kriza aktuale financiare ka tronditur besimin e njerëzve në institucionet financiare dhe madje edhe në qeveritë, pra roli i audituesve për të siguruar raporte që janë të cilësisë dhe kompetencës profesionale më të lartë, dhe që perceptohen si e tillë nga publiku i gjerë, është gjithnjë më i rëndësishëm. Prandaj, Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve të Auditimit Suprem (ISSAIs) të INTOSAI-t, të cilat janë paraqitur dhe miratuar në INCOSAI-n e Afrikës së Jugut në vitin 2010, u pritën me entuziazëm, jo vetëm nga audituesit e sektorit publik, por nga të gjithë profesionistët e kontabilitetit.

Deklarata e Afrikës së Jugut, si pjesë e Marrëveshjeve të Johannesburg-ut u bën thirrje anëtarëve të INTOSAI-t të përdorin kuadrin ISSAI si një kornizë e përbashkët e referencës për auditimin e sektorit publik, për të matur performancën e tyre dhe udhëzimet e auditimit kundër tij, dhe të zbatojnë atë në përputhje me mandatin e tyre, legjislacionin dhe rregulloret kombëtare. Edhe pse ISSAIs përbëjnë parakushtet themelore për funksionimin e rregullt dhe sjelljes profesionale të SAI-ve, secili SAI është plotësisht i pavarur në marrjen e vendimit deri në çfarë




mase të miratojë kornizën e ISSAI-ve. Prandaj, asimilimi i suksesshëm i ISSAI-ve nga sa më shumë SAI është një sfidë e madhe për INTOSAI-n, i cili tashmë është duke promovuar aktivitete të ndryshme dhe duke marrë hapa në këtë drejtim.



*Zj. Chrystalla Georghadji, Audites i Përgjithshëm i Republikës së Qipros, duke dhënë një prezantim për asimilimin e ISSAI-ve në Simpoziumin ASOSAI në Jaipur, Indi, 2012.*

Zona të caktuara që janë të pothuajse ekskluzivisht në fushën e auditimit të qeverisë po fitojnë rritje në rëndësi. Zona të tilla, për shembull auditimi i borxhit publik dhe auditimi mjedisor, janë shumë të specializuara dhe mbulojnë tema ku bashkëpunimi nuk është vetëm i rëndësishëm, por një parakusht themelor. Si pasojë, shpresat janë të larta që INTOSAI do të vazhdojë të promovojë trajnime për këto çështje, të nxjerrë udhëzime profesionale për të inkurajuar anëtarëve të tij që të vazhdojnë të marrin pjesë në projekte të përbashkëta auditimi, për të rritur bashkëpunimin dhe shkëmbimin e njohurive.


Fakti që INTOSAI është një familje e madhe ndërkombëtare e karakterizuar nga shumë diversitet është një nga pikat e saj të forta, por edhe një sfidë e madhe. Anëtarët e kësaj familjeje ndryshojnë, jo vetëm në lidhje me madhësinë e tyre, burimet në dispozicion dhe madje edhe modelin e auditimit të ndjekur, por edhe në kulturë, prioritetet dhe qasjet. INTOSAI ka qenë i suksesshëm në mbledhjen e përvojave dhe njohurive nga të gjitha këto sfone të ndryshme dhe në shpërndarjen e tyre të frytshme në përfitim të të gjithëve, dhe është e sigurt se ai do të vazhdojë kështu edhe në të ardhmen. Ne të gjithë kemi një rol të rëndësishëm në qoftë se ne duam që INTOSAI të vazhdojë të jetë një organizatë e suksesshme, por barra është e madhe për Sekretariatën e Përgjithshëm të INTOSAI-t. Me mbështetje nga të gjithë ne, nuk ka dyshim pavarësisht këtyre sfidave të ardhshme, INTOSAI do të vazhdojë të përparojë nga fuqia në fuqi, duke rritur cilësinë dhe besueshmërinë e auditimit të qeverisë.





## Kontribut nga SAI i Danimarkës

Komiteti i Standardeve Profesionale  
të INTOSAI-t





<i>Komiteti i Standardeve Profesionale (PSC)</i>	<i>Kryetar</i>
<i>Komiteti Drejtues i PSC-së</i>	
<i>Komiteti i Ndërtimit të Kapaciteteve (CBC)</i>	<i>Anëtar</i>
<i>Komiteti i Ndarjes së Njohurive (KSC)</i>	
<i>Nënkomiteti i Auditimit të Pajtuëshmërisë</i>	
<i>Nënkomiteti i Auditimit të Performancës</i>	
<i>Grupi i Punës për Indikatorët Kombëtarë</i>	
<i>Komiteti Drejtues i Bashkëpunimit INTOSAI-Donatorë</i>	
<i>FAC Task Force për Parashikimin Financiar të INTOSAI-t</i>	
<i>Komiteti drejtues i CBC</i>	<i>Vëzhgues</i>
<i>Komiteti drejtues i KSC</i>	

### **Komiteti i Standardeve Profesionale të INTOSAI-t**

Me miratimin e 37 ISSAI-ve të reja në INCOSAI-n e Johannesburg, në Afrikën e Jugut, në vitin 2010, INTOSAI u pozicionua si një organizatë hartuese standardesh ndërkombëtare për auditimin e sektorit publik.

Ambicia e INTOSAI-t për të siguruar një kornizë të përditësuar të standardeve profesionale të auditimit është transmetuar në Planin Strategjik 2005-2010. Zhvillimi i standardeve të auditimit dhe i udhëzimeve nuk është diçka e re për INTOSAI-n; që nga viti 1984 tre komisione të mëdha për standardet (e kontabilitetit, auditimit dhe kontrollit të brendshëm) kanë hartuar një numër të madh standardesh dhe udhëzimesh, por ngritja e profilit dhe e statusit të procesit të përcaktimit të standardeve të auditimit të INTOSAI-t dhe sigurimi që këto standarde pasqyronin praktikën më të mirë ishte një risi dhe përfaqësonte një ndryshim paradigme në INTOSAI.

### **Krijimi i Komitetit të Standardeve Profesionale (PSC)**

Për të kthyer këtë ambicie në praktikë dhe për të dhënë strukturën e nevojshme, INCOSAI 2004, në Budapest vendosi të krijojë Komitetin e Standardeve Profesionale si objektivi i parë i Planit Strategjik të INTOSAI-t. Atëherë Audituesi i Përgjithshëm i Institucionit Suprem të Auditimit të Danimarkës, Henrik Otbo, u zgjodh Kryetar i këtij Komiteti, i cili përbëhet nga rreth 68 anëtarë të INTOSAI-t.

Një Komitet Drejtues me 19 anëtarë është caktuar për të kryer këtë punë, i cili është organizuar në pesë Nënkomitete të Përhershme: i Auditimit Financiar, Nënkomiteti i Auditimit të Pajtuëshmërisë, Nënkomiteti i Auditimit të Performancës, Nënkomiteti i Standardeve të Kontrollit të Brendshëm dhe Nënkomiteti i



Kontabilitetit dhe Raportimit. Aktivitetet e këtyre nënkomiteteve plotësohen nga projekte *ad-hoc* që ekzistojnë për një periudhë të kufizuar kohore.


SAI i Danimarkës ende kryeson PSC, por z. Otbo u pasua nga Asistent Audituesi i Përgjithshëm, zj. Bettina Jakobsen, e cila u emërua Kryetare e re Maj 2012.



*Pjesëmarrësit në Takimin e Komitetit Drejtues të PSC-së, në Manama, në Mbretërinë e Bahrein, 2007.*



*Struktura Organizative e PSC-së – Gusht 2012*







## Qasja e Dyfishtë

Në takimin e Komitetit Drejtues të PSC në Uashington në vitin 2006, u diskutua deri diku roli i INTOSAI-t, si një organizatë për përcaktimin e standardeve, dhe rezultoi në prezantimit e konceptit të qasjes së dyfishtë, që do të thotë se standardet dhe udhëzimet e INTOSAI-t duhet të bazohen në standardet që njihen dhe pranohen nga shumica e SAI-ve. Duke njohur, shfrytëzuar dhe ndërtuar standarde të miratuara nga organe të tjera për aq sa të jetë e mundur dhe e përshtatshme, Komiteti i Standardeve Profesionale (PSC) duhet të përpiqet të harmonizojë auditimin e sektorit publik në nivel ndërkombëtar.

Qasja e dyfishtë e ka vërtetuar vlefshmërinë e saj vitet e fundit; pasi ajo ka siguruar qartësinë e nevojshme për të përcaktuar se ku ndryshojnë standardet e auditimit të sektorit publik nga ato të sektorit privat, për këtë arsye ka lejuar që PSC të përpiqet të zhvillojë udhëzime në ato fusha ku SAI-t kanë nevoja të veçanta për shkak të statusit të tyre si autoritete kombëtare brenda sistemeve kushtetuese dhe detyrimeve të tyre si auditues të sektorit publik.

Përfitimet nga qasja e dyfishtë ndoshta reflektohen më mirë në bashkëpunimin midis Nënkomitetit të Auditimit Financiar dhe Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK). Njëpërmjet Nënkomitetit të Auditimit Financiar, INTOSAI përfaqësohet edhe në grupet e punës që zhvillojnë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) dhe për këtë arsye është në një pozicion të shkëlqyer për të siguruar që ISA-t të aplikohen edhe në auditimin e sektorit publik. Aspektet e auditimit financiar, të cilat janë specifike për auditimin e sektorit publik, dhe për këtë arsye nuk mbulohen nga ISA-t, trajtohen në të ashtuquajturat *Shënime praktike*.

Përveç IFAC-ut, PSC i INTOSAI-t gjithashtu ka një bashkëpunim të frytshëm me Institutin e Audituesve të Brendshëm nëpërmjet Nënkomitetit të Standardeve të Kontrollit të Brendshëm.

## Sigurimi i një Kuadri të Strukturuar për Standardet e INTOSAI-t

Për të lehtësuar përdorimin e standardeve të INTOSAI-t, Komiteti Drejtues i PSC vendosi të bashkojë standardet ekzistuese me standardet dhe udhëzimet e reja në një kuadër - korniza ISSAI - e cila u miratua në INCOSAI-n XIX në Meksikë në vitin 2007. Korniza ISSAI operon me katër nivelet e ISSAIs, në një sistem hierarkik ku dokumentet e nivelit më të lartë sigurojnë bazën për dokumentet e nivelit më të ulët. Dokumentet në këto katër nivele plotësohen nga të ashtuquajturat INTOSAI GOVs që ofrojnë udhëzime për autoritetet administrative, për shembull, në kontrollin e brendshëm dhe kontabilitetin.

Paralelisht me zhvillimin e kornizës, PSC ka krijuar faqen e internetit të ISSAI-ve ku të gjitha standardet dhe udhëzimet e auditimit të INTOSAI-t janë në dispozicion dhe familja e INTOSAI-t është e ftuar të komentojë ExposureDraft-t e rinj të ISSAI-ve. Në vitin 2008, faqja e internetit ka pasur 6.495 vizitorë - në vitin 2011 ky numër është rritur në 18.402, që korrespondon me një rritje prej rreth 183%.

Rritja e numrit të vizitorëve është një pasqyrim i dy gjërave:

1. Në vitin 2008 numri i standardeve të auditimit dhe udhëzimeve ishte mjaft modest, dhe;
2. Përpjekjet për të nxitur ndërgjegjësimin për kuadrin e ISSAI-t nuk patën rezultat deri në 2010/2011.



## Zhvillimi i ISSAI-ve dhe INTOSAI GOV

Që në themelimin e PSC, janë bërë përpjekje për të zhvilluar udhëzime të reja auditimi, dhe nëse është e mundur një përmirësim i standardeve dhe udhëzimeve ekzistuese. Plani Strategjik 2005-2010 bëri thirrje në mënyrë specifike për zhvillimin e parimeve të përgjegjshmërisë dhe transparencës për SAI-t dhe menjëherë pas hartimit të tij, Komiteti Drejtues aprovoi një projekt *ad-hoc* të kryesuar nga SAI i Francës. Ky projekt *ad-hoc* u shoqërua nga Projekti për Auditimin e Kontrollit të Cilësisë, i kryesuar nga SAI i Zelandës së Re. Rezultatet e përpjekjeve të anëtarëve të grupeve të punës të këtyre dy projekteve *ad-hoc* gjenden në ISSAI 20 dhe ISSAI 21, Parimet e Transparencës dhe Përgjegjshmërisë, si dhe në ISSAI 40, Kontrolli i Cilësisë për SAI-t.

Këto tri ISSAI u miratuan në INCOSAI-n e Johannesburgut në vitin 2010, dhe kështu u krijuan 34 ISSAI të tjera të reja nga ana e Nënkomiteteve të Përhershme. Me një kuadër tashmë të kompletuar me një seri të plotë udhëzimesh të auditimit financiar që mbulojnë të gjitha ISA-t, dhe udhëzimi i ri për auditimin e performancës dhe të pajtueshmërisë, si dhe kontrollin e brendshëm, për herë të parë INTOSAI mund t'u ofrojë anëtarëve të tij, dhe të tjerëve me një interes në auditimin e sektorit publik, qasje në një gamë të gjerë udhëzuesish profesional të auditimit të paraqitur në një format të strukturuar dhe të lehtë për përdorim.

Fokusimi në strukturë është reflektuar edhe në Procesin e Rregullt për Standarde Profesionale INTOSAI, i cili u miratua në INCOSAI-n e vitit 2010. Ky proces forcon qasjen profesionale të INTOSAI-t për zhvillimin e standardeve të auditimit; përcakton procedurat përmes të cilave INTOSAI zhvillon, heq nga qarkullimi dhe rishikon ISSAI-t dhe, ndoshta më e rëndësishmja, siguron transparencën e duhur në punën e ISSAI-ve dhe përgjegjshmërinë e Nënkomiteteve të ndryshme, projekteve, grupeve të punës, etj që janë të përfshirë në punën e ISSAI-ve.

## Rritjen e ndërgjegjësimit për ISSAI-t

Mundësia e një përzgjedhjeje të gjerë udhëzimesh profesionale të auditimit në kuadrin ISSAI dhe e një procesi të rregullt ishte për të gjithë shumë pozitive, por në qoftë se secili SAI nuk do të kishte miratuar dhe zbatuar ISSAI-t, asgjë nuk do të ishte arritur.

Deklarata e Afrikës së Jugut për këto Standarde Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, e cila u miratua nga 152 SAI-t që ishin të pranishëm në INCOSAI e Afrikës së Jugut, pasqyron këtë shqetësim dhe u bën thirrje anëtarëve INTOSAI-t për të përdorur kuadrin ISSAI si një kornizë të përbashkët të referencës për auditimin e sektorit publik, për zbatimin e ISSAI-ve në përputhje me mandatin, legjislacionin kombëtar dhe rregulloret e tyre, dhe për të rritur ndërgjegjësimin e ISSAI-ve dhe INTOSAI GOVs në nivel global, rajonal dhe kombëtar.

Komiteti i Standardeve Profesionale (PSC) e mori përsipër këtë sifidë dhe Task Force për Rritjen e Ndërgjegjësimit të ISSAI-ve mbajti mbledhjen e saj të parë në janar të vitit 2011. Anëtarët u rekrutuan nga Komiteti i Ndërtimit të Kapaciteteve (për të siguruar koordinimin e aktiviteteve), IDI, Bahrain, Nënkomiteti i Auditimit të Pajtueshmërisë, Nënkomiteti i Auditimit Financiar dhe Nënkomiteti i Auditimit të Performancës.

Gjatë 18 muajve që vijuan, Task Force shpërndau një numër të madh dosjesh dhe broshura, që theksonin përfitimet e përdorimit të ISSAI-ve. Ajo bëri rreth 20 prezantime mbi kuadrin ISSAI të SAI-ve në mbarë botën dhe



aktorëve të jashtëm si, për shembull, Banka Botërore, e cila ka miratuar mbështetjen financiare për zbatimin e ISSAI-ve përmes IDI-t.



*Pjesëmarrësit në Takimin e 8-të të Komitetit Drejtues të të Standardeve Profesionale (PSC) në Wellington, Zelandë e Re, 2011.*


Përfundimisht, pavarësisht çdo konsiderate tjetër, suksesi i kuadrin ISSAI varet tërësisht nga angazhimi dhe vullneti i secilit SAI për të ecur nëpër shtigje të reja.

### **Aktivitetet e Tanishme të PSC-së**

Detyra thelbësore e PSC-së për mandatin 2010-2013 është zhvillimi i parimeve të reja themelore të auditimit në zëvendësim të ISSAI-ve 100-400 (niveli i tretë i kuadrit). Parimet themelore të auditimit nuk janë rishikuar që nga viti 1992 dhe me miratimin e një seri të plotë udhëzimesh të reja në nivelin e katërt të kuadrin ISSAI, nevoja për të siguruar që ISSAI-t e nivelit më të lartë të jenë në përputhje me të dhe të pasqyrojnë përmbajtjen e nivelit të katërt është mjaft urgjente.

Që nga fillimi i vitit 2011, një projekt i kryesuar nga Sekretariati i PSC-së dhe që përfshin përfaqësues nga të gjitha rajonet e INTOSAI-t është për këtë arsye i përfshirë në zhvillimin dhe sigurimin që niveli i tretë i ISSAI-ve të ketë një "gjuhë të përbashkët", e cila mund të përdoret për të shpjeguar dhe krahasuar detyrat e SAI-ve në kontekstet e tyre të ndryshme kombëtare. Parimet duhet të përmirësojnë pasqyrën e miratuar të ISSAI-ve, duke përfshirë edhe udhëzuesit e nivelit të katërt mbi auditimin financiar, të performancës dhe të pajtueshmërisë.

Parimet e reja themelore të auditimit do të paraqiten për miratim në INCOSAI-v në Pekin, Kinë, në vitin 2013 dhe kështu do të shënojnë fundin e aktiviteteve intensive të zhvillimit që kanë karakterizuar punën e PSC-së që nga themelimi i tij në 2005.






## Kontributi i SAI-t të Ekuadorit

*Carlos Polit Faggioni*

*Kontrollori i Përgjithshëm*

*i Shtetit të Republikës së Ekuadorit*

60 Vitet e INTOSAI-t





*Komiteti i Ndarjes së Njohurive (KSC)*

*Anëtar*

*Komiteti i Administratës dhe Financave (FAC)*

*Grupi i Punës për Auditimin IT*

*Grupi i Punës për Luftën kundër Korrupsionit dhe Pastrimit të Parave*

*FAC Task Force e INTOSAI-t për Parashikimin Financiar*

## **60 Vitet e INTOSAI-t**

Që nga themelimi i saj, Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit, INTOSAI, ka arritur rezultate të mëdha dhe të rëndësishme dhe tani po kthen kokën pas të shohë gjashtëdhjetë vitet e para të punës produktive dhe bashkëpunuese në drejtim të zhvillimit të auditimit të qeverisë në botë.

Në dekadat e fundit, INTOSAI ka promovuar politika dhe strategji midis anëtarëve të saj për të përmirësuar kapacitetet duke ndërhyrë më shumë sukses në çështje gjithnjë e më komplekse që janë në ndryshim dhe gjithnjë e më sfiduese, si për shembull kriza financiare, trans-shtetëzimi i krimeve kundër burimeve publike, profesionalizimi i atyre që përbuzin besimin publik, si dhe përmirësimi i mjeteve për të vepruar në mënyrë të ligjshme.

Me bindjen se ka rëndësi diametrale, këto hapa janë ndërmarrë për të dhënë një kontribut global dhe të qëllimshëm. Në këtë ndërmarrje, INTOSAI kishte mbështetjen e vendosur të Grupeve Rajonale të Punës, të Kryetarëve të Bordit Drejtues, anëtarëve e saj dhe të gjithë atyre që kanë kryesuar komitetet e ndryshme, nënkomitetet, grupet e punës, Task forca dhe grupet e projekteve, si dhe të strukturës organizative shumë komplekse, por të dobishme të vetë INTOSAI-t.

Roli i Sekretariatit të Përgjithshëm, në ngarkim të Gjykatës Austriake të Auditimit, i ka dhënë INTOSAI stabilitet të mjaftueshme me kalimin e kohës për të siguruar vazhdimësinë e projekteve dhe veprimeve, në mënyrë që të kapërcehet udhëheqja e njerëzve dhe institucioneve që kanë shërbyer përkohësisht në organet e INTOSAI-t.

Sfida e madhe e Institucioneve Supreme të Auditimit, veçanërisht në vendet në zhvillim dhe në vendet me burime të pakta, është përgjigja ndaj kërkesave sociale në rritje, për të cilën nevojiten shtete më efikase me ligje që forcojnë administratën publike transparente në sistemet demokratike dhe që bazohen në institucione të forta me funksione autonome dhe të pavarura. Këto funksione duhet të jenë gjithëpërfshirëse për të lehtësuar dhe për të promovuar qeverisjen e përgjegjshmërisë në një kontekst të pjesëmarrjes dhe të përgjegjësisë sociale. Mbrojtja e mjedisit, si trashëgimi e qytetarëve dhe përdorimi racional i burimeve në përpjekje për të arritur zhvillimin e shumëpritur do të jetë gjithashtu një objektiv kyç. Pa dyshim, struktura e INTOSAI, ushqyer nga përvoja dhe potenciali të anëtarëve të saj, gjithashtu i shërben zbatimit të një strategjie institucionale për ngritjen e kapaciteteve. Prandaj duhet të plotësohet nga investimet e vazhdueshme, që janë në linjë me dhe fokusohen në përhapjen dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare të pranuar globalisht, të cilët respektojnë parimin e sovranitetit kombëtar.



Zyra e Kontrollorin të Përgjithshëm të Republikës së Ekuadorit, si anëtar i INTOSAI-t dhe ish-Kryetari i Organizatës së Institucioneve Supreme të Auditimit të Amerikës Latine dhe Karaibeve të (OLACEFS) ka gjetur tek INTOSAI një burim mundësish të mëdha për zhvillim. INTOSAI ka synuar gjithmonë në forcimin e anëtarëve të saj dhe anëtarëve të Rajonit të Amerikës Latine. Ne shpresojmë se ky angazhim do të vazhdojë me të njëjtën frymë dhe me përgjegjësi të madhe nga pasardhësit tanë.



*Kryetari i SAI-t të Ekuadorit, z. Carlos Ramón Polit Faggioni, në Takimin e 62-të të Bordit Drejtues të INTOSAI në Vjenë, Austri, 2011.*

Puna jonë është vetëm një nga disa prej kontributeve që bota ka nevojë për të udhëhequr shoqëritë në nivelet më të mira të jetës përmes promovimit të kapaciteteve të auditimit që janë në mbrojtje të burimeve publike në mënyrë që nga shfrytëzimi i tyre të mund të përfitojnë qytetarët.

Ky motivim duhet të ilustron angazhimin tonë të nevojshëm për një botë më të drejtë, më të barabartë dhe më të bashkuar në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe e karakterizuar nga një komunitet ndërkombëtar që promovon dhe siguron për të gjithë njerëzit ushtrimin e plotë të të drejtave dhe detyrimeve të tyre.

Shoqëria civile duhet ta pranojë rolin transformues të Institucioneve Supreme të Auditimit si nxitës të efikasitetit, përgjegjshmërisë, efektshmërisë dhe transparencës në administratën publike.

Është e një rëndësie të madhe përshpejtimi i zbatimit të programeve të zhvillimit, pasi qytetarët kanë arritur një nivel të tillë të vetëdijes shoqërore që i bën ata të vlerësojmë apo pranojnë vetëm rezultate pozitive.

Ekzistenca e thjeshtë e INTOSAI-t është një vlerësim i nevojës së bashkëpunimit ndërkombëtar dhe të vazhdimin dhe intensifikimin të tij. Në këtë kontekst, ne kemi mundësinë të stimulojmë shkëmbimin dhe bashkëpunimin horizontal ndërmjet SAI-ve të të gjitha kontinenteve.

Qëllimet Strategjike, Grupet e punës, Task Forcat, Komitetet dhe entitetet e tjera të strukturës së INTOSAI-së janë kanalet që kontribuojnë në ndërtimin e kapaciteteve me qëllim përmirësimin e auditimit të qeverisë. Secili prej këtyre subjekteve është i specializuar në çështje të veçanta teknike dhe hulumtuese. Në këtë mënyrë, INTOSAI po hap mundësitë për mbështetje, orientim dhe inovacion të praktikës midis SAI-ve.

Pa dyshim përvjetori i gjashtëdhjetë i INTOSAI-t është një ngjarje e gëzueshme, e cila përfaqëson kremtimin e njohurive, zhvillimit, bashkëpunimit dhe festimin e institucioneve që kanë shkruar historinë e tij si udhëheqës i luftës kundër korrupsionit, që përfshin uljen e varfërisë dhe konsolidimin e demokracisë.






## Kontribut nga SAI i Estonisë

60 Vitet e INTOSAI-t

50 Vitet e Sekretariatit të Përgjithshëm

në Vjenë





*Grupi i Punës për Auditimin Mjedisor*

*Kryetar*

*Komiteti i Ndërtimit të Kapaciteteve (CBC)*

*Anëtar*

*Komiteti i Ndarjes së Njohurive (KSC)*

*Komiteti Drejtues i KSC*

*Nënkomiteti 1: Promovimi i Ngritjes së Kapaciteteve*

*Aktivitetet midis anëtarëve të INTOSAI-t*

*Nënkomiteti 2: Nxitja e Praktikave më të Mira*

*dhe Sigurimi i cilësisë nëpërmjet Peer Review*

*Grupi i Punës për Modernizimin Financiar dhe Reformën Rregullatore*

## **60 Vitet e INTOSAI-t dhe 50 Vitet e Sekretariatit të Përgjithshëm në Vjenë**

### **Zhvillimi i Bashkëpunimit Ndërkombëtar të SAI-ve që nga viti 1953/1963 - 60 vitet e INTOSAI-t/50 vitet e Sekretariatit të Përgjithshëm**

Zyra Kombëtare e Auditimit të Estonisë (Riigikontroll) iu bashkua familjes INTOSAI në vitin 1992. Menjëherë pas pavarësisë së Republikës së Estonisë u rivendos edhe Zyra Kombëtare e Auditimit (NAO) e ri-krijuar. Viti 2012 shënon 20 vjetorin e ngjarjes së paharrueshme në INCOSAI XIV, kur në mbledhjen e Bordit Drejtues të 36-të u pranuan gjashtë Institucione Supreme të Auditimit si anëtarë të rinj të INTOSAI-t, përfshirë *Riigikontroll* të Estonisë.

INCOSAI XIV në Uashington ishte edhe kongresi i parë në të cilin mori pjesë Audituesi i Përgjithshëm të Estonisë. Që atëherë Audituesi i Përgjithshëm dhe përfaqësuesit e SAI-t të Estonisë kanë qenë të pranishëm në të gjitha Kongreset INTOSAI, kanë marrë pjesë në përgatitjet e kongresit, si dhe në diskutime të ndryshme mbi temat e kongresit. Për SAI-n e Estonisë, anëtarësimi në INTOSAI ka lehtësuar krijimin e marrëdhënieve me SAI-t e Evropës dhe rajoneve të tjera të INTOSAI-t, mbështetja dhe ndihmë e të cilit ka qenë e paçmuar për zhvillimin e SAI-t të ri-themeluar.

Në vitet 1990, SAI i Estonisë u bë një anëtar i Grupit të Punës të Auditimit Mjedisor të krijuar rishtazi (kryesuar nga SAI i Holandës) dhe i Grupit të Punës për Privatizimin (kryesuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar). I pari feston përvjetorin e tij të 20-të në vitin 2012 dhe tashmë është bërë grupi i Punës me numrin më të lartë të anëtarëve. INCOSAI XXI në vitin 2013 do të përmbledhë atë që është bërë në Grupin e Punës të Auditimit Mjedisor (WGEA) në gjashtë vitet e fundit nën drejtimin e SAI-t të Estonisë. Megjithatë, event i parë INTOSAI në Estoni ishte takimi i INTOSAI WGEA, që daton qysh më vitin 1997 në Talin dhe që u organizua në bashkëpunim me ish-Kryetarin e WGEA-s, SAI-n e Holandës.



*Paneli i Takimit të 14-të të Grupit të Punës INTOSAI të Auditimit Mjedisor (WGEA) në Buenos Aires, Argjentinë, 2011.*

*Takimit të 14-të të Grupit të Punës INTOSAI të Auditimit Mjedisor (WGEA) në Buenos Aires, Argjentinë, 2011.*



Pjesëmarrja në aktivitetet e Grupit të Punës mbi Auditimin e Privatizimit ishte shumë e rëndësishme për NAO pasi mundësoi që audituesit të përdornin njohuritë dhe përvojat e kolegëve në lidhje me menaxhimin e administrimit financiar dhe kontabilitetit gjatë periudhës së tranzicionit në ekonominë e tregut në Estoni, si dhe gjatë privatizimit masiv.

Gjatë gjithë këtyre viteve, njohuri të vlefshme gjithashtu janë fituar në Seminare të ndryshme OKB/INTOSAI dhe simpoziumet e organizuara nga Sekretariati i Përgjithshëm INTOSAI për çështjet më aktuale në nivel global.

Zyra Kombëtare e Auditimit të Estonisë ka pasur marrëdhënie të mira bashkëpunimi me Iniciativën për Zhvillim të INTOSAI-t (IDI) që nga viti 2001. Disa auditues të NAO-s janë bërë Specialistë të certifikuar IDI të trajnimit falë kurseve të trajnimit IDI afatgjatë dhe kanë pasur mundësi të shkëmbejnë njohuritë e tyre me audituesit në rajon dhe jashtë. Një përfaqësues i NAO-s ka punuar në Sekretariatit e IDI-t mbi Atashimin dhe disa trajnime janë organizuar në bashkëpunim me IDI në Estoni. Sekretariati i INTOSAI WGEA nën kryesinë e NAO-s ka vazhduar këtë bashkëpunim duke mbështetur trajnimet t e IDI-t dhe duke ofruar ekspertizë për Programin Trans - Rajonal të IDI-t mbi Çështjet e Pylltarisë.

INTOSAI dhe Sekretariati i INTOSAI i Përgjithshëm i kryesuar nga Gjykata Austriake e Auditimit janë të pandashëm. Sekretariati i Përgjithshëm ofron gjithmonë mbështetje për iniciativat dhe aktivitetet e INTOSAI-t dhe e gjithë mirënjohja dhe meritat për INTOSAI-n si organizatë, janë në të njëjtën mënyrë vlerësim i punës së shkëlqyer dhe efikase të Sekretariatit të Përgjithshëm.



Ndarja ndërkombëtare e njohurive dhe shkëmbimi i eksperiencës ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e Riigikontroll. Kontaktet në rajonin e Balltikut me SAI-t e Letonisë dhe Lituanisë filluan në fillim të viteve nëntëdhjetë paralel me kontaktet e para me vendet nordike. Nga 2000, këto kontakte individuale janë transformuar në një bashkëpunim rajonal të SAI-ve të rajonit Baltik dhe Nordik me shkëmbim të rregullt të informacionit, mbledhje vjetore dhe aktivitete të tjera. SAI i Polonisë iu bashkua Rrjetin Rajonal Baltik - Nordik në vitin 2004. Bashkëpunimi me SAI-t e Finlandës, Danimarkës, Gjermanisë, Holandës, Norvegjisë, Suedisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, përfshirë trajnime, projekte zhvillimit, atashime, auditimet pilote dhe këshilla të ekspertëve, kanë dhënë një ndihmë të paçmuar për NAO në planifikimin e tij strategjik, si dhe në proceset për zhvillimin e kapaciteteve institucionale, ndër të cilat peer review-t e realizuara nga NAO në vitin 1999 dhe 2005 nën udhëheqjen e SIGMA-s kanë dhënë një kontribut që nuk mund të nënvlerësohet.

## 2. Zhvillimet e Fundit në INTOSAI

Në dekadën e kaluar INTOSAI ka pësuar një zhvillim të jashtëzakonshëm. Ai filloi me nisjen e procesit të planifikimit strategjik që rezultoi në miratimin e Planit të parë Strategjik 2005-2010, i cila u pasua nga ndryshime organizative si rrjedhojë e atij procesi dhe vazhdoi me miratimin e Planit Strategjik 2011-2016. Strategjia e INTOSAI-t transformoi në fjalë vlerat kryesore dhe qëllimet e të organizatës. Arritja më e shquar është padyshim zhvillimi i kuadrit të Standardeve të INTOSAI-t, ISSAI-t, nën drejtimin e përkushtuar të SAI-t të Danimarkës, si dhe përpunimi dhe miratimi i tyre në INCOSAI-n XX në vitin 2010, i cili vëndos një themel të fortë të auditimit publik dhe lehtëson punën audituesve publikë.

Iniciativa e INTOSAI lidhur me përpjekjet për të arritur pranimin nga Kombet e Bashkuara të parimit të pavarësisë të SAI-ve shprehur në deklaratat e Limës dhe Meksikës u realizua si rezultat i angazhimit të përkushtuar të Sekretariatit të Përgjithshëm dhe SAI-ve anëtarë, dhe është një arritje shumë e vlefshme në mbështetje të auditimit publik në të gjitha vendet. Më 22 dhjetor 2011, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi Rezolutën A/66/209 Nxitja e Efikasitetit, Përgjegjshmërisë, Efektivitetit dhe Transparencës së Administratës Publike duke Forcuar Institucionet Supreme të Auditimit.

Vitet e fundit si Kryetar i Grupit të Punës të Auditimit Mjedisor i kanë dhënë Riigikontroll-it një kuptim më të mirë



*Delegacioni i SAI-t të Estonisë në Takimin e 62-të Bordit Drejtues në Vjenë, Austri, 2011.*

të INTOSAI-t, si dhe të funksionimin të organizatave rajonale dhe njësive strukturore. Udhëheqja dhe koordinimi i aktiviteteve të INTOSAI WGEA i ka dhënë një mundësi unike për të mësuarit nëpërmjet punës, ndërsa komunikimi dhe bashkëpunimi me anëtarët e grupit të punës ka qenë një eksperiencë e dobishme dhe



reciprokisht pasuruese. E gjithë kjo po ashtu ka favorizuar pjesëmarrjen në eventet e Komitetit për Ndarjen e Njohurive (KSC), marrëdhënie më të ngushta me Sekretariatit e Përgjithshëm të INTOSAI-t dhe raportime vjetore të KSC dhe të Bordit Drejtues të INTOSAI-t, si dhe bashkëpunime me organizata të ndryshme ndërkombëtare. Grupi i Punës për Auditimin Mjedisor përfaqëson INTOSAI në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC). Statusi vëzhgues i Organizatës Jo-Qeveritare u arrit si rezultat i mbështetjes së fuqishme të Sekretariatit të Përgjithshëm të INTOSAI. INTOSAI WGEA përfaqësoi INTOSAI-n edhe në Konferencën e vitit 2012, Rio + 20, dhe është një partner e Programit të Mjedisit të Kombeve të Bashkuara (UNEP) në Kongresin Botëror UNEP të Ligjit, Drejtësisë dhe Qeverisjes.

### **3. Sfidat e së Ardhmes për INTOSAI-n**

Sikurse INTOSAI, sektori publik ka kaluar dhe po kalon nëpër zhvillime dhe transformime të rëndësishme. Zhvillimi i pandërprerë i shpejtë sjell sfida të reja për auditimi dhe përgjegjshmërinë e qeverisë. Kriza ekonomike e viteve të fundit ka zbuluar probleme dhe mangësi në ekonominë globale dhe, ndër të tjera, tregon nevojën për rritjen e transparencës, standardizimit të mëtejshëm dhe mbikëqyrjes më efektive. Rritja e globalizimit do të thotë se bashkëpunimi ndërkombëtar po fiton peshë edhe më të madhe për të përballuar sfidat e përbashkëta në mënyrë më efektive. Komunikimi dhe rëndësia e tij janë rritur dhe po rriten më tej për shkak të globalizimit. E gjithë kjo paraqet pritjet më të madha në bashkësinë ndërkombëtare të auditimit të qeverisë dhe sjell nevojën për të gjetur mjete të efektshme për të përballuar këto sfida. INTOSAI duhet të jetë në gjendje të reagojë në mënyrë fleksibile ndaj ndryshimeve dhe duhet të përshtasë strategjitë dhe qëllimet e veta me to. Në të ardhmen, duhet t'i kushtojë vëmendje serioze si komunikimit brenda organizatës dhe me partnerët dhe palët e interesuara, edhe formave të mëtejshme të komunikimit. Informacioni më i organizuar për INTOSAI-n, organizatat rajonale, grupet e punës dhe SAI-t anëtare mund të jetë lehtësisht në dispozicion nëpërmjet faqes e internetit. Prezantimi i informacionit në një mënyrë të standardizuar mund të jetë një zgjidhje e mirë. Duke njohur dhe admiruar punën serioze dhe të shkëlqyer të Gjykatës Austriake të Auditimit në 50 vitet e fundit si Sekretariat i Përgjithshëm i INTOSAI-t, duhet marrë në konsideratë krijimi i një sekretariati të pavarur me staf me kohë të plotë, përgjegjësi ekskluzive e të cilit të jetë adresimi i sfidave të ardhshme të organizatës dhe reagimi në mënyrë proaktive ndaj çështjet e reja në sektorin publik, auditimin dhe qëndrueshmërinë.




## Kontribut nga Gjykata Europiane e Llogarive (ECA)

INTOSAI dhe Gjykata Europiane e Llogarive:

35 Vjet Bashkëpunim Reciprok

dhe Frytdhënës







## Kontribut nga Gjykata Europiane e Llogarive (ECA)

<i>Grupi i Punës për Përgjegjshmërinë dhe Auditimin e Ndhimave për Përballjen e Fatkeqsive.</i>	<i>Kryetar</i>
<i>Komiteti i Standardeve Profesionale (PSC)</i>	<i>Anëtar</i>
<i>Komiteti i Ngritjes së Kapaciteteve (CBC)</i>	
<i>Komiteti i Shpërndarjes së Njohurive (KSC)</i>	
<i>Nënkomiteti i Auditimit Financiar</i>	
<i>Nënkomiteti i Auditimit të Përputhshmërisë</i>	
<i>Nënkomiteti i Auditimit të Performancës</i>	
<i>Nënkomiteti 1: Promovimi i Aktivitete të Rritjes së Ndërtimit të Kapaciteteve ndërmjet anëtarëve të INTOSAI-t</i>	
<i>Nënkomiteti 3: Promovimi i Praktikave më të mira dhe Sigurimit të Cilësisë nëpërmjet Peer Review</i>	
<i>Grupi i Punës për Auditimin e Mjedisit</i>	
<i>Grupi i Punës për Modernizimin Financiar dhe Reformën Rregullative</i>	

### **INTOSAI dhe Gjykata Europiane e Llogarive: 35 Vjet Bashkëpunim Reciprok dhe Frytdhënës**

Që në kohët e hershme, Gjykata Europiane e Llogarive (ECA) – institucioni i auditimit të Bashkimit Europian – ka përfituar nga bashkëpunimi i ngushtë me INTOSAI-n. Në këmbim, ECA ka dhënë një kontribut domethënës për INTOSAI-n, kjo pjesërisht falë perspektivës së veçantë të ECA-s dhe stafit të saj nga një gamë e gjerë kombësisht dhe kulturash profesionale.

#### **Ndikimi i madh i Deklaratës së Limës**

Në vitin 1977, viti në të cilin ECA filloi aktivitetin e saj, në Lima të Perusë, në Kongresin e IX-të të INTOSAI-t u miratua Deklarata e Limës. Ky dokument shumë shpejt u bë Magna Carta për INTOSAI-n, duke siguruar kuadrin filozofik dhe konceptual për punën e INTOSAI-t dhe të anëtarëve të tij. Eksperienca ka treguar se ky udhëzues ka pasur një ndikim domethënës në zhvillimin e auditimit të qeverisë dhe në Institucionet Supreme të Auditimit. Diskutimet që shoqëruan përcaktimin e mandatit të ECA-s ishin të influencuara së tepërmi nga zhvillimet në INTOSAI. Në vitin 1975, kur u hartua Marrëveshja e Brukselit, e cila krijoi ECA-n, INTOSAI po analizonte rezultatet e shumë konferencave të zhvilluara në më shumë se 20 vite. Kjo çoi në përgatitjen e Deklaratës së Limës. Drejtuesit e Institucioneve Supreme të Auditimit, të Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian, të cilët ishin të përfshirë në krijimin e Deklaratës së Limës, kuptuan rëndësinë e përfshirjes së veçorive më të rëndësishme të këtij dokumenti në Marrëveshjen e Brukselit.

#### **Pjesëmarrja e hershme në aktivitetet e INTOSAI-t**

ECA ishte gati duke filluar punën e saj, kur Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t - në të cilin Hubert Weber, më vonë Anëtar dhe President i ECA-s, po punonte – arriti ta përfshinte atë në aktivitetet me një nivel të lartë të përgjegjësisë. Që nga viti 1980, ECA ka qenë e përfaqësuar në të gjitha kongreset dhe në shumë raste ka vepruar si drejtues i temave (raportues, kryetar i grupit të punës etj.). Që nga viti 1985, ECA kontribuon çdo vit në financat e INTOSAI-t. Megjithatë,



ECA nuk ka mundur të përfitojë statusin e anëtares me të drejta të plota meqenëse, sipas Nenit 2 të Statutit të INTOSAI-t, kjo ishte e hapur vetëm për SAI-t e vendeve që ishin anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara ose të agjencive të specializuara të saj.

Që nga fillimi i saj, metodat e punës së ECA-s janë frymëzuar nga INTOSAI. Në vitin 1997, kur ECA vendosi të paraqiste në një dokument parimet për planifikimin, zbatimin dhe raportimin e auditimeve të saj përdori si bazë udhëzuesit e auditimit të INTOSAI-t. Ato sigurisht që u përshtatën me detyrat dhe përgjegjësitë specifike të diskutuara në ECA, duke marrë në konsideratë kontekstin e Komunitetit Europian dhe masat specifike të aplikuara për buxhetin e tij.

### Rruga e gjatë për anëtarësim

Anëtarësimi i ECA-s përfundimisht u bë realitet në vitin 2004. Në kongresin e XVIII të INTOSAI-t në Budapest në tetor të vitit 2004, Statutet e INTOSAI-t u ndryshuan për të lejuar anëtarësimin e plotë për SAI-t e organizatave ndërkombëtare. Në takimin e Bordit Drejtues menjëherë pas kongresit aplikimi i bërë nga ECA për anëtarësim në INTOSAI u aprovua unanimisht.

Pranimi me kënaqësi i ECA-s si një anëtare me të drejta të plota në INTOSAI i dha fund një periudhe negociatash intensive dhe përmbushi dëshirën e Anëtarëve të Bashkimit Europian të EUROSAT-t për të garantuar pjesëmarrjen e plotë të ECA-s në jetën e INTOSAI-t. Që atëherë ka qenë prioritet kryesor për ECA-n të jap maksimumin e saj pas një pritje të gjatë për t'u anëtarësuar.

### Plani Strategjik ambicioz i INTOSAI-t 2005-2010

Kongresi i XVIII i INTOSAI-t ishte gjithashtu i një rëndësie të lartë për zhvillimin e mëvonshëm të INTOSAI-t. Me miratimin e Planit të tij Strategjik 2005-2010, pas tre vitesh diskutimesh përgatitore, INTOSAI publikoi një projekt jashtëzakonisht ambicioz. Katër qëllimet strategjike të skicuar nga Plani ishin të shoqëruara nga një vazhdim i mirë i strukturuar i aktiviteteve të INTOSAI-t. ECA ishte shumë mbështetëse për planin, si dhe veproi në përputhje me bashkëpunimin e saj gjithnjë e në rritje dhe pjesëmarrjen në Komitetet e INTOSAI-t dhe në Grupet e Punës. Në veçanti:



Takimi i Nënkomitetit të INTOSAI-t për Auditimin Financiar, Luksenburg 2009



- Në Komitetin e Standardeve Profesionale. ECA merr pjesë në Nënkomitetet e Auditimit Financiar, Auditimit të Përputhshmërisë dhe të Auditimit të Performancës si dhe në Grupin Ad-Hoc të Auditimit të Kontrollit të Cilësisë;
- Në Komitetin për Ngritjen e Kapaciteteve. ECA merr pjesë në Nënkomitetin 1 (Promovimi i i Aktiveteve në Rritje për Ndërtimin e Kapaciteteve midis Anëtarëve të INTOSAI-t) dhe Nënkomitetin 3 (Promovimi i Praktikave më të Mira dhe Sigurimi i Cilësisë nëpërmjet Peer Review –ve Vullnetare);
- Në Komitetin e Përhapjes së Njohurive. ECA kryeson Grupin e Punës për Përgjegjshmërinë dhe Auditimin e Ndhimave për Përballjen e Fatkeqsive dhe merr pjesë në Task Forcën për Krizat Financiare Globale, si dhe në Grupin e Punës për Auditimin e Mjedisit.



Takimi i 1-rë i Grupit të Punës të INTOSAI-t për Përgjegjshmërinë dhe Auditimin e Ndhimave për Përballjen e Fatkeqsive, Luksenburg, 2008



Takimi i 6-rë i Grupit të Punës të INTOSAI-t për Përgjegjshmërinë dhe Auditimin e Ndhimave për Përballjen e Fatkeqsive, Indonezi, 2012



Kjo pjesëmarrje aktive i ka lejuar ECA-s të japë një kontribut të rëndësishëm në sukseset e INTOSAI-t, dhe në të njëjtën kohë duke forcuar pozitën profesionale të ECA-s dhe metodave të saj të punës.

### Mbrojtja e përhershme e pavarësisë së SAI-t

Gjatë gjithë historisë së tij 60-vjeçare, nuk është ekzagjerim të thuhet se pavarësia e SAI-ve ka qenë një shqetësim kryesor për INTOSAI-n, si dhe subjekt i një debati të vazhdueshëm që nga themelimi i tij. Parimet bazë që drejtojnë pavarësinë e SAI-ve rrjedhin nga Deklarata e Limës dhe vendimet e marra në kongresin e XVII të INTOSAI-t në vitin 2001. Ato janë të përcaktuara më konkretisht në *Deklaratën e Meksikës për pavarësinë e SAI-ve* të miratuar nga kongresi i XIX i INTOSAI-t në vitin 2007.

Përpyqjet e komunitetit të INTOSAI-t për të përforcuar pavarësinë e SAI-ve dhe për të siguruar njohje të gjerë të Deklaratave të Limës dhe Meksikës janë shpërblyer kohët e fundit me miratimin e Rezolutës së 66-të të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara A/66/209 *Nxitja e Efikasitetit, Përgjegjshmërisë, Efektivitetit dhe Transparencës së Administrimit Publik, duke forcuar Institucionet Supreme të Auditimit*.

Ky sukses është bërë i mundur, jo vetëm për shkak të kushteve të krijuara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar nga të gjithë anëtarët e INTOSAI-t, por gjithashtu edhe falë rolit të luajtur nga Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t. ECA do të donte t'i jepej mundësia për të uruar Sekretarin e Përgjithshëm dhe ekipin e tij për punën e shkëlqyer të bërë në të mirë të komunitetit të SAI-t gjatë gjithë historisë së tij 50- vjeçare.

### E ardhmja premtuese (por kërkuese)

Plani Strategjik i INTOSAI-t 2011 - 2016 i miratuar nga Kongresi i XX i INTOSAI-t në vitin 2010 është në përputhje me Planin Strategjik të mëparshëm dhe ka për qëllim konsolidimin dhe ndërtimin e arritjeve të tij. Zbatimi praktik nuk mund të kishte filluar më mirë: Prioriteti i parë strategjik - për të ndihmuar në sigurimin e pavarësisë së SAI-ve - është mbështetur shumë nga miratimi i sipërpërmendur i Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara A/66/209.

Tani ECA po feston përvjetorin e saj të 35-të dhe shpreson të vazhdojë dhe të forcojë bashkëpunimin e saj me komunitetin e INTOSAI-t dhe Sekretariatit e Përgjithshëm në kuadër të kësaj periudhe të planifikimit të ri strategjik. Prioritetet që synojnë zbatimin e kornizës së ISSAI-ve dhe përmirësimin e ndërtimit të kapaciteteve të SAI-ve do të jenë detyrat e nevojshme dhe më shumë se kurrë këto përpjekje do të duhet të bëhen në të gjitha nivelet. Por rezultatet përfundimtare vështirë se do të jenë zhgënjyese. Le të krijojmë së bashku ambientin e duhur për jetëgjatësinë e motos së INTOSAI-t: *Experientia mutua omnibus prodest*.

GËZUAR PËRVJETORIN E 60-të KOMUNITETIT TË INTOSAI-t

dhe


GËZUAR 50-të VJETORIN SEKRETARIATIT TË PËRGJITHSHËM TË INTOSAI-t



## Kontribut nga SAI i Gjermanisë

*Dieter Engels President i Bundesrechnungshof*

Qëllimi i Peer Review-ve  
në Auditimin e Jashtëm





## Kontribut nga SAI i Gjermanisë

*Dieter Engels*

*Komiteti i Ngritjes së Kapaciteteve (CBC)*

*Komiteti drejtues i CBC*

*Komiteti i Ndarjes së Njohurive (KSC)*

*Nënkomiteti 1: Promovimi i aktivitete të rritjes së ngritjes së kapaciteteve midis anëtarëve të INTOSAI-t*

*Nënkomiteti 2: Zhvillimi i shërbimeve këshilluese dhe konsultative*

*Nënkomiteti 3: Promovimi i praktikave më të mira dhe sigurimit të cilësisë përmes Peer Reviews*

*Grupi punës për vlerësimin e programit*

*Grupi i punës për luftën kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave*

*Grupi i punës për Vlerat dhe përfitimet e SAI-ve*

*President i Bundesrechnungshof*

*Anëtar*

### Qëllimi i Peer Review-ve në Auditimin e Jashtëm

Peer review-të, janë procese të strukturuar që shërbejnë për të vlerësuar punën shkencore nga kolegët profesionistë. Ato kanë një histori të gjatë që daton në shekullin e 17-të, kur botuesi i *Transaksioneve Filozofike të Shoqërisë Mbretërore*, botuar në Londër që nga viti 1655, u ndie i paaftë për të vlerësuar në mënyrë të besueshme cilësinë e artikujve shkencore që i paraqiteshin për botim. Prandaj, ai ju kërkoi shkencëtarëve të tjerë vlerësime teknike në rolin e tyre si të barabartë.

Që nga fundi i shekullit të 20-të, rishikimet nga kolegët, gjithashtu janë aplikuar në shumë fusha të tjera, veçanërisht në auditimin e jashtëm ku SAI-t rishikojnë SAI-t e tyre partnere. Në total, 40 anëtarë të INTOSAI-t kanë bërë një peer review nga SAI-t partnere që nga viti 1999 – arsye këto të mjaftueshme për të nxjerrë në pah tiparet kryesore të kësaj procedure.

### Peer review-të shërbejnë për të rritur auditimin e qeverisë

Peer review-të në auditimin e jashtëm janë kryer gjithmonë mbi baza vullnetare. Ato kërkojnë marrëveshje midis SAI-t që do të realizojë rishikimin dhe kolegut të tij, e cila e dallon atë nga auditimet tradicionale të bazuara në detyrat dhe mandatet e auditimit. Prandaj, palët e përfshira në një peer review nënshkruajnë marrëveshje me njëri-tjetrin me një qëndrim të njëjtë, pa asnjë paragjykim dhe në frymën e miqësisë dhe bashkëpunimit. Kjo nuk do të thotë se procesi është i dominuar nga fjalët e vlerësimit dhe se kritika është e padëshirueshme. Peer review-të japin përfitime optimale vetëm nëse angazhimi i SAI-ve partnere është i sinqertë, i hapur dhe dialogu është konstruktiv. Për të arritur këtë, duhet të garantohet një e drejtë e plotë për rishikimin e SAI-ve. Në këmbim, rekomandimet e kolegëve dhe propozimet për përmirësim duhet të bazohen në argumente të shëndosha.

Për të promovuar rishikime në të ardhmen, Nënkomiteti 3 i Komitetit të Ndërtimit të Kapaciteteve të INTOSAI-t ka hartuar një udhëzues për peer review-të, të plotësuar nga një listë. Udhëzuesi jep rekomandime për të gjitha fazat e procesit të peer review-ve, duke vendosur theks të veçantë në kuadrin e kushteve për të cilat do të bien dakord paraprakisht të gjitha palët e përfshira. Si udhëzuesi ashtu dhe lista e plotë u miratuan si ISSAI në dhjetor të vitit 2010.



Takimi i Nënkomitetit 3 të  
KNK-së: Promovimi i  
Praktikave më të Mira dhe  
Sigurimit të Cilësisë  
Nëpërmjet Peer Review-ve  
Vullnetare, Luksenburg, 2012

### Qasjet dhe kriteret

Peer review-të kryhen për një shumëllojshmëri arsyesh dhe si pasojë ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme në thelb. Në shumë raste, ato janë të programuara për të ndihmuar SAI-t të përmirësojnë praktikën dhe procedurat e tyre, apo për të kryer punën e tyre audituese në përputhje me standardet profesionale. Ato gjithashtu mund të japin bazën për përpunimin dhe zbatimin e reformave të synuara. Në raste të tjera, qëllimi i tyre është për të ndjekur zbatimin e ndryshimit. Në varësi të drejtuesit dhe të qëllimit, peer review-të mund të ndjekin një qasje mjaft të plotë, duke kërkuar në të gjitha aktivitetet e auditimit dhe gjithë organizimin strukturor të një SAI. Nga ana tjetër, ato mund të përqëndrohen në një ose disa fusha specifike të aktiviteve.

Është me rëndësi të veçantë përcaktimi i kriterëve të aplikueshme për të drejtuar procesin e rishikimit. Me qëllim sigurimin e një pamje të balancuar të SAI-t në shqyrtim, SAI-t partnere shpesh bien dakord që të mbështeten në kriterë kyçe të njohura ndërkombëtarisht, si ISSAI-t për pavarësinë e SAI-t, mandatet e auditimit, performancën dhe kontrollin e cilësisë.

### Cilësitë e aktiviteve peer review

Rishikimet midis kolegëve forcojnë transparencën dhe llogaridhënien e SAI-t të rishikuar. Një nivel i lartë transparence është përparësi kryesore për auditim të jashtëm, e cila është reflektuar gjithashtu edhe në dispozitat përkatëse të ISSAI-ve. Prandaj, SAI-t duhet të japin informacion mbi strukturën e tyre organizative, kuadrin ligjor, metodologjitë dhe strategjitë, dhe aty ku është e lejuar ligjërisht, gjetjet e tyre të auditimit. Përfitimet që një SAI mikëpritës mund të ketë nga një rishikim midis kolegëve janë shumë të varura nga cilësia e procesit të rishikimit. Edhe rekomandimet më të mira do të arrijnë ndikimin e tyre të plotë vetëm në qoftë se ato ndiqen nga rezultate. Si pasojë një peer review e mirë, gjithmonë merr parasysh pyetjen nëse gjetjet në të vërtetë mund të zbatohen.

Rishikimet e funksioneve kryesore të auditimit të jashtëm, d.m.th të auditimit dhe punës këshilluese, mund t'i sigurojnë SAI-t mikëpritës njohuri për qasje të reja të auditimit dhe mjete më efektive të auditimit. Me zbatimin e rekomandimeve





të kolegëve, një SAI mund të rrisë cilësinë dhe efektivitetin e auditimit si dhe një përkrahje të reputacionit dhe besueshmërisë. Në terma konkrete, peer review-të mund të ndihmojnë në identifikimin e nevojave për trajnim të stafit të auditimit si dhe të nxjerrin në pah rregullat dhe udhëzimet teknike të pamjaftueshme. Këshilla mund të jepen për mënyrën se si mund të realizohet më mirë prioriteti i detyrave të auditimit dhe për përdorimin e fondeve në mënyrë me efikasë. Aty ku fokusi është vendosur në aspektet organizative, mund të jepen rekomandime për përmirësime të mundshme në proceset e biznesit. Për më tepër, mund të zbulohen mangësi në menaxhimin e burimeve njerëzore apo pajisjeve të TI.

Megjithatë, vlerat nuk janë të kufizuara vetëm për SAI-n i cili është në procesin e rishikimit. SAI rishikues mund të identifikojë praktikën më të mira duke krahasuar strukturën dhe procedurat e veta me ato të SAI-t mikpritës. Si rregull, kolegët do të analizojnë nëse rekomandimet që japin mund të zbatohen edhe në institucionet e tyre.

### Hapat përgatitore

SAI-t që mikpresin një peer review në përgjithësi janë të lirë të vendosin në cilat fusha të aktiviteteve duhet të fokusohet procesi. Pasi përcaktohet qëllimi i rishikimit, kolegët mund të zgjedhin në përputhje me rrethanat. SAI-t e ftuar duhet të kenë përvojën përkatëse për çështjet që janë nën rishikim. Nëse një rishikim kryhet nga disa kolegë, përgjithësisht një SAI caktohet si drejtues i rishikuesve ose si koordinator. Në këtë rast, ekipi ka nevojë të vendos nëse do të rishikojnë së bashku të gjitha zonat subjekt auditimi, ose do të caktojnë fusha individuale për rishikim, me qëllim përcaktimin e anëtarëve të grupit, të cilët mund të kenë ndikim në kohëzgjatjen e auditimit.

Për të shmangur paqartësi apo keqkuptime gjatë një procesi peer review, SAI-t pjesëmarrëse duhet të bien dakord paraprakisht për një kornizë për gjithë procesin. Këto kushte themelore janë të specifikuar në një dokument të njohur si Memorandumi i Mirëkuptimit (MM). Për shembull, është thelbësore për të rënë dakord mbi objektivin e peer reviews, të drejtat e aksesit të kolegëve dhe autorizimin për të mbledhur evidenca, për afatin kohor si dhe për hapat procedurale

Pjesëmarrja në një peer review nuk përfshin vetëm detyra për kolegët, por SAI mikëpritës gjithashtu duhet të jetë i përkushtuar shumë për të bërë që rishikimi të jetë një sukses. Kjo përfshin informimin e stafit të tij në përputhje me rrethanat, dhe kur është e përshtatshme, duke mbajtur lidhje me kontaktet e jashtme. Me qëllim vlerësimit e ndikimit të punës së një SAI mikëpritës, për shembull, kolegët do të kenë nevojë për të mbledhur reagime nga partnerët përkatës, si përfaqësues të organeve të audituara apo dhe anëtarëve të parlamentit.

### Raportimi

Pas përfundimit të punës në terren dhe analizimit të të gjitha dokumenteve relevante, kolegët hartojnë raportin përfundimtar. Gjetjet zakonisht diskutohen me SAI-n e rishikuar përpara paraqitjes së raportit, dhe në këtë mënyrë çdo kundërshtim mund të merret parasysh në një fazë të hershme. Kjo është e një rëndësie vendimtare për të përcaktuar vlefshmërinë e gjetjeve me qëllim pranimit e gjerë të raportit përfundimtar. Prandaj, SAI mikpritës dhe SAI i ftuar zakonisht përcaktojnë kërkesa specifike dokumentacioni. Si parim bazë, raporti përfundimtar është pronë e SAI-t që mikpret një peer review, i cili vendos nëse, dhe si ta bëjë atë të vlefshëm për palët e treta ose publikun e gjerë.

Pas marrjes së rezultateve të rishikimit, SAI mikpritës është i lirë të zbatoj rekomandimet e dhëna nëse atij i duken të arsyeshme. Në qoftë se përmbajtja e raportit përfundimtar është tashmë e njohur për publikun, trysnia për të marrë



masa të menjëhershme mund të jetë e konsiderueshme. Për të lehtësuar këtë trysni, mund të jetë e përshtatshme sugjerimi i afateve të mundshme kohore për zbatimin e raportit.


#### Rëndësia e peer review-ve për auditimin e jashtëm

Rishikimet e kolegëve nuk janë vetëm një mjet i sigurimit të cilësisë; ata gjithashtu i përgjigjen pyetjes kush e auditon audituesin. SAI-t që kanë marrë pjesë në kryerjen e një peer review-e si rishikues ose si mikpritës unanimitisht konfirmojnë që të gjitha palët e përfshira në proces kanë përfituar jashtëzakonisht nga ndarja e informacionit. Si rezultat, peer review-të japin prova të mjaftueshme se si motoja e INTOSAI-t *Eksperienca e përbashkët ju shërben të gjithëve* mund të vihet në praktikë.



## Kontribut nga SAI i Hodurasit

60 Vjetori i INTOSAI-t dhe  
50 Vjetori i Sekretariatit të Përgjithshëm  
në Vjenë





## Kontributi i SAI-t të Hondurasit

### 60 Vjetori i INTOSAI-t dhe 50 Vjetori i Sekretariatit të Përgjithshëm në Vjenë

Institucioni Suprem i Auditimit të Republikës së Hondurasit (*Tribunal Superior de Cuentas TSC*) ka marrë pjesë në aktivitetet e INTOSAI-t që nga themelimi i tij dhe ka qenë aktiv si anëtar i INTOSAI-t ashtu edhe si anëtar i Grupeve Rajonale të Punës (OLACEFS). Për më tepër TSC është gjithashtu edhe anëtar i nën rajonit të Grupit të Amerikës Qendrore në Organizatën Qendrore Amerikane të Institucioneve Supreme të Auditimit (OLASEFS) dhe në këtë mënyrë kontribuon në mbështetjen e përbashkët në përpjekjet për një epërsi në auditimin e qeverisjes. OLACEFS ka nëntë anëtarë si më poshtë:

Belize, Republikën Domenikane, Guatemalën, Salvadorin, Nikaraguan, Kosta Rikën, Panamanë, Kubën dhe Hondurasin mikpritësin e përhershëm të Sekretariatit Ekzekutiv të OLACEFS.

INTOSAI dhe Sekretariati i Përgjithshëm, në veçanti luajnë një rol qendror në zhvillimin e Institucioneve Supreme të Auditimit në të gjithë botën dhe kanë treguar në vitet e fundit që ndikimi i tyre është i rëndësishëm, i qëndrueshëm dhe i dukshëm. Duke përhapur dhe përfaqësuar vlera morale dhe etike, ato gjithashtu kanë paraqitur mbështetjen e tyre të qartë për SAI-t, siç është Institucioni jonë i Auditimit Suprem, me qëllim përforcimin e pozicionit të tyre si institucione të rëndësishme kombëtare të auditimit, duke mbuluar një buxhet efektiv, të përshtatshëm, qeverisjen ekonomike si dhe mbi menaxhimin e të mirave publike dhe të fondeve për të edukuar një administrim transparent për të mirën e Hondurasit.

Misioni, vizioni dhe vlerat tona janë të lidhura ngushtë me ato të INTOSAI-t dhe të Sekretariatit të Përgjithshëm.

Në aktivitetin e tij dhe me qëllim zhvillimin e kapacitetin institucional dhe për të trajnuar punonjësit, SAI i Hondurasit është mbështetur në ndihmën e dhënë nga INTOSAI për të arritur qëllimet e mëposhtme:

- Edukimin e shkëmbimit të ideve dhe të eksperiencës me SAI të tjera;
- Përmirësimin e procesit të auditimit me qëllim sigurimin që ky proces të jetë i bazuar në njohuri të kualifikuara dhe në gjetje shkencore;
- Trajnimin e audituesve që ato të mund të përmbushin detyrat e tyre në mënyrë profesionale dhe të bazuara në vlerat morale të nevojshme;
- Zbatimin e standardizimit të normave ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit dhe të udhëzuesve të ISSAI-ve në mënyrë që ti bëjë ato të aplikueshme për fushën e auditimit kombëtar;
- Përcaktimin e masave të nevojshme për Komitetin e Ngritjes së Kapaciteteve në një mënyrë të qëndrueshme;
- Zhvillimin e një serie udhëzimesh dhe dokumentesh si për shembull, një *Udhëzues për Ngritjen e Kapaciteteve të SAI-ve ose një Regjistër për Projektet e Ngritjes së Kapaciteteve*;
- Krijimin e fondeve të pakthyeshme për të realizuar projekte për ngritjen e kapaciteteve institucionale duke patur parasysh që INTOSAI ka vepruar si koordinator midis organizatave pjesëmarrëse dhe SAI-t të Hondurasit.



Delegatët e SAI-t të Hondurasit në Simpoziumin e 20-të OKB/INTOSAI në Vjenë, 2009

Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t ka luajtur një rol thelbësor në sigurimin e trajnimeve të mëtejshme për audituesit tanë. Bashkëpunimi i vazhdueshëm ndërmjet Institucionit Suprem të Auditimit të Hondurasit dhe të Komiteteve të INTOSAI, Nënkomiteteve, Grupeve të Punës dhe Task Forcave, si dhe mbështetjes së padiskutueshme dhënë nga IDI për SAI-n e Hondurasit për ngritjen e kapaciteteve, paraqet një kontribut të çmueshëm për përparimin kombëtar të SAI-tonë dhe na jep mundësinë për të rritur vazhdimisht përpjekjet tona si një anëtar i plotë i INTOSAI-t dhe për të siguruar rezultate shumë edhe më të mira nëpërmjet ndihmës së përhershme për përhapjen e informacionit nga Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t, e cila është e bazuar në ligjet ekzistuese, dhe duke respektuar njerëzit dhe Perëndinë.

Duke marrë parasysh që Hondurasit është një shtet me tregues makroekonomik jo premtues dhe që kriza globale po e godet atë më rëndë, si pasojë e një sistemi të dobët ekonomik i cili mbahet gjallë me një buxhet vjetor vërtet të ulët, SAI i Hondurasit do të vazhdojë të përcaktojë objektiva vjetore të detajuara, të përshtatura me kushtet që mbizotërojnë në vend, për të mbrojtur fondet publike. Kjo është pika ku Sekretariati i Përgjithshëm bëhet i domosdoshëm, pasi ai ka shfaqur interes në mbështetjen e aktiviteteve në fusha të cilat kërkojnë një kontribut më të madh. Prandaj duam të falënderojmë Sekretariatit e Përgjithshëm për punën e tij, pasi ai ka kontribuar pavarësisht nga kufizimet tona për faktin që marrëdhëniet dypalëshe janë të mrekullueshme dhe madje janë intensifikuar në vitet e fundit- me shpresën e fillimit të projekteve të reja për ngritjen e kapaciteteve të SAI-ve në vendet në zhvillim. Gjithashtu duam të falënderojmë dhe Sekretariatit e Përgjithshëm për mbështetjen e aktiviteteve të tjera që janë ofruar me qëllim përforcimin e rolit të SAI-t të Hondurasit si një institucion i llogaridhënies, transparencës dhe qeverisjes së mirë.

E fundit por jo më pak e rëndësishme, duhet të theksohet se kemi akoma një rrugë të gjatë për të bërë. Në sajë të një bashkëpunimi të vazhdueshëm me INTOSAI-n, si dhe nga nxitja e dhënë nga Sekretariati i Përgjithshëm për sa i përket projekteve dhe programeve për mbështetjen e përbashkët, ne e dimë që jemi në rrugën e drejtë. Prandaj SAI i Hondurasit përgëzon INTOSAI-n përzemërsisht për 60 vjetorin e tij dhe Sekretariatit e Përgjithshëm për gjysmëshekullin e tij dhe përshëndet marrëdhëniet ekzistuese të karakterizuara nga miqësia dhe shkëmbimi profesional.


Gëzuar përvjetorin dhe urime për realizimin e arritjeve të suksesshme.



## Kontribut nga SAI i Hungarisë

45 Vjet Anëtarësim i Hungarisë

në INTOSAI







## Kontributi i SAI-t të Hungarisë

*Komiteti i Standardeve Profesionale*

*Komiteti i Ngritjes së Kapaciteteve*

*Komiteti i Ndarjes së Njohurive*

*Nënkomiteti i standardeve të kontrollit të brendshëm*

*Nënkomiteti 3: Promovimi i praktikave më të mira dhe i sigurimit të cilësisë nëpërmjet peer review*

*Grupi i punës për indikatorët kombëtar*

*Grupi i punës për modernizimin financiar dhe reformën rregulluese*

*Anëtar*

### 45 vitet e anëtarësimit të Hungarisë në INTOSAI

#### 1. Zhvillimi i bashkëpunimit ndërkombëtar të SAI-ve që nga viti 1953/1963 - 60 vjet INTOSAI/50 vjet e Sekretariati i Përgjithshëm

Zyra e Auditimit Shtetëror të Hungarisë u anëtarësua në INTOSAI në vitin 1968, ky anëtarësim ishte një hap i rëndësishëm në atë periudhë, sepse nga rajoni i Evropës Qendrore Lindore ishte vendi i parë që u bashkua me organizatën. Ne e ruajtëm vazhdimisht anëtarësimin tonë dhe në mënyrë aktive morëm pjesë në aktivitetet e INTOSAI-t. Si rezultat, Hungaria pati nderin të zgjedhej si anëtare e Bordit Drejtues të INTOSAI-t në Kongresin e XII, në Sidnej, në vitin 1986. Më pas, Zyra e Auditimit Shtetëror të Hungarisë (SAO) mori çmimin, Kandutsch, në vitin 1992 për veprimtarinë e saj, të kryer në kuadër të INTOSAI-t, si dhe për faktin që ka qenë vendi i parë që ka zbatuar reformën e auditimit të financave publike në rajonin e Evropës Qendrore Lindore.



Kryetarët e Institucioneve Supreme të Auditimit të shteteve V4+2 (Polonia, Republika Çeke, Sllovakia, Hungaria, Austria, Sllovenia) në takimin e Visegradit në Hungari, 2012



Në vitin 1992, SAO –s ju besua drejtimi i Komitetit të Standardeve të Kontrollit të Brendshëm – më vonë Nënkomitet. Nën drejtimin e saj Konferenca e parë dhe e dytë e Standardeve Ndërkombëtare të Kontrollit të Brendshëm janë organizuar në vitin 1997 dhe në vitin 2000 në Budapest dhe komiteti përpunoi bibliografinë ndërkombëtare për kontrollin e brendshëm për atë periudhë. Në sajë të detyrave në rritje të lidhura me organizimin e Kongresit të XVIII të



INTOSAI-t, Zyra Shtetërore e Auditimit të Hungarisë ia kaloi stafetën e drejtimit të komitetit SAI-t të Belgjikës në vitin 2001.

Kongresi i XVI i INTOSAI-t i dha të drejtën Hungarisë të organizojë Kongresin e XVIII që do të zhvillohej në vitin 2004, si rrjedhim Budapesti ishte vendtakimi i ngjarjeve të ndryshme të rëndësishme. Sipas traditës në vitin para zhvillimit të Kongresit takimi i Bordit Drejtues së INTOSAI-t u organizua në Budapest. Përveç çështjeve standarde të programit, gjatë takimit të Bordit Drejtues Presidenti i Zyrës Shtetërore të Auditimit të Hungarisë realizoi një takim individual me Kryetarin aktual të Bordit Drejtues të INTOSAI-t (Drejtuesi i SAI-t të Koresë) dhe me Sekretarin e Përgjithshëm të INTOSAI-t (Presidenti i SAI-t të Austrisë), me qëllim për të diskutuar çështjet organizative të kongresit pasardhës. Për më tepër u zhvilluan takime edhe me kryetarët e dy temave (SAI-t të Kanadasë dhe SAI-t të Mbretërisë së Bashkuar). Në kuadër të kongresit u mbajt një përkujtimore me rastin e 50 vjetorit të INTOSAI-t. Në festim gjithashtu morën pjesë përfaqësuesit nga SAI-t e shteteve të tjera të cilët nuk ishin anëtarë të Bordit Drejtues. Gjatë festimit të mbajtur në Parlament, u paraqitën prezantime me nivel të lartë për pavarësinë e SAI-ve, domethënien e Deklaratës së Limës si dhe për ndikimin pozitiv të krijimit dhe aktivitetit të INTOSAI-t në komunitetin ndërkombëtar.

Në rrjedhën e përgatitjes së Kongresit të XVIII të INTOSAI-t, Zyra Shtetërore e Auditimit të Qeverisë realizoi disa konsultime me Sekretariatën e Përgjithshëm, i cili i dha këshilla të dobishme në lidhje me organizimin e ngjarjes dhe ishte i gatshëm për të ndihmuar në diskutimin e çështjeve të detajuara të kongresit. Afërsia territoriale dhe marrëdhëniet tradicionalisht të mira midis dy SAI-ve lehtësuan veçanërisht konsultimet dypalëshe. Në rrjedhën e organizimit, ndihmë e dobishme është dhënë edhe nga SAI i Koresë, mikpritës i Kongresit të vitit 2001.

Kongresi i XVIII i INTOSAI-t ishte një arritje e madhe në historinë e INTOSAI-t, pasi u miratua Plani i parë Strategjik i organizatës për vitin 2005-2010, i cili themeloi strukturën organizative të INTOSAI-t, bazuar në katër shtylla, e cila është vlefshme edhe sot. Në përputhje me strukturën e re, gjithashtu u ndryshuan dhe Statutet e INTOSAI-t. Meqenëse Kongresi i XVIII i INTOSAI-t ishte me rëndësi historike, ai u parapri si dhe u pasua nga takime të jashtëzakonshme të Bordit Drejtues, me një diferencë prej disa muajsh, të cilat u përqendruan në përgatitjen dhe realizimin e reformës organizative. Zyra Shtetërore e Auditimit të Hungarisë ka marrë pjesë në mënyrë aktive në këto takime si mikpritëse e Kongresit të INTOSAI-t dhe si kryesuese e Bordit Drejtues pas Kongresit. Në sajë të organizimit të Kongresit, President i SAI-t të Hungarisë ishte kryetar i Bordit Drejtues në vitet 2004-2007.

Për më tepër, SAI i Hungarisë vazhdimisht merrte pjesë në aktivitetet e disa komisioneve profesionale si dhe grupeve të punës. Ai është ende një anëtar aktiv i Nënkomitetit të Auditimit Financiar, Grupit të Punës për Treguesit Kryesorë Kombëtarë dhe në Task Forcën Globale të Krizave Financiare. Gjithashtu, ai ka marrë pjesë në ish Grupin e Punës mbi Privatizimin, Rregullat Ekonomike dhe Partneriteti Publiko-Privat si dhe në Grupin e Punës në Auditimin e Organizatave Ndërkombëtare. Tre zyrtarë të SAI-t të Hungarisë kanë marrë pjesë në programin e trajnimit IDI dhe kanë organizuar trajnime të IDI-t në disa rajone të INTOSAI-t.



Seminari profesional ndërkombëtar në eksperiencën e fituar gjatë periudhës së programimit 2000-2006 organizuar si një aktivitet i përbashkët i Komitetit të Përbashkët dhe Zyrës së Auditimit të Shtetit të Hungarisë (SAO), Budapest, Hungari, 2012



## 2 Zhvillimet e fundit në INTOSAI

Meqenëse disa SAI kanë ndjerë kërcënim të pavarësisë së tyre, forcimi i pavarësisë së SAI-ve u bë një çështje kryesore brenda INTOSAI-t. Simpoziumi i 17-të OKB/INTOSAI u fokusua në këtë temë dhe për disa vite veproi një komitet që trajtonte këtë çështje në kuadër të INTOSAI-t. Në vazhdim të përpjekjeve të Sekretariatit të Përgjithshëm të INTOSAI-t për disa vjet, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi në dhjetor të 2011 rezolutën *Promovimi i efijencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, duke forcuar institucionet supreme të auditimit*. Rezoluta thekson rëndësinë e pavarësisë së SAI-ve dhe i kushton vëmendje Deklaratës së Limës dhe të Meksikës. Pavarësia është një temë aktuale gjithashtu edhe për SAI-n e Hungarisë meqenëse Ligji i ri për Zyrën Shtetërore të Auditimit të Hungarisë që hyri në fuqi në korrik të vitit 2011, forcon pavarësinë e organizatës, e cila është thelbësore për funksionimin efikas të saj. Zhvillimet që lidhen me to u prezantuan nga László Domokos, President i Zyrës Shtetërore të Auditimit të Hungarisë, në takimin e Bordit Drejtues të INTOSAI-t në tetor të vitit 2011.



Presidenti i Zyrës  
Shtetërore të Auditimit të  
Hungarisë, Mr László  
Domokos, në takimin e  
62-të të Bordit Qeverisët  
të INTOSAI-t në Vjenë,  
Austri, 2011


### 3 Sfidat e ardhshme për INTOSAI-n

Një arritje e madhe metodologjike e INTOSAI-t është krijimi i sistemit të ISSAI-ve. Në vitet dhe në dekadat e fundit, një punë domethënëse metodologjike u krye në Komitetet dhe Grupet e Punës së INTOSAI-t. Janë përpunuar dhe janë miruar në Kongrese disa udhëzime dhe dokumente metodologjike. Në këtë drejtim, solli një ndryshim Kongresi i INTOSAI-t i organizuar në vitin 2010 në Johaneshburg. Në lidhje me standardet e INTOSAI-t, theksi është zhvendosur nga përpunimi i tyre drej harmonizimit dhe zbatimit. Aktualisht, përkthimi dhe aplikimi i ISSAI-ve është prioritet në SAI-n e Hungarisë. Si rrjedhojë, disa ISSAI janë përkthyer në gjuhën hungareze dhe në këtë mënyrë audituesit e SAI-t mund t'i përdorin ato më lehtë. Standardet ISSAI po përshtaten me kushtet e vendit, në këtë mënyrë metodologjitë e aplikuara më parë nga organizatat po përfundohen dhe po ndryshohen në përputhje me ISSAI-t. Përshtatja e standardeve të INTOSAI-t në mënyrë të ngjashme do të sigurojë më gjerësisht nivel të lartë të punës audituese brenda komunitetit të INTOSAI-t, si dhe përdorim eficient dhe efektiv të fondeve publike.



## Kontribut nga SAI i Indisë

**Ndryshimi i Paradigmave  
të Qeverisjes dhe INTOSAI**





## Kontribut nga SAI i Indisë

ASOSAI

*Komiteti i Ndarjes së Njohurive (KSC)*

*Komiteti Drejtues i KSC*

*Grupi i punës për Auditimin IT*

*Kryetar*

*Komitetit i standardeve profesionale (PSC)*

*Nënkomiteti i Auditimit të Pajtushmërisë*

*Grupi i punës për Borxhin Publik*

*Grupi i punës për Auditimin e Mjedisit*

*Grupi i punës për përgjegjshmërinë dhe auditimin e ndihmave për përballjen e fatkeqësive*

*Anëtar*

*Komiteti Drejtues i Bashkëpunimit të Donatorëve - INTOSAI*

*FAC Task Forc e INTOSAI-t në Parashikimin Financiar*

*Komiteti Drejtues për PSC*

*Komiteti Drejtues i CBC*

*Vëzhgues*

### **Ndryshimi i Paradigmave të qeverisjes dhe INTOSAI**

#### **Hyrje**

Po jetojmë në kohë të trazuara. Ka një rritje të pakënaqësisë popullore kudo në botë kundër shtetit në përgjithësi, si dhe në disa raste, kundër qeverisjes aktuale të dobët. Të kuptuarit se si qeveria po punon, dhe nëse është e monopolizuar nga një pakicë apo ka një pjesëmarrje më të madhe, është çelësi për çështjet e paqarta të ditës, duke përballur njëlloj si politikë bërësit ashtu edhe qytetarët e zakonshëm. Qeverisja publike është një matricë komplekse e marrëdhënieve që ekzistojnë midis legjislativit, ekzekutivit, gjyqësorit dhe shoqërisë civile. Këto marrëdhënie përcaktojnë përgjegjësinë dhe llogaridhënien e menaxhimit, kontrollit të pasurisë publike dhe të ofrimit të shërbimeve publike. Prandaj, qeverisja e mirë nënkupton menaxhim efektiv të pasurisë publike, nivel të lartë të përgjegjësisë, transparencën, një lëvizje të lirë e informacionit, respekt për sundimin e ligjit, kontroll i korrupsionit, pjesëmarrje të rëndësishme të qytetarëve dhe drejtësi. Në vitet e fundit, marrëveshjet e qeverisjes publike dhe sistemi i ofrimit të shërbimeve publike në mbarë botën kanë përjetuar ndryshime të theksuara. Iniciativat e reformës administrative që synonin përmirësimin e performancës, llogaridhënien dhe menaxhimin e sektorit publik, kanë filluar në disa vende. Ka një shtim të formave të reja organizative në prag të liberalizimit ekonomik dhe gjithashtu ndryshime të rëndësishme në mënyrën se si qeveria qendrore dhe ajo lokale dhe organizatat shumëpalëshe ofrojnë programe dhe shërbime si dhe sigurojnë transparencë në funksionimin e tyre.

Nevoja për llogaridhënie ka sjellë një kërkesë për më shumë informacion për programet dhe shërbimet qeveritare. Zyrtarët publikë, ligjvënësit dhe qytetarët duan, dhe kanë nevojë të dinë nëse fondet qeveritare trajtohen si duhet dhe në pajtushmëri me ligjet dhe rregulloret. Ata gjithashtu kanë nevojë të dinë nëse organizatat qeveritare, programet dhe shërbimet po arrijnë qëllimin e tyre dhe nëse këto organizata, programe dhe shërbime po veprojnë në mënyrë ekonomike dhe me efikasitet. Kështu, rëndësia e rolit që auditimi i jashtëm luan në qeverisjen e mirë po njihet gjithnjë e më shumë në të gjithë botën. INTOSAI, i cili është niveli më i lartë i bashkëpunimit ndërkombëtar midis SAI-ve, ka çuar përpara një model të përkryer të një SAI të pavarur dhe efektiv, plotësisht i vetëdijshëm për aspiratat dhe kërkesat publike si dhe kërkesat për një shtet në zhvillim.



### Ndërkombtarizimi si një iniciativë politike e SAI-t të Indisë.

SAI i Indisë ka një histori të gjatë dhe të shquar më shumë se 150 vjet. Institucioni i Auduesit të Përgjithshëm të Indisë u krijua për herë të parë në vitin 1860. Historikisht, pavarësia e SAI-t të Indisë evoluoji me legjislacione të njëpasnjëshme, veçanërisht Ligji për Qeverinë e Indisë i vitit 1919 dhe 1935 në epokën para-pavarësisë. Pavarësia financiare dhe operacionale dhe parimet e sjelljes profesionale dhe objektiviteti i SAI-t të Indisë u sanksionuan në Kushtetutë, të miratuar dhe të adoptuar nga Republika Indiane në vitin 1950. Në vitin 1971, Parlamenti i Indisë miratoi një legjislacion të përshtatshëm të quajtur Ligji i Kompetencave dhe Kushteve të Shërbimeve, i cili përcakton detyrat, kompetencat dhe kushtet e shërbimeve të Kontrollorit dhe Audituesit të Përgjithshëm të Indisë, duke siguruar më tej pozicionin e tij si një zyrë kushtetuese. Duke pasur parasysh pozitën e saj unike në sistemin kushtetues në Indi, SAI i Indisë ka një pozicion shumë të mirë, për të vlerësuar rolin që pavarësia mund të ketë në evoluimin e një SAI. Në të vërtetë, kanë qenë përpjekjet tona për të promovuar pavarësinë e SAI-t, siç është sanksionuar në Deklaratat e Limës dhe të Meksikës në nivel ndërkombëtar. Ky qëllim i pranuar, ka qenë i përfshirë në angazhimet dhe bashkëpunimet tona ndërkombëtare.

SAI i Indisë ka qenë në ballë të përpjekjeve të ndryshme duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar midis SAI-ve në të gjithë globin. Në kuadrin e politikës së SAI-t të Indisë, bashkëpunimi ndërkombëtar është parë si një burim kryesor i krahasimit dhe miratimit të praktikave më të mira ndërkombëtare në fushën e auditimit të jashtëm të qeverisë. Përvoja e SAI-t të Indisë në lidhje me ndërveprimin e tij si në forumet ndërkombëtare dhe ato dypalëshe ka qenë si të dobishme ashtu edhe frytdhënëse.



Ish kontrollori dhe Auduesi i Përgjithshëm i Indisë, Z. Vinod Rai, dhe Z. Jagbans Singh, Drejtor i Përgjithshëm i Marrëdhënieve me Jashtë, në takimin e 62-të të Bordit Qeverisës së INTOSAI-t, në Vjenë, Austri, 2011

### INTOSAI - korniza për bashkëpunim ndërkombëtar

Pjesëmarrja e SAI-t të Indisë në INTOSAI ka qenë aktive në shumë aspekte. Në ruajtje të motos së INTOSAI-t, *Experientia Mutua Omnibus Prodest (Eksperiencia e Përbashkët ju Shërben të gjithëve)* kjo ka qenë përpjekja jonë dhe qëllimi i përbashkët për të krijuar dhe bashkëpunuar në një platformë të vetme, nga e cila shqetësimet unike, operacionale dhe profesionale, mund t'ju drejtohet të gjitha SAI-ve dhe duhet të përpunohet një kuadër i caktuar politikash. Në të vërtetë, INTOSAI ka provuar të jetë një platformë e tillë. INTOSAI sot ka arritur të jetë një nga organizatat ndërkombëtare më të mëdha, e dyta vetëm në OKB në drejtim të anëtarësismit të saj. Kjo në vetvete është një e drejtë e besimit në vazhdimin e duhur të organizatës në një botë gjithnjë e më të mbushur me pasiguri ekonomike dhe me financa publike të pasigurta.





Fakti se INTOSAI-t i ishte akorduar statusi si organizatë jo-qeveritare (OJQ) nga OKB në vitin 1967, si dhe Statusi Konsultativ sipas OKB-së ECOSOC në vitin 1970 është gjithashtu një tregues përfundimtar drejt vazhdimit relevant të organizatës në mesin e mekanizmave të njohura ndërkombëtarisht, për rritjen dhe forcimin e qeverisjes dhe përhapjen e mekanizmave botërisht. Angazhimi i INTOSAI-t drejt sigurimit të pavarësisë organizative, financiare dhe funksionale të SAI-ve është pasqyruar në Deklaratat e Limës dhe të Meksikës. Kongresi i IX i cili u mbajt në vitin 1977 në Lima, Peru, miratoi Deklaratën e Limës të Udhëzuesve për Rregullat e Auditimit. Ajo deklaroi pavarësinë e SAI-ve në baza organizative, funksionale dhe financiare. Rregullat e Deklaratës së Limës ishin zhvilluar në një grup koherent prej tetë rregullash në Deklaratën e Meksikës për pavarësinë e SAI-ve të miratuar në vitin 2007. Deklarata e Meksikës siguron hapin e fundit proverbial drejt njohjes së pavarësisë së SAI-t si kriter i qeverisjes së mirë dhe sistemeve të përhapjes botërisht. Unë do të mbaj Rezolutën A/66/209 në Asamblenë e Përgjithshme të 66-të të Kombeve të Bashkuara - *Nxitja e efikasitetit, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, duke forcuar institucionet Supreme të Auditimit* e cila është miratuar së fundmi nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së - si moment përcaktues në përpjekjet e INTOSAI-t në drejtim të sigurimit të komunitetit botëror se SAI-t mund të përmbushin detyrat e tyre në mënyrë objektive dhe efektive vetëm kur ato janë të pavarura dhe të mbrojtura nga ndikimet e jashtme. INTOSAI tani mundet që në mënyrë efektive dhe për një qëllim të caktuar të përdorë rezolutën në promovimin më efektiv të pavarësisë së SAI-ve kudo në botë. Gjatë viteve, INTOSAI ka shfaqur një qasje shumë të theksuar multilateralizmi në funksionimin e tij. Kongresi i tij, Bordi Drejtues, Grupet e Punës dhe Task Forcat, kanë nxitur komunitetin e auditimit të jashtëm si kurrë më parë. Gjithashtu po aq unik ka qenë dhe roli i shtatë Grupeve të tij Rajonale të Punës, të cilët, në rrugët individuale, kanë forcuar qëllimet strategjike të vetë INTOSAI-t. Qëllimet strategjike të Grupeve Rajonale të Punës janë të lidhur ngushtë me qëllimet strategjike dhe me vetë Planin Strategjik të INTOSAI-t, duke ju dhënë atyre intensitetin dhe duke ju pasuruar përvojën e përgjithshme në përhapjen e asaj që promovon INTOSAI.

### Shtysë për shkëmbimin e njohurive

Auditimi i jashtëm është një profesion i bazuar në njohuri, dhe kërkon një kuadër të bazuar në njohuritë e standardeve dhe të proceseve. Përditësimi dhe rishikimi i standardeve ekzistuese dhe përpunimi i standardeve të reja në zonat në dukje të papërpunuara të auditimit, është një detyrë e vazhdueshme. Duke kuptuar rëndësinë e përhapjes së njohurive, si pjesë përbërëse e standardeve të tij, Kongresi i XIX i INTOSAI-t i mbajtur në Meksikë në nëntor të vitit 2007 miratoi një propozim për të ngritur një Komitet të Shërbimit dhe Përhapjes së Njohurive. SAI i Indisë është Kryetari i këtij Komiteti. Për të zgjeruar bazën e Komitetit dhe për të thelluar procesin e përhapjes së njohurive në një mjedis të shumëanshëm dhe ndërkohë duke qëndruar brenda kufijve të Planit Strategjik të INTOSAI-t, SAI i Indisë formoi Komitetin e Përhapjes së Njohurive (KPNJ) duke përfshirë të gjithë anëtarët e Grupeve të Punës dhe Task Forcave sipas Objektivit 3 dhe gjithashtu themeloi Komitetin e Drejtimit të KPNJ për të lidhur ndërtimin organizacional të Objektivit 3 me Objektivat 1 dhe 2 të Planit Strategjik. Komiteti kryesor i KPNJ sot ka 104 anëtarë dhe 3 vëzhgues 9 Grupe Pune, 1 Task Forcë dhe një gazetë kryesore ndërkombëtare, *Gazeta Ndërkombëtare në Auditimin të Qeverisë*. KPNJ është një grup aktiv që kërkon të lehtësojë shkëmbimin e praktikave më të mira në auditim duke promovuar përmirësimin e përhapjes së njohurive, ripërdorimin, të mësuarit, bashkëpunimit dhe inovacionit. KPNJ fokusohet në menaxhimin e metodologjive të ndryshme të auditimit si një aset strategjik, dhe inkurajon përhapjen e tyre në mesin e SAI-ve. Qëllimi përfundimtar i KPNJ-ve është për të ndarë njohuri të vlefshme organizative, për të shmangur rishpikjen e rrotës, dhe duke reduktuar kurbën e të mësuarit në asimilimin e teknikave dhe metodologjive të reja të auditimit. Në ndryshimin e shpejtë të skenarit ekonomik dhe politik, mekanizmi institucional i transferimit të njohurive mishëruar nga KPNJ simbolizon stabilitetin dhe besueshmërinë - një domosdoshmëri në skenarin global të ditëve të sotme.

Gjithashtu, Grupet e Punës dhe Task Forcat kanë qenë të dobishëm në ngritjen e vetëdijes të SAI-ve anëtare në një nivel më të lartë të mirëkuptimit, përhapjes dhe asimilimit. Niveli i debatit dhe diskutimit i nxitur nga këto Grupe Pune është i admirueshëm. Zhvillimi i një pike tjetër referimi ka qenë koncepti i auditimeve të përbashkta nga SAI-t për çështjet



mjedisore dhe politikat ndërkufitare si dhe auditimi i marrëveshjeve ndërkombëtare mjedisore. INTOSAI meriton lëvdata për lehtësimin e niveleve të tilla të bashkëpunimit ndërkombëtar.

### Roli i caktuar i ASOSAI-t dhe i grupeve të tjera rajonale

Bordi Drejtues i INTOSAI-t ka njohur shtatë Grupe Pune Rajonale: ASOSAI (i themeluar në vitin 1978), ARABOSAI (i themeluar në vitin 1976), AFROSAI (i themeluar në vitin 1976), CAROSAI (i themeluar në vitin 1988), EUROSAI (i themeluar në vitin 1990), PASAI (i themeluar në vitin 1987) dhe OLACEFS (i themeluar në vitin 1965). Prej këtyre grupeve, ASOSAI me një anëtarësi prej 45 SAI është një nga grupet më të mëdha rajonale. Qëllimet e ASOSAI-t me kryesues SAI-n e Indisë janë:

1. Ndërtimi i Kapaciteteve Institucionale
2. Përhapja e Njohurive dhe Shërbimi i Njohurive
3. Të qënit Grupi Kryesor Rajonal i Punës në INTOSAI



Takimi i 12-të i Komitetit të Trajnimit, në Jaipur, Indi, 2012



Pjesëmarrësit në Asamblenë e 12-të të ASOSAI-t në Jaipur, Indi, 2012

Këto qëllime janë të lidhur ngushtë me qëllimet e vetë INTOSAI-t. Grupet rajonale, nga natyra e tyre e thjeshtë, janë në gjendje të veprojnë më shumë në fuqinë e historisë së përbashkët, vlerave sociale dhe kulturore, si dhe në ngjashmërinë e institucioneve. ASOSAI gjithashtu vendos një theks të madh në nevojat për trajnim të SAI-ve. Është e rëndësishme, se si shumë SAI në Azi janë ende në një fazë fillestare të zhvillimit dhe marrëveshjet e trajnimit institucional në ASOSAI sigurojnë që të gjitha SAI-t janë në gjendje të komunikojnë me njëri-tjetrin me një shkallë të arsyeshme të uniformitetit në përmbajtje dhe përvojë. SAI-t anëtare të ASOSAI-t nuk janë zbrapsur në mbështetjen e tyre për të gjitha aktivitetet e organizatës. Rritja e ASOSAI-t është e lidhur thelbësisht me atë të INTOSAI-t. Një shembull interesant do të ishte qëndrimi proaktiv i ASOSAI-t në promovimin dhe miratimit të ISSAI-ve nga anëtarët e saj. Kjo në fakt ishte tema e Simpoziumit të 5-të të ASOSAI-t i mbajtur në fillim të këtij viti në lidhje me Asamblenë e 12-të të ASOSAI-t. Kumtesat dhe diskutimet e vendeve në këtë simpozium në fakt shkuan më larg në mënyrë unanime deri në përpunimin e afërt ndërmjet ASOSAI-t në lidhje me dëshirën e adoptimit ISSAI-ve.



Ish Kontrollori dhe Audituesi i Përgjithshëm i Indisë Z. Vinod Rai, duke përshëndetur Asamblenë e 12-të të ASOSAI-t në Jaipur, Indi, 2012



Është besimi i fortë i SAI-t të Indisë që ndërveprimi shumëpalësh si në ASOSAI ashtu dhe në INTOSAI duhet të promovohet në një nivel tjetër bashkëpunimi dhe të shkëmbimit të eksperiencës.



Ceremonia e hapjes së Asamblesë së 12-të të ASOSAI-t në Jaipur, Indi, 2012

### Rritja e bashkëpunimit në nivele më të larta

INTOSAI ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt përmirësimit të mëtejshëm të ngritjes së kapaciteteve në SAI-t anëtare. IDI dhe Bashkëpunimi i Donatorëve të INTOSAI-t janë hapa për një drejtim të tillë. Iniciativa për Zhvillim INTOSAI (IDI) është themeluar në vitin 1986 për të nxitur përparimin e kontabilitetit publik dhe auditimit, veçanërisht në kombet në zhvillimin, përmes shkëmbimit të informacionit dhe të trajnimit të audituesve si dhe trajnerëve të SAI-ve. Bashkëpunimi i Donatorëve të INTOSAI-t, nga ana tjetër, kërkon të përdorë për një qëllim të caktuar aftësitë e Komunitetit të Donatorëve të bazuar në kërkesën e SAI-ve të vetme, vendosjen e një plan veprimi dhe të qëllimeve të cilat do të hartohen në ekspertizën në dispozicion diku tjetër brenda INTOSAI-t. Një thirrje Globale për Propozime (A



Global Call for Proposals GCP) që u propozua në shtator të vitin 2011 për t'ju siguruar mundësinë të gjitha SAI-ve, rajoneve dhe organeve të INTOSAI-it, që të japin kërkesë propozime të drejtuara bazuar në nevojat e SAI-ve në vendet në zhvillim shkaktuan një reagim të dukshëm. Qëllimi i Bashkëpunimit të Donatorëve të INTOSAI-t është për të krijuar një Fond të Sigurtë Multi Donatorësh me qëllim për të përmirësuar performancën e SAI-ve në vendet në zhvillim. Përpjekjet të tilla kanë gjeneruar shumë interes në mesin e SAI-ve në vendet në zhvillim.

### Përfundim


INTOSAI ka ecur përpara në ruajtjen e komunitetit ndërkombëtar të SAI-ve në aspektin e të qenit i njohur si një hallkë e rëndësishme në praktikën e qeverisjes së mirë në të gjithë botën. Përhapja e njohurive ka qenë vendimtare për përpjekjet e saj në thellimin e këtij procesi të miratimit dhe asimilimit të praktikave më të mira ndërkombëtare në fushën e auditimit të jashtëm. SAI i Indisë është i angazhuar për përpjekjet dhe iniciativat që INTOSAI merr në zbatim të objektivave të tij.



## Kontribut nga IDI Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t

Magnus Borge  
Drejtore i Përgjithshëm i IDI-t

Një Sekretariat Trajnimi për SAI-t  
e Vendeve në Zhvillim





## Kontribut nga IDI Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t

*Magnus Borge*

*Drejtor i Përgjithshëm i IDI-t*

*Komiteti i Ndarjes së Njohurive (KSC)*

*Task Forca në Bazën e të Dhënave Informativ të SAI-ve*

*Komiteti Drejtues i INTOSAI-t – Bashkëpunimi i Donatorëve*

*Anëtar*

*Komitetit Drejtues i (PSC)*

*Komiteti Drejtues i (KSC)*

*Nënkomiteti 1: Promovimi i Rritjes së Aktiviteteve në Ngritjen e Kapaciteteve midis Anëtarëve të INTOSAI-t*

*Grupi i Punës në Luftën kundër Korrupsionit dhe Pastrimit të Parave*

*Grupi i Punës në Vlerësimin dhe Përfitim të SAI-ve*

*Vëzhgues*

### Një Sekretariat Trajnimesh për SAI-t e Vendeve në Zhvillim

Themelimi i IDI-t në Kongresin e XII të INTOSAI-t në vitin 1986 ishte pika kulmore e diskutimeve në INTOSAI që nga fundi i viteve 1970. Anëtarët kishin diskutuar gjatë që ishte e nevojshme një organizëm ndërkombëtar për të ndihmuar trajnimin e punonjësve të SAI-ve, veçanërisht në vendet në zhvillim, që do të kishte si karakteristikë kryesore centralizimin e instruktorit të trajnimit dhe zhvillimin e kurrikulave mësimore. Në fokus të programeve dhe aktiviteteve të trajnimit do të ishin bazat e kontabilitetit dhe të auditimit, duke theksuar rolin e Grupeve Rajonale të INTOSAI-t në pjesëmarrjen reale të programeve trajnuese. Në të vërtetë që në fazat e hershme u vendos që të ofroheshin trajnime në rajonal, se sa të pritej që stafi i SAI-t të udhëtonte në qendrën e IDI-t për këtë arsye. IDI gjithashtu do të zhvillonte dhe rolin e zyrës qendrore për mbledhjen dhe përhapjen e informacionit, zhvillimin e materialeve, dhe trajnimin e trajnuesve si dhe menaxherët e trajnimit. Ndërsa financimi i funksionimit të IDI-t do të sigurohej nga ndihma kombëtare dhe nga agjencitë e zhvilluara.

### Vitet e para të IDI-t

Që nga zanafilla e tij Sekretariati i IDI-t ishte bashkëlidhur me Zyrën Kanadeze të Auditorit të Përgjithshëm dhe ishte ngritur një Bord Drejtorësh, i kryesuar nga Auditori i Përgjithshëm i Kanadasë dhe nga Kontrollori i Përgjithshëm i Shteteve të Bashkuara. IDI filloi të funksiononte në vitin 1987, duke ofruar programet e para të trajnimeve si dhe shpërndarjen e botimit të parë të një Udhëzuesi Ndërkombëtar me Informacione Trajnimi për Auditimin. IDI ngriti një komitet me përfaqësues nga rajonet e INTOSAI-t dhe SAI të tjera dhe kjo vendosi tonalitetin e bashkëpunimit të ngushtë të SAI-ve dhe rajoneve të INTOSAI-t për të përcaktuar nevojat e trajnimit, për të zhvilluar dhe përhapur programe trajnimi mbi bazë të rajoneve dhe të nën rajoneve.

Gjatë 10 viteve të para, nga viti 1986-1995 programet e zhvilluara ishin në mënyrë tipike kurse trajnimi teknike të përshtatura për të përmbushur nevojat e veçanta të SAI-ve në rajone të ndryshme. Përqendrimi ishte në rritjen e njohurive të audituesve nëpërmjet kurseve në planifikimin dhe mbikëqyrjen e auditimit, auditimin e TI, testimin e auditimit; dhe instruktimi i menaxherëve të trajnimit dhe departamenteve të personelit me njohuri të reja nëpërmjet workshopeve dhe seminareve për tranierët.

### Ndryshimi i rolit të IDI-t

Një shqyrtim i gjerë nga ana e INTOSAI-t, pas 10 viteve, mbi programet dhe aktivitetet e IDI-t theksoi nevojën për një përqendrim të fortë në zhvillimin e infrastrukturës së trajnimit rajonal për të siguruar qëndrueshmërinë dhe



zbatueshmërinë afatgjatë të rezultateve të arritura në nivele rajonale dhe lokale. Si pasojë u zhvillua IDI dhe në vitin 1996, filloi Programi i Trajnimit Rajonal Afatgjatë (PTRAGJ), i cili do të fokusohet në radhë të parë në zhvillimin e burimeve njerëzore dhe institucionale në nivel rajonal, me përfitimet e pritura që gjithashtu rriten për SAI-t individuale. Objektivi kryesor i këtij programi afatgjatë ishte të ndihmonte grupet rajonale dhe SAI-t anëtare për të rritur mundësinë e trajnimit të tyre dhe për të zgjeruar fushën e trajnimit dhe aktivitetet e shkëmbimit të informacionit duke krijuar një infrastrukturë të trajnimit për të siguruar qëndrueshmërinë dhe zbatueshmërinë e programeve të trajnimit rajonal. Elementet kyçe të Programit të Trajnimit Rajonal Afatgjatë (PTRAGJ) ishin krijimi i komiteteve të reja rajonale të trajnimit, zhvillimi i planeve operacionale rajonale të trajnimit, krijimin e udhëzuesve të trajnimit rajonal dhe të formojnë një rezerve specialistësh trajnimi të diplomuar në çdo rajon në gjendje për të vlerësuar nevojat e trajnimit dhe për t'i përmbushur ato me organizimin e aktiviteteve relevante trajnuese, lokale dhe rajonale.

PTRAGJ ishte projektuar për të edukuar grupet dhe nën grupet rajonale që gjithnjë e më shumë mund të marrin përgjegjësi shtesë për ngritjen e kapaciteteve të tyre, nga identifikimi i nevojave për trajnim në projektim, zhvillim, përhapje, vlerësim dhe financimin e programeve të tyre rajonale të trajnimit. Sekretariati i IDI-t do të luajë gradualisht një rol më pak të drejtpërdrejtë në trajnimin rajonal. Në vend të kësaj, roli i tij do të jetë për të siguruar koordinim dhe mbështetje; lehtësimin e shkëmbimit të metodologjive dhe teknologjive; të ndihmojë në identifikimin e burimeve njerëzore, materiale, dhe monetare; dhe të ofrojë udhëzime dhe këshilla.

#### Sekretariati IDI-t - nga Kanadaja në Norvegji

Kongresi XVI i INTOSAI-t në vitin 1998 miratoi një propozim për të transferuar Sekretariatit e IDI-t nga SAI i Kanadasë në SAI-n e Norvegjisë në fillim të vitit 2001. U ndje që, pas 15 vitesh, një ndryshim i udhëheqjes dhe i vendit do të jetë e dobishme për IDI-n dhe do të sigurojë një stimul në rritje për ide dhe përpjekjeve të reja. Transferimi vazhdoi i qetë, dhe Sekretariati i ri i IDI-t në Norvegji e mori në dorëzim në vitin 2001. Bordi i IDI në Norvegji kryesohet nga Auditori i Përgjithshëm i Norvegjisë dhe përmban anëtarë nga Kanadaja, Norvegjia, Suedia, Holanda, Mbretëria e Bashkuar dhe Zimbabve. Kryesuesi i Komitetit për Ngritjen e Kapaciteteve të INTOSAI-t dhe Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI-t janë vëzhgues të përhershëm të Bordit. Gjithmonë ka qenë një bashkëpunim i shkëlqyer dhe një koordinim i aktiviteteve midis IDI-t dhe Sekretariatit të Përgjithshëm të INTOSAI-t.

Një studim i SAI-ve të vendeve në zhvillim është kryer në vitin 1999-2000, dhe ai informacion është përdorur për të modeluar planin e parë strategjik të IDI-t për periudhën 2001 - 2006. Plani parashikonte ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës së trajnimit rajonal, shtrirjen e programeve në fusha të reja, si bashkëpunimi më sistematik me komitetet e INTOSAI-t dhe grupeve të punës dhe duke eksploruar e-learning si një mjet i ri trajnimi për SAI-t.





Pas tre vjetësh qasje rajonale, IDI/AFROSAI-E Programi i Menaxhimit të Zhvillimit është hapur në nivel kombëtar të SAI-t, SAI i Tanzanisë, Dar es Salaam, 2012

**Drejtimi i IDI-t nga trajnime të vetme drej kapacitetit të plotë të zhvillimit të programeve.**

Pas një procesi planifikimi konsultativ me bazë të gjerë gjatë vitit 2004-2005, IDI zhvilloi një strategji të re afatgjatë për periudhën 2007-2012. Gjatë viteve ka pasur një theks gjithnjë e në rritje për të drejtuar përpara nga trajnimi i thjeshtë në klasë të trajnimi për impakt. Kjo ishte e nevojshme për tu siguruar sepse trajnimi nuk është një qëllim në vetvete, por mbetet një mjet për qëllimin final dhe të vërtetë duke forcuar aftësinë e SAI-ve për të planifikuar. Plani strategjik i IDI-t 2007-2012, aspironte të përparonte më tej në drejtim të këtij ndryshimi strategjik dhe të mbronte reputacionin e shkëlqyer që IDI gëzon në komunitetin INTOSAI. Gjatë viteve të fundit IDI ka kaluar nëpër një ndryshim strategjik dhe vepron në përputhje me modelin e zhvillimit të kapaciteteve të IDI-t.

Qasja e IDI-t për zhvillimin e kapaciteteve në SAI, adreson dy dimensione të zhvillimit; kompetencën e burimeve njerëzore dhe sistemet organizative. Dimensionin njerëzor përqendrohet në mbushjen e boshllëqeve në njohuri, aftësi dhe qëndrimet e punonjësve të SAI-t në nivele të ndryshme. Ndërsa trajnimi ballë për ballë zhgjedh një komponent kyç, IDI kryesisht përdor metoda të tjera të të mësuarit të cilat janë më të integruara me vendin e punës, si auditimet pilot. Dimensionet e sistemeve organizative përqendrohen në zhvillimin e auditimit dhe në mbështetjen e proceseve dhe strukturave në SAI. Të dy dimensionet ndikojë dhe plotësojnë njëri-tjetrin. Për të zbatuar këtë qasje për ndërtimin e kapaciteteve të SAI-t, IDI ka miratuar një model të përbërë nga hapat e renditura në vijim:





Për vlerësimin e nevojave, IDI ka ngritur një kornizë të vlerësimit të nevojave dhe një udhëzues mbështetës. Korniza adreson mangësitë në sistemin organizativ të SAI-ve dhe në kompetencat profesionale të punonjësve. Pasi ka identifikuar nevojat, IDI harton ndërhyrjet e duhura për të adresuar mangësitë e identifikuar. Hartimi i ndërhyrjes është bërë në konsultim të ngushtë me aktorët rajonalë dhe me SAI-t pjesëmarrëse.



Delegatët nga SAI-t Afrikane (CREFIAP) pjesëmarrës në workshop-in e Vlerësimi i Nëvojave dhe Planifikimi Strategjik, në Marok, 2012



Grupi i instruktorëve dhe organizatorët në Programin e Ngritjes së Kapaciteteve në Auditimin e TI të IDI/AFROSAI-E, Afrikë e Jugut, 2012

Nga e majta: Z. Kevin Vanderpuye (SAI i Ganës), Zj. Florence Kiriinya (IDI/SAI i Kenias ), Zj. Shefali Andaleeb (IDI/SAI i Indisë), Zj. Erica Dien (SAI i Nambisë), Z. Richard Brisebois (Kanada), Zj. Bernadene Rautenbach (SAI i Afrikës së Jugut) dhe Zj. Vongai Shiri (SAI i Zimbabeve)

Përvoja e IDI-t është se mësimi vetëm në klasë ka ndikim të kufizuar. Prandaj programet e IDI-t për zhvillimin e kapaciteteve kanë një kombinim midis zhvillimit të njohurive teorike dhe implementimit të njohurive në punën praktike. Pjesa teorike për më tepër është kryer ballë për ballë me anë të trajnimit në klasë ose nëpërmjet e-learning që është gjithnjë e në rritje. Kjo pasohet



nga një zbatim praktik, për shembull, nëpërmjet auditimeve pilot, ku ofrohet ndihma gjatë punës në terren si dhe nëpërmjet takimeve rishikuese. Programet zakonisht përfshijnë një komponent për implementimin e metodologjisë së re për SAI-t pjesëmarrëse. Bazuar në mësimet e nxjerra dhe përvojat e realizuara, rezultatet dhe përfundimet e programeve janë dokumentuar në raporte, manuale apo materiale të tjera udhëzuese, të cilat janë në dispozicion për të gjithë SAI-t dhe aktorë të tjerë.

IDI ka vazhduar të zbatojë kryesisht programin e tij të zhvillimit të kapaciteteve nëpërmjet strukturave rajonale dhe nënrajonale të INTOSAI-it. Programet mund të përfshijnë zhvillimin e SAI-ve prej më shumë se një rajon (programe ndër - rajonale), një rajon të tërë, apo më e zakonshme, një grumbull SAI-sh brenda rajonit. Kjo është një qasje efektive dhe e qëndrueshme që siguron efikasitetin e kostos, nëse ajo arrin një grup të madh të SAI-ve, adreson SAI-t me nevoja dhe sfida të ngjashme, kontribuon në ndërtimin e rrjeteve rajonale, të mësuarit kolegj me kolegj dhe të jugut me të jugut si dhe bashkëpunimin trekëndësh, si dhe përdor njohuritë dhe bashkëveprimin e ngushtë që strukturat rajonale kanë me anëtarët e tyre. Një kuadër rezultatesh është formuar për programet e zhvillimit të kapaciteteve të IDI-t, për tu siguruar se programet e IDI-t janë relevante për nevojat e zhvillimit të kapaciteteve të SAI-t dhe për të kontribuar në përmirësimin e performancës së qëndrueshme në SAI.

#### IDI si sekretariat i INTOSAI-t për Bashkëpunim e Donatorëve

Në vitin 2010 IDI ishte përzgjedhur si Sekretariati për Bashkëpunim e Donatorëve të INTOSAI-t. Roli si sekretariat për këtë bashkëpunim përbën një pjesë të integruar të IDI-t përkrah vazhdimin të aktiviteteve të programuara, me qëllim krijimin e sinergjive. Duke qenë një pjesë përbërëse e INTOSAI-t dhe duke bashkëpunuar vazhdimisht me SAI-t, rajonet dhe Komitetet e INTOSAI-t, do të thotë se IDI ka një bazë të gjerë të kontakteve brenda grupit. Sekretariati i Donatorëve të INTOSAI-t bazohet në shprehjen IDI's know-how të kuadrit të INTOSAI-t, në bazën e tij të gjerë të kontakteve dhe përvojën e ngritjes së kapaciteteve të SAI-t për të siguruar përfshirjen e dëshiruar dhe zotërimin e SAI-ve.

Sa për programet e ngritjes së kapaciteteve të IDI-t, është zhvilluar një kuadër rezultatesh për Bashkëpunimin e Donatorëve të INTOSAI-t. Kuadri i rezultateve do të përdoret për të matur dhe për të monitoruar progresin në rritjen dhe forcimin e mbështetjes për SAI-t e vendeve në zhvillim.

#### IDI në të ardhmen

Në Planin Strategjik të INTOSAI-t 2011-2016, IDI si një prej organizmave aktuale kryesore të INTOSAI-t, është parë si një partner i rëndësishëm në arritjen e qëllimeve strategjike të INTOSAI-t. Mbështetja për zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI-t) është detyra më e madhe dhe më të rëndësishme për IDI-n sipas Planit Strategjik të INTOSAI-t. Ndërsa është vendosur shumë theks në ISSAI-t operacionale në nivelin 4 të kuadrit, është e qartë se baza për një zbatim të suksesshëm në këtë nivel është përputhja me ISSAI-t në nivelet kryesore 1, 2 dhe 3. Në përgjithësi, të gjitha aktivitetet e zhvillimit të kapaciteteve të IDI-t mund t'i referohen kuadrit të ISSAI-ve i cili mbulon gjithnjë e më shumë të gjithë përgjegjësinë e çdo SAI meqenëse korniza është duke u zhvilluar dhe harmonizuar më tej në mes të niveleve. Mbështetja për zbatimin e ISSAI-ve do të jetë e theksuar në planin e ardhshëm strategjik të IDI-t, nga viti 2013 dhe në vazhdim.



**Nga e majta, në rreshtin e parë:** Zj. Jianhua Qian (IDI), Z. Abdullah Omer Karamollaoglu (SAI i Turqisë), Zj. Violet Roebeck-Fasavalu (SAI i Samoas), Zj. Luz Loreto Tolentino (SAI i Filipineve), Zj. Archana P. Shirsat (IDI), Zj. Manako Leocadia Ramonate (SAI i Lesotos), Z. Magnus Borge (IDI), Zj. Mafani Constance Masoabi (SAI i Lesotos), Zj. Ines Metsalu (SAI i Estonisë), Zj. Josephine Mukomba (AFROSAI-E)

**Nga e majta në rreshtin e dytë:** Z. Mourad Ben Gassouma (SAI i Tunizisë), Zj. Margret Te Paeru-a-te Ara Numanga (SAI i Ishujve Cook), Zj. Mere Mermi Waqanicagica (SAI i Fixhit), Z. Subramanian Krishnan Sangaran (SAI i Indisë), Zj. Carolyn Dawn Lewis Watson (SAI i Xhamajkës), Z. Dagomar Henriques Lima (SAI i Brazilit), Zj. Isha Odeane Abrahami Mc. Donald (SAI i Grenadës), Z. Khalid Hamid (SAI i Emirateve të Bashkuara Arabe), Z. Md. Shofiqul Islam (IDI)

### IDI - në partneritet me palët e interesuara


Një faktor kryesor në suksesin e konceptit të IDI-t ka qenë inputi aktiv dhe i vlefshëm, në një mbështetje të mirë të marrë në çdo fazë nga anëtarët e INTOSAI-t. Pa mbështetjen e fortë të këtyre SAI-ve, të cilët kanë siguruar ekspertë të fushave përkatëse, ose kanë organizuar workshop-et e IDI-t, ose kanë ofruar specialistët e tyre në dispozicion të trajnimit për planifikimin dhe ofrimin e workshop-eve, puna e IDI-t do të ishte e përgjysmuar. Donatorët që ofrojnë mbështetje financiare për IDI-n janë një tjetër grup i partnerëve, mbështetja e të cilëve është vendimtare. Pa miratimin e Parlamentit Norvegjez dhe mbështetjes financiare nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Norad –it (Agjencia Norvegjeze e Zhvillimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar), SAI Norvegjez kurrë nuk mund të merrte përgjegjësinë e mikpritjes së Sekretariatit të IDI-t. Kontributet e drejtpërdrejta financiare të ofruara nga donatorë të shumanshëm dhe nga agjencitë e zhvillimit të bashkëpunimit ndërkombëtar nga shumë shtete, kanë bërë të mundur për IDI-n të ofrojë programe relevante dhe inovative në ndërtimin e kapaciteteve për SAI-t e vendeve në zhvillim.

Shiko [www.idi.no](http://www.idi.no) për informacionin më të fundit në IDI



## Kontribut nga SAI i Irakut

Historia e Bordit  
Suprem të Auditimit të Irakut  
me INTOSAI-n





## Kontribut nga SAI i Irakut

*Komiteti i Standardeve Profesionale (PSC)*

*Anëtar*

*Komiteti i Ngritjes së Kapaciteteve (CBC)*

*Nënkomiteti 1: Promovimi i Aktivitete të Rritjes së Ndërtimit të Kapaciteteve ndërmjet anëtarëve të INTOSAI-t*

*Grupi i Punës në Auditimin TI*

*Grupi i Punës në Luftën kundër Korrupsionit dhe Pastrimit të Parave*

### **Historia e Bordit të Auditimit Suprem të Irakut me INTOSAI-n**

SAI-t kanë një rol të rëndësishëm në auditimin e aktiviteteve ekonomike të të gjitha subjekteve publike në emër të autoritetit legjislativ. Bordi i Auditimit Suprem të Irakut, themeluar në bazë të ligjit nr. 17 të vitit 1927, është një institucion publik financiarisht dhe administrativisht i pavarur me një individualitet juridik, me qëllim mbrojtjen e fondeve publike, luftimin e korrupsionit financiar dhe administrativ rritjen e përgjegjësisë së publikut si dhe promovimin e ekonomisë dhe kredibilitetit të qeverisë së Irakut. Ai ishte ligji i parë për SAI-n e Irakut. Pas pavarësisë së Irakut, Bordi i Auditimit Suprem ka ruajtur zhvillimin dhe ka përparuar së bashku me ndryshimet politike ekonomike dhe legjislative. Ky zhvillim përkon me miratimin e ligjeve që rregullojnë punën e tij, domethënë ligjet (42), (149) dhe (6) respektivisht të viteve 1968, 1980 dhe 1990. Sipas ligjit të ri nr. 3 I BAS të vitit 2011, BAS ka marrë shumë mandate që mbështesin pavarësinë e tij organizative dhe administrative në një mënyrë që i mundësojnë atij për të përmbushur detyrat e caktuara dhe aktivitetet e kryera në subjektet që janë brenda objektit të auditimit të tij.

Si Institucioni Suprem i Auditimit në Irak dhe që nga themelimi i tij, BAS ka luajtur një rol aktiv në ofrimin e shërbimeve ndaj shtetit në fushat e kontrollit dhe auditimit në emër të autoritetit legjislativ. BAS auditon pasqyrat financiare, kryen auditime të performancës dhe jep raporte mbi rezultatet e njësive të punëve publike në përputhje me rregullat dhe ligjet e vendosura, brenda periudhave të caktuara kohore. BAS ka marrëdhënie me organizata ndërkombëtare profesionale nëpërmjet ndarjes së pikëpamjeve dhe përvojës me këto organizata në fushën e auditimit financiar. BAS ka për qëllim zhvillimin e mjeteve të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të eksperiencave me SAI të tjera në të gjithë botën, nëpërmjet organizatave të tjera ndërkombëtare. BAS është anëtarësuar në INTOSAI në vitin 1974 dhe merr pjesë në takimet e tij vjetore si dhe pajtohet me të gjitha rekomandimet, direktivat dhe udhëzimet e tij. Ai gjithashtu është anëtarësuar në një numër komisionesh të INTOSAI-t, përkatësisht Komitetin e Standardeve Profesionale (KSP), Komitetin e Ngritjes së Kapaciteteve (KNK) dhe Grupin e Punës për Luftën kundër Korrupsionit dhe Pastrimit të Parave (GPLKKPP). Për më tepër, BAS kohët e fundit është bashkuar me Grupin e Punës për Auditimit e IT. BAS ka marrë pjesë në një numër aktiviteteve të sponsorizuara nga INTOSAI. Më poshtë janë pjesëmarrjet më të rëndësishme të BAS në aktivitetet e organizatës INTOSAI për tri vitet e fundit:

1. Pjesëmarrja në Simpoziumin e 20-të, OKB/INTOSAI zhvilluar në Qendrën Ndërkombëtare në Vjenë në vitin 2009 (*INTOSAI: Partner aktiv në rrjetin anti-korrupsion ndërkombëtar; Sigurimi i transparencës për të promovuar sigurinë sociale dhe uljen e varfërisë*) ku u prezantuan marrëveshjet ndërkombëtare për anti-korrupsion, si për rritjen e zbatimit të qëllimeve të mijëvjeçarit, ashtu dhe rekomandimet më të rëndësishme të praktikave më të mira për luftimin ndërkombëtar të pastrimit të parave dhe korrupsionit nga pikëpamja e INTOSAI-t. Gjatë këtij Simpoziumi,



Iraku iu bashkua Grupit të Punës në Luftën kundër Korrupsionit dhe Pastrimit të Parave, dhe që atëherë është anëtar dhe ka filluar të marrë pjesë në takimet e tij të veçanta. Në këtë aktivitet, BAS ka paraqitur një dokument pune që përmban masat e marra nga BAS në fushën e luftës kundër korrupsionit si dhe në rritjen e transparencës në administratën e qeverisë.



Delegacioni nga Bordi i Auditimit Suprem të Irakut i udhëhequr nga Presidenti Abdul Basit Turki Said, pjesëmarrës në Simpoziumin e 20-të, OKB/INTOSAI në Vjenë, Austri, 2009

2. Pjesëmarrja në takimin e 12-të të Grupit të Punës të INTOSAI-t për Auditimin e Mjedisit (WGEA) më 25-29 janar 2009 në Doha, Katar, për të diskutuar një numër çështjes të lidhura me mjedisin, zhvillimin e qëndrueshëm dhe metodat e auditimit të mjedisit. SAI-t nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre u përqendruan në çështjet ndërkombëtare, rajonale dhe lokale si dhe në proceset përmirësuese të zbatuara nga këto institucione për të hartuar dhe menaxhuar praktikatat e auditimeve të mjedisit. Gjatë takimit, Iraku paraqiti përvojën BAS-së në Kompaninë Shtetërore të Baterive për vitin fiskal 2006.
3. Nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, Iraku dha mbështetjen e tij për nismën e INTOSAI-t në miratimin e deklaratave të Limës dhe të Meksikës në një rezolutë të Këshillit Ekonomik dhe Social të OKB-së, si dhe Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së me qëllim për të promovuar pavarësinë e SAI-ve dhe auditimit të qeverisë. Ministria udhëzoi misionet e saj jashtë Irakut për të mbështetur dhe për të inkurajuar këtë iniciativë.
4. Pjesëmarrja në Seminarin e 6-të të Auditimit të Performancës dhe në takim e 19-të të Grupit të Punës në Auditimin e IT të INTOSAI-t, të mbajtur në Kinë më 12-17 prill 2010 në treguesit e performancës së efikasitetit të projekteve të TI dhe zbatueshmërisë së investimeve. Gjatë takimit, Iraku paraqiti një kumtesë studimore për diskutim ndërsa po paraqitej një diskutim rreth planifikimit gjithëpërfshirës, i cili përfshin planifikimin strategjik të sistemeve të TI, planifikim të plotë të sistemeve të TI, vlerësimit të projekteve, kuadri i studimit të fizibilitetit ekonomik të sistemeve të TI, vlerësimi i sistemeve strategjike të TI, vlerësimi i aplikacioneve dhe infrastrukturës, zhvillimi i strategjisë së punës, vlerësim strategjik i TI, treguesit e qëndrueshmërisë së investimeve në projektet e TI, analiza e kthimit të investimeve, treguesit e meritave dhe të përfitimeve të marra nëpërmjet investimeve në projektet e TI.
5. Si anëtar i Komitetit të Ngritjes së Kapaciteteve, Iraku ka marrë pjesë në zhvillimin e një udhëzuesi në rritjen e





përdorimit dhe ndikimit të raporteve të auditimit. Martin Sinclair, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm i Mbretërisë së Bashkuar dhe drejtuesi i Nënkomitetit 1 të Ngritjes së Kapaciteteve, i përcolli një kopje të udhëzuesit Ahmed El Midaoui, ish-President i Gjykatës së Llogarive të Marokut, i cili përshëndeti përpjekjet e bëra për përgatitjen e udhëzuesit. Ai ishte paraqitur në takimin kryesor të komitetit në Afrikën e Jugut, i cili u ndoq nga Iraku si një pjesë e Kongresit të XX të INTOSAI në tetor të vitit 2010.

6. Pjesëmarrje në takimin e 5-të të Grupit të Punës për Luftën kundër Korrupsionit dhe Pastrimit të Parave në Republikën Çeke, në Pragë në 12-14 Shtator 2011. Në takim u diskutuan mënyrat e bashkëpunimit me Grupin e Punës së INTOSAI-t në Auditimin e Mjedisit. Iraku është bërë anëtar në grupin e punës së ARABOSAI-t në auditimin e mjedisit, me qëllim zhvillimin e një udhëzuesi për çështjet e korrupsionit dhe të mashtrimit në fushën e auditimit të mjedisit. Në takim gjithashtu u diskutua aktivizimi i zhvillimit të një baze të dhënash mbi praktikën dhe eksperiencat më të mira të SAI-ve në luftën kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave.
7. Pjesëmarrja në Simpoziumin e 21-të, të OKB/INTOSAI, i cili u mbajt në datat 13-15 korrik 2011 në Vjenë. Simpoziumi u fokusua në *Praktikat efektive për bashkëpunim ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit dhe qytetarëve për të rritur përgjegjshmërinë publike*. Ky takim paraqiti një mundësi për të vlerësuar se si çdo SAI pjesëmarrës angazhon publikun në punën e tij dhe se si e njeh publikun me punën e tij. Iraku ka marrë pjesë duke prezantuar një kumtesë mbi Identifikimin dhe Komunikimin e Vlerës dhe Përfitimit të SAI-ve.

Delegacioni nga Bordi i Auditimit Suprem të Irakut i udhëhequr nga Presidenti Abdul Basit Turki Said, pjesëmarrës në Simpoziumin e 22-të, OKB/INTOSAI në Vjenë, Austri, 2013



8. Ishte planifikuar që BAS të merrte pjesë në takimin e katërt të Grupit të Punës së INTOSAI-t në Luftën kundër Korrupsionit dhe Pastrimit të Parave në Ekuador më 5 - 6 gusht 2010.

Takimi u fokusua në vlerësimin e progresit të aktiviteteve të Grupit të Punës që nga takimi i kaluar dhe në diskutimin e raporteve të paraqitura nga SAI-t anëtare në grup, për të miratuar planin e veprimit të grupit për periudhën 2012 - 2015. Në fund Iraku nuk mori pjesë në këtë takim për shkak të problemeve që lidhen me procedurat e udhëtimit.

Aktivitetet dhe shërbimet e INTOSAI-t luajë një rol aktiv në ngritjen e kapaciteteve institucionale të SAI-ve anëtare, përveç rolit të tyre në forcimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të ekspertizës midis SAI-ve.

BAS ka rritur vetëdijen dhe njohuritë e stafit të tij për rëndësinë e bashkimit me një organizatë të tillë nëpërmjet trajnimit dhe



## EXPERIENTIA MUTUA OMNIBUS PRODEST


shkëmbimit të stafit në kurset e trajnimit brenda dhe jashtë Irakut. BAS ka përmirësuar legjislacionin dhe efikasitetin e rezultateve të punëve të tij duke zbatuar parimet e veçanta dhe standardet e nxjerra nga INTOSAI dhe miratimin e parimeve të transparencës në auditime. BAS synon që të jetë një anëtar aktiv në organizatë përmes informacionit të vazhdueshëm, komunikimit, duke formuar grupe të përbashkëta pune me SAI-t anëtare për të marrë parasysh problemet dhe pengesat e punës, nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së tij në konferencat e organizuar nga organizata si dhe duke bërë të mundur përdorimin e përvojës së vendeve anëtare në organizatë në zhvillimin e auditimit dhe bartjes së përvojës të dobishme të tyre në Irak.



## Kontribut nga SAI i Japonisë

Hiroyuki Shigematsu  
President i mëparshëm i  
Bordit Auditues të Japonisë

Bashkëpunimi Ndërkombëtar i  
Bordit të Audituesve të Japonisë





## Kontributi i SAI-t të Japonisë

Hiroyuki Shigematsu

President i mëparshëm i Bordit Auditues të Japonisë

Komiteti i Standarteve Profesionale (PSC)

Komiteti i Ngritjes së Kapaciteteve (CBC)

Komiteti Drejtues i CBC

Komiteti i Ndarjes së Njohurive (KSC)

Nënkomiteti 1 : Nxiti rritjen e aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve

përgjatë anëtarëve të INTOSAI-t

Grupi i punës për auditimet e IT

Grupi i Punës përgjegjës për auditimin e ndihmave lidhur me fatkeqësitë

Grupi i Punës për Modernizimin e Financave dhe Reformave Rregullatore

## **Bashkëpunimi Ndërkombëtar i Bordit të Audituesve të Japonisë**

Eshtë një nder i madh për mua të kontribuoj në këtë botim lidhur me 60-vjetorin e INTOSAI-t. Dua të shpreh respektin më të madh kolegëve tanë të këtij komuniteti ndërkombëtar dhe gjithashtu Sekretariatit të Përgjithshëm, i cili ka lehtësuar këtë marrëdhënie të përzemërt përgjatë dekadave, Unë do të doja shkurtimisht të përshkruaja aktivitetin e Bordit të Audituesve të Japonisë lidhur me INTOSAI-n duke iu referuar dhe momenteve historike të shquara në historinë e INTOSAI-t.

### **1. Bashkëpunimi Ndërkombëtar për më shumë se gjysëm shekulli**

Lidhja e gjatë dhe e qëndrueshme e Bordit të Audituesve të Japonisë dhe INTOSAI-t filloi kur Bordi mori pjesë në INCOSAI II i mbajtur në Bruksel në 1956 dhe iu bashkua komunitetit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Këto ditë ishte duke filluar periudha e rritjes së shpejtë ekonomike në Japoni, dhe pritjet e njerëzve për supervizimin e institucioneve për financat publike ishin duke u rritur ndjeshëm. Që atëherë Bordi ka marrë pjesë vazhdimisht në INCOSAI dhe i është përkushtuar aktiviteteve të INTOSAI-t.



Në vitin 1968, INCOSAI VI i paharrueshëm u mbajt në Tokio ku 70 SAI u mbledhën së bashku dhe diskutuan çështje të ndryshme. Kjo ishte konferenca e parë Ndërkombëtare e mbajtur në Tokio mbi auditimin e sektorit publik dhe Bordi bëri përpjekje të përbashkëta për të trajtuar çdo lloj pune të përfshirë, me aq sa kam dëgjuar, duke fituar aprovimin e kabinetit, dhe duke nxitur pjesmarrjen e Princit dhe Princeshës së Japonisë. Konferenca u mbyll me sukses dhe çdokush u ndje i lehtësuar.

Duke i paraprirë INCOSAI-t, në 1967, organizatës (INTOSAI) i është dhënë statusi konsultativ si një organizatë jo-qeveritare nga Kombet e Bashkuara Ekonomike dhe Këshilli Social. Lidhur me këtë, përgjatë sesionit të INCOSAI-t VI, Jorg Kandutsch, President i SAI-t të Austrisë dhe Sekretari i parë i Përgjithshëm, deklaroi si më poshtë:

*“Unë mendoj se ky është sukcesi më i shquar i përpjekjeve tona deri më sot. Megjithatë varet nga ne për ti dhënë këtij bashkëpunimi të nderuar me agjensinë e rëndësishme të Kombeve të Bashkuara vlera praktike ... le të mendojmë për detyrat e përbashkëta profesionale dhe le të kuptojmë bashkëpunimin me agjensitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara në përputhje me Kombet e Bashkuara përkundër shumë pengesave duke na ndihmuar për të ndërtuar frymën e paqes dhe mirëkuptimit midis të gjithë njerëzve”*

Duhet theksuar se frymezimi i INTOSAI-t i shprehur në Deklaratën e z. Kandutsch është trashëguar dhe ka sjellë një tjetër arritje të rëndësishme kur në vitin 1966 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi Rezolutën duke promovuar eficensën, përgjegjësinë, efektivitetin dhe transparencën e administratës publike duke forcuar institucionet supreme të auditimit në 22 Dhjetor 2011. Është e nevojshme të theksojmë se ky është dhe një frut i përpjekjeve për një kohë të gjatë e udhëhequr nga Josef Moser, Presidenti i SAI-t të Austrisë dhe Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t.

Veç kësaj duhet kujtuar që në INCOSAI VI në Tokio u miratuan Statutet e para të INTOSA-it (urdhërat e rëndësishme të INTOSAI-t) të cilët zyrtarisht themeluan INTOSAI-n si një organizatë e përhershme e Institucioneve Supreme të Auditimit. Statutet gjithashtu përcaktuan edhe rolin e Presidentit të Gjykatës Austriake të Auditimit si Sekretari i



Përgjithshëm i INTOSAI-t. Pas kësaj, duke qenë se është rishikuar shumë herë, Statuti mbetet shtylla kryesore e Përgjegjësisë dhe Transparencës së vet INTOSAI-t.

## 2. Zhvillimet e fundit në INTOSAI

Përgjatë periudhës 1966-1983 dhe 2001-2007, Bordi shërbeu dhe si anëtar i Bordit Qeverisës së INTOSAI-t. Në qëllimin e dytë si anëtar i Bordit Qeverisës, Bordi u përfshi në vendime të reja siç ishte zhvillimi dhe miratimi i Planit të Parë Strategjik të INTOSAI-t, krijimi i kornizës së ISSAI-t, fillimi i konsultimeve të Komiteteve të medha dhe grupeve me Sekretariatit e Përgjithshëm dhe anëtarë të tjerë të SAI-ve.

Sot, Bordi është anëtarë i Komiteteve të ndryshme dhe Grupeve të Punës brenda INTOSAI-t, të quajtura Komiteti i Standarteve Profesionale, Komiteti i Ngritjes së Kapaciteteve (Komiteti Drejtues dhe Nënkomiteti 1 ), IDI, Grupet e Punës në Auditimin e IT , Grupet e Punës për përgjegjësinë për auditimet për ndihmat në raste fatkeqesie dhe Task Forcën për Krizën Financiare Globale. Për çdo takim të këtyre Grupeve dhe Komiteteve ne jemi munduar ti dërgojmë delegatët tanë sa më shumë me qëllimin për të kontribuar në komunitetin e INTOSAI-t dhe për të ndarë njohuri dhe ekperienca me anëtarët e tjerë të SAI-ve.

Bordi ka pasur kënaqësinë të mirëpresë takime të ndryshme siç ishte Takimi i 4 i Grupit të Punës së INTOSAI-t në auditimin e Institucioneve Ndërkombëtare në 2003, takimi i 17 i Grupit të Punës së INTOSAI-t në auditimin e IT në 2008 dhe takimi i 5-të Nënkomitetit të ngritjes së Kapaciteteve në 2012.

Takimi i 17 i Grupit të Punës së INTOSAI-t në auditimin e IT  
Tokio, Japoni , 2008



Përveç aktiviteteve tona të vazhdueshme të komiteteve të INTOSAI-t, unë dua të trajtoj dhe aktivitetet tona në Organizatën Aziatike të Institucioneve Supreme të Auditimit (ASOSAI), një grup Rajonal Pune i INTOSAI-t i themeluar në 1978. Gjatë gjithë historisë së ASOSAI-t Bordi ka marrë çdo mundësi për të kontribuar në aktivitete e tij të ndryshme, veçanërisht në hapësirën e ngritjes së kapaciteteve për anëtarët e SAI-ve. Në këtë drejtim, për më shumë se një dekadë, Presidenti i Bordit ka shërbyer si administrator i trajnimeve të ASOSAI-t (Administrator i programit të trainimeve ASOSAI,



përpara 2009), duke planifikuar dhe sjellë një numër të programeve të trainimeve në bashkëpunim të ngushtë me Sekretariatit e Përgjithshëm të ASOSAI-t.



Delegatët e SAI-t të Japonisë në Asamblenë e 11-t të ASOSAI dhe takimet e 40 dhe 41 të Bordit Qeverisës të ASOSAI-t në Islamabad, Pakistan, 2009

Nga pikpamja e Administratorit të trajnimeve, Jam i bindur që çdo audituesi të SAI-ve u kërkohet gjithnjë dhe më shumë të kenë profesionalizëm, duke rifreskuar aftësitë dhe njohuritë e tyre gjatë punës së përditshme të auditimit. Do të më pëlqente të ushtroja veten time më shumë në ngritjen e kapaciteteve në rajonin e Azisë, në bashkëpunim me ngritjen e kornizave të kapaciteteve të INTOSAI-t siç është Komiteti i Ngritjes së Kapaciteteve dhe Bashkëpunimi i Donatorëve të INOSAI-t.






### 3 Sfidat e ardhshme të INTOSAI-t

Si President i Bordit të Audituesve të Japonisë dhe si anëtar i këtij Komuniteti të mbrekullueshëm të Institucioneve Supreme të Auditimit, përsëri, doja ti bëja nderimet e mija kolegëve të mi në INTOSAI, gjithashtu Josef Moser për përpjekjet e bëra kundrejt aktiviteteve të tashme dhe të ardhshme të INTOSAI-t. Jam i bindur se lidhjet e ngushta ndërmjet anëtarëve të SAI-ve do të forcohen dhe konsolidohen nëpërmjet komunikimeve ballë për ballë ndërmjet krerëve të SAI-ve dhe gjithashtu komunikimeve të rregullta në nivel pune.

Përballja në mbarë botën me rritjen e të kuptuarit dhe kritika kundër menaxhimit të financave publike, pritjet e publikut kundrejt INTOSAI-t dhe gjithashtu SAI-ve individual janë rritur shumë. Duke parë këtë situatë, mund të ketë ardhur koha të vëmë në punë njohuritë dhe eksperiencat tona përgjatë dekadave të fundit. Do të doja të nxisja të gjithë anëtarët e INTOSAI-t të shikojnë punën e paraardhësve tanë dhe të mësojnë se si i kanë analizuar çështjet në fjalë në çdo fazë.


Gjatë INCOSAI-t VI të mbajtur në Tokio në 1968, pjesëmarrësit e SAI-ve nga e gjithë bota diskutuan tema të ndryshme nën temën e Metodave dhe Procedurave të Auditimit Suprem dhe Metodave të Raportimit të përdorura nga SAI-t. Megjithatë ne i kemi diskutuar shumë herë këto çështje për më shumë se gjysëm shekulli, këto subjekte janë akoma të përkohshme. Vërejtjet e Jorg Kandutsch janë shumë të aplikueshme në situatën e tanishme, në çdo kohë që ju mund ti referoheni dokumentave dhe materialeve të kaluara, ju do të shikoni që kolegët tuaj që përpara disa dekadave kanë sjellë sugjerime intuitive. Un besoj se kjo është një tjetër mënyrë e ndarjes së eksperiencave të përbashkëta e cila i sjell përfitime të gjithëve.





## Kontribut nga SAI i Koresë

Funksioni i Bordit të Auditimit dhe  
Inspektimit të Koresë në INTOSAI





## Kontributi i SAI-t të Koresë

ASOSAI Sekretariati i Përgjithshëm

Platforma INTOSAI për bashkëpunimin me Kombet e Bashkuara Karrige

Komiteti i Standarteve Profesionale (PSC)

Komiteti i Ngritjes së Kapaciteteve (CBC)

Komiteti Drejtues i CBC

Komiteti i Ndarjes së Njohurive (KSC)

Nënkomiteti 1 : Nxiti rritjen e aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve

përgjatë anëtarëve të INTOSAI-t

Grupi i Punës për Borxhin Publik

Grupi i Punës për Auditimin e Mjedisit

Grupi i Punës për Programet e Vlerësimit

Grupi i Punës përgjegjës për auditimin e ndihmave lidhur me fatkeqësitë

Grupi i Punës për Modernizimin e Financave dhe Reformave Rregullatore

Komiteti Drejtues i Bashkëpunimit të Donatorëve të INTOSAI-t

## Funksioni i Bordit të Auditimit dhe Inspektimit (BAI) të Koresë në INTOSAI



Delegacioni i Bai, i udhëhequr nga kryetari i Kun Yangat  
Takimi 62 i Bordit Drejtues të INTOSAI  
Vjenë, Austri, 2011

### 1 Zhvillimi i bashkëpunimit ndërkombëtar i (BAI-t) të Koresë

Pas bashkimit me Organizatën Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) në 1965, Bordi i Auditimit dhe Inspektimit (BAI) i Koresë i shërbeu INTOSAI-t si Auditues (1992-1995) dhe si Anëtar i Bordit Qeverisës (1998-2010).

Gjithashtu gjatë Kryesisë së Bordit Qeverisës së INTOSAI-t nga 2001 në 2004 BAI mikpriti Kongresin e XVII –t të INTOSAI-t në Seoul në 2001, në të cilën BAI futi me sukses sistemin elektronik për herë të parë në historinë e INTOSAI-t

Në mënyrë për të zhvilluar sistemin e auditimit, Bai është përpjekur të kuptojë tendencat e auditimit ndërkombëtar dhe të ndajë teknikat e auditimit me SAI-t e tjera duke kryer studime të përbashkëta dhe duke marrë pjesë në Komitete, Nënkomitete dhe Grupe Pune të



INTOSAI-t si Komiteti i Ngritjes së Kapaciteteve, Nënkomiteti për Udhëzimet e Auditimit Financiar, Grupi i Punës përgjegjës për auditimin e ndihmave lidhur me fatkeqësitë, Grupi i Punës për Borxhin Publik dhe Grupi i Punës për Programet e Vlerësimit.

**Që prej bashkimit me Organizatën Aziatike të Institucioneve Supreme të Auditimit (ASOSAI) në 1979, e cila është një grup pune i INTOSAI-t, BAI është përfaqësuar në Bordin Qeverisë të ASOSAI-t për 10 periudha për 30 vitet e mëvonshme. BAI ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të rritur aftësitë e auditimit për anëtarët e SAI-ve në këtë rajon, veçanërisht duke mirëpritur Asamblenë e 2-t të ASOSAI-t në 1982 dhe mirëpritur 11 seminare në Kore.**



Në vitin 2009, BAI u zgjodh për të pritur Sekretariatit e ASOSAI-t. Që atëherë BAI ka marrë rolin udhëheqës në promovimin e bashkëpunimit ndërkombëtar përmes aktiviteteve të ndryshme të ASOSAI-t. Në shkurt të vitit 2011 u miratua në mënyrë të rregullt Plani Strategjik i ASOSAI-t për 2011-2015. Që në vitin 2004, ASOSAI ka implementuar programe të ndryshme në bashkëpunim me Inicativën për Zhvillim të INTOSAI-t, veçanërisht duke drejtuar aktivitete për ngritjen e kapaciteteve. Midis programeve të bashkëpunimit të IDI-t dhe ASOSAI-t janë kryer deri tani *Programi për Sigurimin e Cilësisë, Programi Elektronik për Trajnuesit, Programi i Sigurimit të Cilësisë në Auditimet e Performancës dhe Plani Strategjik i Takimit*. ASOSAI

gjithashtu ka punuar për të promovuar me grupet e tjera të punës Rajonale të INTOSAI-t. Organizata Europiane e Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI) është një grup rajonal pune i INTOSAI-t. Në konferencën e Parë të Bashkimit të ASOSAI-EUROSAI të mbajtur në Stamboll, Turqi në shtator të vitit 2011, një diskutim u mbajt për rëndësinë e komunikimit të kapaciteteve të SAI-ve duke promovuar përgjegjësi dhe transparencë. Pas bashkimit të konferencës, u nënshkrua një memorandum kuptimi për bashkëpunimin Ndër –Rajonal midis EUROSAI-t dhe ASOSAI-t për të promovuar bashkëpunimin dhe komunikimin midis anëtarëve të dy Grupeve Rajonale të SAI-ve.

### Zhvillimet e fundit në INTOSAI

Midis shumë arritjeve të INTOSAI-t, BAI vlerësoi shumë Inicativën e INTOSAI-t, në të cilën të gjithë anëtarët e INTOSAI-t ndoqën me entuziazëm lidhshimin e Sekretariatit të Përgjithëm të INTOSAI-t të arrinte të bindte Kombet e Bashkuara të njohin rëndësinë e INTOSAI-t, Deklaratës së Limës dhe Deklaratës së Mexikës.

Asambleja e Përgjithshme njohu A/66/442 Draft Rezolutën e II. Përpjekjet Intensive dhe të mirorkestruara të INTOSAI-t kulmuan në miratimin e Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme. Në Dhjetor të vitit 2011, Sesioni i 66 i Asamblesë së Përgjithshme miratoi Rezolutën e tij A/66/209 *Duke promovuar efikasitetin, përgjegjshmërinë, efektivitetin dhe transparencën e administratës publike duke forcuar institucionet supreme të auditimit*. Sekretariati i ASOSAI-t ka inkurajuar të gjithë anëtarët e SAI-ve të ASOSAI-t të ofrojnë mbështetje përmes autoriteteve qeverisëse kombëtare.



45th ASOSAI Governing Board Meeting in Jaipur, India, 2012



1st ASOSAI-EUROSAI Joint Conference in Istanbul, Turkey, 2011

Veç kësaj BAI merr shënime nga Plani Strategjik i INTOSAI-t 2011-2016, i cili e pajis INTOSAI-n me zhvillimet dhe strategjitë për zhvillimin e ardhshëm, pas Planit Strategjik të INTOSAI-t 2005-2010 i cili tashmë ka ndihmuar të takohen nevojat dhe kërkesat profesionale të SAI-ve. Strategjia e Re për ngritjen e kapaciteteve të INTOSAI-t reflekton MoU ndërmejt INTOSAI-t dhe Komunitetit të Donatorëve. Këto aktivitete do të forcojnë kapacitetet e SAI-ve, njësoj si Komiteti i Ngritjes së Kapaciteteve të INTOSAI-t ka ndihmuar shumë SAI të përmirsohen vitet e fundit.

BAI ngeli i impresionuar që – me rastin e Forumit të Katërt të Nivelit të Lartë për Efektivitetin e Ndihmave në nëntor të vitit 2011 dhe në Forumin e tretë Botëror të OECD në tetor 2009, të dyja të mbajtura në Busan, Korea – INTOSAI i adresoi pjesëmarrësit në rëndësinë e partneritetit Global për zhvillimin e bashkëpunimit efektiv dhe për prespektivat e bashkëpunimit të OECD-s dhe INTOSAI-t respektivisht në sferën e matjes së progresit.

Platforma për Bashkëpunim e INTOSAI-t me OKB, e krijuar në INCOSAI XIX e mbajtur në Mexikë në 2007 me SAI-n e Koresë si Kryetar, ka qënë joaktive që nga themelimi. Përgjatë Simpoziumit të 21 të UN/INTOSAI në 2011, Lideri i INTOSAI-t dhe Departamenti Ekonomik dhe i Çështjeve Sociale të UN-s (UN DESA) ranë dakort të rishikojnë fushat e mundshme të bashkëpunimit të UN/INTOSAI-t. BAI i Koresë në kapacitetin e tij si Kryetar i Platformës, ka biseduar me Sekretarin e Përgjithshëm të INTOSAI-t për zgjidhjet e mundshme. Gjatë bashkimit të Konferencës së parë EUROSAI-ASOSAI në 2011, marrëveshja u arrit që Platforma të Rindërtohej përmes kornizave strukturale dhe funksionale të reja. Me kornizën e re BAI do të bëjë më të mirën të lehtësojë bashkëpunimin ndërmjet UN dhe INTOSAI-t dhe do të punojë ngushtësisht në zona specifike të bashkëpunimit me Sekretarin e Përgjithshëm të INTOSAI-t mbi baza të qëndrueshme.

### 3 Sfidat e ardhshme për INTOSAI-n

Që nga themelimi në vitin 1953 me 29 vende themeluese, INTOSAI, i cili tashmë konsiston në 191 anëtarë të plotë dhe 4 anëtarë miqësor, ka kontribuar në mënyrë të vazhdueshme një marrëveshje shumë të mirë duke përmirësuar qëndrimet dhe kapacitetet profesionale të gjithë SAI-ve nëpër botë.



Në dekadat e fundit, INTOSAI ka përjetuar arritje me shumë rëndësi veçanërisht: 1) Miratimi i Deklaratë së Mexikos për pavarësinë e SAI-ve, 2) krijimin dhe miratimin e Standarteve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit 3) nënshkrimin e MoU midis INTOSAI-t dhe Komunitetit të Donatorëve.

Si një çelës strategjik i prioritetve për katër vitet e ardhshëm, Plani Strategjik i INTOSAI-t 2011-2016 ka specifikuar katër qëllime kryesore. Prandaj BAI inkurajon INTOSAI-n tu qëndrojë prioritetve për mbajtjen e një lidhësi të fortë dhe efektive për të realizuar qëllimet strategjike siç janë shkruajtur në Planin e tij.

Nën Qëllimi i parë. Standartet e Përgjegjësisë Profesionale. INTOSAI duhet të kontribuojë në zhvillimin e standarteve të sektorit publik të cilat janë po aq efektive dhe profesionale si në sektorin privat. e rëndësishme është që ISSAI-t duhet të bëhen lehtësisht të arritshme.

Nën Qëllimi i dytë. Ngritja e Kapaciteteve Institucionale INTOSAI duhet të kërkojë më shumë bashkëpunim aktiv me Komunitetin e Donatorëve në mënyrë që të ndihmojë SAI-t, veçanërisht SAI-t në vendet në zhvillim për të ngritur kapacitetet audituese.

Nën Qëllimi i tretë. Ndarja dhe Shërbimet e njohurive, INTOSAI duhet të promovojë bashkëpunimin midis kolegëve dhe bashkëpunimin rajonal për të vendosur programe më të mira online.

Nën Qëllimi i katërt. Modeli i Organizatës Ndërkombëtare, INTOSAI pritet të organizojë dhe të qeverisi veten e tij në mënyrë të parashikueshme dhe të analizojë dhe rregullojë ndryshimet e shpejta mjedisore me praktika efikente dhe vendimarrje efektive.

#### **4 Përfundime**


Duke festuar 60-vjetorin e mbarë të INTOSAI-t dhe 50-vjetorin e Sekretariatit të Përgjithshëm në Vienë, BAI i Koresë uron suksese të mëtejshme për INTOSAI-n dhe Sekretariatit të Përgjithshëm. Si një anëtarë krenar i INTOSAI-t dhe i Sekretariatit të Përgjithshëm, Grupi Rajonal i INTOSAI-t, BAI do të vazhdojë të punojë për të arritur qëllimet dhe objektivat si në INTOSAI ashtu dhe në ASOSAI.





## Kontribut nga SAI i Kuwajtit

Vizioni i Zyrës Shtetërore të Auditimit (SAB)  
të Kuwajtit në rrugëtimin e INTOSAI-t





### Kontribut nga SAI i Kuvaajt

Komiteti i Ngritjes së Kapaciteteve (CBC)

Komiteti i Ndarjes së Njohurive (KSC)

Grupi i punës për auditimet e IT

Grupi i Punës për Auditimin e Mjedisit

## VIZIONI I ZYRËS SHTETËRORE TE AUDITIMIT (SAB) TË KUVAJTIT NË RRUGËTIMIN E INTOSAI-T



From the left: Mr Philippe Roland  
(President of the Court of Audit of Belgium)

& Mr Khalid Al-Abdulghafour (State Audit Bureau of Kuwait)

Në Ligjin nr. 30 të vitit 1964 u përcaktua krijimi i një entiteti të auditimit financiar në Shtetin e Kuvajtit i quajtur *Zyra Shtetërore e Auditimit*. Ajo është e lidhur me Parlamentin në mënyrë që të sigurojë një kontroll eficient të fondeve publike duke ushtruar kompetencat të besuara SAB-t sipas ligjit të themelimit.

Pas formimit të SAB-t dhe departamenteve të tij të ndryshëm dhe përmes ushtrimit të detyrave të caktuara, SAB ishte i etur për tu anëtarësuar në Organizatën Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI). SAB u pranua si një anëtar në Organizatë në vitin 1968. Që nga ajo kohë e deri më sot, SAB ka marrë pjesë në mënyrë aktive në të gjitha aktivitetet dhe eventet e organizatës, aktivitete të cilat mbështesin rolin e auditimit të SAB-it. Aktivitetet e organizatës gjithashtu ndihmojnë në zhvillimin e aftësive dhe kualifikimeve të punonjësve të tij përmes kërkimeve të publikuara, rekomandimeve, seminareve, programeve të trainimit dhe aktiviteteve të tjera të ndryshme. Në rrjedhën e periudhës së lartpërmendur, SAB dëshmon zhvillimin e INTOSAI-t i shprehur në rritjen e anëtarësisë si dhe diversitetin dhe madhësinë e punës dhe aktiviteteve të tij duke mbuluar gjithë misionet dhe kontributet e anëtarëve të SAI-t në përmbushjen e kërkesave dhe nevojave të ndryshme.

Sigurisht shumë çështje të rëndësishme janë drejtuar dhe shumë vendime të mençura janë marrë përgjatë rrugëtimit të INTOSAI-t duke kontribuar në zhvillimin e vazhdueshëm të detyrave dhe qëllimeve të INTOSAI-it. Është gjithashtu e njohur që motoja që është marrë nga INTOSAI, *Experientia Mutua Omnibus Prodest*, ndihmon për të rritur bashkëpunimin midis organizatës dhe anëtarëve të saj dhe të grupeve rajonale.



Iniciativa për zhvillim e INTOSAI-t IDI gjithashtu luan një rol të rëndësishëm duke siguruar suport për ndihmën e kërkuar për të kualifikuar trajnerët e specializuar të cilët mund të kontribuojnë për të arritur planin e trainimit në grupet rajonale. Duke marrë pjesë në këto takime për nevojat dhe zhvillimin e trainimeve të SAI-ve aftësitë dhe njohuritë e audituesve janë konsideruar një arritje e madhe për rezultatet praktike duke iu referuar qëllimeve të INTOSAI-t.



Organizata miratoi përkrahjen e shtatë Grupeve Rajonale të Punës duke iu referuar rregullave të INTOSAI-t. Qëllimi është të rritet bashkëpunimi në nivel rajonal dhe ndërkombëtar midis SAI-ve. Një nga faktorët për të arritur zhvillimet e sipërpërmendura është të sigurohet që çdo Grup Pune Rajonal të përfaqësohet në Bordin Qeverisës. Grupet e përmendura mund të japin opinionet e tyre për vështirësitë e përballura dhe të gjejnë zgjidhje, të koordinojnë politika dhe të përgatisin plane midis tyre dhe organizatës kryesore. Aktivitetet e sipër përmendura janë përpjekje të mira, dhe ne aspirojmë të vazhdojmë këtë suport dhe zhvillimin e tij në një mënyrë të dobishme për të gjithë anëtarët.


Duhet përmendur që përqsja me planin strategjik e miratuar nga organizata si metodologji pune e cila përcakton hapat dhe nënvizon punën për qëllimet e dëshiruara, është vlerësuar dhe meriton bashkëpunimin dhe suportin e të gjithë anëtarëve për zhvillimin në vazhdimësi. Përqsjet e sipërpërmendura janë efektuar në ristrukturimin e komiteteve dhe grupeve të punës, të cilët e bëjnë më efektiv rolin e tyre si anëtarë të SAI-t. Duke iu referuar ngjarjeve aktuale , veçanërisht krizës globale financiare që bota po përballon dhe ndryshimeve të reja të lidhura me llogaridhënjen dhe konceptin e auditimit, ne po presim më shumë bashkëveprim në eventet e sipër përmendura nga komitetet e organizatave të ndryshme.



Zhvillimet e vazhdueshme në organizatën e Sekretariatit të Përgjithshëm , të strukturave të tij dhe performancës së detyrave të tij i kanë mundësuar të zhvillojnë detyrat e tyre në mënyrë eficiente dhe profesionale. Këto zhvillime kanë kontribuar në rritjen e lidhjes dhe bashkëpunimit midis organizatës dhe anëtarëve të saj, duke promovuar arritjen e qëllimeve.

Ka sfida të tjera që organizata duhet të përballet dhe ti kapërcejë, në mënyrë që ti performojë në mënyrë eficiente detyrat në fushën e mbështetjes së anëtarëve të SAI-ve. Në këtë mënyrë, SAI-t mund të performojnë detyrat e tyre në mbrojtjen e të ardhurave publike, duke siguruar një përdorim më të mirë të të ardhurave, duke arritur një zhvillim të qëndrueshëm në kornizat e transparencës dhe qeverisjes së mirë përmes disa propozimeve, si më poshtë :

1. Të vazhdojnë mbështetjen për planin strategjik si një metodologji pune e organizatës dhe anëtarëve të SAI-ve. Të inkurajojnë anëtarët për ta bërë këtë dhe tu kërkojnë anëtarëve një përdorim efektiv të planit strategjik për më tepër, të punojnë në integrimin e Planit Strategjik në organizatë dhe në Grupet Rajonale të Punës.
2. Të rrisi bashkëpunimin midis anëtarëve të SAI-t ose përmes bashkëpunimit të përbashkët ose brenda fushës së Gupeve Rajonale të Punës.
3. Të promovojnë ndërveprimin dhe bashkëpunimin ndërmjet anëtarëve të INTOSAI-t në arritjen e qëllimeve dhe aspiratave. Të mbajnë dhe të rrisin mbështetjen e anëtarëve në aktivitetet dhe strukturat e ndryshme të INTOSAI-t të bëjnë të mundur performimin e detyrave dhe rolit në mënyrë efektive dhe eficiente.
4. Të zhvillojë rolin e besuar të Grupeve dhe Komiteteve të INTOSAI-t . Të studiojë problemet dhe vështirësitë që po përballet bota, veçanërisht krizën financiare, të identifikojë efektet e saj, të sugjerojë metoda dhe përjasje për ta eliminuar dhe për të siguruar që nuk do të ndodh më. Veç kësaj të rrisin dhe bashkëpunimin e brenda organizatës me të gjithë SAI-t e ndryshëm sipas qëllimeve dhe parashikimeve të INTOSAI-t. Veç kësaj, promovimi i përdorimit të kapaciteteve, aftësive, dhe eksperiencës bëjnë të mundur që grupet dhe komitetet e përmendura të kryejnë rolin e tyre. SAB i Kuvajtit është i gatshëm të zgjerojë bashkëpunimin dhe ndërveprimin me të gjitha aktivitetet e INTOSAI-t dhe anëtarët e Grupeve Rajonale të Punës Rajonale. SAB konfirmon rolin e tij në vazhdimësi në mbështetje të kryerjes së detyrave të besuara dhe në vendosjen në praktikë të motos së INTOSAI-t, si dhe në mbështetjen e gjithë anëtarëve të SAI-t. SAB-i pret një bashkëpunim më eficient me organizatën dhe të gjithë anëtarët për tu përballur me ndryshimet e organizatës tonë ndërkombëtare.





## Kontribut nga SAI i Latvisë


Inguna Sudraba

Ish Auditues i Përgjithshëm i

Republikës së Latvisë

Përmes Bashkëpunimit

Drejt Mbrojtjes së Interesave të Shoqërisë







Kontribut nga SAI i Latvisë

## Inguna Sudraba

### Ish Auditues i Përgjithshëm i Republikës së Latvisë

Komiteti i Ngritjes së Kapaciteteve (CBC)

Grupi i Punës për Auditimin e Mjedisit

Grupi i Punës për Trekuesit Kryesorë Kombëtarë

## Përmes Bashkëpunimit drejt Mbrojtjes së Interesave të Shoqërisë

### Aplikimi i praktikave më të mira ndërkombëtare si një mjet i rëndësishëm për ngritjen e kapaciteteve

Pjesëmarrja e zyrës Shtetërore të Auditimit të Republikës së Latvisë si një anëtar i ri i INTOSAI-t është shumë e mëvonshme krahasuar me 60-vjet histori të organizatës. Ndryshimet historike të komplikuar të ekzistencës së Shtetit të Latvisë kanë diktuar dhe historinë e Institucionit Suprem të Auditimit, i cili e përtëriti punën e tij si një institucion i përkohshëm vetëm pas gjysmës së vitit 1992 pas 50 vjet ndërprerje.

Fakti që Zyra Shtetërore e Auditimit u pranua në INTOSAI në 17 Tetor 1994 u supozua si një pranim profesional në nivel ndërkombëtar. Duke qënë në fillim të zhvillimit të profesionalizmit, institucioni u përball me mungesën e një metodologjie të përbashkët auditimi dhe përgjegjësitë e auditimit janë realizuar kryesisht duke kërkuar gabimet e kontabilitetit në administratën publike. Duke iu bashkuar INTOSAI-t, një platformë bashkëpunimi e rëndësishme, nga e cila mund të marrësh eksperienc nga Institucionet e tjera Supreme të Auditimit, rritja e mëtejshme profesionale u siguroa. Në fillim të kësaj rritje profesionale, marrëdhëniet ndërkombëtare u rregulluan hap pas hapi përmes pjesëmarrjes në evente të ndryshme të bashkëpunimit të INTOSAI-t, dhe disa nga konkluzionet e para u aplikuan në fushën e auditimit të procesit të privatizimit dhe në auditimin mjedisor, pas pjesëmarrjes për të parën herë në Kongresin e INTOSAI-t –INCOSAI XV i mbajtur në Kairo në vitin 1995. Megjithatë, vetëm në fund të dekadës së parë të bashkëpunimit ndërkombëtar u bënë më shumë përpjekje për rritjen e bashkëpunimit me anëtarët e INTOSAI-t duke e vendosur fokusin në përmirësimin sistematik të plotësimin të nevojave themelore të organizatës.

Pas përcaktimit të misionit të saj, zyra kuptoi se hapat e saj duheshin kushtuar të gjitha përpjekjeve të nevojshme për një zhvillim të rëndësishëm të profesionalizmit të saj, duke vendosur standartet më të larta të mundshme në mënyrë që të jetë një organizatë model përpara se të auditojë dhe këshillojë të tjerët. Vetëm atëherë do ta kishte të mundur për t'iu afruar vizionit të saj, të ndihmojë shtetin të menaxhojë dhe përdorë me mençuri burimet. Duke kuptuar përfitimet e mëdha të asistencës së jashtme për të arritur objektivat, zyra mund të vlerësojë anëtarësimin në INTOSAI, një institucion me 40-vjet eksperiencë, duke bashkuar anëtarët me eksperiencë për një periudhë të gjatë kohe. Kuptimi i situatës ndërkombëtare dhe tendencave të saj, si dhe nevojat e brendshme të zyrës për të zgjedhur partnerët e veçantë të bashkëpunimit përvoja e të cilëve do të përshtatej më së miri me nevojat specifike të Zyrës Shtetërore të Auditimit. Si



rezultat ndryshime thelbësore janë realizuar nëpërmjet projekteve dypalëshe me anëtarët e INTOSAI-t – Zyra Kombëtare e Auditimit e Mbretërisë së Bashkuar dhe Gjykata e Llogarive të Holandës. Nga viti 2005 deri në vitin 2007, Zyra Shtetërore e Auditimit, në bashkëpunim me partnerët e projekteve, prezantoi një proces riorganizimi të rëndësishëm në lidhje me strukturën e institucionit, duke përfshirë shqyrtimin e kualifikimeve të nevojshme për pozicione të ndryshme dhe për sistemin e shpërblimeve. Pas zhvillimit të metodologjisë së auditimit dhe hartimit të manualeve, SAI filloi të drejtojë auditimet drejt standarteve të auditimit ndërkombëtar. Zyra vazhdoi aktivitetet e bashkëpunimit dypalësh për të përshtatur administratën me softuerin e auditimit TeamMate dhe për të shpikur software IDEA. Bashkëpunimi dypalësh me partnerët solli afhtësi të dobishme të mësuesve shumë të njohur për të rritur profesionalisht anëtarët e stafit të institucionit, duke rezultuar në një zbatim të plotë të të gjitha përmirësimeve përkatëse. Duke analizuar nevojat dhe duke kryer ndryshimet përkatëse, Zyra e Auditimit Shtetëror nxorri sistemet e menaxhimit të cilësisë për të siguruar përdorimin e standarteve.

### Forcimi i INTOSAI-t përmes arritjeve të SAI-ve anëtarë

Lidhur me kapacitetet profesionale të Zyrës së Auditimit Shtetëror, e cila ishte rritur në mënyrë të konsiderueshme vitet e fundit përmes pjesëmarrjes aktive në Grupet e Punës dhe Nënkomitetet e ndryshme të INTOSAI-t, dhe përmes kontributit si partner këshilles në projektet dypalëshe me anëtarët e tjerë të INTOSAI-t, SAI e ka vendosur veten e tij në dispozicion të mundësive të reja për të ndryshuar ndjeshëm shtrirjen e aktiviteteve në nivel ndërkombëtar në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të INTOSAI-t.

Duke u rritur profesionalisht, Zyra e Auditimit Shtetëror ka përdorur forma të ndryshme për të ndarë eksperiencën e saj me anëtarët e tjerë, por dhe në të njëjtën kohë ka forcuar kapacitetet dhe profesionalizmin përmes këtij bashkëpunimi.



Pas ndarjes së eksperiencave të ndryshimeve thelbësore të metodologjisë së auditimit të vet zyrës, si një partner këshillues, në vitin 2010 dhe në vitin 2011 mori pjesë në projekte dypalëshe me Dhomën e Kontrollit të Gjeorgjisë dhe Dhomën e Llogarive të Republikës së Kyrgyzit për të dhënë dhe për të marrë eksperiencë dhe njohuri në përmirësimin e metodologjive të auditimit duke iu referuar standarteve ndërkombëtare të auditimit, gjithashtu për të lehtësuar përdorimin e praktikave më të mira gjatë auditimeve në partnerët e Institucioneve Suprenme të Auditimit. Në vitin 2007 Institucioni provoi një formë të re të bashkëpunimit dypalësh me anëtarët e tjerë të INTOSAI-t, auditimin paralel. Nga viti 2007 deri në vitin 2011 në bashkëpunim Dhomën e Llogarive të Federatës Ruse, Zyra Shtetërore e Auditimit zhvilloi katër udhime paralele.




Pjesëmarrja në INTOSAI dhe në aktivitete dypalëshe ka lehtësuar njohjen profesionale të Zyrës Shtetërore të Auditimit, por çka është më thelbësore i ka shërbyer zyrës të tregojë standartet e larta profesionale, respektin, kuptueshmërinë dhe përgjegjësinë kundrejt shtetit. Futja dhe mbështetja e dispozitave më të larta profesionale në operacionin e saj ka lehtësuar aftësinë për të prezantuar rezultatet e saj në nivel kombëtar duke treguar mangësitë kombëtare të menaxhimit financiar dhe përmes rritjes profesionale të zyrës së Auditimit Shtetëror të fuqizojnë të drejtat morale dhe të kërkojnë pajtueshmërinë me të njëjtat standarte të larta nga strukturat e auditimit.

### **Përpjekjet drejt sigurimit të interesave të shoqërisë**

Si një Organizatë Ndërkombëtare e cila ka unifikuar pothuajse 200 Institucione Supreme të Auditimit, INTOSAI kombinon përvojën e ndryshme historike, politike dhe gjithashtu eksperiencat kulturore të anëtarëve të saj. Puna e organizatave Rajonale të INTOSAI-t ka qenë dhe do të jetë model i lehtësimit të përvojave për çdo anëtar të veçantë të çdo organizate rajonale. Megjithatë çështjet në favor të pavarësisë dhe kapaciteteve profesionale të çdo anëtari të INTOSAI-t dhe interesat e shoqërisë, qëndrojnë përtej aktiviteteve të bashkëpunimit ndërmjet anëtarëve të INTOSAI-t.

Si Platforma më e lartë e jashtme për ndarjen e njohurive dhe praktikave më të mira ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit, INTOSAI përballet me sfidën dhe mundësinë e forcimit të rolit të anëtarëve në nivel kombëtar vitet e ardhshme. Ai do të bëjë të gjitha përpjekjet e mundshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë në çdo vend anëtarë. Duke vlerësuar shembullin më të njohur të viteve të fundit, miratimin e Rezolutës së 66 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuar, për promovimin e efikasitetit, efektivitetit, përgjegjshmërisë dhe transparencës së administratës publike duke forcuar institucionet supreme të auditimit, çdo Institucion Suprem Auditimi i është mirënjohës INTOSAI-t përmes kontributeve dhe përpjekjeve të përbashkëta të anëtarëve të INTOSAI-t dhe Sekretariatit të Përgjithshëm-me seli në Gjykatën Austriake të Auditimit- sepse ka lehtësuar dhe përkrahur formimin ndërkombëtar të parimeve bazë të cilat janë të rëndësishme për të gjithë anëtarët e INTOSAI-t. Dispozita dhe standarde të tilla themelore të miratuara në nivel ndërkombëtar mund të luajnë një rol të rëndësishëm për të rritur promovimin e vendimeve përkatëse në çdo vend të veçantë. Prandaj, funksioni i INTOSAI-t si instrumenti kryesor mbështetës për sigurimin e pavarësisë dhe kapaciteteve profesionale të anëtarëve të SAI-ve do të fuqizohen përmes promovimit ndërkombëtar të vendimeve në mënyrë për të forcuar rolin e INTOSAI-t si kujdestar dhe mbrojtjen e interesave të shoqërive të anëtarëve të saj.






## Kontribut nga SAI i Lihtejnshtajni-t

Cornelia Lang

Kryetare e Zyrës së Auditimit të Principatës së  
Lihtejnshtajni-t (Kontrolli Financiar  
Principata e Lihtejnshtajnit)

60 Vjet INTOSAI dhe  
50 Vjet Sekretariat i Përgjithshëm





## Kontributi i SAI-t të Lihtejshtajnit

Cornelia Lang

Kryetare e Zyrës së Auditimit të Principatës së Lihtejshtajni-t

(Kontrolli Financiar i Principatës së Lihtejshtajnit)

60 VJET INTOSAI DHE 50 VJET SEKRETARIAT I PËRGJITHSHËM

Përgëzime për këto dy jubile mbreslënëse:

60 Vjetori i INTOSAI-t dhe 50-vjetori i mbështetjes së Sekretariatit të Përgjithshëm!

Zyra e Auditimit të Principatës së Lihtejshtajnit i përket Institucionit më të vogël Suprem të Auditimit në organizatën profesionale të INTOSAI-t. Është shumë e rëndësishme për ne që të përfshiheshim në komunitetin e INTOSAI-t dhe rrjetit mbarëkombëtar të shkëmbimit të eksperiencave dhe për zhvillimin në vazhdimësi të standarteve për auditimin e qeverisë. Hyrja në thelbin e njohurive në auditimin e zonave tona specifike dhe mundësisë për të përfituar nga eksperiencia e institucioneve të mëdha të auditimit kanë qenë gjithmonë të vlefshme për ne. Shkëmbimi me kolegët nga e gjithë bota na ofrojnë prespektiva të reja dhe na japin stimuj të rëndësishëm për punën tonë.

Kur u përpunua baza ligjore për auditimet e qeverisë në Principatën e Lihtenshtajnit, Deklarata e Limës dhe e Meksikës ishin tekstet udhëzuese për punë autonome dhe të pavarur të institucionit tonë. Arritjet e INTOSAI në fushën e auditimit të pavarur të qeverisë nuk mund të nënvlerësohen dhe vlerësohen sa duhet! INTOSAI ka bërë vazhdimisht përpjekje, të cilat kanë rezultuar në Rezolutën e Kombeve të Bashkuara për Promovimin e efikasitetit, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, duke forcuar institucionet supreme të auditimit në fund të vitit 2011. Ky moment historik në historinë e INTOSAI i atribuohet iniciativës të palodhur dhe angazhimit të Sekretarit të Përgjithshëm, Josef Moser. Ky sukses i jashtëzakonshëm në forcimin e punës meriton respektin dhe vlerësimin tonë!

Përpjekjet e përbashkëta do të jenë të nevojshme për të ardhmen e INTOSAI-t dhe anëtarëve të Institucioneve Supreme të Auditimit në mënyrë që të insistojnë dhe të mbështesin kontrollin transparent të Qeverisë nga institucionet e auditimit. Vërtetësia dhe gjithëpërfshirja e kontrollit të qeverisë është themeli i punës tonë audituese dhe kontribon në mënyrë të konsiderueshme te besimi i qytetarëve në qeveri dhe në institucionet e saj.

Ekziston dhe nevoja për mbështetjen e administratës publike në futjen e proceseve ekonomike me mekanizma të integruar kontrolli, të cilat janë përmirësuar vazhdimisht. Një sistem funksional i kontrollit të brendshëm ndihmon për të shmangur gabimet dhe rrjedhimisht ka funksion parandalues. Auditimet dhe syzjerimet për përmirësim ndihmojnë të përmirësojnë efektivitetin e proceseve dhe kontrollit të brendshëm dhe ndihmojnë të parandalojnë gabimet, në këtë mënyrë reagojnë për të metat e institucioneve të auditimit që tregojnë gabimet vetëm pasi dëmi ka ndodhur.

Ne vetë jemi angazhuar për të njëjtat standarte të efektivitetit dhe efikasitetit që ne kërkojmë nga subjektet që ne auditojmë. Këto standarte aplikohen dhe për institucionet tona të auditimit dhe gjithashtu për organizatën tonë globale profesionale. Kjo është një sfidë e rëndësishme, e cila mund të jetë decisive për arritjet në të ardhmen tonë.



## EXPERIENTIA MUTUA OMNIBUS PRODEST

Ashtu si në 60 vitet e fundit, organizata jonë profesionale INTOSAI na ofron mjetin më të mirë që na ndihmon të plotësojmë në mënyrë të sukseshme detyrat tona të kërkuara në linjë me moton e INTOSAI-t. Si një koordinator midis anëtarëve dhe partnerëve të jashtëm, Sekretariati i Përgjithshëm meriton shumë lavdërime për mbështetjen e saj të shkëlqyer. Ne do të donim të falenderonim të gjithë audituesit tanë të përkushtuar të të gjitha vendeve anëtare, të cilët me punën e tyre kanë drejtuar shumë projekte dhe iniciativa të INTOSAI-t të cilat kanë sjellë përfitime për të gjithë.

INTOSAI dhe Sekretariati i Përgjithshëm mund të shohin mbrapa me krenari një të kaluar të kurorëzuar me sukses - ne u urojmë atyre më të mirat për të ardhmen!






## Kontribut nga SAI i Lituanisë

Giedre Svedine

Auditues i Përgjithshëm i

Zyrës Kombëtare të Auditimit të Lituanisë

20 Vjet me INTOSAI-n





## Kontribut nga SAI i Lituanië

Giedre Svedine

Auditues i Përgjithshëm i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Lituanië

Komiteti i Standarteve Profesionale (PSC) Anëtar

Komiteti i Ndarjes së Njohurive (KSC)

Nënkomiteti i Auditit të Pajtuëshmërisë

Nënkomiteti i Kontrollit të Standarteve

Nënkomiteti i Përgjegjshmërisë dhe i Raportimit

Grupi i Punës për Borxhin Publik

Grupi i Punës për auditimin e IT-së

Grupi i Punës për Auditimin e Mjedisit

Grupi i Punës për Programet e Vlerësimit

Grupi i Punës për indikatorët kryesorë kombëtar

## 20 Vjet me INTOSAI-n

*Pavarësia na hapi dyert e auditimit të jashtëm. Duke ardhur nga asgjëja, ne duhej të ndërtonim zyrën e auditimit, duke balancuar ambicjet me kapacitetet tona dhe duke inkuadruar vizionin tonë ditë pas dite. Fatmirësisht, INTOSAI ishte në kohën e duhur për të na ofruar ne eksperiencë, dije dhe inkurajim.*



Në 5 Prill të vitit 2012, Zyra Kombëtare e Auditimit të Lituanië (NAOL) festoi 22-vjetorin e rikrijimit, dhe kjo ishte periudha më e mirë për të takuar 5 nga Auditorët e Përgjithshëm, dhe gjithashtu për të kujtuar momentet më të rëndësishme të asaj periudhe të shkurtër.

22 Vjetori është një moshë e bukur për një institucion kur ju mund të gjeni njerëz që punojnë aty që nga fillimi dhe kur historia e një institucioni nuk është një libër shkollor me pluhur i ruajtur në një vend të sigurt dhe të shfletohet vetëm gjatë momenteve solemne, por konsiston në momentet e gjalla të kolegëve tanë, ambicieve të tyre,



arritjeve dhe pengesave.

Në të vërtetë ai nuk ishte një takim me dyer të mbyllura i 5 Audituesve të Përgjithshëm; ata erdhën të bisedojnë dhe të punojnë me njerëzit edhe me ata më të rinjtë të cilët kishin ardhur më pas dhe kishin njohur emrat dhe fytyrat e tyre vetëm nëpërmjet fotove të vendosura në rrjesht në mur të 12 Audituesve të Përgjithshëm që nga viti 1919, viti i themelimit i Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Duke punuar në 5 sesione, ne kujtuam momentet më të rëndësishme të historisë. Çuditërisht tema e INTOSAI-t ishte e lidhur disi në të gjitha sesionet, sepse në çdo kohë pavarësisht nga objektivat kryesore të Zyrës, INTOSAI gjithmonë shfaqet si mentori dhe kolegu jonë.

### **Hapat e parë**

Kazimeras Uoka ishte Audituesi i Parë i Përgjithshëm pas rikrijimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Lituaniës (21 Qershor 1990 -26 Qershor 1992): *“Si çdo revolucion kjo periudhë kërkon njerëz të fortë dhe të motivuar të cilët janë të gatshëm të rrezikojnë mirëqënien e tyre për interesat e vendit. Isha i lumtur të drejtoja këtë zyrë në atë kohë dhe me ata njerëz”.*

Restaurimi i pavarësisë së Lituaniës në 11 Mars të vitit 1990, kërkoi të ndërtoheshin institucione shtetërore për të mbështetur sovranitetin kombëtar. Ligjet e para të miratuara nga Parlamenti dhe Kushtetuta e Republikës së Lituaniës akoma duheshin të pranoheshin nga qytetarët e Republikës së Lituaniës në Referendumin e 25 tetorit 1992. Ligji për kontrollin e departamentit shtetëror u miratua në 31 Maj 1990 dhe krijoi mandatin për departamentin e ri të kontrollit të krijuar rishtazi dhe përcaktoi detyrat kryesore dhe përgjegjësitë.

Shumë gjëra duhej të bëheshin në vend dhe Zyra Kombëtare e Auditimit të Lituaniës duhej të vendoste në të njëjtin drejtim Institucionet Shtetërore në Lituani dhe Institucionet Supreme të Auditimit në botë. Kjo ishte koha e duhur për të aplikuar anëtarësimin në INTOSAI.

Tetori i vitit 1992 është një datë e rëndësishme në historinë e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Lituaniës- Në Kongresin e XIV të INTOSAI-t në Washington, aplikimi për anëtarësimin në INTOSAI u miratua dhe Departamenti Shtetëror i Kontrollit të Lituaniës u bë një anëtar i ligjshëm i Institucionit Suprem të Auditimit. 20- vjet me INTOSAI-n, kjo është një datë e rëndësishme për institucionin tonë.

Kur hapi i parë është bërë ti kupton se ka ardhur koha të ngrihesh dhe të ecësh. Audituesi i Parë i Përgjithshëm Kazimieras Uoka i kaloi mandatin Vidas Kundrotas, Audituesi i dytë i Përgjithshëm (4 janar 1993 -23 shtator 1999) . Qëllimi kryesor i zyrës ishte të siguronte një auditim me njohuri të plota dhe themelore.

Si anëtar i INTOSAI-t , Zyra Kombëtare e Auditimit të Lituaniës është integruar në mënyrë progresive në strukturat e INTOSAI-t: Në vitin 1994 u bë anëtar i Grupit të punës të INTOSAI-t për privatizimin dhe i Komitetit të Standarteve të Kontrollit të Brendshëm INTOSAI (sot Nënkomiteti i Standarteve të Kontrollit të Brendshëm ), në vitin 1995 u bë anëtar Komitetit të Borxhit Publik (sot, Nënkomiteti i Borxhit Publik).



Këto tre zona ishin shumë të rëndësishme për pavarësinë e Lituaniës – ne duhej të fillonim procesin e privatizimit dhe të siguroheshim që ky proces ishte në kontroll, koncepti i kontrollit të brendshëm dhe borxhi publik duhej të zhvilloheshin dhe integroheshin në kornizat qeverisëse të vendit.

Gjithashtu në vitin 1993 u bëmë anëtar i Grupit Rajonal të Punës EUROSAL, dhe kjo na lejoji të fokusoheshim në aktivitetet lidhur me Rajonin e Europës.

Gjatë takimit të Grupit të Punës të INTOSAI-t për Privatizimin i mbajtur në Londër në 14 Shkurt 1994, Zyra Kombëtare e Auditimit të Lituaniës u fut për herë të parë si një anëtar i ri i INTOSAI-t. Në kongresin e XV të INTOSAI-t në Kairo në vitin 1995 ne u ftuam për të moderuar temën *Standartet e Kontrollit të Brendshëm*. Në shtator të vitit 1997 gjatë konferencës së parë të organizuar nga Nënkomiteti për Standartet e Kontrollit të Brendshëm, Lituania u ftua për të bërë një prezantim Roli i SAI-ve në zhvillimin dhe mbështetjen e një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm, bazuar në informacionin e kontrollit të brendshëm ekzistues të shtetit, i marrë nga republika post-sovietike. Këto ishin vetëm disa nga hapat e rëndësishëm dhe të shpejtë që NAOL mori drejt një anëtarësimi të plotë dhe aktiv në INTOSAI.

## Rritja

Unë nuk jam në pozicionin për të interpretuar historinë e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Lituaniës, duke përcaktuar vizionin dhe rolet e kolegëve të mi në periudha të caktuara. Ndoshta është një koinçidencë që impakti i jashtëm përcakton drejtimin e NAOL dhe që Audituesit e Përgjithshëm ishin kapitenën në udhëheqjen e shpejtë dhe të sigurt të zyrës. Të gjithë ne jemi pjesë e historisë. Është më pak e rëndësishme se çfarë postesh na janë besuar dhe në çfarë periudhe kemi vepruar. Përgjegjshmëria për çfarë kemi për të bërë dhe si duhet ti bëjmë është gjithmonë rruga jonë. Ne jemi të lumtur të lëmë gjurmët tona, të cilat më vonë do të ishin një rrugë, një drejtim për të gjithë ata që do të vinë më vonë.

Janas Liaucius, Audituesi i Tretë i Përgjithshëm (9 shtator 1999- 4 shkurt 2005) mori drejtimin në një periudhë kur hyrja në Bashkimin Europian ishte prioriteti i parë i Lituaniës. Gjatë periudhës së para aderimit, vendi duhej të implementonte *acquis communautaire*-legjislacionin pranues dhe eksperiencën praktike të shteteve anëtarëve të BE-s. Për Zyrën Kombëtare të Auditimit ishte një tranzicion kalimi nga kontroll në auditim. Ishte një periudhë intensive e të mësuarit dhe INTOSAI ishte gati ta mbështetste atë.

Në vitin 2001 ne u bëmë anëtar të Komitetit të Standarteve Profesionale të INTOSAI-t dhe nën grupeve të tij, Komitetit të auditimit IT (sot Grupi i Punës për auditimin e IT), Grupi i Punës për Auditimin e Mjedisit, dhe Grupi i Punës për programet e vlerësimit. Më vonë ne iu bashkuam dhe Grupit të Punës për Indikatorët kryesorë Kombëtar.

Audituesit e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Lituaniës ishin pjesëmarrësit e parë të programit të trainimit IDI *Kursi i Projektit dhe Teknikat e zhvillimit dhe mësimi*, në vitet 2001-2002 dhe më vonë instruktorët e trajnimit të IDI-t morën pjesë për një kohë të gjatë në Programet e Trajnimit Rajonal duke asistuar në këtë mënyrë IDI-n të zhvillonte dhe shpërndante kurset e trajnimit në rajone të ndryshme të INTOSAI-t.



## Pjekuria

Pasi Lituania iu bashkua Bashkimit Europian në 1 Maj 2004, prioritetet e vendit ishin integrimi europian politik dhe ekonomik. Rasa Budbergyte, Audituesja e katërt e Përgjithshme (2 shkurt 2005-15 prill 2010), erdhi me misionin për të zhvilluar auditimin e vlerës së parasë i cili ishte akoma në hapat e parë në atë kohë. Kjo kërkonte njohuri, dhe një pjesëmarrje aktive në INTOSAI ose në eventet e EUROSAT-t.

Ne u përpoqëm të ishim shumë aktiv dhe ne ia dolëm mbanë: në Maj të vitit 2005 në Kongresin e VI të INTOSAI-t në Bonn, Rasa Budbergyte U zgjodh zëvendës Presidente e Bordit Qeverisës EUROSAT.

Nje prioritet tjetër i zyrës ishte të mikëpriste sa më shumë evente ndërkombëtare. Në vitin 2005 ne pritëm një seminar trajnimi për IT-n e qeverisë dhe çështjet e auditimit të SAI-ve për kontrollin i IT me 32 përfaqësues nga 16 vende anëtare të EUROSAT-t.

Workshopi i Implementimit të praktikave cilësore të Auditimit u zhvillua në Vilnius në vitin 2006, seminari i Standarteve të Auditimit Financiar u zhvillua në 2008. Në vitin 2011 ne pritëm Takimin e Përvitshëm të Grupit të Punës së INTOSAI-t për Borxhin Publik.



Në vitin 2008 Iniciativa për zhvillim e INTOSAI-t lançoi një Program për Ngritjen e Kapaciteteve Transrajonal për Auditimin e Menaxhimit të Borxhit Publik 2008-2011 dhe ne ishim pjesëmarrës aktiv të këtij programi.



Vizita e parë e përfaqësuesve të Zyres Kombëtare të Auditimit të Lituanië tek SAI-et e tjerë - Ne u ftuam të moderonim seminarin e vet-vlerësimit të Teknologjisë së Informacionit në Letoni (2005), në Federatën Ruse (2005) dhe në Ukrainë (2006).

Unë kam qenë Audituesi i pestë i Përgjithshëm që nga 15 Prill 2010 dhe vizioni im është që të forcohet integrimi i Zyres Kombëtare të Auditimit të Lituanië në INTOSAI, të jetë një anëtare aktive dhe të ndajë njohuritë tona me anëtarët e tjerë të komunitetit.

Unë e konsideroj Marrëveshjen bashkëpunuese me Dhomën e Kontrollit të Gjeorgjisë të nënshkruar në 2011 si shumë të rëndësishme për mua, meqenëse audituesit tanë do të vijnë të ndihmojnë kolegët tanë nga ky vend i ngrohtë dhe miqësor. Ne jemi gjithashtu bashkëpunues në Shqyrtimin e Kolegëve në Zyrën më të Lartë Audituese në Poloni që do të thotë se njohuritë tona dhe eksperiencia vlerësohet.

Si pjesë përbërëse e këtij konteksti nënvizohet objektivi i forcimit institucional, organizues dhe i kapaciteteve profesionale të SAI-t. Ndërtimi i këtyre kapaciteteve do të mundësojë që SAI të ushtrojë në mënyrë efektive rolin që ka në lidhje me auditimin publik.



Në qoftë se pavarësia e SAI-t kërkohet nga natyra e auditimit publik, ngritja e kapaciteteve të auditimit efektiv përballet me një vështirësi të veçantë dhe kompleksitet që mund të kapërcehen vetëm nëpërmjet një procesi të gjatë, të vazhdueshëm, një kontrolli efektiv dhe interaktiv që duhet vazhdimisht të përmirësohet.

Cilat kapacitete duhen ndërtuar dhe cilat auditime janë për SAI-n

Evoluimi i teknologjisë dhe sistemeve të menaxhimit të shërbimeve publike bëjnë të mundur zhvillimin e punës dhe metodikave investiguese, si dhe kapaciteteve analitike të SAI-t. SAI-t duhen pajisur mjaftueshëm në mënyrë që të luajnë rolin që kanë, jo vetëm në kushtet e rregullshmërisë dhe përputhshmërisë për transaksionet financiare, por edhe në termat ekonomike, efektive dhe përdorimit fitimprurës të burimeve publike.

Në fakt, për ndërtimin solid, të përgjegjshëm, ligjor dhe auditim financiar të përputhshëm, është thelbësore vendosja e një auditimi që lejon një vlerësim dhe matje performance lidhur me operacionet dhe projektet të kryera nga institucionet publike.

Megjithatë, duhet theksuar që zhvillimi i auditimit të performancës nga SAI duhet kryer gradualisht dhe adoptuar në nivel të zhvillimit të institucioneve, në veçanti dhe zhvillimit ekonomiko-social dhe politik në përgjithësi.

Kështu që SAI-t në vende me ekonomi të zhvilluar duhen përmirësuar më shumë me një vizion të gjerë dhe të saktë mbi rezultatet e menaxhimit të institucioneve publike. Në këtë kontekst, është gjithashtu e nevojshme që zhvillimi i auditimit të performancës të bëhet një objektiv parësor për këto institucione dhe se hapja duhet bërë në një mënyrë ekuivalente me auditime që lidhen me disiplinën, siç është menaxhimi i riskut dhe auditimi strategjik, të cilat po bëhen vendimtare në mjedise që ndryshojnë në mënyrë të vazhdueshme.

SAI-t e vendeve në zhvillim duhen të konsolidojnë arritjet e tyre dhe eksperiencën në drejtim të auditimit financiar të rregullshmërisë dhe përputhshmërisë. Ato duhet gjithashtu të përmirësojnë auditimin e performancës i cili ka me shumë gjasa të promovojë një menaxhim të financave publike efektiv dhe të shëndoshë.

Si përfundim, për SAI-t e vendeve në zhvillim, është e rëndësishme të zhvillohet së pari një auditim efektiv e rregullator dhe përputhshmërisë e cila është një parakusht për zhvillimin e një kulture kontrolli dhe llogaridhënie brenda institucioneve publike. Ky auditim mbetet thelbësor për kontrollin dhe gjurmimin e lëvizjeve financiare. Kjo është e vetmja mënyrë që SAI-t të zhvillohen gradualisht drejt një auditimi të gjerë, siç është auditimi i performancës.

Gjithashtu, duhet nënvizuar fakti që arritjet e auditimit të performancës nuk varen detyrimisht nga krijimi e një kornize paraprake të zhvilluar mirë nga ana konceptuale, organizative dhe procedurale. Në fillim duhen matur ambiciet, qasjet fleksibile dhe implementimi gradual.

Mënyrat e ndërtimit të kapaciteteve

Ndërtimi i kapaciteteve nuk duhet konsideruar si një proces teknik që përfshin një transfertë të thjeshtë njohurish apo një prototipi organizues por duhet konsideruar konteksti dhe mjedisi në të cilin ushtron detyrën SAI.



Shanset në ndërtimin me sukses të kapaciteteve janë më të mëdha kur bëhet fjalë për një program endogjen apo të brendshëm të SAI-t, sepse kontribuon në qëndrueshmërinë e tij. Megjithatë, për disa SAI, sfida për ndërtimin e kapaciteteve është shumë e madhe saqë mund të nevojitet ndihmë e jashtme. Patjetër që një ndihmesë e tillë nuk duhet të kompromentojë pavarësinë e institucionit.

Në këtë kuadër ndërtimi i Komitetit për Ndërtimin e Kapaciteteve (CBC) në nivel INTOSAI është i domosdoshëm. Përmes përpjekjeve dypalëshe dhe rajonale, ky komitet punon për të siguruar që çdo anëtar i INTOSAI-t mundet që, bazuar në nevojat që ka, të përfitojë nga iniciativat për ndërtimin e kapaciteteve, për forcimin e pavarësisë dhe profesionalizmit.

Implementimi i procesit të një ndërtimi të përshtatshëm kapacitetesh varet kryesisht në arritjet e disa kushteve bazë, të cilat janë si më poshtë:

1. Forcimi i pavarësisë së SAI-t: Një Institucion Suprem Auditimi i pavarur duhet të sigurohet me asetet e nevojshme si nga ana institucionale ashtu dhe në nivel profesional.
2. Forcimi i statusit institucional të SAI-t: Ndhmon në qartësimin e statusit të SAI-t dhe marrëdhëniet e tij me institucione të tjera kushtetuese, në mënyrë të veçantë me Qeverinë dhe Parlamentin
3. Rekrutimi i një stafi të kualifikuar: Cilësia e stafit i cili do të kryejë auditime, në veçanti auditime performance , është një element kyç drejt suksesit. Meqënëse auditimi mbulon fushat e ndërhyrjes së institucioneve publike dhe një mori aspektesh të menaxhimit të tyre, profili dhe kompetencat e stafit të SAI-t duhet të reflektojnë këto diversitete. Rekrutimi i një stafi të kualifikuar duhet kompletuar me anë të trajnimeve fillestare në shumë fusha dhe aspekte të auditimit dhe një trajnim të vazhdueshëm për të siguruar përditësimin e teknikave dhe kompetencave.
4. Ekzekutimin e një udhëheqje efektive dhe profesionale të SAI-t, kryesisht duke zhvilluar dhe implementuar plane strategjike dhe gjithëpërfshirëse. Këto plane duhet të jenë të përshtatshme me reformat në vazhdim e sipër të një



Takimi i Komitetit Drejtues të Ndërtimit të kapaciteteve (CBC)  
Rabat, Marok, shtator 2007

shteti, në terma të menaxhimit financiar publik sipas praktikave më të mira (P.sh. Standartet dhe manualët e zhvilluara nga INTOSAI)

5. Forcimi i marrëdhënieve me palët e interesuara: Në mënyrë që të jetë efektiv, SAI duhet që, për sa kohë mandati ja lejon, të krijojë marrëdhënie të ngushta me palët e interesuara, por duhet të mbajë, në të njëjtën kohë, pavarësinë e tij nga Parlamenti, Qeveria, entet e auditimit, media, opinionin publik, shoqëria civile etj.

Kushtet për të kompletuar procesin për ndërtimin e kapaciteteve

Një implementim i suksesshëm për ndërtimin e kapaciteteve kërkon një mbështetje politike, një rregullore të përshtatshme, një udhëheqje dhe një përfshirje aktive nga kryetarët e SAI. Të gjithë këto faktorë duhet të punojnë sëbashku për sigurimin e një financimi të përbashkët dhe në kërkimin e partnerve që mundësojnë forcimin e kapaciteteve në institucionet e tyre.



Ndërtimi i kapaciteteve duhet të mundësojë që SAI të përdorë me mirë kapacitetet egzistuese dhe të krijojë të reja në nivel profesional, organizues dhe institucional. Kjo përfshin një vlerësim të përshtatshëm të nevojave dhe të krijimit të një sërë aksionesh të domosdoshme për këtë proces.

Megjithatë, duhet theksuar që suksesi i procesit të krijimit të kapaciteteve kërkon një angazhim të vetë SAI në një anë dhe nga ana tjetër të komunitetit europian. Ky angazhim i dyfishtë është konfirmuar nga dy aksione të rëndësishme të kryera prej INTOSAI-t:

1. Ndërgjegjësimi i SAI-t mbi nevojën për rritje të kapaciteteve profesionale dhe institucionale. Ndërtimi profesional duhet bazuar tek një platformë institucionale. Deri tani, niveli i kapacitetit të arritur nga çdo SAI varet kryesisht tek përmbushjet e objektivave fikse. Kapacitetet e SAI-t nuk maten vetëm me anë të parimeve ligjore apo provigjioneve të përcaktuara në terma absolut por duhen gjithashtu trupëzuar me praktika të mira, pa të cilat do të ishte thjeshtë deklarata qëlimesh. Bazuar në sa më sipër, rëndësia e aksioneve që duhen marrë për rritjen e përgjegjësisë të SAI-t në interes të forcimit të kapaciteteve institucionale bëhet e dukshme.

Kjo implikon një ndryshim në qëndrim dhe në kulturën e auditimit brenda SAI-t, në motivimin e stafit dhe në angazhimin e liderave të tyre.

2. Strategjia e partnershipit global me donatorë dhe në promovimin e ndërtimit të kapaciteteve në përfshirjen e donatorëve në financimin e SAI-t për programet e zhvillimit dhe modernizimit: Për këtë qëllim është nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit nga donatorët e INTOSAI-t (tetor 2009 në Bruksel). Ky memorandum ofron mundësi shtesë për mbështetjen financiare për projektin e ndërtimit të kapaciteteve nga komuniteti i donatorëve. Kjo përfshin matjet që përforcojnë statusin institucional të SAI-t, përmirëson mjetet financiare dhe materiale, menaxhon burimet e tyre, vendos një plan strategjik, përmirëson metodat e punës (manuale auditimi dhe sisteme informacioni) dhe siguron trajnime për audituesit.

## Konkluzione

Zhvillimi i auditimit publik dhe kapacitetit të SAI-ve duhet të kalojë shumë faza, në kontekstin që nxit pavarësinë dhe profesionalizmin e këtyre institucioneve.

Kjo është padyshim një iniciativë madhore që në të njëjtën kohë harxhon burime.

Përsa më sipër, është e nevojshme që SAI të adoptojë një qasje progresive që përfshin një implementim gradual për një auditim të zhvilluar. Ky proces duhet të kryhet në një shkallë të arsyeshme, me objektiva specifike dhe me një lidhje perfekte me burimet dhe forcën e punës së çdo SAI. Kjo gjë do të sjellë që, që në fillim të procesit SAI-t do të identifikojnë dhe përcaktojnë nevojat dhe objektivat, si dhe mjetet e nevojshme për të patur sukses në misionin e tyre. Gjithashtu duhet të jenë në gatishmëri për të përballuar ndryshimet e vazhdueshme në mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm dhe zhvillimin e një kulture të llogaridhënies dhe etikës profesionale e cila është një garanci premtuese për sukses.

Për me shumë informacion për komitetin për rritjen e kapaciteteve, udhëzuesit dhe burime të tjera, ju lutem vizitoni faqen e internetit <http://cbc.courdescomptes.ma>






## Kontribut nga SAI i Hollandës

Saskia J. Stuiveling

Presidenti i Gjykatës së Auditimit të Hollandës

Intosai: nga Rritja e Përfitimeve të SAI-t

Përfitojnë të Gjithë Qytetarët





## Kontributi nga SAI i Hollandës

*Saskia J. Stuiveling*

*Presidenti i Gjykatës së Auditimit të Hollandës*

*Komiteti i Standarteve Profesionale (PSC)*

*Anëtar*

*Komiteti i Ngritjes së Kapaciteteve (CBC)*

*Komiteti i Transferimit të Njohurive (KSC)*

*Nënkomiteti i Auditimit të performancës*

*Nënkomiteti i Standarteve të Kontrollit të Brendshëm*

*Grup i Punës për Auditimin Mjedisor*

*Grup i Punës për përgjegjshmërinë dhe auditimin e rasteve të ndihmës në lidhje me fatkeqësitë.*

*Grup i Punës për Modernizimin Financiar dhe Reformën Rregullatore*

*Nënkomiteti 1: Promovimi në Rritje i Aktiviteteve për Ndërtimin e Kapaciteteve brenda anëtarëve të INTOSAI*

*Komiteti Drejtues i (CBC)*

*Vëzhgues*

## **INTOSAI: NGA RITJJA E PËRFITIMEVE TË SAI-T PËRFITOJNË TË GJITHË QYTETARËT**

INTOSAI u themelua në vitin 1953 nga një grup SAI që dëshironin të mësonin prej njëri tjetrit. Atyre iu bashkuan dhe SAI të tjerë gjatë viteve në vazhdim dhe grupi ynë tashmë ka arritur numrin 191 anëtarë. Duke parë prapa, mund të shohim që INTOSAI ka ndryshuar nga viti në vit nga një organizatë që, me gjithë respektin, ishte e interesuar para së gjithash tek vetëvetja në një organizatë që kërkon lidhje të vazhdueshme kudo në botë. Lavdia paraprake për kurorëzimin e këtij procesi: kalimi i rezolutës nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara mbi rolin e pavarësisë së SAI-ve në promovimin e një efëcence më të madhe, llogaridhënie, efektiviteti, transparence dhe një përdorimi të fondeve publike në dobi të qytetarëve. Përgëzime për qëllimet e arritura! Përgëzime veçanërisht për Sekretariatën e INTOSAI-t dhe për Sekretarin e Përgjithshëm z. Josef Moser, i cili padyshim ka harxhuar shumë energji për pranimin e OKB-së.

Shumë prej nesh pranojnë nevojat për t'i dhënë drejtim organizatës sonë, të promovojë rëndësinë e SAI-ve dhe në menyrë të veçantë të përgjigjemi më mirë se çfarë po ndodh rreth nesh. Sekretari i Përgjithshëm ka luajtur dhe luan një rol të jashtëzakonshëm në arritjen e këtyre ambicieve; në të vërtetë, disa Sekretarë të Përgjithshëm Austriakë kanë punuar shumë në këtë fushë. Pa ata, ne nuk do ishim aty ku jemi tani.



Është shumë kohë, por INTOSAI ka evoluar në më shumë se një SAI i përbashkët. Dhe ne, si anëtarë, gëzojmë nga të mirat çdo ditë: ne ndajmë njohuritë tona me njëri-tjetrin. Në qoftë se mendojmë se ndonjë shtet tjetër mund të na ndihmojë për ndonjë problem tonin, kërkojmë partnerë, zhvillojmë së bashku strategjitë, mesojmë nga njëri-tjetri, mundohemi të operojmë në mënyrë sa më efektive për të mirën e shoqërisë dhe ndonjëherë kryejmë auditime të përbashkëta përtej kufijve. Në mënyrë të veçantë në dhjetë-vjeçarin e kaluar kontaktet janë intensifikuar, duke e thjeshtësuar disi me anë të përdorimit të internetit. Ku do ishim sot nëse nuk do egzistonin faqet e internetit apo e-maili?

Përpjekjet e përbashkëta janë pasqyruar nga shembuj të vlefshëm: kemi punuar bashkë për të ndarë fondet globale për tsunamin, kemi bashkuar focat për të audituar dhe krahasuar pasojat buxhetore të krizës së kredive në një numër të madh vendesh dhe për të analizuar mashtrimin ndër-kufitar të TVSH-së. Asnjëri prej nesh nuk mendon se pavarësia jonë është kompromentuar në ndonjë mënyrë.

Tani ka ardhur momenti për hapin tjetër. Me rezolutën e OKB-së që na mbështet, është koha që ti hedhim një sy çfarë ndodh rreth nesh. Duhet të mendojmë se si mund të përmirësojmë rolin tonë në INTOSAI. Zhvillimet e fundit në mjedisin global kanë vënë në pah nevojën për t'u bërë një organizatë ndërkombëtare. Pyetja kyçe tani është: *Cfarë zhvillimesh globale mund të identifikojmë dhe si mund ti ngreme ato si SAI?*



Çështjet ndërkombëtare si hiri vullkanik, smogu i lëshuar nga mega zjarret e pyjeve, mbeturinat që hidhen në oqeanë, karburantet që derdhen dhe ndotjet nga uji që përdoret për ftohjen nukleare, janë në rritje të vazhdueshme dhe duhet të jenë në axhendën tonë. Tani për tani nuk ka një legjislacion për këto çështje . Siç ka thënë dhe Hugo Grotius në vitin 1609: *“Deti është prona e të gjithëve. Ai përfaqëson jo vetëm një fushë të ligjit, por gjithashtu një interes të përbashkët me një përgjegjësi të përbashkët”*

Deri më sot, ne kemi dizenuar një axhendë ndërkombëtare me një bazë *ad-hoc*. Ne kemi krijuar task-forca dhe grupe pune që të adresojmë këto çështje siç është kriza financiare që preku shumë vende. INTOSAI ende nuk ka kapacitetin për të trajtuar çështje të tilla të cilat shtrihen më gjerë se një vend i caktuar. Ne akoma nuk bëjmë auditim global. Çështjet globale duhen audituar globalisht. Ne duhet të braktisim


idenë që më mirë të përballojmë problemet si individualistë. Duhet të ecim përpara duke bërë auditime të paërbashkëta brenda kuadrit institucional të INTOSAI-t.

Kjo gjë, që në pikpamjen tonë është një ndryshim i pëlqyeshëm, është brenda mundësive tona dhe mund të zhvillohemi nga një organizatë kombëtare e përbashkët në një organizatë e cila punon në trajta të ndryshme për auditime ndërkombëtare. SAI kombëtar do të mbetet një institucion autonom por INTOSAI vëtë do të jetë një institucion global,



me një axhendë të tijën për çështjet globale. Nëse sjellim këtë transformim, INTOSAI do të jetë më shumë se një bashkësi SAI individuale. E gjithë kjo do të jetë shumë më e madhe sesa një shumë e pjesëve përbërëse: një institucion me objektiva dhe strategji, që mbledh dhe ndan njohuritë, që punon për një program që ka një prezencë kuptimplotë. INTOSAI do të shërbejë më mirë shoqërisë nëse artikulon çështjet dhe risqet e përfshira dhe të jetë e hapur për të ndarë njohuritë. Atëhere do të jemi një institucion modern, i ndjeshëm në zemrat e shoqërisë. Duke vepruar me transparencë me njohuritë e mbledhura, do të jetë një institucion me autoritet.


Në vizionin tonë për transformimin e INTOSAI-t, Sekretariati i Përgjithshëm, luan një rol deçiziv. Jemi të bindur që jemi në rrugën e duhur në procesin e evolucionit nga një grup relativisht konservator në një institucion modern që nuk është i kufizuar nga kufij gjeografik, Së bashku, ne duhet të bindemi që, me mbështetjen e bordit dhe Sekretariatit të Përgjithshëm ne po guxojmë të bejmë hapin për t'u bërë një institucion global. Është shumë e nevojshme për të përmirësuar reputacionin tonë të mirë dhe për t'u bërë të dobishëm për të gjithë qytetarët.





## Kontribut nga SAI i Zelandës së Re

Shoqata e Institucioneve  
Supreme të Auditit të Paqësorit







## Kontributi nga SAI i Zelandës së Re

*Sekretariati i Përgjithshëm: PASAI*

*Komiteti i Standarteve Profesionale (PSC) ..... Anëtar*

*Komiteti Drejtues i (PSC)*

*Komiteti i Transferimit të Njohurive (KSC)*

*Nënkomiteti i Kontabilitetit dhe Raportimit*

*Grup i Punës për Auditimin Mjedisor*

*Grup i Punës për Faktorët Kyç të Indikatorëve Kombëtar*

*Grup i Punës Për Vlerat dhe Përfitimet e SAI-t*

*Komiteti Drejtues i INTOSAIT për Bashkëpunimin me Donatorët*

## SHOQATA E INSTITUCIONEVE SUPREME TË AUDITIT TË PAQËSORIT

Hyrje

SAI-t kanë një rol kyç në promovimin e llogaridhënies dhe transparencës në qeverisjen publike të një shteti. Shoqata e Paqësorit të Jugut e Institucioneve Supreme të Auditit (SPASAI), siç u njoh dhe më vonë, u krijua për të inkurajuar, promovuar dhe për të avancuar bashkëpunimin midis anëtarëve në fushën e auditimit publik, SPASAI u pranua formalisht si anëtare e INTOSAI në vitin 1987 dhe në vitin 2008 u njoh si PASAI. PASAI tani ka 25 anëtarë në rajonin e paqësorit dhe përfaqësohet në INTOSAI nga Sekretari i Përgjithshëm, Kontrollori dhe Audituesi i Përgjithshëm i Zelandës së Re.

SAI i paqësorit njeh rëndësinë e llogaridhënies publike për përdorimin e fondeve të qeverisë, rolin e legjislaturës dhe rëndësinë e SAI në arritjen e kësaj llogaridhënie. Këto mund të kontribuojnë në përmirësimin e performancave ekonomike dhe zhvillimin e vendeve të paqësorit. Objektivi i përgjithshëm i PASAI-t është promovimi i transparencës, llogaridhënies, efektivitetit dhe përdorimit eficient të burimeve të sektorit publik në rajonin e paqësorit. PASAI kontribuon tek këto objektiva duke ndihmuar anëtarët për përmirësimin e cilësisë në auditimin e sektorit publik duke rritur standartet, të cilat priten të përmirësojnë transparencën dhe llogaridhënien në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike.





## EXPERIENTIA MUTUA OMNIBUS PRODEST

PASAI është i mandatuar:

- Të përforcojë mirëkuptimin, bashkëpunimin dhe koordinimin midis anëtarëve të tij
- Të mbrojë interesat e një qeverisje të mirë, duke përfshirë transparencën, llogaridhënien dhe nevojën për një SAI të fuqishëm dhe të pavarur, të qeverive në rajonin e paqësorit
- Të ndërtojë kapacitetin e një auditimi publik në rajonin e paqësorit duke ndarë njohuritë dhe duke mbështetur anëtarët e tij
- Të asistojë anëtarët e tij për të kryer funksionet e auditimit duke përfshirë auditime bashkëpunuese dhe aktivitete të ngjashme
- Të shërbejë si një grup pune rajonal i INTOSAI-t, në interes të të gjithë SAI-ve në rajonin e paqësorit
- Të inkurajojë bashkëpunimin me grupe të tjera pune rajonale

PASAI ka marrë mbështetje financiare nga një grup i madh donatorësh, në veçanti nga Banka Aziatike për Zhvillim dhe AusAID në fillim, e më pas nga Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Tregëtisë e Zelandës së Re dhe nga Banka Botërore



Kongresi i 15th PASAI në  
Noumea, New Caledonia,  
2012



Auditimi publik në rajonin e paqësorit përballlet me shumë sfida. Kapacitetet e burimeve njerëzore janë të kufizuara, me mungesa të stafit të kualifikuar dhe vështirësira në tërheqjen dhe mbajtjen e stafit. Llogatitë publike janë shpesh jo të audituara me standarte të larta në kohën e duhur dhe legjislacioni nuk vepron gjithmonë sipas rekomandimeve. Si



shtesë, llogaritë nuk prodhohen për auditim. SAI-t e paqësorit janë në stadi të ndryshme zhvillimi dhe për disa ka ende shumë gjëra për të bërë që të arrihen standarde të larta.

#### Iniciativa Rajonale e Paqësorit për Auditim

PASAI është shumë ambicioze në përmirësimin e standardeve të auditimit të sektorit publik në rajonin e paqësorit dhe, në 2009, në Kongresin e Palau, adoptoi Iniciativa Rajonale e Paqësorit për Auditim, një program katër vjeçar i hartuar për të adresuar sfidat që përballen nga standartet e shumëfishta të auditimit publik në zonën e paqësorit. Kjo iniciativë u zhvillua pas një procesi konsultimi të gjerë për një periudhë dy vjeçare, nën udhëzimet e PASAI dhe anëtarëve të tij dhe në bashkëpunim të ngushtë me Forumit të Liderave të Ishujve të Paqësorit.

#### Produktet e kësaj iniciativës PRAI janë:

- Ndërtimi dhe mbështetja e auditimit publik
- Drejtimi i bashkëpunimit për auditimet financiare dhe të performancës
- Zhvillimi i komunikimit dhe përkrahja e transparencës dhe llogaridhënies
- Asistimi i bashkëpunimit dhe koordinimit rajonal

PRAI pa vendosjen e Sekretarisë së PRASAI, me bazë në Auckland Zelandë e Re në 2010 dhe veçoi progrese të rëndësishme në:

#### 1) Ndërtimi i kapaciteteve

Katër manuale (mbi menaxhimin e burimeve njerëzore, sigurimit të kualitetit, auditimit të performancës dhe raportimit) janë publikuar dhe ndërtuar për programin e trajnimit të PASAI, i cili është në dispozicion të të gjithë anëtarëve të PASAI-t dhe anëtarëve të tjerë rajonalë të INTOSAI-t. Manuali i auditimit AFROSAI u adoptua në tetor të vitit 2012 në Kongresin e Noumea dhe do të shërbejë për trajnimet e vitit tjetër. Menaxhimi strategjik dhe udhëzimet për veprimet po zhvillohen më tej. Një numër prej 101 stafi auditimi nga 17 shtete të paqësorit u trajnuan nga programet e trajnimit të PASAI-t në dy vitet e fundit dhe do vazhdojnë dhe në të ardhmen të trajnohen në nivel rajonal dhe kombëtar.

#### 2) Auditime performance bashkëpunuese

PASAI ka kryer tre auditime performance bashkëpunuese të bazuara në udhëzimet e grupit të punës mbi auditin mjedisor:

- Menaxhimin e mbetjeve inerte
- Akses në ujë të pijshëm
- Dhe menaxhimin e qëndrueshëm për peshkimin e tonit

Një auditim i performancës i katërt rajonal mbi adaptimin e ndryshimeve klimaterike dhe rrezikut të katastrofave filloi në Nëntor 2012. Këto auditime bashkëpunuese janë arritje të mëdha për rajonin e Paqësorit të cilat janë marrë nga rekomandimet e një numëri të madh vendesh.

#### 3) Llogaridhënia dhe transparenca

Në tetor të vitit 2012 kongresi i PASAI miratoi raportet më të fundit nga PASAI mbi llogaridhënien dhe transparencën në rajonin e Paqësorit. Ky raport identifikoi një numër praktikash pozitive në rajon. Kongresi inkurajoi përdorimin e



raporteve të transparencës dhe llogaridhënies (2009 dhe 2011) në të gjitha nivelet për të përimrësuar rezultatet e qeverisjes në vendet e paqësorit.

### **E ardhmja**

PRA kishte efekte pozitive mbi kapacitetet dhe zhvillimet e SAI-ve dhe matjet e vazhdueshme kryhen për vlerësimin e efekteve më të gjera të programit PRAI. PRAI duhet të vlerësohet nga PASAI dhe partnerët e tij të zhvillimit përpara mbarimit të viteve 2012/2013. Ky vlerësim është hapi i mëtejshëm për të zhvilluar një strategji të re për mbështetjen e punës së PASAI në periudhë afatgjate si në nivel rajonal dhe në atë individual për çdo SAI dhe sistemet respektive të çdo vendi.

PASAI është themeluar sipas strukturës së INTOSAI-t. Me inkurajimin e liderave tanë ndërkombëtarë dhe partnerve për zhvillim, PASAI po vazhdon përpjekjet individuale dhe kolektive për të përmirësuar auditimin publik dhe qeverisjen në paqësor.

INTOSAI ka moton Experientia Mutua Omnibus Prodest që do të thotë Eksperienca e përbashkët i shërben të gjithëve e cila përshkruan me vend parimet e bashkëpunimit dhe ndërtimit të kapaciteteve që formojnë programin e PRAI të PASAI-t dhe të cilat kanë parë zhvillim të rëndësishëm në auditimin publik në rajonin e paqësorit.


### **Komente përmbyllëse**

PASAI përgëzon INTOSAI-n për përvjetorin e 60 të krijimit të saj dhe Sekretariatit të Përgjithshëm për përvjetorin e 50-të. PASAI i shpreh falenderime të sinqerta kombeve anëtare të INTOSAI-t, Sekretariatit të Përgjithshëm dhe Iniciativës për Zhvillim për mbështetjen dhe kontributin e dhënë në auditimin publik të rajonit të paqësorit.



## Kontribut nga SAI i Paraguajit

Eksperiencat e Arritura nga SAI i Paraguajit  
si Anëtare e INTOSAI-t Sfidat dhe  
Objektivat për të Ardhmen





## Kontributnga SAI i Paraguajit

*Anëtar i Komitetit të Transferimit të Njohurive (KSC)*

*Grup i Punës për Auditimin Mjedisor*

### **EKSPERIENCAT E ARRITURA NGA SAI I PARAGUAJIT SI ANËTARE E INTOSAI-t**

#### SFIDAT DHE OBJEKTIVAT PËR TE ARDHMEN

Organizata e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) është organizata qendrore për auditimin e jashtëm të qeverisë. INTOSAI u themelua në vitin 1953, kur 34 SAI dhe organizata partnere u takuan në një kongres në Kubë për herë të parë. INTOSAI ka tani 191 anëtarë të plotë dhe 4 anëtarë të bashkuar. Në prag të themelimit të INTOSAI-t, u ndërtua një strukturë institucionale për të garantuar transparencën për të rritur njohuritë e anëtarëve të INTOSAI-t dhe për të sjellë auditimin publik të qeverisë në një nivel të njëtrajtshëm, duke forcuar kështu pozicionin e saj, mandatet dhe prestigjin e çdo SAI në vendin e tyre. Forcimi i SAI-t siguron gjithashtu një auditim publik që ecën përpara drejt objektivave të rinj.



Zyra e Kontrollorit të Përgjithshëm të Republikës së Paraguajit

Pas rrëzimit të një diktature të gjatë në 1989, zhvillimi politik dhe social i Paraguajit pësoi ndryshime të mëdha, të cilat evoluan në mënyre progresive gjatë kalimit të viteve. Në këtë kohë, filloi një periudhë premtuese për hapjen drejt demokracisë, duke shkaktuar kështu masa të mëtejshme drejt reformave dhe duke modernizuar iniciativa dhe dhe procese të ndryshme. Hap pas hapi, këto ndryshime u implementuan për të arritur këto qëllime. Edhe pse eksperiencat dhe njohuritë nuk ishin në kohë për vendin, ato kontribuan në një proces demokratizimi, të cilat ishin të perceptueshme për vendin. Përfundimisht, në vitin 1992 hyri në fuqi kushtetuta e re e vendit, e cila mishëroi parimet demokratike dhe thelbësore të lirisë.



Arritjet që rezultuan nga zhvillimet e reja në vend u depolitizuan nga forcat ushtarake dhe policore, përtëritja e Gjykatës Supreme dhe themelimi i Kontrollit të Përgjithshëm Shtetëror (CGR).

Këto detyra dhe përgjegjësi të CGR Paraguaj janë të përcaktuara në ligjin Nr 276/94. Për këtë arsye CGR vepron si një organ kontrolli për aktivitetet financiare dhe ekonomike të shtetit, autoritetet dhe bashkitë. Misioni i CGR është promovimi i menaxhimit të transparencës të pronësive publike duke kryer kontrole auditimi me qëllimin e mirëqënies së qytetarëve. Vizioni i CGR është të ketë një rol kryesor si një organ kontrolli dhe të gjejë zgjidhje të përshtatshme për menaxhimin e fondeve publike. SAI i Paraguajit numëron 700 nëpunës civil, pozicionet kryesore mbahen nga Kontrollori dhe Nën-Kontrollori, të cilët zgjidhen nga Kongresi Kombëtar dhe ushtrojnë detyrat e tyre për 5 vjet.

Boshti qendror i aktiviteteve të CGR pjesërisht është pjesë e makro-procesit të auditimit të qeverisë. Ky proces u zhvillua nga autoritetet e ndryshme që ju besua auditimi i të gjitha njësive publike dhe njësive private që përfitojnë fonde publike. Si bosht kryq angazhimi i qytetarëve u prezantua në auditimin qeveritar.

Në fillimet e saj, CGR ose SAI i Paraguajit ka vendosur specifikimet e parimeve themeluese dhe cilësisë institucionale në plan të parë, duke marrë parasysh limitet e saj buxhetore dhe mungesën e eksperiencës në lidhje me kulturën e auditimit ekzistues në të gjitha fushat. Si shtesë, organet e reja të CGR pranojnë rëndësinë e krijimit të lidhjeve me institucione ndërkombëtare që bashkojnë SAI të ndryshëm siç janë OLACEFS dhe INTOSAI.

Në vitin 1998 pjesëmarrja zyrtare e përfaqësuesve të CGR Paraguaj në INCOSAI-n e XVI në Montevideo, Uruguaj, hapi mundësi të reja për një bashkëpunim efektiv në lidhje me zhvillimet e aktiviteteve të INTOSAI-t. Me këtë rast, përfaqësuesit e SAI-t të Paraguajit patën mundësinë e pjesëmarrjes në dy grupe pune: a) Grupi i punës për Auditimin Mjedisor dhe b) Grupi i punës mbi Privatizimin.

Është e rëndësishme të themi faktin që tema me më shumë përparësi në këtë kongres ishte lufta kundër korrupsionit. Kjo ishte dhe pika e parë e prezantimit të *Kodit të detyrave dhe Administrimi i SAI*.

Në vijim të pjesëmarrjes në INCOSAI në e Montevideos, SAI i Paraguajit mori pjesë në Kongreset trevjeçare të INTOSAI-t dhe në mbledhjet vjetore të Grupeve të ndryshëm të Punës. SAI i Paraguajit ka kontribuar rregullisht si anëtare e INTOSAI që nga viti 2001.

IDI (Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t) është një organ që mbledh së bashku Grupe Pune të ndryshme, i cili në njërin anë është i përbërë nga ekspertë trajnues dhe nga ana tjetër nga profesionistë.

Pjesëmarrja e përfaqësuesve të Paraguajit në grupe pune të ndryshme si dhe shkëmbimi i eksperiencës kanë një vlerë të madhe për SAI-n.

Për dy periudhat e mëvonshme, Paraguajit iu besua të udhëheqë auditimin e jashtëm të INTOSAI-t. Në bashkëpunim me përfaqësuesit e SAI-t të Zvicrës, përfaqësuesit e Paraguajit kishin për detyrë auditimin e financave për vitet 2004 - 2007: Atilio Gayoso Jara, Mario Estigarribia and Adriana Hug. Në bashkëpunim me SAI-n e Malajzisë, Atilio Gayoso, Nën Kontrollori i Përgjithshëm, udhëhoqi auditimin e financave për vitet 2007 - 2009.





Me rastin e Simpoziumit të INTOSAI-t në Vjenë në vitin 2011, përfaqësuesit e SAI të Paraguajit- Nancy Torreblanca, Nën-Kontrollorja e Përgjithshme e Republikës dhe Fabian Forestieri, shefi i departamentit për kontroll – prezantuan kontributin mbi *Eksperiencat e Paraguajit në angazhimin e qytetarëve*.


Ne gjithashtu dëshirojmë të nënvizojmë që SAI i Paraguajit merr pjesë në mënyrë aktive në mbledhjet EUROSAI - OLACEFS, të cilat organizohen çdo dy vjet.

Duke marrë parasysh shkëmbimin e eksperiencës, aktivitetet e prezantuara dhe aplikimet direkte të aspekteve të ndryshme të rekomanduara nga INTOSAI, drejtuesi i SAI-t të Paraguajit mund të shohë pas në një rekord pozitiv të pjesëmarrjes së SAI-t në INTOSAI. Është në interesin e tij vazhdimësia e bashkëpunimit në nivele të larta, duke qënë se ky bashkëpunim do i ofrojë SAI-t një mbështetje më të madhe në implementimin e vizioneve, objektivave dhe përparësive.

Nën drejtimin e udhëheqësit aktual, SAI është fokusuar tek përparësitë tematike që janë shumë të qarta dhe që mbartin një vizion të ri të auditimit të qeverisë. Këto tematika të reja përmbajnë p.sh; angazhimin qytetar, auditimin e burimeve natyrore, mbrojtës së mjedisit dhe përmirësimin e standarteve të auditimit.

Në këtë kontekst, SAI i Republikës së Paraguajit nënvizon rëndësinë vendimtare të faktit që INTOSAI shfrytëzon instrumentet teknologjike dhe i konsideron ato si një mundësi efektive për të ndërvepruar globalisht me SAI-t e tjerë me intensitet më të lartë. INTOSAI duhet gjithashtu që të bëhet një zë i afërt dhe i vendosur në luftën kundër korrupsionit.

Ne jemi të bindur që INTOSAI po zhvillon një kontribut shumë të madh në përmirësimin e cilësisë së SAI-ve, në promovimin e demokracisë globale dhe që jep përgjigje të përshtatshme në luftën kundër korrupsionit. Kjo është arsyeja për të cilën ne dëshirojmë të inkurajojmë SAI-t për të intensifikuar bashkëpunimin e tyre për arritjen e objektivave në legjitimimin e kërkesave të shoqërisë.






## Kontribut nga SAI e Polonisë

Jacek Jezierski

Ish/Kryetari i Zyrës Supreme  
të Auditit të Polonisë (NIK)

Zhvillimi i Bashkëpunimit Ndërkombëtar  
të SAI-ve që nga Viti 1953/1963- 60 Vjetori  
i INTOSAI/ 50 Vjetori i Sekretarisë së Përgjithshme





## Kontributi nga SAI e Polonisë

Jacek Jeziarski Ish/Kryetari i Zyrës Supreme të Auditit të Polonisë (NIK)

*Nënkomiteti të Standarteve të Kontrollit të Brendshë*

*Kryeta*

*Komiteti i Transferimit të Njohurive (KSC)*

*Anëtar*

*Grupi i Punës për Auditimin e I.T.*

*Grupi i Punës për Auditimin Mjedisor*

*Grupi i Punës për Evaluimin e Programeve*

*Grupi i Punës për Luftën kundër Korrupsionit*

*Grupi i Punës për Faktorët Kyc të Indikatorëve Kombëtar*

*Grupi i Punës për Modernizimin Financiar dhe Reformës Rregullatore*

*Komiteti Drejtues i INTOSAI-t Bashkëpunim me Donatorët*

*FAC Task Force për Parashikimet Financiare të INTOSAI-t*

*Nënkomiteti 3: Promovimi i Praktikave më të Mira dhe Sigurimi i Cilësisë nëpërmjet Peer-Reviewës.*

## ZHVILLIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR TË SAI-VE QË NGA VITI 1953/1963- 60 VJETORI I INTOSAI/ 50 VJETORI I SEKRETARISË SË PËRGJITHSHME



Delegacioni i Institucionit Suprem të Auditimit të Polonisë, të kryesuar nga ish-Presidenti Jacek Jeziarski, në Takimin e 62-të të Bordit Drejtues të INTOSAI në Vjenë, Austri, 2011

Së pari dua të filloj me reflektimet e mia për INTOSAI-n si një organizatë globale e Institucioneve Supreme të Auditit me disa vrojtime të përgjithshme. Si President i Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë (NIK), më duhet të pranoj që institucioni që drejtoj, edhe pse bën pjesë në INTOSAI që nga fundviti i 1950, nuk ishte i përfshirë në një bashkëpunim të vërtetë për një periudhë të gjatë, për më tepër anëtarësimi e tij ishte i limituar me disa kontakte formale në nivel drejtuesish të lartë. Në vitin 1970, presidenti i NIK ishte dhe anëtar i Bordit Qeverisës së INTOSAI-t, i cili nuk prodhoi asnjë rezultat në promovimin e ideve demokratike të INTOSAI-t në Poloni apo në mbledhjen e informacionit se si ishin të organizuara organet supreme të auditimit në vendet



e tjera dhe si ishin metodat e punës (përsa na përket, Deklarata e Limës e vitit 1977 u përkthye në gjuhën polake vetëm në vitin 1992!)

Qëndrimi ndaj marrëdhënieve ndërkombëtare e NIK-ut ndryshoi rrënjësisht pas transformimit demokratik në Poloni në fillim të viteve 1990. Atëhere, NIK filloi të bashkëpunojë me SAI të tjera, në nivel rajonal duke u përfshirë në iniciativa të organizatave ndërkombëtare siç është INTOSAI dhe EUROSAI.

Këto dy organizata kanë ndryshuar shumë gjatë dy dekadave të fundit. Këto ndryshime i atribuohen pjesërisht qëndrimeve të reja ndaj bashkëpunimit me anëtarët ndërkombëtarë, që vijnë si pasojë e ndryshimeve demokratike në vendet e tyre- siç është rasti i NIK. Një grup i SAI-t është i interesuar në një bashkëpunim real sesa në një anëtarësim formal në INTOSAI. SAI-t e ristrukturuara nga ish vendet totalitare, jo vetëm nga Europa Qendrore dhe Lindore, por edhe nga pjesa tjetër e botës, ndaluan së qeni anëtar pasiv të organizatave ndërkombëtare dhe u bënë bërthama aktive të tyre, duke ndarë njohuritë, eksperiencën dhe praktikat më të mira. Një numër i madh i grupeve të punës u formuan në INTOSAI, si rezultat i temave dhe rekomandimeve të INCOSAI.

Grupi i punës për auditimin mjedisor i formuar në vitin 1992, ku NIK-u është anëtar, jep një shembull të shkëlqyer se si INTOSAI kontribon për ndarjen e eksperiencave dhe njohurive në lidhje me sfidat që SAI-t përballen, siç janë proceset ekonomike dhe sociale të një bote moderne dhe çfarë duhet të jetë subjekt për tu audituar. Grupi i Punës ka përpunuar disa guida duke përfshirë këshilla dhe shembuj që lidhen me auditimin e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshmërisë. Grupi organizon seminare dhe trajnime si edhe ofron një forum për ndarjen e eksperiencave dhe njohurive. Ky grup gjithashtu ka ndërmarrë auditimin e parë global, në të cilin SAI-t e të gjithë vendeve të botës morën pjesë. Veç kësaj, grupi bashkëpunon ngushtësisht me partnerët e jashtëm, përfaqësuesit e tyre morën pjesë në Samitin e tokës në vitin 2002 në Johannesburg, në Kongresin Botëror për Drejtësi dhe në Samitin e Tokës në vitin 2012 në Rio de Janeiro.

SAI-t dhe organizatat e tyre në ditët e sotme nuk janë një qark i mbyllur specialistësh financiarë. Auditimi i sektorit publik kërkon një njohuri të thellë dhe eksperiencë në një numër të madh disiplinash. Auditimi i performancës është rritur ndjeshëm, si dhe bashkëpunimi me partnerët e jashtëm, i cili është reflektuar në strategjinë e komunikimit të INTOSAI-t.



Delegatët e SAI të Polonisë  
të 20 të OKB-së / INTOSAI Simpoziumi në Vjenë, Austri, 2009

Revolucioni global në teknologjinë e komunikimit që mund të vërehet vitet e fundit ka prekur funksionimin e INTOSAI-t. Marrëdhëniet midis anëtarëve të INTOSAI-t janë bërë më të thjeshta falë mjeteve të reja të komunikimit. Bashkëpunimi brenda INTOSAI-t nuk është më formal siç ka qenë më parë dhe pjesëmarrësit nuk janë më vetëm në nivel drejtuesish të lartë dhe departamenteve të marrëdhënieve me jashtë. Në ditët e sotme, bashkëpunimi i INTOSAI-t ndodh në nivele të ndryshme, nga Drejtuesit e SAI-ve deri te punonjësit që merren



direkt me auditime dhe trajnime, të cilët mund të kenë impaktin më të madh në rezultatin final të bashkëpunimit.

### Zhvillimet më të fundit në INTOSAI

Në vitin 2004, INTOSAI adoptoi Planin Strategjik për periudhën 2004-2010. Ai përcaktoi vlerat e organizatës dhe identifikoi objektivat bazë strategjike në të cilat duhet të përqëndrohen aktivitetet e saj. Zhvillimet e këtij plani frymëzuan Brodin Drejtues të EUROSAT-t, në të cilën SAI i Polonisë kishte nderin të kryesonte për vitet 2008-2011. Ne besuam që EUROSAT, si një Grup Pune Rajonal i INTOSAI-t, duhet të mernte pjesë në mënyrë aktive në implementimin e



Seminari EUROSAT mbi Komunikimit SAIS 'me Opinionin Publik nëpërmjet mediave në Varshavë, Poloni, 2011

Planit Strategjik. Ne gjithashtu menduam që kjo mund të bëhej njëkohësisht në dy drejtime: së pari me përfshirjen direkte të anëtarëve tanë në iniciativat e INTOSAI-t dhe së dyti duke implementuar Planin tonë Strategjik Rajonal, i cili në një masë të madhe, do të ishte i pajtueshëm me atë të INTOSAI-t. Tek punonim për zhvillimin e Planit Strategjik të EUROSAT-t, ne vendosëm të ndërtonim diçka në lidhje me përvojën e INTOSAI-t. Kjo është arsyeja që ne ftuam përfaqësuesit e Sekretariatit të INTOSAI-t për të marrë pjesë në ekipin e Planit Strategjik, së bashku me përfaqësuesit e EUROSAT-t të cilët ishin angazhuar për zhvillimin e Planit të Parë Strategjik të INTOSAI-t.



Njohuritë dhe përvoja e tyre bënë që përpunimi i Planit Strategjik të EUROSAT-t të bëhej në mënyrë të qetë dhe efektive. Ne supozuam që EUROSAT, si një Grup Pune Rajonal i INTOSAI-t, duhet të kishte të njëjtat objektiva strategjike. Njëherazi, u vendos që objektivi në lidhje me standartet ndërkombëtare profesionale duhet të promovonte dhe lehtësonte implementimin e këtyre standarteve sesa të fokusohet në zhvillimin e tyre, në mënyrë që të mos kishte mbivendosje me punën e INTOSAI-t. Në mënyrë të ngjashme, ndërkohë që propozoheshin aktivitete dhe projekte për objektivat individuale të EUROSAT-t, iu kushtua një vëmendje e veçantë mospërkimit me iniciativat e INTOSAI-t, por maksimizit të përdorimit të efektshëm të produkteve të tyre për zhvillimin e auditimit të sektorit publik në rajonin European.



Grupe të tjera pune rajonale, jo vetëm EUROSAI, janë duke zhvilluar planet e tyre strategjike. Kjo vërteton faktin që INTOSAI konsiderohet si një partner me influencë. Shembulli i të cilit ndiqet dhe zëri i dëgjohej. Strategjia dhe iniciativat e reja janë në kuadrin e strukturës së re dhe e bëjnë INTOSAI-n më të dukshëm në arenën ndërkombëtare.

Përpjekjet e bëra nga Sekretariati i Përgjithshme i INTOSAI-t për planin strategjik gjate viteve 2004-2010, rezultuan në inkorporimin e Deklaratës së Limës dhe Meksikës, dy dokumeta kyç të INTOSAI-t në ligjet ndërkombëtare: Në dhjetor të vitit 2011, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara adoptoi rezolutën e titulluar *Promovimi i efijencës, llogaridhënies, efektivitetit dhe transparencës publike duke forcuar Institucionet Supreme të Auditit*. Për herë të parë, Asambleja e Përgjithshme njohu që SAI-t mund të përmbushin në mënyrë efektive dhe objektive mandatet e tyre vetëm nëse kryejnë auditime të pavarur dhe të mbrojtur kundrejt influencave të jashtme. Në këtë mënyrë, u nënvizua fakti i rëndësisë së promovimit të efijencës, efektivitetit, llogaridhënies dhe transparencës nga ana e SAI-ve . Në të njëjtën kohë, Kombet e Bashkuara inkurajuan shtetet anëtare për të aplikuar parimet e Deklaratës së Limës dhe Meksikës, si dhe intensifikimin e bashkëpunimit me INTOSAI, në fushën e ndërtimit të kapaciteteve.

Një arritje tjetër e padiskutueshme e INTOSAI-t në vitet e fundit është zhvillimi i Standarteve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI) promovimi dhe implementimi i të cilave garantojnë cilësinë e punës së SAI-t, shtojnë rëndësinë e tyre dhe forcojnë auditin e sektorit publik. Duke ndjekur INCOSAI 2010 dhe miratimin e 37 standarteve (ISSAI) të reja, INTOSAI ka tashmë një gamë të gjerë standartesh dhe manualesh të reja. Në mënyrë që të kenë një kornizë të përbashkët reference, standartet e ISSAI duhet tu bëhen të njohura SAI-ve dhe partnerve të jashtëm. Që kjo gjë të jetë e arritshme, Sekretariati i Përgjithshëm doli me një iniciativë për të përgatitur një përmbledhje ekzekutive të standarteve, në mënyrë që të jenë më lehtë për tu trajtuar. Plani Strategjik i dytë i INTOSAI-t, për vitet 2011-2016, përmban implementimin e ISSAI-it si një nga gjashtë përparësitë e INTOSAI-t.

#### Sfidat e ardhshme të INTOSAI

Sfidat me të cilat përballen INTOSAI dhe anëtarët e tij nuk kanë ndryshuar shumë. Ka shumë raste që SAI-ve të ndryshëm u cënohet pavarësia dhe ka raste të aktiviteteve të ndryshme që synojnë të kufizojnë kompetencat e tyre. Për më tepër, kriza ekonomike financiare solli rritjen e presionit ndaj shumë vendeve, që SAI-t respektive, të provojnë që vendet e tyre kanë shpenzuar burimet në mënyrën më efektive. Pritshmëritë rreth punës së tyre janë në rritje të vazhdueshme, duke qënë se, media, shoqëria dhe legjislati kombëtar shpreson se SAI-t do të kontribuojnë në përdorimin sa më të mirë të burimeve publike, për një qeverisje sa më të mirë dhe në luftën ndaj korrupsionit.






## Kontribut nga SAI i Portugalisë

Guilherme d'Oliveria Martins

Kryetar i Gjykatës së Llogarive të Portugalisë

Evolimi i Bashkëpunimit Botëror: e Ardhmja  
dhe Eksperiencat e Gjykatës së Llogarive të Portugalisë





## Kontribut nga SAI i Portugalisë

Guilherme d'Oliveria Martins

Kryetar i Gjykatës së Llogarive të Portugalisë

*Kryetar i EUROSAI*

*Anëtar i Komitetit të Standarteve Profesionale (PSC)*

*Grupi i Punës për Borxhin Publik*

### **EVOLIMI I BASHKËPUNIMIT BOTËROR: E ARDHMJA DHE EKSPERIENCAT E GJYKATËS SË LLOGARIVE TË PORTUGALISË**

Hyrje

INTOSAI do të festojë përvjetorin e 60-të në 2013-ën. Ky është një event që përbën një moment historik për të cilin shumë SAI duhet të krenohen.

Gjykata e Llogarive të Portugalisë, një anëtar themelues e INTOSAI ka konsideruar për shumë vjet që stimuli dhe përfshirja vullnetare në iniciativën e bashkëpunimit ndërkombëtar, janë prioritete shumëpalëshe. Gjithashtu është në pozicionin që të njohë dhe të jetë dëshmitar i të mirave të përbashkëta që rrjedhin si pasojë e këtij bashkëpunimi.

Në këtë këndvështrim ne kërkojmë të dëshmojmë në lidhje me bashkëpunimin botëror të SAI-ve.

#### **1. Bashkëpunimi në shërbim të kapaciteteve të auditimit dhe njohja e rolit të SAI-t**

Qysh prej themelimit, INTOSAI ka evoluar rrënjësisht, si në numrin e anëtarëve si dhe në impaktin e aktiviteteve të kryera. Zgjerimi i shkallës gjeografike kërkoi themelimin e Grupeve Rajonale të Punës, të cilat hyjnë në zbatim në mënyrë progresive në rajone të ndryshme të botës. Konkluzionet dhe rekomandimet e adoptuara në njëzet kongreset e realizuara deri tani tregojnë qartë thellimin e reflektimeve të kryera në fushëveprimin e INTOSAI-t.





Takimi i Komitetit të Standardeve të Auditimit INTOSAI (ASC)  
Lisbonë, Portugali, 2002

INTOSAI-t, i drejtuar nga Gjykata Austriake e Auditimit.

Në kuadër të udhëzimeve teknike dhe metodologjike, duhet treguar sa të rëndësishëm janë Standartet e Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI), të cilat janë krijuar me koncepte të shëndosha teknike dhe parime themelore të SAI-ve

Shumë aktivitete të tjera janë me vlerë për tu theksuar dhe për shkak të natyrës së tyre si ato të kryera për auditin mjedisor.

Duhet theksuar faktin që zhvillimi i auditimit publik ndërkombëtar nga SAI-t ka qënë gjithnjë i mbështetur në mënyrë aktive dhe konstruktive nga Sekretari i Përgjithshëm i

## 2. E ardhmja dhe eksperiencat e Gjykatës së Llogarive të Portugalisë

Në dokumentat e planifikimit strategjik, Gjykata e Llogarive të Portugalisë konsideron që zgjerimi i bashkëpunimit me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare është një nga pikat më të rëndësishme.

Brenda kontekstit të INTOSAI, bashkëpunimi është kryer nga iniciativa të ndryshme, siç janë kontaktet dypalëshe dhe informale që SAI-t zhvillojnë, duke ndarë informacionin dhe eksperiencat në forma të ndryshme.

Në mënyrë më direkte, Gjykata e Llogarive të Portugalisë, mori pjesë si Anëtar i Bordit Qeverisës të INTOSAI-t gjatë viteve 1995-2007.

Ende në strukturat funksionale të INTOSAI-t, Gjykata e Llogarive e Portugalisë mori pjesë në punën e Komitetit të Standardeve të Auditimit dhe në nënkomitetin për pavarësinë e SAI-t dhe është anëtar i Grupit të Punës për Borxhin Publik.

Duke parë anëtarësimin e saj nga këndvështrimi i një pjesëmarrësi, Gjykata e Llogarive të Portugalisë gjithmonë ka konsideruar që iniciativat me qëllim paraqitjen e propozimeve lidhur me çështjet që do diskutohen dhe për përpunimin e kontributeve mbi subjektet trajtuar në Kongres, janë në maksimumin e interesit dhe i ka përmbushur në mënyrë të vazhdueshme.

Gjithashtu nga këndvështrimi i ndjekësit të objektivave kryesore të shoqëruara me bashkëveprimin ndërkombëtar midis SAI-ve, Gjykata e Llogarive të Portugalisë ka zhvilluar aktivitete që përkrahin bashkëveprimin në kontekste si Organizata e Insitucioneve Supreme të Auditit të Komunitetit Portugalisht-folës dhe Grupeve Rajonale të INTOSAI, me theks, në këtë rast, mbi EUROSAI-n.

Viti 2013 shënon ditëlindjen e gjashtëdhjetë të INTOSAI-t. Krijuar në Havanë në vitin 1953 nga 34 SAI dhe organizata partnere, aktualisht Organizata ka 191 anëtarë të plotë dhe katër anëtarë të asociuar. Këto shifra vetë dhe gjithashtu tregojnë progresin e madh që veprimtaritë e INTOSAI-t kanë pasur gjatë këtyre viteve, të specializimit dhe kompleksitetit si edhe ndikimin e tij në komunitetin e auditimit të jashtëm në shkallë globale ndërkombëtare, e veçanërisht në kontekstin e Kombeve të Bashkuara, një Organizatë me të cilën ai mban lidhje të veçanta për shkak të statusit të veçantë me Këshillin Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara (ECOSOC).

Nxitja e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave në fushën e auditimit të jashtëm të qeverisjes: është motorri i madh i INTOSAI-t

INTOSAI është një organizatë e përhershme e krijuar për të nxitur shkëmbimin e ideve dhe eksperiencave ndërmjet SAI-ve anëtare, veçanërisht për çështje të auditimit të jashtëm të qeverisjes. “Nga eksperiencia e përbashkët përfitojnë të gjithë” (*Experientia Mutua Omnibus Prodest*) është motoja dhe motori i fuqishëm i veprimeve të tij. Hapat janë ndërmarrë në mënyrë progresive për të bërë këtë objektiv realitet. Si një element i rëndësishëm në këtë detyrë, mund të tregojmë për faktin se INTOSAI nuk synon vetëm të jetë një organizatë në vetvete, por ajo gjithashtu ka punuar për t'a ofruar veten si një platformë, një forum për inkurajimin SAI-ve me një mjedis historik dhe kulturor dhe një trashëgimi të përbashkët që të formojnë grupimet e tyre rajonale dhe të bashkëpunojnë midis tyre, duke pasur INTOSAI-n si një referencë dhe pikë qendrore të përbashkët.

### **Grupet rajonale të punës filluan të krijohen në 1962.**

Grupi i Punës për Rajonin European të INTOSAI-t, EUROSAI, u krijua formalisht në Madrid në Nëntor 1990, në vijim të INCOSAI XIII (Berlin, 1989), edhe pse hapat e parë u ndërmorrën në INCOSAI VIII (Madrid, 1974). Sekretariati EUROSAI



është themeluar në mënyrë të përhershme në Gjykatën e Auditimit të Spanjës në Madrid. EUROSAL, i cili mbajti përvjetorin e tij të njëzetë në vitin 2010, filloi punën me tridhjetë anëtarë dhe tani përbëhet nga pesëdhjetë të tillë. Ai i ka bërë veprimet e tij gjithnjë e më të larmishme, aktualisht është në zhvillim të bazuar në Planin Strategjik 2011-2017, të miratuar në Kongresin e VIII (Lisbonë, 2011) dhe ka për qëllim të jetë në një linjë me objektivat e INTOSAI-t.

Një tjetër hap i rëndësishëm që ka ndikuar që INTOSAI të veprojë si një forum nxitës për zhvillimin dhe shkëmbimin e përvojave midis SAI-ve, është krenaria që ka organizata për pjesëmarrjen e gjerë dhe ruajtjen e ekuilibarve për rajonet përfaqësuese dhe sistemet e ndryshme të auditimit. INTOSAI ka synuar t'a ktheje pluralizmin brenda organizatës në një pasuri të përbashkët dhe më e rëndësishmja të përhapë frymën e unitetit duke ruajtur individualitetin dhe duke përfituar nga sinergjia kolektive për të kontribuar në një qeverisje më të mirë. Kjo bën pjesë në grupin e vlerave të përbashkëta të ofruara nga INTOSAI.



20 vjetori i EUROSAL mbajtur me rastin e Kongresin e INCOSAI XX  
Johanesburg, Afrika e Jugut, 2010

Gjatë zhvillimit të këtyre gjashtëdhjetë viteve, INTOSAI ka promovuar shkëmbimin, duke shfrytëzuar larmishmërinë gjuhësore, kështu INTOSAI ka pesë gjuhë zyrtare - për të garantuar një numër të madh kontributesh dhe shpërndarjen maksimale të rezultateve të punës së organizatës, për të kaluar pengesat e faktorit "gjuhë". INTOSAI përbën një forum në të cilin audituesit publik nga e gjithë bota mund të diskutojnë tema të interesit reciprok dhe të përditësojnë standardet profesionale dhe praktikat më të mira.

Një shtyllë e tretë e madhe mbi të cilën INTOSAI ka themeluar objektivin e tij është shkëmbimi i eksperiencës dhe bashkëpunimit në mes anëtarëve të tij dhe me partnerët jashtë. Për këtë arsye janë ngritur struktura dhe nënshkruar marrëveshje që INTOSAI të zhvillojë aktivitetin e tij në mënyrë eficientë si dhe të përshtasë vetën drejt efektivitetit. Bordi Drejtues, Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t, si organe statutore, përbëjnë pjesën thelbësore e cila monitoron



veprimtarinë për t'u siguruar se çdo gjë po kryhet në drejtim të vendosjes në praktikë të objektivave strategjike. Iniciativa për Zhvillim INTOSAI (IDI), ka kryer një rol kyç në promovimin e zhvillimit institucional dhe ndërtimin e kapaciteteve. Organe të ndryshme - Komitete, Grupe Pune, Task Forca, Komisione – janë krijuar për të shqyrtuar dhe analizuar detyrat e çdo njësie me prioritet respektimin e efijencës dhe efektivitetit të gjithë veprimtarisë së INTOSAI-t.

### **Gjykata Austriake e Auditimit: 50 vjet mirëpritje e Sekretariati të Përgjithshëm të INTOSAI-t**

Është e drejtë dhe e duhur në këtë pikë të përmendim në mënyrë të veçantë Sekretariatit e Përgjithshëm të INTOSAI-t. Nëse do të bënim një ekzaminim rreth funksioneve të caktuara në Statutin e Organizatës, mund të shihet qartë se Sekretariati i Përgjithshëm është një organ me shumë qëllime, pothuajse gjithëpërfshirës; " trupi" ku organizata mbështetet. Mes detyrave të tjera, ai mban marrëdhëniet me anëtarët dhe midis anëtarëve, përkrah vendosjen në praktikë të marrëveshjeve të miratuara nga Kongresi dhe Bordi Drejtues, promovon zhvillimin e aktiviteteve të Grupeve Rajonale të Punës, organizon aktivitete për promovimin e objektivave të INTOSAI-t, zbaton buxhetin dhe mban llogaritë. Në praktikë, nuk ka një detyrë në të cilën Sekretariati i Përgjithshëm nuk është i përfshirë, në një mënyrë apo një tjetër.

Prej vitit 1963, Sekretariati i Përgjithshëm ka patur bazën në Gjykatën Austriake të Auditimit. Ai e ka kryer punën e tij në mënyrë të vazhdueshme dhe jashtëzakonisht të dedikuar, duke e udhëhequr INTOSAI-n me urtësi dhe efijencë. Për pesëdhjetë vjet, SAI i Austrisë, me Presidentët e tij të njëpasnjëshëm në krye dhe një ekip të madh me përvojë të konsiderueshme, ka qenë i aftë t'i sigurojë INTOSAI-t stabilitetin e nevojshëm dhe të përhershëm, rigorozitet në përputhje me Statutet dhe procedurat, udhëzime të kujdesshme dhe iniciativa të nevojshme për vazhduar drejt sfidave të reja si pasoje e evoluimit të mjedisit rrethues. Qëndrueshmëria dhe inovacioni kanë ecur gjithmonë së bashku nën drejtimin e Sekretariatit nga kolegët tanë Austriakë. Përfshirja e tyre personale dhe menaxhimi i kapaciteteve e kanë konvertuar një detyrë në një stimul të përhershëm personal dhe kolektiv.

Unë sinqerisht do të doja të falënderoj dhe përgëzoj përzemërsisht Josef Moser dhe ekipin e tij aktual, të gjithë Sekretarët e Përgjithshëm të njëpasnjëshëm dhe stafin e Zyrës së Sekretariatit të INTOSAI të cilët kanë shërbyer në këtë funksion gjatë pesëdhjetë viteve me këmbëngulje dhe përkushtim, me një numër të madh sfidash dhe qëllimesh të arritura dhe me një ndërhyrje të dukshme shtytëse dhe inkurajuese në çdo hap të ndërmarrë nga INTOSAI.

### **60 vjet sfida dhe iniciativa në INTOSAI**

Motoja e INTOSAI-t se "Mutual Experience Benefits All" është vënë në praktikë dhe është materializuar në shumë prej sfidave dhe nismave përgjatë këtyre gjashtëdhjetë viteve histori. Angazhimi i madh i INTOSAI-t për të promovuar zhvillimin institucional të anëtarëve të tij duhet të theksohet me çdo kusht. Kontributi i IDI-t në bashkëpunim me Kombet e Bashkuara me anë të mbajtjes rregullisht të simpoziumit OKB / INTOSAI dhe promovimin e formulave të ndryshme të mbështetjes për SAI-t - me vëmendje të veçantë drejt atyre që janë në procesin e zhvillimit - përbëjnë shembuj të mirë të këtij veprimi.

Gjithashtu nxitja e bashkëpunimit midis grupeve rajonal të punës ka qenë prioritet për Organizatën INTOSAI. EUROSAI aktualisht mban bashkëpunim të rregullt me OLACEFS, ARABOSAI dhe ASOSAI, duke formalizuar Memorandumet e Mirëkuptimit që janë përcaktuar dhe nënshkruar nën kujdesin e INTOSAI-t, si "trupi amë".



Për shkak të rëndësisë së tyre, dy nisma të mëdha aktuale të INTOSAI-t megjithëse janë të projektuara për të ardhmen, duhet të nënvijëzohen. E para iniciativë ka të bëjë me zhvillimin e veprimeve të INTOSAI-së që nga viti 2005, në kuadër të Planit Strategjik, duke përfutur nga sinergjitë e të gjitha aktiviteteve të tij, detyrave dhe punës së të gjithë organeve të tij. Nisma e dytë ka për qëllim inkurajimin e veprimeve të drejtuara në forcimin e auditimit të jashtëm publik dhe nxitja për SAI-t më të fuqishëm dhe më të pavarur. E megjithëse janë përmendur si dy nisma, do të ishte më e saktë t'iu referoheshim atyre si një e vetme me dy përbërës: njëra siguron formën dhe tjetra siguron përmbajtjen.



Konferenca e 1-rë e përbashkët ASOSAI-EUROSAT Stamboll, Turqi, 2011



Konferenca e 3-të e përbashkët EUROSAT-ARABOSAT

Abu Dhabi, Emiratet e Bashkuara Arabe, 2011





Konferenca e 6-të e përbashkët EUROSAT-OLACEFS

Isla de Margarita, Venezuela, 2009

Plani Strategjik INTOSAI 2005-2010 u hartua me katër objektiva strategjike, me misionin për të ofruar mbështetje reciproke, promovimin e shkëmbimit dhe inkurajimin për përmirësim të vazhdueshëm ndërmjet anëtarëve të saj. E gjithë kjo me qëllim për të promovuar një qeverisje më të mirë, për të rritur transparencën, garantimin e përgjegjshmërisë, rritjen e besimit të publikut dhe nxitjen e përdorimit të burimeve publike në dobi të qytetarëve. Gjatë periudhës 2005-2010, Deklarata e Mexico-s ishte miratuar si zhvillimi i Deklaratës së Limës e 1977-ës. ISSAI-t dhe udhëzimet INTOSAI për Qeverisje të Mirë (INTOSAI GOVs) u miratuan, gjithashtu u zhvilluan një numër i konsiderueshëm standardesh, direktivash dhe udhëzimesh për komunitetin INTOSAI.

Komiteti i Standardeve Profesionale INTOSAI, Komiteti i Ndërtimit të Kapaciteteve dhe Komiteti i Shkëmbimit të Njohurive me grupet e punës që operojnë brenda tyre dhe Komitetin e Financës dhe Administrimit punuan së bashku për arritjen e objektivave të vendosura.

Planit Strategjik është nën menaxhimin e Bordit Drejtues dhe nën koordinimin e Sekretariatit të Përgjithshëm, të gjithë kryejnë një detyrë të madhe.

Mbi këtë bazë, sfidat e mëdha strategjike të periudhës së re 2011-2016 kanë për qëllim mbështetjen e SAI-ve në zbatimin e kuadrit ISSAI, rritjen e kapaciteteve institucionale të SAI-ve - të cilat janë përforsuar me krijimin e Komitetit INTOSAI-Donatorë, si dhe vënien në praktikë të Strategjisë së Komunikimit INTOSAI, për të cilat INTOSAI Journal dhe faqja e saj në web janë mjete të rëndësishme komunikimi.

Nga ana e saj, Rezoluta e Kombeve të Bashkuara e datës 22 dhjetor 2011, në promovimin e efijencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës në administratën publike paraqesin kulmin e përpjekjeve të filluara nga INTOSAI disa vjet



më parë për të forcuar pavarësinë e SAI-ve dhe njohjen e Deklaratave të Limës dhe asaj të Meksikës. Synimi i palodhur i kësaj nisme nga Sekretariati i INTOSAI-t ka qenë themelor për këto arritje.

### EUROSAI në INTOSAI

EUROSAI ka qenë një aleat i përhershëm i INTOSAI dhe ka bashkëpunuar në mënyrë aktive me të dhe në organet e tij, këshillat dhe grupet punuese. EUROSAI ka ndërmarrë veprimtari intensive për promovimin e mirëkuptimit dhe bashkëpunimin profesional dhe teknik ndërmjet anëtarëve të saj me të tjera grupe rajonale INTOSAI dhe me partnerë të jashtëm, me anë të shkëmbimit të ideve, përvojës, informacione dhe dokumentacion në fushën e auditimit të fondeve publike. Ai ka promovuar edhe studime nga këndvështrime të doktrinave dhe praktike duke i kushtuar vëmendje zhvillimeve të reja dhe sfidave të paraqitura nga mjedisi i tij, gjithashtu janë ngritur edhe grupe pune për këtë qëllim.



Takimi i 39-të i Bordit Drejtues të EUROSAI Ankara, Turqi, 2012


EUROSAI ka bërë përpjekje të veçanta për të forcuar trajnimet dhe t'i ofrojë anëtarëve të tij akses në programet për zhvillim dhe promovim institucional, një detyrë e rëndësishme të cilën Komiteti i Trajnimit EUROSAI e kryen në bashkëpunim me IDI. EUROSAI ka nxitur edhe kryerjen e veprimeve të përbashkëta, të cilat kanë treguar se, edhe pse sistemet e kontrollit të jashtëm ndryshojnë, institucionet në zhvillim janë trajtuar me detyra dhe sfida të përbashkëta. EUROSAI ka si qëllimin e tij të bëhet *guri mbështetës* për INTOSAI-n në rajonin e Europës, duke mbështetur iniciativat e tyre, duke kontribuar në mënyrë aktive në drejtime të dyfishta për t'i prezantuar në mesin e anëtarëve të saj dhe në të njëjtën kohë të maksimizojë përdorimin e produkteve të tyre dhe shfrytëzimin e iniciativave. EUROSAI ka marrë gjithashtu në një angazhim për forcimin e auditimit të jashtëm të qeverisjes dhe mbështetjen e pavarësisë së SAI-ve, nëpërmjet një deklarate të miratuar në këtë drejtim në Kongresin e VIII për mbështetjen e iniciativës INTOSAI në Kombet e Bashkuara siç u përmend më parë.

Si Sekretariati i Përhershëm i EUROSAI-t, Gjykata e Auditimit e Spanjës ka mbajtur marrëdhënie shumë të ngushta, të përzemërta dhe të përkushtuara me INTOSAI-n, në veçanti me Sekretariatën e Përgjithshme të saj, ku Sekretariati EUROSAI ka gjetur gjithmonë mbështetje, udhëzime, reciprocitet dhe miqësi. Për këtë arsye, si Kryetar i Gjykatës së Auditimit të Spanjës dhe Sekretar i Përgjithshëm i EUROSAI, është për mua një nder i ndjerë thellë të përgëzoj INTOSAI-n në gjashtëdhjetë vjetorin e tij dhe Sekretariatën e Përgjithshme INTOSAI në ditëlindjen e tij të pesëdhjetë. Unë i ofroj atyre bashkëpunim të plotë dhe aktiv, veçanërisht me Sekretariatën e tij. Do të uroja në të gjithëve si anëtarë të familjes së madhe INTOSAI, shumë vite sukses dhe shkëmbim të përvojës për të mirën e qeverisjes së mirë në nivel global.



## Kontribut nga SAI i Suedisë

Udhëheqje duke vendosur Standarde të  
një Cilësie të Lartë  
Kontributi nga SAI i Suedisë  
Nënkomiteti i Auditimit Financiar Kryetar  
Komiteti i Standardeve Profesionale (PSC)  
Anëtar Komiteti Drejtues i  
Komitetit të Standardeve Profesionale  
Komiteti Ndërtimit të Kapaciteteve (CBC)





## Kontribut nga SAI i Suedisë

*Komiteti Shpërndarjes së Njohurive (KSC)*

*Nënkomiteti i Auditimit të Performancës*

*Nënkomiteti Kontabilitetit dhe Raportimit*

*Grupi i Punës për Borxhin Publik*

*Grupi i Punës mbi Vlerat dhe Përfitimet e SAI- t*

*Grupi i Punës për Modernizimin Financiar dhe Reformën*

*Nënkomiteti 1 : Nxitja e Rritjes*

*Veprimtari të Ndërtimit të kapaciteteve midis Anëtareve të INTOSAI-t*

### **Udhëheqje duke vendosur Standarde të një Cilësie të Lartë**

INTOSAI miratoi versionin e parë të standardeve të auditimit të INTOSAI-t në kongresin e Berlinit në vitin 1989. Këto standarde janë rishikuar, por thelbi mbetet i njëjtë. Standardet e auditimit të INTOSAI-t janë ende të njëjtat, por janë duke u rishikuar aktualisht nga Komitëti i Standardeve Profesionale dhe Projekti i Harmonizimit. Edhe pse standardet janë përdorur gjerësisht nga anëtarët e INTOSAI-t, ka pasur kërkesa të menjëhershme nga disa SAI që kishin nevojë të orientoheshin mbi përdorimin e udhëzimeve në punën e përditshme të audituesëve të tyre. Si rezultat, puna për zhvillimin 38 ISSAIs (Standardet Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit) për auditimin financiar filloi në vitin 2002. Në atë kohë u vendos që SAI-t të bazoheshin në standardet e përgjithshme ekzistuese të pranuar dhe të zhvilluara nga Bordi Ndërkombëtar i Sigurimit të Standardeve të Auditimit. Këto standarde janë pranuar dhe përdoren gjerësisht nga audituesit në mbarë botën, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Nënkomiteti i Auditimit Financiar (FAC) mori përsipër detyrën e shkrimit të shënimeve praktike për të plotësuar më tej standardet dhe duke i bërë ato të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në sektorin publik.

Nënkomiteti i Auditimit Financiar të INTOSAI-t shumë shpejt kishte 9 SAI anëtare dhe një sekretariat i dytë u krijua dhe u organizua nga Zyra e Auditimit të Suedisë. Ka patur diskutime të gjera dhe është bërë shumë punë për ngritjen e një strukture të projektit dhe proceset e përshtatshme të punës. Në vitin 2003, u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet INTOSAI-t dhe IFAC, nëpërmjet organeve përkatëse të vendosjes së standardeve, Komitëti i Standardeve Profesionale dhe Bordi i Sigurimit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Një bashkëpunim shumë i suksesshëm mori formë. Për të bërë më të mirën dhe përdorimin e ekspertizës ekzistuese në të gjithë botën, u krijua një Panel Reference që përmbante CV-ët e njëqind audituesve të kualifikuar financiar nga të gjithë anët e botës. Një numër i madh prej tyre u caktuan për të punuar në grupet e punës të SAI-ve në atë kohë dhe kështu puna e zhvillimit të shënimeve praktike ishte në aktivitet të plotë.

### **ISSAI-t për Auditimin Financiar**



Z. Jonas Hallstrom dhe Z. Dong Hyuk EIM (Bai Korea) në Takimin e nënkomitetit të Auditimit Financiar në Seul, Republika e Koresë, 2008



Takim i KVV-së Auditimit Financiar Nënkomitetit (FAS) në Seul, Republikën e Koresë, 2008  
Nga e majta: Z. David Hughes (SAI i Mbretërisë së Bashkuar), zonjën Kelly Ånerud (SAI i Norvegjisë), Z. Jan van Schalkwyk (SAI i Afrikës së Jugut )

Puna për zhvillimin e ISSAI-ve ka përfshirë kontribute dashamirëse nga 60 SAI të ndryshme nga e gjithë bota, të cilat bashkëpunuan në mënyrë aktive. Ndërsa SAI të tjerë kontribuan me ekspertizën dhe eksperiencën e tyre në komentet e drafteve të ekspozuar. Puna u lehtësua nga kontributet e Bankës Botërore, Bankës Aziatike për Zhvillim dhe IAASB. Ndërsa NAO suedez mori përsipër detyrën e zgjeruar dhe sfiduese të planifikimit dhe të bashkë-koordinimit të punës së FAC, por një ngarkesë e konsiderueshme ka rënë edhe mbi anëtarët e tjerë të nënkomitetit. Disa anëtarë kanë marrë përsipër përgjegjësinë për të udhëhequr grupe pune dhe nënprojekte duke u fokusuar në standardet individuale dhe shënimet praktike. Të tjerët janë përfshirë në formimin e strategjive dhe planeve të punës. Sekretariati i Përgjithshëm ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në lehtësimin e takimeve të bordit drejtues, si edhe në përgatitjet për INCOSAI 2010, ku është miratuar një grup i plotë i ISSAI-ve për auditimin financiar.

Të gjitha së bashku janë të rëndësishme për FAC, për të ndjekur një proces të rregullt si edhe për të siguruar përgjegjshmëri, transparencë dhe besueshmëri. Kjo do të thotë pjesëmarrje e gjerë në punë nga ana e anëtarëve të INTOSAI dhe bashkëpunim me partnerët e njohur dhe pranuar globalisht. Për më tepër, transparenca në proces është arritur përmes ekspozimit të drafteve dhe mirëprirjes së komenteve të Institucioneve të Larta të Auditimit si edhe komentet e palëve të interesuara. Për shkak se ky proces është ndjekur gjatë fazës së zhvillimit, ISSAIs janë të një cilësie të lartë profesionale dhe të zbatueshme në mjedise të ndryshme të auditimit.

Përveç asaj që është gjetur në ISSAI-t hyrëse (ISSAI 1000, hyrje e përgjithshme e Udhëzimeve të Auditimit Financiar të INTOSAI-t), fjalori shtesë i ISSAI-ve përbëhet nga shënimet praktike të zhvilluara nga FAC të mbledhura nga të 36 SAI-t. Shënimet praktike përshkruajnë si këto ISSAI të aplikohen në mënyrën më të mirë në ambjentin e sektorit publik. ISSAI-t mbulojnë të gjitha fushat ose proceset e përfshira në një auditim të pasqyrave financiare.

Si rezultat ISSAIs do të kontribuojnë në rritjen e cilësisë së auditimit të pasqyrave financiare, duke rritur besueshmërinë në punë dhe duke formuar një bazë të përbashkët profesionalizmi për të gjithë veprimtaritë audituese në mbarë botën.

Duhet të përmendet gjithashtu se, përveç auditimit të pasqyrave financiare, shumë prej angazhimeve në sektorin publik përfshijnë përgjegjësi shtesë të auditimit në lidhje me ligjet dhe rregulloret. Me qëllim të dhënies së udhëzimeve për



kryerjen e auditimeve të tilla, disa ISSAI janë zhvilluar nga Nënkomiteti i Auditimit të Përputhshmërisë (CAS). Ka një bashkëpunim të ngushtë midis FAC dhe CAS për këtë lloj auditimi.



Takim FAS në Zyrën Kombëtare të Auditimit në Londër, Britani e Madhe, tetor 2009 Nga e majta: Znj Annie Leclerc (SAI i Kanadasë), Z. David Hughes (NAO), Ms Gail Valieres (Gao), Z. Jonas Hallstrom (SAI i Suedisë), Z. Mirko GOTTMANN dhe Z. John Speed (Gjykata Evropiane e Auditorëve)

Ambicia e FAC është që të jetë një nënkomitet model brenda INTOSAI. Për të arritur këtë, FAC ka punuar me një proces të qartë, që përfshin një shumëllojshmëri të gjerë të anëtarëve të INTOSAI dhe organizatave profesionale simotra, duke qenë transparent në proceset e punës, si dhe në proceset e vendimmarrjes dhe duke punuar në mënyrë eficiente me një nivel të lartë të profesionalizmi në të gjithë rastet.

### **Zhvillimet e fundit në INTOSAI**

INTOSAI ka një grup të shprehur standardesh ISSAI për Auditimin Financiar. Megjithatë, do të ketë gjithmonë nevojë për përditësim dhe zhvillim të mëtejshëm të ISSAI-ve. Kjo punë momentalisht kryhet nga FAC.

Është shumë pozitive që anëtarët e INTOSAI-t kanë filluar të zbatojnë standardet. Kjo punë është bërë në mënyrë të pavarur nga SAI-t individuale, si dhe në bashkëpunim me kolegët mbështetës. Një numër i konsiderueshëm seminaresh janë ndërmarrë nga INTOSAI, duke u fokusuar kryesisht në rritjen e vetëdijes.

Komiteti i Standardeve Profesionale (PSC) drejton një projekt për rritjen e ndërgjegjësimit për të lehtësuar shkëmbimin e njohurive dhe zbatimin e ISSAI-ve. Banka Botërore është angazhuar së fundmi për të ndihmuar në implementimin e iniciativës për Zhvillimin të INTOSAI-t.

INTOSAI është një partner i njohur i IFAC, dhe për shumë vite ka qenë i nominuar si një nga anëtarët publik të Sigurimit Ndërkombëtar dhe Bordit të Standardeve të Auditimit (IAASB). INTOSAI është gjithashtu një anëtar i FNK, Grupit



Konsultativ Këshillues dhe është ftuar nga IFAC për t'u bërë anëtare e Grupit të referencës ndërkombëtare për të zhvilluar një kornizë për qeverisjen e mirë.

Kriza financiare dhe kriza pasuese e borxhit që bota është ballafaquar që nga viti 2008 në mënyrë të pashmangshme kanë pasur një ndikim në punën e pritshmëritë e SAI-ve. Ka shumë mësim për të mësuar nga këto kriza. Njëra është se ndërvarësia midis vendeve dhe tregjeve të ndryshme është rritur ndjeshëm. Çfarëdo që ndodh në tregjet në rritje si Kina, India dhe kontinentin Afrikan kanë një ndikim në tregjet financiare të New York-ut, Londrës, Zyrhut dhe Hong Kong-ut. Për më tepër, ajo që ndodh në tregje ka një ndikim në qeveritë kombëtare. Si përgjigje, disa qeveri zgjedhin të

shpenzojnë më shumë për të stimuluar tregun vendas. Të tjera e konsiderojnë të nevojshme të mbikëqyrin tregjet financiare me qëllim shmangien e dëmeve të mëtejshme. Disa palë të interesuara kanë theksuar mungesën e transparencës dhe llogaridhënies, si një nga shkaqet kryesore për të metat aktuale të ekonomisë botërore. Vazhdimisht, ka pasur thirrje për unifikimin e standardeve të kontabilitetit financiar dhe auditimit. Vendet e G20 janë shprehur se ekziston një nevojë urgjente për konvergjencë kur është fjala për zhvillimin dhe zbatimin e standardeve të përgjithshme globale. Puna e tanishme e FAC me përditësimin, rafinimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të ISSAI-ve është shumë e rëndësishme në këtë kontekst.



Takimi FAS në Uashington, SHBA, 2011

### Sfidat e ardhëshme të INTOSAI-t

SAI-t iu shërbejnë qytetarëve. Në një botë të informimit dhe keqinformimit, qytetarët i drejtohen SAI-t me pritshmërinë e gjetjes së fakteve të duhura. Në mënyrë që të përmbushen këto pritshmëri në mënyrën më objektive dhe të besueshme, është me një rëndësi të veçantë që anëtarët e INTOSAI-t të aplikojnë praktikën më të mira të standardeve të auditimit. Pritshmëritë ndaj njësive të qeverisjes dhe SAI-ve rriten në mënyrë të qëndrueshme edhe pse në kushtet e një krize ndërkombëtare financiare dhe ekonomike.

Duke u kthyer nga një fazë intensive e zhvillimit në një fazë të mirëmbajtjes dhe implementimit të sfidave të reja. Këto sfida do të ndryshojnë në varësi të maturimit të SAI-ve, kontekstit në të cilin SAI-t operojnë, kërkesat ligjore, burimet në dispozicion, duke përfshirë personelin, burimet teknike dhe financimit dhe ambiciet përkatëse. Do të jetë e rëndësishme për çdo SAI që të bëjë vlerësimin e tij, që të jenë të mirë përparuar për procesin e implementimit.

Implementimi i ISSAIs është një angazhim afat-gjatë, dhe menaxhuesit duhet të përcaktojnë një vizion të qartë për atë që duhet të arrihet, të vendosin objektiva për implementimin dhe të sigurohen për angazhimin brenda organizatës për zbatimin e tyre si edhe për angazhimin e palëve të interesit.

Implementimi i standardeve të pranura globalisht kërkon një përjasje me bazë riskun, e cila mund të çojë në ndryshime pozitive në metodat dhe proceset e punës, kontrollit të cilësisë, regjistrimit të evidencave të auditimit, përdorimin e teknikave të përzgjedhjes etj. Këto ndryshime mund të ndikojnë në strukturat organizative, si edhe në menaxhimin dhe sjelljen organizative. Si rezultat, trajnimi do të jetë i nevojshëm për të gjithë nivelet e stafit dhe






menaxhimit. Si për të gjithë proceset e ndryshimeve brenda një organizatë, implementimi i ISSAI-ve ka nevojë për mbështetjen dhe përkushtimin e plotë të menaxhimit të lartë të një SAI.

Përveç një mbështetjeje më të mirë për implementim, marrja e masave bazuar në zgjidhje financiare dhe organizative janë të domosdoshme për të siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë në punën e ardhshme të FAC.

Ka një sërë partnerësh të mundshëm për të mbështetur në implementimin e ISSAI-ve. Kjo mund të përfshijë programe rajonale dhe globale për zbatimin e ISSAI-ve nën kujdesin e Bashkëpunimit INTOSAI-Donatorë të cilat do të zbatohen nga Iniciativa për Zhvillim Ndërkombëtar (IDI) në bashkëpunim me Komitetet dhe grupe rajonale pune të INTOSAI-t..

Në terma afatgjatë, çdo SAI do të përfitojë shumë nga implementimi i ISSAI-ve.

Të gjithë anëtarët e INTOSAI-t janë të inkurajuar t'i kushtojnë vëmendje të veçantë ISSAI-ve dhe të konsiderojnë implementimin e tyre në çdo SAI. Aplikimi i ISSAI-ve rrit cilësinë e punës së SAI-ve, rrit konfidencën e menaxherëve të lartë të SAI-t, rrit vetë-vlerësimin e audituesit dhe mundësinë për të kontribuar në auditime cilësore. Akoma më e rëndësishme është se të punuarit me standarte të mira komunikimi të cilat do të rrisin transparencën e SAI-ve dhe transparencën operacioneve dhe pozicioneve financiare në sektorin publik në përgjithësi. Të punosh sipas standardeve ISSAIs mund të mos jetë e lehtë por ia vlen mundimi në termat e rritjes së besueshmërisë, cilësisë dhe profesionalizmit.






## Kontribut nga SAI i Zvicrës

Kurt Grütër

Drejtor i Zyrës Federale Zvicerane të Auditimit





## Kontribut nga SAI i Zvicrës

*60 Vjet INTOSAI -*

*Komiteti i Shpërndarjes së Njohurive (KSC) Anëtar*

*Grupi i Punës në Auditimin e IT*

*Grupi i punës për Vlerësimin e Programit*

*Grupi i Punës për Treguesit Kyç Kombëtar*

*50 Vjet të Sekretariatit i Përgjithshëm në Vjenë*

*60 vjet INTOSAI - 50 vjet Sekretariatit i Përgjithshëm në Vjenë*

Arsye të mjaftueshme për të uruar dhe falënderuar të dy organizmat duke bërë një rishikim të shkurtër nga perspektiva Zvicerane

### **1 Zhvillimi i bashkëpunimeve në mbarë botën ndërmjet SAI-ve prej vitit 1953**

Fakti që INTOSAI u konceptua në Zvicër është një burim i veçantë kënaqësie për Zyrën Federale të Auditimit të Zvicrës (SFAO).

Në vazhden e Luftës së Parë Botërore, përfaqësues të institucioneve të ndryshme Supreme të Auditimit (ISA) iu bashkuan Kongresit Ndërkombëtar të Shkencave Administrative në Bern, Zvicër, dhe vendosën të krijonin një forum për auditimet në qeveri. Kështu, nëpërmjet SFAO, Zvicra ka qenë anëtare e INTOSAI-t që prej fillimit, duke përfituar nga shkëmbimi i ideve dhe eksperiencave. Në mungesë të INTOSAI-t, SFAO me siguri nuk do të ishte institucioni që është sot.

Në krahasim ndërkombëtar, sistemi mbikëqyrës i Zvicrës në nivel federal mund të trajtohet si një rast special për një sërë arsyes: ka disa elementë të demokracisë direkte, ndarja federale i jep njësisë administrative dhe komunave një autonomi të lartë financiare, sistemi i marrëveshjeve dhe një parlament me kohë të pjesshme me dy dhoma me vendime njësoj të zbatueshme. Me fjalë të tjera, pjesëmarrja e njerëzve në çështjet financiare dhe të taksave dhe decentralizimi i fuqisë në shtetin federal janë partnerë të ngushtë të SFAO.

Edhe pse implementimi aktual i mbikëqyrjes kushtëzohet nga vendet individuale me ndryshime në strukturat politike dhe ato kulturore, natyra rregullatore e INTOSAI-t ka efektin t'i harmonizojë metodat e rritjes së nivelit të profesionalizmit. Një grup i standardeve të auditimit shërben si një guidë për të gjithë institucionet e auditimit në gjithë botën. Me rëndësi të veçantë janë përpjekjet e INTOSAI-t për forcimin e pavarësisë së SAI-ve, duke kulmuar me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për pavarësinë e SAI-t.

Historia e SFAO, duke shkuar 100 vjet para në kohë, pasqyron evoluimin e institucionit të Zvicrës nga një "roje nate" në një institucion modern të shekullit të 21, me një përjasje të orientuar drejt shërbimit të qytetarëve, një ndikim të



madh në këtë arritje kanë diskutimet brenda INTOSAI-t. Ndër vite detyrat publike u rritën në shumëllojshmëri dhe kompleksitet, gjithashtu edhe SFAO-s i nevojiteshin aftësi dhe instrumente të reja për t'a zhvilluar në institucionin e sigurtë të mbikëqyrjes financiare që është sot.

SFAO e falënderon INTOSAI-n për këtë zhvillim. Në të gjitha reformat e mëdha legislative gjatë 60 viteve, SFAO është mbështetur në parimet e INTOSAI-t . Vitet 1967, 1994 dhe 1999 sollën ndryshime të rëndësishme në statusin ligjor të SFAO-s dhe fuqisë së auditimit.

Midis të tjerash, falë Deklaratës së Limës në 1977 institucioni përmbush sot kriterin kryesor të pavarësisë.

Si President i SFAO prej vitit 1998, kam marrë pjesë në pesë Kongrese (INÇOSAI), i pari në Montevideo, Uruguay. Në shumë raste kam pasur privilegjin të shoh se si tema të ndryshme janë përzgjedhur e trajtuar nën kujdesin e Sekretariatit të Përgjithshëm. Përgatitjet e kongreseve kanë qenë po aq të rëndësishme sa adoptimi i rezolutave. Për mua dhe SFAO-n pjesëmarrja aktive ishte një mundësi për të mësuar më shumë mbi këto tema, duke diskutuar ndryshimet tona me kolegë të vendeve të tjera dhe duke vlerësuar me sy kritik pozicionet tona. Jo të gjitha temat ishin me të njëjtën rëndësi për SFAO, por të gjitha temat na kanë ndihmuar në zgjerimin e horizonteve tona por edhe na kanë shtyrë të adresojmë çështje të cilat nuk kanë qenë parësore në axhendën tonë. Edhe nëse tema e INCOSAI-t ishte mbi parandalimin e korrupsionit, reformave administrative, borxhit publik apo përfitimet e SAI-ve, kishte gjithmonë gjetje interesante për t'i marrë me vete në Zvicër.

Përveç pjesëmarrjes në kongrese, pjesëmarrja në grupe studimore ka qenë një përvojë e pasur, si një familje e madhe e cila merret me të gjitha problemet e fëmijëve të saj. Me fjalë të tjera e njoha dhe e vlerësova moton e INTOSAI-t në mënyrën më të mirë: *“Experientia Mutua Omnibus Prodest”* (Eksperiencia e Përbashkët i Shërben të Gjithëve). Por shkëmbimi i informacionit është vetëm njëra anë e INTOSAI-t; njësoj të rëndësishëm edhe njerëzit me të cilët kam pasur kënaqësinë të takoj përgjatë këtyre viteve. Marrëdhëniet personale kanë provuar gjithmonë se janë “të paçmuara” dhe e kanë pasuruar punën tonë.

## 2 Zhvillimet e momentit brenda fushës së INTOSAI-t

Miratimi i Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së mbi pavarësinë e SAI-ve shënon një moment historik në historinë e INTOSAI-t, falë përpjekjeve të palodhura të Josef Moser, President i Gjykatës Austriake të Auditimit dhe Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t. Kjo i jep INTOSAI-t dhe kontrolleve financiare njohjen nga komunitetet ndërkombëtare të cilën e kanë merituar prej kohësh për kontributin e tyre në demokracinë dhe qeverisjen e mirë.

Me planin e tij strategjik, INTOSAI ka krijuar kuadrin e duhur dhe në të njëjtën kohë ka vendosur një grup udhëzimesh për SAI-t individual.

Implementimi me sukses, padyshim që do të ndihmohet nga fakti që Drejtoresha e Planifikimit Strategjik Monika Gonzalez ka punuar për disa vite në Sekretarinë e Përgjithshme dhe ka njohuri të thelluara për INTOSAI-n, duke punuar si audituese e jashtme e INTOSAI-t në vitet 2001 deri në 2007. Unë personalisht do të dëshmoj për nivel të lartë përkushtimi dhe profesionalizmi në stafin e Sekretariatit të Përgjithshëm.




INTOSAI Auditorët e jashtëm nga SAI të Paragujit dhe Zvicër me Sekretarin Përgjithshëm, Z. Josef Moser, dhe stafi i tij, Vienna, Austria, 2007

### 3 Sfidat e ardhshme me të cilat do përballlet INTOSAI

Sfidat me të cilat përballen vendet në një botë të globalizuar janë edhe ato të SAI-ve. Problemet mjedisore do të jenë padyshim më të rëndësishmet, veçanërisht ato që kërkojnë një vëmendje ndërkombëtare. Dhe kush është në pozitë më të mirë se INTOSAI për t'i siguruar një forum për bashkëpunim SAI-ve? Krizat financiare dhe ato të borxheve kanë theksuar rëndësinë e SAI-ve në të ardhmen: jo vetëm për të treguar përmirësimet e nevojshme për masat e shtetit por ato gjithashtu do të duhet të japin paralajmërim paraprak për çdo zhvillim të padëshirueshëm. Për të qenë i besueshëm në këtë rol, SAI-t do të duhet të jenë të pavarura dhe profesionale. Pavarësia dhe profesionalizmi, të dyja të promovuar nga INTOSAI, sigurojnë zhvillimin e vazhdueshëm dhe përmirësimin e sistemeve të ndryshme politike, mbështesin transparencën më të madhe dhe në këtë mënyrë një shoqëri civile të fortë. Me Iniciativën për Zhvillimin e INTOSAI (IDI), organizata ka krijuar një instrument efektiv për të ndarë këto njohuri edhe me vendet që kanë ende për të ngritur institucionet e tyre. Zvicra e konsideron veten me fat që ka qenë një financuese e IDI-t për shumë vite deri tani.

Për ta përmbledhur, unë do të doja t'ju kujtoj Nenin 14 të Deklaratës së të Drejtave të Njeriut dhe të Qytetarit, 31 gusht 1789: "Të gjithë qytetarët kanë të drejtë të vendosin, qoftë personalisht ose nga përfaqësuesit e tyre, si për domosdoshmërinë e kontributit publik; për ta dhënë këtë lirisht; ashtu dhe të dinë se për çfarë përdoret ajo që është dhënë; dhe për të rregulluar përqindjen, mënyrën e vlerësimit dhe të mbledhjes, dhe kohëzgjatjen e taksave." Nga Deklarata e të Drejtave të Njeriut, Dokumenti Final thotë: *se një pikënisje e rëndësishme për ndërtimin e institucioneve demokratike është që qytetarët e një vendi duhet të jenë në gjendje të mbajnë përfaqësuesit e tyre të përgjegjshëm. Përfaqësuesit e zgjedhur në mënyrë demokratike mund të qëndrojnë vetëm nëse ata mund të mbajnë përgjegjësi për vendimet e tyre. Prandaj Parlamenti ka nevojë për një trup në formën e SAI-t që të mund të kontrollojë ose auditojë përmbushjen e përgjegjësive.*

Do të deshiroja të perfitoja nga ky rast për t'i uruar INTOSAI-t dhe Sekretarit të Përgjithshëm, Josef Moser, sukses të vazhdueshëm në të ardhmen.








## Kontributi nga SAI i Ukrainës

Bashkëpunimi për Zhvillimin Ndërkombëtar:

Rruga për një të Ardhme më Cilësore





## Kontributi nga SAI i Ukrainës

*Komiteti i Standardeve Profesionale (PSC) Anëtar*

*Komiteti Kapacitetit Ndërtimit (CBC)*

*Komiteti Shpërndarjes së Njohurive (KSK)*

*NënKomiteti i Auditimit të Pajtueshmërisë*

*NënKomiteti i Standardeve të Kontrollit Brendshëm*

*Nënkomiteti i Kontabilitetit dhe Raportimit*

*Grupi i Punës për Borxhin Publik*

*Grupi i Punës për Auditim Mjedisor*

*Grupi i Punës për Përgjegjshmërinë dhe Kontrollin e Ndhmës lidhur me Fatkeqësitë*

*Grupi Punës për Treguesit Kyç Kombëtare*

*NënKomiteti 1: Promovimi i Rritjes së Kapaciteteve ndërmjet anëtarëve të INTOSAI*

### **Bashkëpunimi për Zhvillimin Ndërkombëtar: Rruga për një të ardhme me cilësi**

Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve të Larta të Auditimit (INTOSAI) feston 60 vjetorin e tij. Ky rast i jep mundësinë për të vlerësuar rezultatet dhe arritjet. Për një organizatë ndërkombëtare, 60 vjetori është gjithashtu një ngjarje që na fton të shikojmë në perspektivat e ardhshme dhe për të përpunuar planet të cilat do të bazohet në përvojën që ka fituar komuniteti ndërkombëtar i auditimit.

Nëse ne shikojmë në aktivitetet e INTOSAI-t, na vjen natyrshëm të theksojmë përfitimet e pakushtëzuara dhe nevojën e kësaj organizate si një qendër e bashkuar që drejton, akumulon dhe promovon zhvillimin e anëtarëve të tij, si dhe institucionet e auditimit në gjithë botën.

Organizimi dhe koordinimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimit i përvojës kanë qenë gurët kryesorë të aktiviteteve të INTOSAI gjatë gjithë periudhës së ekzistencës së tij. Duke i ofruar anëtarëve të tij një forum transparent bashkëpunimi, ai u jep atyre mundësinë për të shkëmbyer në mënyrë efektive informacion, ide dhe përvojë profesionale. Ajo gjithashtu siguron instrumentet për elaborimin e procedurave të përgjithshme dhe për përcaktimin e standardeve dhe normave të auditimit të bazuara në përvojë.

Kjo çon në një rritje të besueshmërisë dhe të suksesit të auditimeve të kryera nga anëtarët e INTOSAI-it. Suksesi i aktiviteteve të INTOSAI-it është ilustruar nga pozita e përforcuar e SAI-ve, njohja e pavarësisë së tyre dhe rritja e anëtarësimit në INTOSAI. Si pasojë e miratimit të Deklaratës së Limës (1977) dhe Deklaratës së Meksikos për Pavarësinë e SAI-ve (2007), INTOSAI dhe Sekretariati i Përgjithshëm, ka mundur të përpunojë qasje të përbashkëta dhe të unifikuara



në mënyrë që të forcojë rolin e institucioneve të auditimit në sistemin e administratës publike dhe për të vënë në përdorim praktikatat më të mira.

Sot, politikatat ekonomike në përgjithësi dhe auditimi i qeverisjes në veçanti demonstron në nivel global se duke u bazuar në përvojën kombëtare të dikujt nuk është gjithmonë e mjaftueshme për marrjen e një vendimi efektiv. Kjo është arsyeja pse bashkëpunimi i frytshëm i Institucioneve të Auditimit është më i rëndësishmi për realizimin e detyrave të tyre në mënyrë efektive dhe të suksesshme. Në të njëjtën kohë, Institucionet e Larta të Auditimit në çdo vend veprojnë në mjedise të ndryshme politike dhe ekonomike dhe kanë statuse dhe autoritete të ndryshme. INTOSAI respekton plotësisht pavarësinë e çdo SAI dhe të drejtat e tyre për të përcaktuar drejtimet dhe aktivitetet e tyre. Një nga specifikat kryesore të kësaj organizate është se nuk përpiket t'i diktojë anëtarëve të saj se si të zbatojnë masat. Standardet e INTOSAI-t vijnë në formën e rekomandimeve që përfshijnë praktikatat më të mira. INTOSAI i jep Institucioneve të Larta të Auditimit mundësinë për të përdorur dhe përshtatur këto rekomandime, duke marrë parasysh autoritetet e tyre, politikën kombëtare dhe veçoritë ekonomike. Një zhvillim i pavarur nga çdo SAI është i mundur vetëm në kushtet e një rruge demokratike. Dhe ky është burimi i përvojës së dobishme për institucionet e tjera.

Përveç kësaj, një përparësi thelbësore e INTOSAI është se, në praktikë aktivitetet e saj mbulojnë të gjitha drejtimet kryesore dhe komponentëve të auditimit të qeverisjes. Kjo i jep çdo SAI mundësinë për të marrë informacione metodike dhe metodologjike të cilat janë më aktuale dhe të rëndësishme.

Në vitet e para pas shpalljes së pavarësisë së Ukrainës, vendi u përball me problemin e krijimit të një sistemi të kontrollit parlamentar të pavarur dhe transparent të financave të shtetit. Bazuar në përvojën ndërkombëtare, ishte mjaft e qartë që një institucion i tillë mund të ishte Dhoma e Kontabilitetit, e cila ishte themeluar në vitin 1996. Si një institucion i pavarur auditimi, institucioni ynë zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje me parimet e ligjshmërisë, planifikimit, objektivitetit, pavarësisë dhe transparencës. Audituesit ukrainas kanë mundësi për të studiuar praktikatat më të mira ndërkombëtare në lidhje me auditimet e qeverisjes, për të futur forma dhe metoda moderne të auditimit në aktivitetet e tyre, për të shkëmbyer informacion dhe për të zgjeruar fushën e marrëdhënieve profesionale. Kjo e gjitha është bërë e mundur për shkak të faktit se Dhoma e Kontabilitetit të Ukrainës iu bashkua INTOSAI-t.

Është mjaft e qartë se një transferim i drejtpërdrejtë i përvojës së jashtme në Ukrainë nuk është gjithmonë e mundur dhe e arsyeshme, por njohuritë që vendet e tjera kanë fituar në lidhje me auditimet e qeverisjes, duke studiuar mbi arritjet dhe problemet e tyre, na ndihmojnë padyshim në rrugën tonë për të ndërmarrë këto auditime.

Në fazat e para të zhvillimit të Dhomës së Kontabilitetit të Ukrainës, aktivitetet e SAI-ve ndërkombëtare janë drejtuar kryesisht drejt studimit të standardeve të INTOSAI-it, për të mësuar nga përvoja e avancuar e anëtarëve të tjerë në fushën e zhvillimit dhe duke aplikuar standardet, procedurat, metodat dhe mjetet juridike si dhe në drejtim të shkëmbimit të informacionit dhe pjesëmarrjes në konferencat dhe seminarët e INTOSAI-t dhe EUROSAT-t.

Paralelisht me transformimet dhe proceset e brendshme institucionale, cilësia e bashkëpunimit ndërkombëtar e Dhomës së Kontabilitetit të Ukrainës ka ndryshuar. Deri më sot, Dhoma e Kontabilitetit të Ukrainës arriti në përfundimin e bashkëpunimit dypalësh në marrëveshje me 22 SAI anëtare. Nga marrëveshjet përfitojmë konsultime mbi metodologjinë dhe standardet e auditimit të qeverisjes, procedura dhe metoda, përmirësime në sistemin e auditimit



dhe llogaridhënies, transparencës në formimin dhe zbatimin e politikave shtetërore, trajnimin profesional dhe auditime paralele të koordinuara për çështje me interes të ndërsjellët.

Dhoma e Kontabilitetit të Ukrainës merr pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet e Komiteteve të INTOSAI dhe nënkomitetet, në veçanti në Komitetin Profesional të Standardeve INTOSAI, Komitetin e Ndërtimit të Kapaciteteve, Grupit të Punës për Auditimin Mjedisor, Grupi Punës për Borxhet Publike dhe Grupit të Punës për Treguesit Kyç Kombëtare dhe në Grupin e Punës EUROSAI për Auditim Mjedisor dhe Grupi e Punës për IT.



Takimi i 6 i Grupit Punues EUROSAI për Auditimin e Mjedisit në Kiev, Ukrainë, 2008



Në vitin 2008 në Kongresin e VII EUROSAI, Dhoma e Kontabilitetit të Ukrainës u zgjodh për një mandat gjashtë-vjeçar nga Bordi Drejtues i EUROSAI.



Më 30 Prill 2009, Dhoma e Kontabilitetit është përzgjedhur si audituesi i jashtëm i OSBE-së. Ky ishte një nder për Dhomën e Kontabilitetit të Ukrainës dhe një ngjarje historike për OSBE-në dhe për Ukrainën si një anëtare e kësaj organizate, sepse ishte hera e parë në historinë e OSBE-së që ky pozicion i lartë u mbajt nga një institucion që përfaqëson një ish shtet të Bashkimit Sovjetik. Më 15 Prill 2010, u mor vendimi për të rinovuar kompetencat plenare të Dhomës së Kontabilitetit të Ukrainës për dy vjet, kjo për shkak të realizimit të suksesshëm të detyrave të saj si auditues i jashtëm i OSBE-së. Në muajin Mars 2012 ky pozicion u rinovua edhe për 1 vit.

Mbledhja e 35-të e Bordit drejtues EUROSAI në Parlamentin e Ukrainës, Kiev, 2009

Përveç kësaj, Dhoma e Kontabilitetit të Ukrainës kryesoi EUROSAI Task Forcës mbi Auditimin e Fondeve të akorduara për Fatkeqësitë dhe Katastrofat. Nga Rezoluta e Kongresit të VIII të EUROSAI mbajtur në Lisbonë në qershor 2011, anëtarëve të Task Forcës iu rinovua kontrata



edhe për tre vitet në vijim (deri në 2014).

Dhoma e Kontabilitetit të Ukrainës si pjesë e komunitetit global të Institucioneve të Larta të Auditimit përfshin të gjitha parimet themelore të INTOSAI dhe vlerat e auditimit të jashtëm të qeverisjes.

Zhvillimet globale janë vazhdimisht në ndryshim, sidomos në fushën financiare. Në kohën e krizave financiare dhe të stanjacionit ekonomik, roli i SAI-t është rritur në mënyrë të qëndrueshme, si dhe nevoja për marrjen e kualifikimeve të reja. Pavarësia, objektiviteti, auditimi jo-paragjykses që realizohet vetëm nga Institucionet e Larta të Auditimit duhet të jetë prioritet i ardhshëm i aktiviteteve të anëtarëve të SAI-t.

Në këtë kontekst, Dhoma e Kontabilitetit të Ukrainës përcaktoi disa prioritete për aktivitetet e saj që na lejojnë ne të jemi në puls të zhvillimeve financiare, ekonomike dhe zhvillimeve sociale në vendin tonë:

**Së pari:** Sigurimi i një rritjeje të vazhdueshme të njohurive me sfond financiar dhe çështjeve ekonomike, e cila përfshin praktikën më të mirë për menaxhimin dhe tejkalimin e krizës dhe pasojave të saj.

**Së dyti:** Shfrytëzimit të njohurive me këtë sfond në procesin e auditimit dhe në përpunimin e propozimeve në lidhje me tejkalimin e krizës dhe të pasojave të saj.

**Së treti:** Ruajtja dhe forcimi i besimit të publikut në institucionin tonë dhe në rezultatet e veprimtarive tona.

**Së katërti:** Kryerja e Auditimeve dhe marrja e masave në lidhje me:

- Aktivitetet e qeverisë, institucionet financiare shtetërore që merren me kontrollin e brendshëm;
- Zbatimin e akteve ligjore duke përfshirë edhe aktet që kanë për qëllim tejkalimin e krizës;
- Problemet sociale dhe populizmi, i cili u bë një nga shkaqet kryesore që solli paqëndrueshmëri dhe fenomenin e krizës në financat e komunitetit dhe shtetit;
- Ngritja e akteve anti-korrupsion.

**Së pesti:** Forcimi i kontrollit në lidhje me përgatitjen dhe implementimin e buxhetit kombëtar duke theksuar ekspertizën e projekteve të saj në lidhje me efektivitetin e masave drejtuar tejkalimit të pasojave të krizës financiare dhe ekonomike në sferën sociale; perspektiva e zbatimit të buxhetit;

**Së gjashti:** Forcimi i rolit të planifikimit me qëllim theksimin paraprak të problemeve e fenomeneve të krizës.

Në ditët e sotme, qeveritë e të gjitha vendeve përpiqen për të kapërcyer krizën dhe për të zbatuar masa aktive, duke luftuar me pasojat e saj. Është për të ardhur keq që rezultatet e arritura nuk janë gjithmonë të plota, objektive dhe të përdorshme për analiza.

Në lidhje me këtë, një vlerësim i efektivitetit të përdorimit të financave publike drejtuar tejkalimit të krizës është e nevojshme, si dhe një analizë e efikasitetit të parashikimeve dhe të masave të marra për të parandaluar ose zbutur




rreziqet ekonomike. Për më tepër, ne do të duhet të punojmë për metodologjitë e reja shkencore për të arritur objektivat e vendosura.

Është e nevojshme të theksohet se kriza ekonomike ka paraqitur sfida të reja për institucionet tona. Në auditimet e qeverisjes, një nga detyrat është kalimi nga orientimi drejt rezultateve (e cila vlerëson aktivitetet dhe rezultatet e arritura) në orientimin prej problemit, i cili përfshin analizën e problemeve dhe shkaqeve të paraqitjes së tyre. Rezultat i një auditimi të tillë mund të jetë përgatitja e propozimeve për përmirësimin e legjislacionit, për të sjellë ndryshime strukturore të aktiviteteve të qeverisë, për të modernizuar financat e shtetit dhe për të rritur aktivitetet e nëpunësve civilë.

Me vënien e këtyre prioritetëve në praktikë, ne nuk duhet të harrojmë që të zhvillojmë potencialin institucional dhe atë të burimeve njerëzore për shkëmbimin e përvojës dhe njohurive ndërmjet SAI-ve. E gjithë kjo është e parashikuar në Planin Strategjik të INTOSAI-t 2011-2016.

Dhoma e Kontabilitetit të Ukrainës, si dhe Institucionet e tjera të Auditimit, janë në gjendje të përmbushin me sukses kërkesat e përcaktuara në Kushtetutë dhe në Deklaratat e Limë për të qenë plotësisht të pavarur (përfshirë pavarësinë financiare). Për këtë qëllim, paanshmëria, transparenca dhe efektiviteti i auditimit publik të financave nga Institucionet e Larta të Auditimit, kanë si parakusht kryesor pavarësinë politike.

Në këtë kontekst, ne vetëm mund të përgëzojmë INTOSAI-n për nismën e tij, për shkak të së cilës Rezoluta A/66/209 nxiti eficiencën, përgjegjshmërinë, efektshmërinë dhe transparencën e administratës publike, duke forcuar institucionet e larta të auditimit u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 22 Dhjetor 2011. Sipas kësaj Rezolutive, Institucionet e Larta të Auditimit mund të kryejnë detyrat e tyre objektivisht dhe në mënyrë efektive vetëm nëse ato janë të pavarura ndaj subjektit të audituar dhe janë të mbrojtura nga ndikimet e jashtme.








Kontributi nga SAI i  
Emirateve të Bashkuara Arabe

RRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT DHE  
BASHKËPUNIMI SHUMËPALËSH





## Kontributi nga SAI i Emirateve të Bashkuara Arabe

*Nënkomiteti për Kontabilitetin dhe Raportimin – Anëtar*

*Grupi i Punës për Luftën kundër Korrupsionit dhe Pastrimit të Parave*

### Rritja e ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimi shumëpalësh

#### Së bashku për të mbrojtur fondet publike

Institucioni Suprem i Auditimit i Emirateve të Bashkuara Arabe, në Maj të vitit 2012, ka nisur një fushatë ndërgjegjësimi që synon të theksojë ndërgjegjësimin publik mbi rëndësinë e mbrojtjes së fondeve publike dhe rolin e tyre në ruajtjen e pasurisë së Emirateve të Bashkuara Arabe (EBA). Të gjithë individët dhe subjektet kanë përgjegjësinë kombëtare për të mbrojtur fondet publike nëpërmjet mbështetjes së tyre për iniciativat e SAI-t të luftës kundër korrupsionit por gjithashtu dhe duke njohur rolin e rëndësishëm që SAI luan në sigurimin për përdorimin më të mirë dhe më efektiv të fondeve publike. Strategjia e SAI-t ishte të bënte ndryshime konjitive/ njohëse, drejtuese dhe më pas të sjelljes për kategoritë e synuara duke gdhendur parimet dhe vlerat që përcillen nëpërmjet mesazheve në mendësinë e njerëzve dhe për më tepër duke i nxituar ata të veprojnë në pajtueshmëri me sistemet, rregullat dhe ligjet.

Për më tepër, publiku do të jetë më i ndërgjegjshëm dhe do të nxisë etikën e punës po ashtu dhe shmangien e çështjeve të dyshimta si dhe t'i raportojë rastet kur ato shfaqen. Audiencia e synuar e fushatës ishin të gjithë punonjësit e SAI-t , studentët e universiteteve dhe kolegjeve si dhe të gjithë punonjësit e sektorit publik e privat të Emirateve të Bashkuara Arabe. Nëpërmjet saj , SAI pati mundësinë të arrinte shumë prej objektivave kryesore/ të pritshme të fushatës sikurse janë listuar më poshtë:

1. Rritja e ndërgjegjësimit publik mbi mashtrimin dhe rëndësia e ruajtjes së fondeve publike.
2. Nxitja e publikut për të mësuarit mbi rreziqet e korrupsionit dhe raportimin e mashtrimeve.
3. Inkurajimi i audituesve të SAI për të nxitur e promovuar standardet e qeverisjes dhe performancës.
4. Rritja e nivelit publik të shkëmbimit të informacionit midis SAI-t , publikut dhe subjekteve, njësisve kompetente lidhur me mbrojtjen e fondeve publike.



*Pjesëmarrësit në fushatën e ndërgjegjësimit të Institucionit Suprem të Auditimit në EBA, 2012*



Fushata ishte e suksesshme në shumë nivele; ajo u publikua në mënyrë të tillë që siguroi mbulimin maksimal me rrugët më të thjeshta. Kjo nuk rriti vetëm numrin e njerëzve të përfshirë në fushatë, por ajo siguroi që ne gjithnjë mund të punojmë me publikun nëpërmjet një faqeje interneti të fushatës.<sup>1</sup>

Gjithashtu, ajo kishte në objektiv të saj një pjesë të rëndësishme të komunitetit të Emirateve, e cila është rinia e vendit, ndaj është shumë e rëndësishme të ndërtohen njohuritë edhe më parë se kjo kategori t' bashkohet fuqisë punëtore, dhe si të tilla këto njohuri e dije do të shërbejnë si një instrument për të parandaluar mashtrimin.

Mbi të gjitha SAI i EBA beson shumë në angazhimin e publikut nëpërmjet punës së SAI-t si një institucion i pavarur. Të pasurit e mbështetjes së publikut është shumë i rëndësishëm për të qenë i aftë të veprosh akoma dhe më mirë.



*Pjesëmarrësit në programin e trajnimit të avancuar mbi auditimin financiar dhe qeverisjen korporative për punonjësit e Gulf Cooperation Council SAIs, 2012*

### **Rritja e profesionalizmit nëpërmjet bashkëpunimit shumëpalësh**

SAI- ka organizuar gjithashtu një trajnim të avancuar mbi auditimin financiar dhe qeverisjen korporative për punonjësit e SAI-ve të GCC (Gulf Cooperation Council). Ky program trajnimi tre ditor u organizua në vijueshmëri të përpjekjeve të SAI-t për të kontribuar në zhvillimin e veprimtarisë audituese në Këshillin e Bashkëpunimit të Gulf. Kjo gjithashtu është në pajtueshmëri me planin e trajnimit të hartuar nga Këshilli i Zhvillimit të SAI-ve të GCC, i cili ka si qëllim të përmirësojë performancën e audituesve dhe aftësitë në fushat e auditimit të njësive qeverisëse.



Programi u është adresuar disa temave që lidhen me auditimin financiar dhe kuadrin e qeverisjes korporative krahas disa faktorëve që mund të ndikojnë mbi to. Ai gjithashtu ngre problemin se si të përdoren procedurat analitike për identifikimin e elementëve të auditimit sipas SNA (ISA) 520. Përmbajtja e programit të trajnimit u hartua në përputhje me praktikat më të mira dhe tendencave më të fundit ndërkombëtare për trajnimin dhe kualifikimin e audituesve.


Për më tepër programi theksoi rëndësinë e përdorimit dhe zhvillimit të kontrolleve të korporative në njësitë e qeverisjes krahas prezantimit të elementëve kyç të qeverisjes korporative dhe auditimit me bazë risku. Ai gjithashtu theksoi dobësitë në qeverisjen korporative në nivele të menaxhimit strategjik, menaxhimit të burimeve dhe auditimit. Pjesëmarrësit vlerësuan përfitimet dhe dobishmërinë e programit të trajnimit. Ata gjithashtu vërejtën se përmbajtja e workshop-it përfshinte disa aplikime dhe ushtrime praktike, të cilat mund të zbatohen direkt në fushën e qeverisjes korporative.

<sup>1</sup> <http://saiwb1.saiuae.gov.ae/English/Campaign/Pages/CampaignGoals.aspx>



### ***Implementimi i objektivave të INTOSAI***


Institucioni Suprem i Auditimit të Emirateve të Bashkuara Arabe është shume i interesuar në përhapjen e njohurive audituese referuar kështu një prej objektivave të rëndësishme dhe strategjike të INTOSAI. Në këtë mënyrë, është punuar ngushtë në nivel rajonal ashtu dhe të brendshëm për rritjen dhe përmirësimin e njohurive dhe ekspertizës si në komunitetin e auditimit ashtu dhe në komunitetin e rregullt (joauditues). Sigurisht që ofrimi i trajnimeve jo vetëm që nxit një kuptim dhe zbatim të ri dhe ndoshta më të përmirësuar të disa koncepteve , por gjithashtu ai pasuron pjesëmarrësit me një koncept të ri të aplikimit që ndoshta ata nuk e kanë menduar më parë dhe që lidhet direkt me forcimin dhe ndërtimin e kapaciteteve të SAI-t. Më së fundi , ai forcon akoma dhe më shume lidhjet që Institucionet Supreme te Auditimit kanë me njëri tjetrin.





## Kontributi i SAI- të Mbretërisë së Bashkuar

Në 60 – vjetorin e INTOSAI-t







## Kontributi nga SAI i Mbretërisë së Bashkuar

*Nënkomiteti 1: Promovimi i veprimtarive të rritjes së ndërtimit të kapaciteteve*

*ndërmjet anëtarëve të INTOSAI*

*Kryetar*

*Komiteti i Standardeve Profesionale (PSC)*

*Anëtar Komiteti i Ndërtimit të Kapaciteteve(CBC)*

*Komiteti Drejtues i Komitetit të Shpërndarjes së Njohurive,*

*Komiteti Drejtues i Auditimit Financiar*

*Nënkomiteti i Auditimit të Performancës*

*Nënkomiteti i Standardeve të Kontrollit të Brendshëm*

*Nënkomiteti i Grupit të Punës mbi Auditimin e TI*

*Grupi i Punës mbi Auditimin e Ambientit*

*Grupi i Punës për Vlerat dhe Përfitimet e SAI-ve*

*Grupi i Punës mbi Modernizimin Financiar dhe Reformës Rregullatore.*

### **Zhvillimi i bashkëpunimit ndërkombëtar të SAI-ve që nga viti 1953**

Zyra Kombëtare e Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar është krenare të jetë anëtar aktiv i familjes së INTOSAI-t dhe të luajë rolin e saj në përhapjen e praktikave më të mira audituese dhe të të mësuarit nga kolegët tanë ndërkombëtarë. Gjatë viteve, NAO ka kërkuar të demonstrojë angazhimin e saj për INTOSAI-n dhe anëtarët e tij nëpërmjet pjesëmarrjes së saj në Bordin Qeverisës së INTOSAI-t, dhe udhëheqjen prej saj të Grupeve të ndryshme të Punës, Task Forcave dhe Nënkomiteteve të INTOSAI-t. Dy shembuj të kësaj udhëheqjeje janë roli që NAO ka luajtur në shkëmbimin e eksperiencave në auditimin e privatizimeve dhe të mbikëqyrjes dhe përgatitjen e Gazetës së Teknologjisë së Informacionit të INTOSAI-t.

Në 1993, NAO inicioi Grupin e Punës së INTOSAI-t për Privatizimin , i cili më vonë u quajt Grupi i Punës për Privatizimin, Rregullimin Ekonomik dhe Partneriteti Publiko-Privat. Ky Grup Pune ofroi mundësinë për komunitetin e SAI-ve për të mësuar shpejt nga njeri tjetri në një kohë kur shume vende po zbatonin programet e privatizimeve, prezantimin e rregulloreve më të mëdha ekonomike, dhe përdorimin e partneriteteve publiko-private për të ofruar shërbime publike dhe për të ndërmarrë projekte kapitale. NAO ka patur nderin të marrë Çmimin Jörg Kandutsch (Jörg Kandutsch Award) në INCOSAI-n e 2004 në njohje të kontributeve që ajo ka dhënë në këtë grup pune.

Për dymbëdhjetë vjet NAO publikoi Revistën e TI së INTOSAI-t (IntoIT) dhe mbajti faqen e internetit për Grupin e Punës mbi auditimin e TI ( WGITA) . Interesi i anëtarëve të INTOSAI-t për auditimin e TI po rritet vit pas vit dhe 20 publikimet e



Revistës të publikuara nga NAO siguruan një forum për përhapjen e rasteve studimore teknike dhe eksperiencave të anëtarëve të SAI-ve.

Një nga manifestimet publike më jetëgjata të vënies në jetë të motos *Experientia Mutua Omnibus Prodest* ( *Nga eksperiencia e përbashkët përfitojnë të gjithë*) ka ardhur nëpërmjet Kongresit trevjetor të INCOSAI-t dhe të Grupeve të Punës Rajonale. NAO ka një histori të fuqishme , të qëndrueshme të kontributit në përgatitjen dhe ofrimin e suksesshëm , të një game të gjerë të temave të Kongreseve të INCOSAI dhe EUROSAI gjatë viteve.

Po ashtu si partneritet në nivel të INTOSAI, NAO ka qenë aktive në forume të ndryshme të SAI-ve . Këto SAI që janë gjithashtu anëtarë të Bashkësisë mbajnë gjithashtu një konferencë çdo tre vjet. NAO e Mbretërisë së Bashkuar së bashku me SAI të tjerë ishte shumë e rëndësishme në krijimin e një fondi për të mundësuar SAI-t që të kenë akses financimi për të realizuar këto konferenca.



Auditori dhe Kontrollori i Përgjithshëm i NAO së Mbretërisë së Bashkuar ,  
Mr Amyas Morse, pjesëmarrja në Konferencën e 21- të  
të Auditorëve të Përgjithshëm të Bashkësisë në Windhoek, Namibia, 2011

### Zhvillimet e mëparshme brenda INTOSAI

Një nga pikat më të fuqishme të INTOSAI- t është aftësia e tij për ndryshim dhe rritje. Hartimi dhe miratimi i Planit të Parë Strategjik të INTOSAI-t ka qenë një hap i rëndësishëm përpara , veçanërisht në fushën e ndërtimit të kapaciteteve . Para vitit 2004, shumë prej SAI-ve kanë qenë të angazhuar në mënyrë aktive në mbështetje të njeri tjetrit- disa herë nëpërmjet përpjekjeve dypalëshe por shpesh me financime të siguruara nga Bashkimi Evropian nëpërmjet programeve të binjakëzimit apo të burimeve të agjencive ndërkombëtare të zhvillimit sikurse Baka Botërore. Megjithatë, kishte pak koordinim dhe shumë mbivendosje të përpjekjeve. Duke e vendosur ndërtimin e kapaciteteve në krye të Qëllimit të



INTOSAI-t dhe duke krijuar Komitetin e Ndërtimit të Kapaciteteve , u bë e mundur që të arrihet një qasje më bashkëkohore dhe e koordinuar për të mbështetur SAI-t.

Tre shtyllat e përpjekjeve të INTOSAI-t në këtë fushë janë:

- Komiteti Ndërtimit të Kapaciteteve – i kryesuar nga SAI i Marokut. Ky Komitet kërkon të punojë ngushtë me rajonet e INTOSAI-t për të identifikuar dhe përhapur praktikat më të mira. Ai ka qenë përgjegjës për përgatitjen e një serie të Udhëzimeve mbi tema të tilla si Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, Rishikimet e Ekspertëve, dhe Auditimet e Përbashkëta. Këto udhëzime ka qenë dhe janë përkthyer në shumë gjuhë të ndryshme dhe janë shpërndarë nëpërmjet një Programi të Master Classes i projektuar dhe administruar prej IDI (INTOSAI Development Initiative/ Iniciativës së Zhvillimit të INTOSAI-t);
- Iniciativa e Zhvillimit të INTOSAI (IDI) është e vendosur në Novergji dhe ofron trajnime dhe mbështetje për ndërtimin e kapaciteteve në mënyrë globale, me fokus të veçantë në mbështetjen për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit për SAI-t (ISSAI-t) dhe punën me rajonet; dhe
- Bashkëpunimi INTOSAI-Donatorë duke siguruar një forum për agjencitë ndërkombëtare të zhvillimit dhe komunitetin e SAI-ve për të rritur volumin dhe cilësinë e mbështetjes për SAI-t në vendet në zhvillim. Ky bashkëpunim ka treguar tashmë rezultatet pozitive me kërkesa për propozime globale për të identifikuar nevojat e shume SAI-ve të ndryshëm dhe Kuadrin e Matjes së Performancës duke siguruar një mjet potencialisht të dobishëm për vlerësimin e kapacitetit të SAI-t dhe monitorimin e progresit.

NAO ka qenë aktivisht i angazhuar me të gjitha këto iniciativa. Së bashku ato përfaqësojnë çfarë është më e mira për komunitetin e INTOSAI dhe kapacitetin e tij kolektiv për të mobilizuar burimet dhe për të gjetur energjinë dhe pasionin e audituesve individualë në të gjithë gamën e gjerë të institucioneve të ndryshme të auditimit për të dhënë përfundime të përbashkëta. Në gjithë këtë , roli i Sekretariatit të INTOSAI-t është jetësor për të siguruar kontaktin midis grupeve të ndryshme, përhapjen e informacionit dhe sigurisë që iniciativat e ndryshme janë paraqitur tek Bordi Qeverisës i INTOSAI-t.



*z.Martin Sinclair, SAI i Mbretërisë së Bashkuar, në mbledhjen e 62ntë Bordit Qeverisës të INTOSAI në Vienë, Austri, 2011*



## Sfidat e ardhshme për INTOSAI-n

INTOSAI ka bërë përparime të mëdha , veçanërisht vitet e fundit. Miratimi nga OKB dhe adoptimi i standardeve ndërkombëtare të auditimit - ISSAI – e vendosin tashmë organizatën në qendër të vëmendjes në përpjekjen ndërkombëtare për përmirësimin e qeverisjes dhe transparencës. Por me këtë njohje vijnë dhe sfida të reja. Marrëveshjet qeverisëse të vetë INTOSAI-t duhet të aspirojnë për standardet më të larta, duke ecur me të njëjtin hap, dhe dukë shtuar vlerë për nevojat e qëndrueshme për zhvillim të një organizate moderne progresive. Dhe kredibilitetit, besueshmëria e INTOSAI-t si një organ që vendos standardet kërkon që këto struktura të ruajnë dhe zhvillojnë ISSA-t dhe për të siguruar cilësinë duhet të vendoset aplikimi i tyre.

Çuarja përpara e këtij roli , si dhe të tjerë që burojnë nga puna e pjesëve të tjera të INTOSAI-t do të kërkojë vendosjen e prioriteteve dhe bashkim të kujdesshëm të burimeve. Ne nuk do të jemi të aftë t'i bëjmë këto menjëherë ose të paktën të gjitha në të njëjtën kohë. INTOSAI është i varur në një masë të madhe nga vullneti i anëtarëve, dhe me disa vende duhet investuar kohe dhe përpjekje të rëndësishme.

Këto burime kanë nevojë të menaxhohen me kujdes dhe për të kryer punën e INTOSAI-t nevojitet të gjenden rrugët me efikente – përdorim më i madh i teknologjisë moderne dhe një qasje më e kujdesshme për të krijuar grupe të reja pune dhe task forcat. Ne nuk mund të marrim të mirëqenë që qeveritë e vendeve anëtare do të vijojnë të ofrojnë burimet që janë të nevojshme për të menaxhuar INTOSAI-n nëse ne nuk mund të demonstrojmë se kemi përdorur burimet që kemi me sa më shumë kujdes që të mundemi.

Në gjithashtu duhet të gjejmë rrugët me të mira për të angazhuar të gjithë gamën e anëtarëve. INTOSAI- duhet të rishikojë çështjet e qeverisjes për të inkurajuar pjesëmarrje më të gjerë nëpërmjet psh. qarkullimit/rotacionit më të rregullt të kryetarëve të grupeve. Dhe duke ndjekur udhëheqjen e Komiteti të Ndërtimit të Kapaciteteve, duke siguruar fonde për të lejuar institucionet e auditimit me financim më të paktë të marrin pjesë në mbledhjet kyç.

Në një botë me ndryshime të shpejta procesi i planifikimit të INTOSAI-t do të duhet t'i kushtojë vëmendje skanimit të ambientit të gjerë për të identifikuar problemet e reja që kërkojnë vëmendjen e komunitetit të INTOSAI-t , duke kërkuar rrugët për të angazhuar anëtarësimin kolektiv , veçanërisht për rajonet , në procesin e planifikimit dhe të sigurojë që veprimtaritë e ardhshme janë prioritarizuar, u është llogaritur kostoja dhe është rënë dakord për burimet e financimit. Dhe në themel të të gjithë këtyre , INTOSAI duhet të vazhdojë përpjekjet për të siguruar që të gjithë anëtarët të kenë pavarësinë e nevojshme për të kryer auditime rigorozë dhe aftësinë për të paraqitur gjetjet tek Parlamenti dhe populli pa patur frikë nga pasojat. Rezoluta e OKB hap rrugën. Por më shumë është e nevojshme të bëhet për të siguruar që auditimet e kryera nga SAI-t e në të gjithë botën të kenë impakt real në jetën e taksapaguesve dhe qytetarëve. SAI-t mund të sjellin ndryshimin edhe duke luftuar humbjen , inefiçencën dhe mashtrimin duke kontribuar për qëllimet e zhvillimit global.


Në 60 – vjetorin e tij, INTOSAI është në një pozitë të mirë për t'u përballur me këto sfida.



Kontributi nga SAI i  
Shteteve të Bashkuara të Amerikës

60 vjet INTOSAI / 50 vjet

Sekretariat i Përgjithshëm në AUSTRI





## Kontributi nga SAI i Shteteve të Bashkuara të Amerikës

*Revista Ndërkombëtare e Auditimit Qeveritar*

*Grupi i Punës për Reformën Rregullatore dhe të modernizimit financiar*

*Task Forcë mbi Planifikimin Strategjik*

*Komiteti Standardeve Profesionale (PSC)*

*Komiteti Drejtues i PSC*

*Komiteti Ndërtimit të Kapaciteteve (CBC)*

*Komiteti Drejtues i BCB*

*Komiteti përkapjes së njohurive (KSC)*

*Komiteti Drejtues i KSC*

*Komiteti i Financës dhe Administrimit (FAC)*

*Nenkomiteti i Auditimit Financiar*

*Nenkomiteti i Standardeve të Kontrollit të brendshëm*

*Nenkomiteti i Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar*

*Grupi i Punës për Borxhin Publik*

*Grupi i Punës për Auditimin e Mjedisit*

*Grupi i Punës për Auditimitn e TI*

*Grupi i Punës për Vlerësimin e Programit*

*Grupi Punës për Luftën kundër korrupsionit dhe Pastrimit të Parave*

*Grupi i Punës për Përgjegjshmërinë dhe Auditimin e ndihmave për përballimin e fatkeqësive.*

*Grupi i Punës për Treguesit Kyç Kombëtar*

*Grupi i punës për vlerat dhe përfitimet e SAI*

*Task Force për parashikimet financiare të INTOSAI-t*

*Nënkomiteti për Database-n e informacionit*



*Nënkomiteti 1: nxitja e rritjes së veprimtarive për ndërtimin e kapaciteteve midis anëtarëve të INTOSAI*

*Nënkomiteti 3: Nxitja e praktikave më të mira dhe siguri i cilësisë nëpërmjet rishikimeve vullnetare nga kolegët.*

## **60 vjet INTOSAI / 50 vjet Sekretariat i Përgjithshëm në Austri**

Zyra Përgjegjshmërisë Qeveritare të Shteteve të Bashkuara (GAO) i jep përgëzimet e saj INTOSAI-t me rastin e 60 vjetorit të tij dhe 50 vjetorit të Sekretariatit të INTOSAI-t. Në vite, qëkurse i është bashkuar INTOSAI-t Shtetet e Bashkuara kanë qenë një anëtar aktiv dhe ka punuar së bashku me SAI-t e tjerë të botës për ta bërë INTOSAI-n një organizatë ndërkombëtare të fuqishme dhe efektive. GAO filloi të merrte pjesë aktivisht në INTOSAI në vitin 1969, atëherë kur Elmer Staats Kontrollori i Përgjithshëm u zgjodh në Bordin Qeverisës të INTOSAI-t. Në gjithë pjesëmarrjen e GAO-s në INTOSAI, Sekretariati i Përgjithshëm ka qenë një partner i rëndësishëm dhe mbështetje për aktivitetit tona.

Në një organizatë ndërkombëtare të tillë si INTOSAI- ky shkëmbimi i eksperiencave dhe mirëkuptimi i ndërsjelltë janë qëllime të rëndësishme thelbësore për të gjithë anëtarët- komunikimi efektiv është i një rëndësie të madhe në funksionimin e suksesshëm të organizatës.

Kjo ka qenë gjithnjë një prioritet i GAO-s për pjesëmarrjen në INTOSAI. Sekretariati i Përgjithshëm ka njohur gjithashtu rëndësinë e komunikimit – për shembull, nëpërmjet përpjekjeve të tij për të promovuar strategjinë e komunikimit për INTOSAI-n që ishte provuar në vitin 2010 në Kongresin e XX INCOSAI, në Johannesburg.

### **Revista e INTOSAI-t**



Nxitja e komunikimit efektiv dhe shkëmbimit të eksperiencave ka qenë qëllimi kryesor për GAO-n në rolin e saj si publikues i Revistës Ndërkombëtare të Auditimit Qeveritar (*International Journal of Government Auditing*). Revista është themeluar në vitin 1971 dhe GAO ka publikuar atë që prej vitit 1979, kur GAO pasoi SAI-n e Kanadasë. Revista ka qenë gjithmonë një platformë e gjallë komunikimi për INTOSAI-n dhe anëtarët e tij, duke lehtësuar një shkëmbim të frytshëm të eksperiencave, praktikave më të mira dhe njohurive për thujse katër dekada. Kryetari i bordit të INTOSAI-t, Sekretariati i Përgjithshëm auditorët e përgjithshëm të ndryshëm, po ashtu

*dhe stafet e SAI-ve nëpër botë, të gjithë ka shkëmbyer njohuritë dhe pikëpamjet në faqet e saj.*



Përfaqësuesit e Zyrës së Përgjegjshmërisë Qeveritare (GAO) në takimin e Taks Forcës së Strategjisë së Komunikimit të INTOSAI-t Vjenë, Austri, 2010

Revista mishëron parimet bazë të INTOSAI-t duke ofruar një zë të barabartë për të gjithë anëtarët dhe përpiqet për të siguruar përfaqësimin e të gjithë grupet rajonale dhe gjuhësore të organizatës. Gjatë viteve, përmbajtja e Revistës ka evoluar për të reflektuar dhe mbështetur ndryshimet në INTOSAI në përgjithësi. Ajo aktualisht përfshin lajme nga vendet anëtare, mbulon ngjarjet e INTOSAI-t dhe





aktivitetet profesionale të anëtarëve dhe organizatave rajonale të SAI-ve, dhe artikuj praktik mbi auditimin në sektorin publik- të tilla si rastet studimore , idetë apo metodologjitë e reja të auditimit, dhe mësimet e mësuara nga SAI-t.



*Tituj të ndryshem të Revistës Ndërkombëtare të Auditimit Qeveritar që në vitin 1971 në pesë gjuhë zyrtare të INTOSAI-t*

Revista gjithashtu punon për të përfshirë prioritetet organizative të INTOSAI. Për shembull, në vitet e mëparshme , Revista ka mbuluar tema prioritare të INTOSAI-t me qëllim që të promovohen objektivat e gjera të INTOSAI-t. Këto tema prioritare u propozuan nga Sekretariati i Përgjithshëm dhe u aprovuan nga Bordi si pjesë e strategjisë së komunikimit të INTOSAI-t. Në vitin 2009, Revista i dedikoi një temë speciale Pavarësisë së SAI-t, tema për 2009-2010. Në fillim të vitit 2011, Revista filloi të zhvillonte një tipar të veçantë për çdo çështje për të theksuar ISSAI-t dhe INTOSAI GOV, temat për vitin 2011-2012. Ky është thjesht një shembull i bashkëpunimit të suksesshëm midis Revistës dhe organeve të tjera të INTOSAI-t , përfshirë Sekretariatit e Përgjithshëm dhe Bordin Qeverisë.

Në të gjithë historinë e publikimit , Revista është mbështetur në rrjetin e partnerëve dhe vullnetarëve të SAI-ve në të gjithë botën të cilët përkthyen Revistën në gjuhët zyrtare të INTOSAI-t, ofruan lajme dhe artikuj, dhe ofruan mbështetje në përgjithësi. Pa këtë nivel të bashkëpunimit midis anëtarëve të komunitetit të INTOSAI-t, Revista do të mund të kish qenë mjet i komunikimit efektiv dhe i shkëmbimit të eksperiencës , dhe si i tillë vazhdon të jetë dhe sot.

### **INCOSAI XIV në Washington, D.C.**

GAO kishte nderin të mirëpriste INCOSAI XIV në Washington, D.C., më 18-23 Tetor 1992. Më shumë se 400 delegatë dhe vëzhgues nga 120 kombe anëtare dhe 10 organizata ndërkombëtare morën pjesë aktivisht në më shumë se 75 grupe diskutimi, workshope , mbledhje komitetesh dhe sesione plenare.

Temat e Kongresit ishin Auditimi në një ambient të ndryshueshëm: Roli evolues i SAI-ve dhe Përmirësimi Menaxhimit Financiar të Qeverisjes nëpërmjet Komiteteve të Përhershme të INTOSAI-t. Pjesëmarrja e plotë e shumë anëtarëve në Kongres dhe po aq e rëndësishme , gjatë tre viteve që nga Kongresi i Berlinit në 1989, rezultoi në një numër të rëndësishëm të arritjeve të INTOSAI-t në Kongres.

Si konkluzion i INCOSAI XIV, delegatët miratuan në mënyrë unanime dhe me duartrokitje sa më poshtë:



- standardet dhe udhëzuesit për auditimin dhe kontrollin e brendshëm dhe punën e tre komiteteve të përhershme të INTOSAI-t për kontabilitetin, borxhin publik , dhe përpunimin elektronik të të dhënave.;
- një protokoll të procedurave operative për punën e komiteteve të ardhshme;
- rishikimin e statutit të INTOSAI ; dhe
- Marrëveshjet e Washingtonit, që përmbanin rezultatet dhe rekomandimet për çështjet e kongresit.

Kongresi dhe Bordi Qeverisës reagueshan shpejt mbi këto arritje. Brenda kushteve të statutit të miratuar rishtazi, nga Kongresi i zgjodhën 7 anëtarë të rinj të Bordit, duke bërë që në Bord të ketë më shumë përfaqësues të sistemeve të ndryshme të auditimit po ashtu dhe shtatë Grupet Rajonale të Punës së INTOSAI-t. Në Mbledhjen e 37të të Bordit Qeverisës që ndoqën menjëherë Kongresin, tre komitete /grupe studimore të rinj (mbi privatizimin, vlerësimin e programit, dhe auditimin e ambientit) u krijuan si përgjigje e rekomandimeve që përmbanin Marrëveshjet e Washingtonit.

INCOSAI XIV ishte gjithashtu një kohë e rritjes për INTOSAI, dhe Sekretariati i Përgjithshëm iu bashkua INTOSAI që nga Kongresi i Berlinit. Sekretariati i Përgjithshëm raportoi në Kongresin e Washington, D.C., që kishte përpunuar tashmë aplikimet e anëtarëve të ndryshëm të ardhshëm dhe kishte dërguar në Bordin e Qeverisjes aplikimet e tyre për praninë në INTOSAI. Sekretariati i Përgjithshëm raportoi gjithashtu se ai kishte shpërndarë një pyetësor për SAI-t e vendeve që kishin dalë nga ish Bashkimi Sovjetik për të vlerësuar statusin ligjor të SAI-t në vendet individuale që dëshironin të bashkoheshin me INTOSAI.

Rritja e INTOSAI-t, të cilën Sekretariati i Përgjithshëm e ndihmoi duke udhëhequr , ka pasuruar organizatën dhe e ka drejtuar për shkëmbim më të fortë të ideve dhe eksperiencave. Për me tepër, Charles Bowsher, atëherë –Kontrollor i Përgjithshëm i Shteteve të Bashkuara dhe kryetar i Kongresit, vuri re që bashkëpunimi dhe komunikimi ndërmjet SAI-ve nëpër të gjithë botën para dhe gjatë Kongresit ka ndihmuar për të hapur rrugën për arritjet e takimit.

Përgatitja e INTOSAI për të ardhmen: Planifikimi Strategjik dhe iniciativa financimit të Donatorëve

Zhvillimi, miratimi dhe implementimi i Planit Strategjik të INTOSAI-t kanë qenë ngjarje të rëndësishme në historinë e INTOSAI.

Në Kongresin e Seulit në vitin 2001, një taks force 10-kombëshe , e udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara , u krijua për të zhvilluar një plan strategjik për INTOSAI-n. Tre vjet më vonë , Kongresi i Budapestit në vitin 2004 shënoi një moment historik në historinë e INTOSAI-t, kur 187 anëtarët e INTOSAI-t miratuan njëzëri planin e parë strategjik në historinë 50 vjeçare të organizatës.

Zhvillimi dhe miratimi i Planit Strategjik 2005-2010 të INTOSAI-t mishëronte shumë prej vlerave kryesore të INTOSAI-t , përfshirë konsultimin, kompromisin, konsensusin dhe komunikimin. Procesi i planifikimit strategjik pasqyron konsensusin për atë që kishte punuar mirë gjatë historisë së INTOSAI-t, vlerësim të veprimtarive në vijim të INTOSAI-t dhe parashikimin e ndryshimeve të nevojshme për të ndihmuar anëtarët t'u përgjigjen kërkesave me të cilat SAI-t përballen. Ashtu sikurse ka thënë Kontrollori i Përgjithshëm në atë kohë dhe kryetari i task forces David M. Walker “



qëllimi i planit strategjik nuk është të perfeksionojë të kaluarën por më shumë për të krijuar të ardhmen”. Në frymën gjithëpërfshirëse të INTOSAI-t plani strategjik i propozuar u qarkullua për të gjithë anëtarët e INTOSAI-t për rishikimin prej tyre. Pak pasi plani strategjik ishte miratuar në Kongresin e Budapestit, Bordi Qeverisës miratoi krijimin e pozicionit të drejtorit të planifikimit strategjik.

INCOSAI XIX në Meksiko City ishte një etapë tjetër e rëndësishme për pjesëmarrjen e GAO-s në INTOSAI. Kongresi i Meksikos City miratoi krijimin e dy task forcave nën Komitetin e Financës dhe Administrimit ( FAC): një task forcë për të përditësuar planin strategjik për periudhën 2011-2016, po ashtu dhe Task Forcën për Financimin e Donatorëve të INTOSAI-t, e cila u ngarkua me hartimin e një propozimi për financimin nga donatorët për të fuqizuar anëtarësimin e SAI-ve dhe mbështetur përpjekjet e INTOSAI-t për ndërtim kapacitetesh. Të dy task forcat udhëhiqeshin nga Kontrollori aktual i GAO-s Gene Dodaro.

Për përditësimin e planit strategjik , Shtetet e Bashkuara punuan në mënyrë bashkëpunuese me kryesuesit e objektivave, koordinatorët e objektivave, Sekretariatit e Përgjithshëm , drejtorin e planifikimit strategjik , dhe Bordin Qeverisës. Taks forca iu drejtua gjithashtu për konsultim Sekretariateve të Grupit të Punës Rajonal dhe përsëri u ofroi të gjithë SAI-ve Anëtar shansin/mundësinë për të rishikuar dhe komentuar mbi planin para prezantimit në INCOSAI-n XX në Johannesburg, në Afrikën e Jugut.

Në Johannesburg, kryetari i Task Forcës për Planifikimin Strategjiku miratua unanimisht. Për shkak se misioni u përmbush, task forca i shkri dhe funksioni i planifikimit strategjik u institucionalizua në Sekretariatit e Përgjithshëm me FAC Komitetin e Financës dhe Administrimit duke ruajtur përgjegjësinë për mbikëqyrjen e përgjithshme dhe monitorimin e implementimit. Kjo strukturë bashkëpunuese , me Sekretariatit e Përgjithshëm duke punuar së bashku me KFA/ FAC dhe organe të tjera të INTOSAI-t , sigurojnë që INTOSAI do të jetë i gatshëm për t’u përballur me krisat e së nesërme.

Task forca për financimin nga Donatorët shënoi gjithashtu një sukses kryesor që është i rëndësishëm për të ardhmen e INTOSAI-t. Pas afërsisht dy vjet përpjekjesh nga ana e task forcës dhe komunitetit të donatorëve , dhanë frytet e tyre kur përfaqësues të INTOSAI dhe 15 donatorë ose agjenci shumëpalëshe dhe kombëtare nënshkruan një memorandum mirëkuptimi (MoU) Në Bruksel më 20 Tetor 2009.

Memorandumi Mirëkuptimit bën bashkë SAI-t dhe komunitetin e donatorëve në një qasje të përbashkët që siguron (1) një fokus strategjik në vendet në zhvillim dhe (2) një larmishmëri mekanizmash për të lehtësuar financimin dhe mbështetjen nga donatorët në pajtueshmëri me mandatin e donatoreve , prioritetet dhe kërkesat e tyre.

Memorandumi i Mirëkuptimit ofron gjithashtu një strukturë qeverisëse duke konsistuar në një Komitet Drejtues të mbështetur nga një Sekretariat që siguron mbështetjen administrative. Përfaqësimi në Komitetin Drejtues INTOSAI-Donator përfshin Kryetarin dhe nënkryetarin e Komitetit të Financës dhe Administrimit, Kryetarin e Komitetit të Shkëmbimit të eksperiencave, Kryetarin e Krijimit të Kapaciteteve , Kryetarin e Komitetit të Standardeve Profesionale , Sekretariatit e Përgjithshëm, IDI, dhe Grupet e Punës Rajonale të INTOSAI-t. Që nga viti 2012 , Komiteti Drejtues INTOSAI-Donator është takuar katër herë, dhe organizata e 16 donatore ka nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit

Nëpërmjet Bashkëpunimit INTOSAI-Donator, Komiteti Drejtues vazhdon punën e tij për të implementuar Memorandumin e Mirëkuptimit, mbledhjen e informacionit mbi nevojat e SAI-ve , përshtatjen e propozimeve të



## EXPERIENTIA MUTUA OMNIBUS PRODEST


donatorëve si të jetë më e përshtatshme , koordinojë përpjekjet e planifikuara dhe të propozuara, dhe të zhvillojë rezervë fondesh për të plotësuar mbështetjen ekzistuese të SAI-ve. Me iniciativën e financimit të donatorëve , INTOSAI dhe komuniteti donatorëve po punojnë së bashku për të fuqizuar përgjegjshmërinë , transparencën, qeverisjen e mirë dhe miradministrimin e fondeve publik.

Përpjekjet e përbashkëta të fokusuar në të ardhmen e INTOSAI-t të tilla si Bashkëpunimi INTOSAI Donator dhe zhvillimi i planit strategjik të INTOSAI-t, tregojnë qartë se si INTOSAI po përgatit vetveten për akoma dhe më shumë sukses në 50 vitet e ardhshme.



## Kontributi nga SAI i Jemenit

ARRITJET E SAI-t TË  
JEMENIT NË INTOSAI





## Kontributi nga SAI i Jemenit

*Komiteti Standardeve Profesionale (PSC)*

*Komiteti Ngritjes Kapaciteteve (CBC)*

*Komiteti Drejtues i CBC*

*Komiteti Shpërndarjes së Njohurive(KSC)*

*Grupi i punës për Borxhin Publik*

*Grupi i Punës për Luftën Kundër Korrupsionit dhe Pastrimit të Parave*

*Nënkomiteti 1: Nxitja e rritjes së veprimtarive për ngritjen e kapaciteteve midis anëtarëve të INTOSAI-t*

## Arritjet e SAI-t të Jemenit në INTOSAI

Një ngjarje e rëndësishme për SAI –n e Jemenit ishte organizimi i Asamblesë së Përgjithshme të 9-të të Organizimit Arab të Institucioneve Supreme të Auditimit (ARABOSAI) në vitin 2007



*Kryetarët e Delegacioneve në Asamblesë e 9-te të Përgjithshme te ARABOSAI me Kryeministrin e Jemenit, Sana'a, Jemen, 2007*



*Asambleja e 9-te e ARABOSAI e mbajtur në Sana'a, Jemen, 2007*

Pjesëmarrja në përgatitjen e Planit të Parë Strategjik të po ashtu dhe organizimi i evenimenteve të trajnimit dhe prezantimi i Programeve të TI, janë disa prej arritjeve të SAI-t të Jemenit. Emri i ARABOSAI u ndryshua nga Grupi Arab i Institucioneve Supreme të Auditimit, dhe u bë një ristrukturim i disa prej komiteteve të përhershme, psh Komiteti i Trajnimit dhe Kërkimit Shkencor, Komiteti i Ndertimit së Kapaciteteve Institucionale dhe Komiteti i Standardeve Profesionale dhe të Auditimit. Për më tepër, ndryshime thelbësore u ndërmorën në Kartën e ARABOSAI-t, po ashtu dhe në Statutin e ARABOSAI-it, të cilat specifikojnë veprimtaritë e organizatës.

Në gjithashtu do të dëshironim të theksonim bashkëpunimin e intensifikuar midis ARABOSAI dhe Komunitetit të donatorëve, i cili rezultoi në një rritje të numrit të projekteve të zhvillimit të mbështetura dhe nxitura nga vetë Komuniteti i Donatorëve. Marrëdhëniet me Institucionet Supreme të Auditimit (SAI-t) u theksuan, fuqizuan dhe zhvilluan, gjë që çoi në përmirësimin e një numri aspektesh të punës audituese dhe në një shkëmbim më të madh të eksperiencave midis kolegëve të SAI-ve përkatës.

### ***Forcimi i pavarësisë së Institucionit Suprem të Auditimit të Jemenit***

Institucioni Suprem i Auditimit të Republikës së Jemenit ka bërë përpjekje për të arritur të ndryshojë Kushtetutën Jemenase me qëllim që të forcojë pavarësinë financiare, administrative dhe organizative të SAI-t të Jemenit në Ligjin Kushtetues. Për më tepër, SAI i Jemenit ka ndryshuar gjithashtu ligjin me qëllim që të theksohet kjo pavarësi. Doke bërë këtë, SAI i Jemenit pati mundësinë të referohej shtyllave të pavarësisë që ITOSAI miratoi në Kongresin e tij të XIX në Meksiko në vitin 2007.

SAI i Jemenit ka kontribuar ndjeshëm për forcimin e pavarësisë së Institucioneve Supreme të Auditimit si pjesë e iniciativës së lançuar nga Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI. Ai përgatiti një propozim i cili iu dërgua Këshillit Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara dhe i vazhdoi përpjekjet e tij derisa në Dhjetor të vitit 2011 u miratua Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Ky angazhim i SAI-t të Jemenit u mbështet nga fakti që ai





kryesonte ARABOSAI-n dhe që Republika e Jemenit drejtonte Grupin e të 77-ve. Miratimi i Rezolutës së OKB është një arritje e vërtetë në historinë e INTOSAI. Këto qëllime ambicioze dhe kjo arritje historike për INTOSAI-n dhe anëtarët e tij mundën të arrihen vetëm nëpërmjet një bashkëpunimi shumë të madh intensiv të të gjithë SAI-ve anëtarë, dhe me mbështetjen e Sekretarit të Përgjithshëm të INTOSAI, Josef Moser, forcës së palodhur lëvizëse të INTOSAI-t dhe me ndihmën e ZOTIT



Ish president ii SAI- t të Jemenit, Abdullah Abdullah Al-Sanafi, në Konferencën e INTOSAI për Forcimin e Auditimit të Jstëm Publik në Rajonet e INTOSAI-t të mbajtur në Vjenë, Austri, 2010

SAI i Jemenit ka qenë gjithashtu pritësi i mbledhjeve të Bordit Qeverisës të ARABOSAI dhe të mbledhjeve të Komitetit të Trajnimit dhe Kërkimit Shkencor. Si Kryetar i Bordit Qeverisës të ARABOSAI-t, SAI i Jemenit mori pjesë në konferencën e 2-te në kryeqytetin e Francës në vitin 2008.

## Arritjet e Drejtorisë për Bashkëpunimin Teknik dhe financimi projektit të bashkëpunimit në 2011

Si pjesë e Bashkëpunimit Teknik Jemeno-Gjerman ( Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar GIZ) në Amamn të Mbretërisë Hashemite të Jordanisë nga 16 deri më 21 Shtator të 2011 u organizua workshopi për zhvillimin e burimeve njerëzore të SAI-ve. Anëtarët e SAI-t të Jemenit morën pjesë në programin e trajnimit Auditues i Brendshëm i Certifikuar- CIA (Certified Internal Auditor) për të marrë këtë certifikim. Ky trajnim u organizua nga Qendra për Auditim dhe Menaxhim.

Qeveria e Jemenit realizoi një Projekt Modernizimi për financat publike duke synuar rritjen e kompetencave dhe njohurive të SAI-t të Jemenit lidhur me Sistemin e Kontabilitetit dhe Menaxhimit Financiar (AFMIS). Ky projekt përfshiu dhe Trajnimin e Trajnerëve – ToT dhe program trajnimi të veçantë për AFMIS i cili u fokusua mbi edukimin dhe kompetencat e trajnerëve. Ne trajnimin që u organizua nga 19-20 gusht 2011, morën pjesë 67 trajnerë nga departamente të ndryshëm të SAI-t të Jemenit.



Qendra e trajnimit të SAI-t të Jemenit u modernizua nga pajisja me kompjuterë të rinj në Shtator 2011.

Si pjesë e Projektit të Qeverisjes së Përgjegjshme ( RGP), u krye një sondazh me qëllim që të vlerësoheshin kërkesat e SAI-t të Jemenit. Pyetësi iu përcoll Kryetarit të Jemenit dhe të gjithë departamenteve të tij më kërkesën për t'u plotësuar prej tyre.



## EXPERIENTIA MUTUA OMNIBUS PRODEST

Dy përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme për Teknologjinë e Informacionit të SAI-t të Jemenit morën pjesë në një workshop njëditor mbi sistemet e TI, i cili u organizua me rastin e Projektit të Qeverisjes së Përgjegjshme dhe u financua nga Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtare Shteteve të Bashkuara ( USAID)

Ish presidenti Abdullah Abdullah Al-Sanafi dhe Drejtori i Përgjithshëm për bashkëpunim teknik Ahmed K. Ashaybani, të SAI-t të Jemenit me Sekretarin e Përgjithshëm të INTOSAI, Josef Moser, në takimin e task forcës për Strategjinë e Komunikimit të INTOSAI-t në Vjenë, Austri, 2010




## ***INTOSAI NË TË DHËNA DHE FAKTE***

### ***NGA EKSPERIENCA E PËRBASHKËT PËRFITOJNË TË GJITHË***

#### ***INTOSAI NË NJË VËSHTRIM***

#### **INTOSAI NË NJË VËSHTRIM**

#### **KRYETARËT E INTOSAI**



INTOSAI Sekretaret e Pergjithshem Kryetaret e INTOSAI	1968-1980: Jorg Kandutch eshte Sekretari i Pergjithshem i INTOSAI															1980-1992: Tassilio Broesigke eshte Sekretari i Pergjithshem i INTOSAI																																																																										
	1968-1971: Takashi Yamazaki eshte Kryetari i INTOSAI					1971-1973: Andrew Maxwell Henderson eshte Kryetari i INTOSAI					1973-1974:James J.Macdonell eshte Kryetari i INTOSAI					1974-1977: Servando Fernandez-Victorio y Camps eshte Kryetari i INTOSAI					1977-1980:Luis Montoya eshte Kryetari i INTOSAI					1980-1983: David Gico Njoroge eshte Kryetari i INTOSAI					1983-1986: Francisco S.Tantuico, Jr eshte Kryetari i INTOSAI																																																											
Kongreset e INTOSAI	VI INCOSAI Tokio, Japoni 58 SAI dhe 11 Vëzhguesit 4 tema Kongresi: ●Metodat dhe Procedurat e Auditimit Suprem ●Metoda e Raportimitit per tu perdorur nga Institucionet Supreme te Auditimit ●Auditimi Suprem dhe Njohurite Teknike ●Auditimi Suprem në Çmimin e Kontratës Publike					VII INCOSAI Montreal, Kanada 72 SAI 4 tema Kongresi: ●Stafi i auditimit - Përzgjedhja e tij dhe Trajnimi ●Përpunimi i të dhënave elektronike dhe ndihma të tjera teknike ●Auditimi Menaxherial ose Operacional ●Zbatimi i Rekomandimeve te bera nga një Institucion suprem Auditimi					VIII INCOSAI Madrid, Spanjë 90 SAI dhe 4 Vëzhgues 4 temat e Kongresit, e.g .: ●Institucionet Supreme të Auditimit dhe Kontrolli i Brendshëm Institucional ●Problemet themelore në Auditimin e Qeverise me Konsideratë të veçant për Rekomandimet përkatëse të miratuara nga Kongreset INTOSAI					IX INCOSAI Lima, Peru 95 SAI 4 temat e Kongresit, e.g .: ●Deklarata e Limes per Udhëzimet mbi normat e auditimit ●Auditimit i Shëndetit Publik dhe Agjencitë e Mbrojtjes se Mjedisit					X INCOSAI Nairobi, Kenya 92 SAI dhe 3 Vëzhguesit 4 temat e Kongresit, e.g .: ●Zbatimi i sistemeve kompjuterike në Kontabilitetin buxhetor dhe Kontrollin Financiar me vëmendje për të dhënat e regjistruara në imazhin e transportuesit ●Problemet e përshtatjes dhe zbatimit te Teknikave moderne te auditimit në Vendet në zhvillim					XI INCOSAI Manila, Filippine 85 SAI dhe 8 Vëzhgues 4 tema Kongresi: ●Trajnimi i Audituesve të Shtetit ●Auditimi i Shërbimeve Sociale ●Metodat dhe Procedurat e Auditimit për të arritur objektivat e auditimit ●Teknikat efektive të auditimit																																																																
Takimet e Bordit Drejtues te INTOSAI	Takimi i 3 dhe 4 i Bordit Drejtues Intosai ne Tokipo, Japoni			Takimi i 5-të i Bordit Drejtues në Vjenë, Austria			Takimi i 6-të i Bordit Drejtues INTOSAI në Vjenë, Austria			Mbledhja e 7-të dhe 8-të e Bordit Drejtues INTOSAI në Montreal, Kanada			Takimi i 9-të i Bordit Drejtues INTOSAI në Villach, Austria			Takimi i 10-të i Bordit Drejtues INTOSAI në Vjenë, Austria			Mbledhja e 11-të dhe 12-të e Bordit Drejtues INTOSAI në Madrid, Spanje			Takimi i 14-të i Bordit Drejtues INTOSAI në Lima, Peru			Takimi i 15-të i Bordit Drejtues INTOSAI në Vjenë, Austria			Takimi i 18-të i Bordit Drejtues INTOSAI në Vjenë,Austria			Takimi i 19-të i Bordit Drejtues INTOSAI ne Nairobi, Kenia			Mbledhja e 20-të dhe 21-të e Bordit Drejtues INTOSAI në Nairobi, Kenia			Takimi i 22-të i Bordit Drejtues INTOSAI në Vjenë,Austria			Takimi i 23-të i Bordit Drejtues INTOSAI në Manila, Filippine			Mbledhja e 24-të dhe 25-të e Bordit Drejtues INTOSAI në Manila,Filippine			Takimi i 26-të i Bordit Drejtues INTOSAI në Innsbruk,Austri			Takimi i 27-të i Bordit Drejtues INTOSAI në Sidnej, Australi																																									
Viti	1968					1969					1970					1971					1972					1973					1974					1975					1976					1977					1978					1979					1980					1981					1982					1983					1984					1985				
